STUDIMI MBI MUNDËSITË E AVANCIMIT TË MËSIMDHËNIES DHE MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE NË KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

BEOGRAD, 2014

Emri i publikimit

Studimi mbi mundësitë e avancimit të mësimdhënies dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Botuesi

Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë
për Komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Editoret

Natasha Boshkoviq, Danijella Nenadiq, Millica Rodiq, Jellena Marjanoviq

Lektura/korektura

Millan Ajxanoviq

Recenzimi

Ana Llukoviq

Përkthimi dhe lektura

Event Group d.o.o., Beograd

Përgatitja teknike

Perollo d.o.o., Beograd

Studimi mbi mundësitë e avancimit të mësimdhënies dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Të gjitha termet të cilat gjatë studimit janë përdorur në gjininë mashkullore gramatikore
përfshijnë gjininë femërore dhe mashkullore të personave për të cilët bëhet fjalë

Përmbajtja

PËRMBLEDHJA 5

HYRJA 9

I. KONTEKSTI– KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË 17

II. KORNIZA LEGJISLATIVE DHE KONCEPTUALE 21

II.1. KORNIZA KONCEPTUALE – RËNDËSIA E GJUHËS NË INTEGRIMIN E SHOQËRIVE TË NDRYSHME 21

II.2. PASQYRA E LEGJISLACIONIT NË REPUBLIKËN E SERBISË NË FUSHËN E MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE 29

III. ANALIZA E GJENDJES, PROBLEMEVE DHE REZULTATEVE TË MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE NË SHKOLLAT FILLORE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË 41

III.1. KORNIZA METODOLOGJIKE DHE PËRSHKRIMI I STUDIMIT 41

III.2. ANALIZA E PLANIT DHE PROGRAMIT MËSIMOR PËR GJUHËN SERBE SI GJUHË JOAMTARE PËR SHKOLLËN FILLORE 51

III.2.1. Pasqyrë e historisë së mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe programit për këtë lëndë 51

III.2.2. Gjuha serbe si gjuhë joamtare në planin mësimor të arsimit dhe edukimit fillor sot 54

III.2.3. Pasqyra dhe komenti i mendimit të arsimtarëve për planin dhe programin mësimor për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare 64

III.2.4. Vërejtjet për programin e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare 67

III.3. MËNYRA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT NË SHKOLLAT FILLORE NË KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË 71

III.3.1. Përshkrimi i gjendjes aktuale 72

III.3.2. Analiza e përgjigjeve nga pyetësori për arsimtar 76

III.3.3. Pajisja profesionale e arsimtarit 87

III.3.4. Analiza e përgjigjeve nga pyetësori për nxënës 88

III.3.5. Vërejtjet përmbledhëse për rezultatet e përgjigjeve të nxënësve 99

III.4. ANALIZA E TEKSTEVE MËSIMORE PËR GJUHËN SERBE SI GJUHË JOAMTARE PREJ KLASËS I DERI VIII TË SHKOLLËS FILLORE 103

III.4.1. Pasqyra e strukturës dhe përmbajtjes së teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare prej klasës I deri IV të shkollës fillore 103

III.4.2. Vështrimi i strukturës dhe përmbajtjes së teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare prej klasës V deri VIII të shkollës fillore 118

III.4.3. Përdorimi i teksteve mësimore në mësimin e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës 128
III.5. ANALIZA E REZULTATEVE TË TESTIMIT 131
III.5.1. Testimi 131
III.5.2. Struktura e testit 132
III.5.3. Përmbajtja e testit 133
III.5.4. Analiza e rezultateve të testit 139
III.5.5. Konkluzioni 159

IV. QËNDRIMET, MENDIMET DHE NEVOJAT E PALËVE TË INTERESUARA NË LIDHJE ME MËSIMIN E GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE 161
IV.1. QËNDRIMET E DEPUTETIT POPULLOR NGA KOMUNITETI SHQIPTAR, KRYETARIT TË KOMUNËS SË PRESHEVËS, BUJANOCIT DHE MEDVEGJËS DHE KRYETARIT TË KNPNSH 161
IV.2. MENDIMI I KËSHILLTARIT ARSIMOR NGA ADMINISTRATA SHKOLLORE NË LESKOC 166
IV.3. QËNDRIMET E DREJTORËVE DHE DREJTORESHAVE NË 16 SHKOLLAT FILLORE NË TË CILAT MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN SHQIPE 167
IV.4. QËNDRIMET E PRINDËRVE TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE FILLORE MBI MËSIMIN E GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE 170
IV.5. QËNDRIMET DHE MENDIMET E NXËNËSVE 172
IV.6. QËNDRIMET E MEDIAVE LOKALE DHE SHOQËRISË CIVILE 174
IV.7. QËNDRIMET E PËRFAQËSUESVE TË ORGANEVE SHTETËRORE, ADMINISTRATËS KOMUNALE, SEKTORIT EKONOMIK DHE TË PUNËSUARVE 175

V. REKOMANDIMET PËR AVANCIMIN E MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE NË SHKOLLAT FILLORE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË 179

Shtojca 1 – Përvojat e projekteve të cilët kanë për qëllim arritjen dhe avancimin e njohjes së gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë dhe Bujanoc 189
Shtojca 2 – Vështrim tabelar i nxënësve sipas shkollave në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes 201
Shtojca 3 – Pyetësorët e shfrytëzuar përgjatë hulumtimit në terren në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes 211
RRETH AUTORËVE DHE AUTOREVE 253
RRETH BASHKËPUNËTORËVE DHE BASHKËPUNËTOREVE 257
BIBLIOGRAFIA 258

PËRMBLEDHJA

PËRMBLEDHJA

Qëllimi i këtij studimi është që vendimmarrësve dhe palëve të interesuara t'i ofrojë një seri të rezulateve të studimit dhe në këto t'i mbështesë rekomandimet për avancimin e arsimimit dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Çështjet kryesore të cilat janë përpunuar gjatë studimit përfshijnë analizën e situatës në fushën e arsimimit dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në tri komunat e lartëpërmendura në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe, si dhe problemet dhe sfidat me të cilat ballafqohen aktorët e ndryshëm në procesin e mësimit të gjuhës serbe dhe/ose sigurimi i kualitetit të mësimit për këtë lëndë. Në bazë të analizës së gjendjes, problemeve dhe mundësive janë definuar rekomandimet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjate për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në tri komunat në jug të Serbisë. Në këtë përmbledhje janë bartur rezultatet kryesore të studimit, të cilat janë përpunuar në mënyrë të detajuar në tekstin e Studimit.

Nevoja për hartimin e këtij studimi është paraqitur pasi që gjatë viteve të fundit, në raportet dhe në bazë të përvojave të institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe të organizatave ndërkombëtare – shumë shpesh janë krijuar përshtypjet të cilat kanë të bëjnë me njohuritë e pamjaftueshme të gjuhës serbe në mesin e pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës nacionale shqiptare të cilët jetojnë në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Në kapitullin e I është dhënë konteksti për tri komunat me theks në arsimimin dhe mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Prezantimi i kontekstit për tri komunat është i rëndësishëm për t'i kuptuar arsyet për hartimin e Studimit, si dhe shqyrtimin e mundësive konkrete të avancimit të arsimimit dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në ato mjedise, duke marrë parasysh specifikat lokale. Presheva, Bujanoci dhe Medvegja janë komuna në jug të Serbisë të cilat i karakterizon heterogjeniteti etnik i përbërjes së popullsisë.

Roli integrues i gjuhës në shoqëritë e ndryshme ka shërbyer si bazë fillestare për t'u marrë me çështjen e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Korniza konceptuale e Studimit, e treguar në kapitullin II, qëndron në tërësinë e standardeve dhe normave ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave, para së gjithash të atyre të cilat kanë të bëjnë me integrimin e shoqërive të ndryshme. Një nga qëllimet e Studimit është që të ofrojë pasqyrën e dokumentuar për nivelin e njohurive dhe problemeve në kuptimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në tri komunat në jug të Serbisë në mënyrë që politika arsimore gjuhësore, si pjesë e

politikës integruese, të zhvillohet drejt nxitjes së integrimit, duke respektuar në mënyrë të plotë diversitetet e të gjitha identiteteve, duke përfshirë edhe atë gjuhësor.

Ligjet dhe rregullat në fuqi me të cilët në Republikën e Serbisë janë rregulluar të drejtat e pakicave nacionale, para se gjithash fusha e arsimimit të pjesëtarëve të pakicave nacionale në gjuhën amtare, paraqesin kornizën në përputhje me të cilën janë paraqitur rekomandimet për avancimin e arsimimit dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat në jug të Serbisë në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Pasqyra e kornizës legjislative është dhënë në kapitullin II.

Pjesa qendrore e studimit iu është dedikuar aspektit pedagogjik të arsimimit dhe mësimit dhe është paraqitur në kapitullin më voluminoz – III. Në të njëjtin kapitull në mënyrë të detajuar është përshkruar metodologjia e studimit. Për nevojat e këtij studimi janë përpiluar teste për verifikimin e njohurive të gjuhës serbe si gjuhë joamtare për nxënësit e klasës së IV dhe klasës së VIII të cilët janë përdorur në 16 shkolla fillore. Përveç kësaj, është vëzhguar edhe mësimi i lëndës së gjuhës serbe si gjuhë joamtare në klasët e ulëta dhe të larta. Është analizuar Plani mësimor dhe programi për lëndën e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, si dhe tekstet mësimore dhe manualet ekzistuese për arsimtarët, të cilat i ka lejuar Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit dhe Këshilli nacional për arsim për mësimin e kësaj lënde. Kapitulli III përmban edhe analizën e mënyrës së realizimit të Programit mësimor, si dhe analizën e nevojave dhe opinioneve të arsimtarëve dhe nxënësve në lidhje me të mësuarit dhe mësimin.

Rezultati kryesor i studimit është se mësimi i lëndës së gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe njohuritë e nxënësve në shkollat fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë– nuk janë në nivel të mjaftueshëm. Problemi kryesor që është vërejtur është se nxënësit nuk munden të zhvillojnë komunikim spontan në gjuhën serbe.

Sipas rezultateve të studimit, padyshim që situata të cilën e kemi vërejtur në terren duhet të avancohet, me ç'rast disa prej masave mund të përfshihen për përpilimin e materialit mësimor më bashkëkohor, si dhe të sigurohen komplete të caktuara të teksteve ekzistuese të cilët për momentin nuk janë në përdorim në mësimin e klasëve të larta. Në lidhje me tekstet mësimore – siç është, fundja, rasti edhe me bashkësitë e tjera etnike – edhe te ajo shqiptare është domosdoshmëri që prezenca e saj të bëhet më e dukshme si në tekste mësimore ashtu edhe në mjetet tjera mësimore.

Trajnimi i arsimtarëve për zhvillimin e kësaj lënde është parakusht themelor për avancimin e mësimit

dhe arritjes së rezultatit më të mirë për nxënësit në zotërimin e gjuhës serbe. Padyshim se arsimtarëve në zhvillimin e mësimit iu nevojitet ndihma e asistentëve/bashkëpunëtorëve, para së gjithash e atyre të cilët e kanë gjuhën serbe gjuhë amtare dhe të cilët janë të kualifikuar që të ofrojnë këtë lloj ndihme.

Kujdes i posaçëm duhet ti kushtohet përpjekjeve që nxënësit gjuhën serbe ta përdorin edhe jashtë mësonjtoreve, që mund të arrihet qoftë me organizimin e ekskurzioneve të ndryshme nëpër Republikën e Serbisë qoftë me stimulimin e kontakteve në aktivitete e përbashkët me folësit burimor lokal të gjuhës serbe.

Me qëllim të vështrimit gjithëpërfshirës të aspekteve të ndryshme të çështjes së mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare, janë konsultuar të gjithë personat relevant– deputeti popullor në Parlamentin e Republikës së Serbisë nga bashkësia shqiptare, kryetarët e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, kryetari i KNPNSH, këshilltari i arsimit kompetent për rrethin e Pçinjës dhe të Jabllanicës, drejtorët dhe drejtoreshat e 16 shkollave fillore në tri komunat në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe, arsimtarët dhe arsimtaret të cilët/at në këto shkolla ligjërojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare, nxënësit, prindërit e tyre, përfaqësuesit e mediave lokale dhe shoqërisë civile, përfaqësuesit e organeve shtetërore në Bujanoc dhe Preshevë, përfaqësuesit e administratës komunale dhe të sektorit ekonomik. Qëndrimet, opinionet dhe nevojat e tyre janë dhënë në kapitullin IV.

Kur bëhet fjalë për nevojat në lidhje me mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, sipas mendimit të të gjithë bashkëbiseduesve të lartëpërmendur nevojitet të përmirësohet kualiteti i mjeteve mësimore, të realizohen trajnime të cilat iu dedikohen arsimtarëve të cilët ligjërojnë gjuhën joamtare, respektivisht, t'iu mundësohet arsimtarëve trajnim i vazhdueshëm profesional nga lëmia e teknikës së mësimit dhe shfrytëzimit të mjeteve mësimore bashkëkohore, të stimulohet kontakti direkt i nxënësve me gjuhën dhe të shfrytëzohet socializimi me moshatarët për ta mësuar gjuhën.

Në të tri komunat nxënësit e të gjitha klasëve konsiderojnë që njohja e gjuhës serbe mund t'i shërbejë në të ardhmen, si për arsye formale (shkollimi, punësimi në institucionet publike ose në ushtrimin e punëve të përditshme) ashtu edhe për komunikim të përditshëm.

Pa përjashtim, të gjithë prindërit e intervistuar konsiderojnë se është me rëndësi që nxënësit në shkollë ta mësojnë gjuhën serbe sepse besojnë se fëmijët që jetojnë në Serbi, përveç asaj që është e domosdoshme ta njohin gjuhën zyrtare të shtetit, gjuhën serbe duhet ta njohin për të komunikuar pa vështirësi në mjedisin multietnik, si mjedisi i tyre, të socializohen dhe të kuptohen me moshatarët e tyre. Prindërit

konsiderojnë se përveç angazhimit të asistentëve edhe shfrytëzimi i audio dhe video materialeve në mësim, stimulimi i socilaizimit të fëmijëve të përkatësive të ndryshme nacionale edhe organizimi i orëve të përbashkëta dhe aktiviteteve sportive dhe aktiviteteve tjera të përbashkëta– sigurisht se do të japë rezultate të mira.

Studimi ka përfshirë edhe shembuj nga përvoja e realizimit të projekteve në komunat Bujanoc dhe Preshevë qëllimi i të cilëve ka qenë fitimi dhe avancimi i njohurive të gjuhës serbe (Shtojca 1), ndërsa leksionet e mësuara nga këto përvoja janë marrë parasysh gjatë definimit të rekomandimeve.

Me përpilimin e këtij studimi janë identifikuar më shumë mundësi për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamatare në shkollat fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Ato mund të realizohen përmes zbatimit të një varg rekomandimesh afatshurtëra, afatmesme dhe afatgjata, të cilat janë paraqitur në kapitullin V. Është me rëndësi që të gjitha palët e interesuara të jenë pjesëmarrëse në marrjen e masave të nevojshme–institucionet kompetente për çështjet e arsimit (Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, Enti për avancimin e arsmimit dhe edukimit, Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimimit dhe edukimit), Shërbimi i Trupit koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, organet e vetqeverisjes lokale, shkollat, arsimtarët, mediat lokale dhe shoqëria civile, prindërit dhe nxënësit. Marrja e disa masave të propozura mund të fillojë qysh gjatë vitit shkollor 2014/2015.

HYRJA

HYRJA

Dokumenti i cili gjendet para jush ju prezanton analizën e gjendjes dhe rekomandimet për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe. Në kuadër të ligjeve dhe rregullave relevante në fuqi në fushën e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në sistemin e shkollimit fillor, dhe standardeve ndërkombëtare të integrimit të bashkësive të ndryshme me fokus në rolin dhe rëndësin e njohjes së gjuhës zyrtare, rezultatet e studimit empirik janë përmbledhur në mënyrë që të ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për situatën dhe problemet në shkollat fillore në tri komunat në jug të Serbisë, dhe t'i argumentojnë rekomandimet e masave për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe.

Duke pasur parasysh faktin se përdorimi i gjuhës së përbashkët është çështje që shtrihet në të gjitha dimensionet e jetës shoqërore dhe në integrimet shoqërore, si dhe atë që për krijimin e politikave publike të suksesshme nevojitet që ato të mbështetën në fakte, me përpilimin e këtij studimi është caktuar detyra që të ofrohet kontributi për zbatimin e përgjegjshëm të politikës së integrimeve shoqërore me qëllim të krijimit të shoqërisë kohezive. Me përpilimin e këtij studimi është bërë përpjekje që një varg i njohurive të fragmentuara dhe jozyrtare të verifikohen dhe të organizohen në mënyrën e cila iu mundëson kreatorëve të politikave publike, vendimmarrësve dhe institucioneve relevante t'i shfrytëzojnë rezultatet e studimit dhe rekomandimet e bazuara në të, nga ekspertët me qëllim që t'iu mundësohet pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës nacionale shqiptare që në tërësi të inkuadrohen në rrjedhat shoqërore, politike dhe ekonomike në Republikën e Serbisë.

Informacionet për njohjen e dobët të gjuhës serbe ndër pjesëtarët dhe pjesëtaret e pakicës nacionale shqiptare vijnë nga shoqëria civile, institucionet, ekspertët, pjesëmarrësit e iniciativave të ndryshme, programeve dhe projekteve të cilat realizohen me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, si dhe nga individët nga bashkësia shqiptare. Niveli i pamjaftueshëm i njohjes së gjuhës zyrtare të Republikës së Serbisë vihet në lidhje direkte me mundësitë më të zvogëluara që pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare t'i shfrytëzojnë mundësitë në lidhje me arsimimin në gjhën zyrtare të Republikës së Serbisë, që të paraqiten në konkurset për punësim (posaçërisht në administratën shtetërore), që të përfshihen në masë më të madhe në procesin e vendimmarrjes, të komunikojnë dhe t'i shkëmbejnë qëndrimet dhe mendimet dhe të marrin pjesë në dialog me pjesëtarët e pakicave tjera nacionale dhe popullsisë shumicë, t'i përcjellin programet formale dhe joformale të trajnimit dhe përsosjes etj.

Nevoja për përpilimin e këtij studimi është paraqitur pasi që gjatë disa viteve të fundit, në raporte dhe në

bazë të përvojave të institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe të organizatave ndërkombëtare – gjithnjë e më shumë është hasur në njohuritë të cilat kanë të bëjnë me njohjen e pamjaftueshme të gjuhës serbe ndër pjesëtarët dhe pjesëtaret e pakicës nacionale shqiptare të cilët jetojnë në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Për zgjidhjen sistematike të cilit do problem të indentifikuar nevojitet së pari analiza profesionale nga e cila pasojnë politikat publike të definuara në mënyrë të qartë. Analiza ka për qëllim të tregojë për problemet, t'i identifikojë personat kryesor, ta shqyrtojë kornizën legjislative, të kontribuojë në vendosjen e dialogut dhe në krijimin e konsenzusit për zgjidhjet më të mira, të rekomandojë zgjidhje dhe të tregojë për afatet në të cilat është e mundur të realizohet ndryshimi.

Politikat publike do të jenë të suksesshme vetëm nëse vijnë nga bashkësia me të cilën ka të bëjë ndryshimi. Ky është kushti i parë. Kushti i dytë është që nevojën për ndryshim ta njohin institucionet të cilat duhet që ta zbatojnë në pjesën më të madhe. Kushti i tretë është që të ekzistojë mbështetja e gjerë për këtë ndryshim, prej përfaqësuesve të pushteteve lokale, organizatave të shoqërisë civile deri te bashkësia ndërkombëtare, e cila shumë herë e ka identifikuar rëndësinë e iniciativave të këtilla për mirëqenien e bashkësive të cilat jetojnë në jug të Serbisë.

Jemi të bindur se në rastin e Studimit i cili gjendet përpara jush – janë plotësuar të gjitha kushtet. Për Trupin koordinues çështja e integrimit dhe puna me të rinjtë, posaçërisht arsimimi formal dhe joformal, janë prioritet prej vitit 2008. Prandaj janë zhvilluar shumë programe: bursa për nxënësit e shkollës së mesme; bursa për studime në Universitetin e Novi Sadit; mbështetja e Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare (KNPNSH) në sigurimin e teksteve në gjuhën shqipe në përputhje me ligjet e Republikës së Serbisë; mbështetja e organizatave të shoqërisë civile për projektet në fushën e arsimimit. Sigurimi i përfaqësimit më të madhë të shqiptarëve dhe shqiptarëve në institucionet e Republikës së Serbisë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjën ose për pjesët tjera të Republikës së Serbisë, është njëri nga prioritetet e përmendura. Një nga problemet në realizimin e programeve të këtilla është njohja e pamjaftueshme e gjuhës serbe tek pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare edhe atë posaçërisht tek gjeneratat e reja.

Së pari organizatat e shoqërisë civile kanë filluar të zhvillojnë projekte për mësimin e gjuhës serbe. Në muajin mars të vitit 2011, në konkursin e Shërbimit të Trupit koordinues për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dy organizata kanë kandiduar projekte të cilat kanë pasur për qëllim mësimin e gjuhës serbe për pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare.[1] Në arsyetimin e projekteve është theksuar se „nevo-

1 Fjala është për organizatat „International Human Center" nga Presheva me projektin „Kursi i gjuhës serbe" dhe „Centar za toleranciju i integraciju juga Srbije" me projektin „Me edukim drejt integrimit".

jitet të sigurohen kushte për përsosje shtesë të punësuarve, rinisë dhe të tjerëve për njohjen e gjuhës serbe në mënyrë që të mos kenë probleme në të folurit dhe në të shkruarit në gjuhën serbe respektivisht në gjuhën shtetërore“ dhe „që të rinjët shqiptar nga jugu i Serbisë për shkak të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës serbe të studiojnë në Tiranë, Shkup, Tetovë ose Prishtinë dhe pikërisht për shkak të kësaj nuk kanë mundësi të studiojnë në universitetet në Serbi, prandaj mosnjohja e gjuhës serbe paraqet pengesë për punësimin e tyre“. Të dy projektet e kanë fituar financimin, ndërsa janë paraqitur më shumë të interesuar se sa që është paraparë me projekte. Shërbimi i trupit koordinues ka organizuar edhe disa aktivitete të tjera *ad hoc* në bazë të kërkesave të cilat kanë ardhur nga bashkësia shqiptare, siç janë kurset e gjuhës serbe për studentët nga Presheva dhe Bujanoci të cilët kanë regjistruar fakultete në Universitetin e Novi Sadit, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Serbi dhe Zyrën e komesariatit të lartë për pakicat nacionale janë organizuar kurse të gjuhës serbe për studentët e departamentit të Fakultetit ekonomik në Bujanoc, dhe kurse për kandidatët e përzgjedhur të Qendrës për trajnimin policor themelor.

Shërbimi i trupit koordinues e ka inicuar projektin „Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë nga bashkësia shqiptare nga komunat e Bujanocit dhe Preshevës“.[2] Një falënderim të madhë ia kemi borxh Ambasadës së Britanisë së Madhe, e cila, si edhe shumë herë më parë, e ka njohur rëndësinë e iniciativës. Misioni i OSBE-së në Serbi gjithashtu e ka njohur rëndësinë e përmirësimit të kualitetit të mësimit të gjuhës serbe për pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare, dhe me sukses e ka realizuar projektin „Avancimi i aftësive gjuhësore të popullsisë pakicë në jug të Serbisë“.[3] Përkujtojmë se edhe orgaizatat e tjera ndërkombëtare e kanë kuptuar rëndësinë e avancimit të mësimit të gjuhës serbe në bashkësinë shqiptare. Një falënderim të madhë ia kemi borxh Delegacionit të unionit evropian dhe projektit Progresi evropian, të cilët e kanë radhitur avancimin e kualitetit të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë në aktivitetet e planifikuara në tri vitet e ardhshme.

Evaluimet e projekteve dhe programeve konfirmojnë se është fjala për masa shumë të suksesshme të cilat japin rezultate të mira. Megjithkëtë, duke marrë parasysh faktin se ato mund të përfshijnë vetëm numër të kufizuar të pjesëmarrësve, si dhe faktin që janë relativisht të shtrenjtë dhe zgjasin shkurtë, iniciativat e këtilla afashkurtëra nuk mund t’i përgjigjen nevojave të avancimit sistematik të njohjes së gjuhës serbe. Përvec kësaj, duke pasur parasysh se nevojat e bashkësisë shqipëtare në lidhje me mësimin e gjuhës shqipe janë në rritje, është treguar nevoja e qartë për shqyrtimin e mundësive për zbatimin e zgjidhjeve sistemore.

2 Për projektin „Shkolla e gjuhës serbe“ në mënyrë të detajizuar në Shtojcën 1 „Përvojat e projekteve qëllimi i të cilëve ka qenë arritja dhe avancimi i njohurive të gjuhës serbe në komunat Preshevë dhe Bujanoc“.

3 Për projektin „Avancimi i aftësive gjuhësore të popullsisë pakicë në jug të Serbisë“ në mënyrë të detajizuar në Shtojcën 1 „Përvojat e projekteve qëllimi i të cilëve ka qenë arritja dhe avancimi i njohurive të gjuhës serbe në komunat Preshevë dhe Bujanoc“.

Zgjidhja e problemit fillon në vendin në të cilin fëmijët për herë të parë ballafaqohen me mësimin sistemor të gjuhës serbe – në shkollën fillore. Duke pasur parasysh faktin se gjuha serbe si gjuhë joamtare mësohet prej klasë së I të shkollës fillore, deri në fund të arsimit të mesëm, ka qenë e domosdoshme të shqyrtohet situata në shkollat follore në tri komunat në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe dhe të përgjigjemi në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me nivelin e njohurive të nxënësve dhe të nxënëseve, kualitetin e mësimit dhe kualitetin e kuadrit arsimor, si dhe qëndrimet, opinionet dhe nevojat e palëve të interesuara në lidhje me mësimin në gjuhën serbe si gjuhë joamtare, para së gjithash të drejtorëve të shkollave, prindërve dhe vet nxënësve.

Duke pasur parasysh tërë ato që u përmendën më lartë, jemi përcaktuar për punë serioze, të vështirë dhe sfiduese për përpilimin e këtij studimi. Mbështetjen për përpilimin e Studimit, si edhe herën e kaluar, e kemi marrë nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Zyra e Komesarit të lartë për pakicat nacionale. Të përmendim edhe këtë se Zyra e Komesarit të lartë për pakicat nacionale ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e përpilimit dhe realizimit të projektit, si dhe me propozimet dhe aktivitetet ka kontribuar shumë në përpilimin e Studimit.

Tani më kur i kemi prezantuar argumentet për përpilimin e Studimit, është koha të themi disa fjalë për aktorët kryesor. Për procesin arsimor në Republikën e Serbisë është kompetente Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik. Ministria jo vetëm që i ka njohur iniciativat e dhëna por edhe i ka mbështëtur në mënyrë të fuqishme dhe i ka kontribuar suksesit të aktiviteteve të lartëpërmendura. Për secilën fazë të studimit Ministria ka qenë e informuar dhe ka dhënë mbështetjen dhe rekomandimet profesionale të cilat janë të rëndësishme për studimin. Me Ministrinë jemi marrë vesh për formimin e trupit punues në përbërjen e të cilit kanë hyrë: përfaqësuesit e Entit për avancimin e arsimimit dhe edukimit, përfaqësuesit e Entit për vlerësimin e kualitetit të arsimimit dhe edukimit, përfaqësuesit e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, KNPNSH, dhe ekspertët nga Universiteti i Novi Sadit dhe Beogradit dhe hulumtuesit. Trupi punues ka pasur për qëllim t'i vendosë kahjet e studimit, por më e rëndësishme ka qenë të sigurohet përfaqësimi i të gjithë aktorëve kryesor.

Për ta fituar pasqyrën e dokumentuar për njohuritë, kuadrin mësimor, kushtet e punës, problemet dhe zgjidhjet e mundshme – është dizajnuar metodologjia përkatëse për hulumtimin në terren. Ekipi hulumtues, edhe përveç kësaj, kujdes të posaçëm i ka kushtuar qëndrimeve të deputetëve popullor nga bashkësia shqiptare, kryetarëve të secilës nga tri komunat dhe kryetarit të KNPNSH, këshilltarit të arsimit të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik nga bashkësia shqiptare, si dhe të organizatave lokale të shoqërisë civile, mediave dhe përfaqësuesve të sektorit ekonomik dhe përfaqësuesve të administratës komunale dhe shtetërore. Shumë të dobishme kanë qenë edhe njohuritë për përvojat e pjesëmarrësve dhe pjesëmarrëseve të dy projekteve të rëndësishme – „Shkolla e gjuhës serbe", të cilin e

implementon Shërbimi i Trupit koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë në komunat Bujanoc dhe Preshevë, dhe projektit „Avancimi i aftësive gjuhësore të popullsisë pakicë në jug të Serbisë“, të cilin e implementon Misioni i OSBE-së në Serbi në Shkollën e mesme „Sezai Suroi“ në Bujanoc.

Gjatë disa viteve të fundit për shkak të nevojës për avancimin e bashkëpunimit në procesin e integrimit shoqëror dhe të gjitha përpjekjeve sistematike drejt ndërtimit të besimit të sërishëm, motivimi për mësimin e gjuhës serbe ndër pjesëtarët dhe pjesëtaret e pakicës nacionale shqiptare është gjithnjë e më shumë prezent. Nga bisedat me liderët politik të pakicës nacionale shqiptare mund të konkludohet se ekziston vetëdija e shprehur për ekzistimin e problemit të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës serbe në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Deputeti popullor, kryetarët e komunave Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, kryetari i KNPNSH e kanë vlerësuar si jo të kënaqshëm nivelin e njohjes së gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe kualitetin e mësimit në shkollat fillore në të tri komunat. Është vendosur bashkëpunim i shkëlqyeshëm me të gjithë aktorët lokal me të cilët ekipi hulumtues ka pasur rast të takohet gjatë hulumtimit në terren, duke filluar nga kryetarët e komunave dhe kryetari i KNPNSH, të cilët kanë deleguar përfaqësuesit e vet për nevojat e hulumtimit në terren, deri te drejtorët e shkollave dhe zëvendësit dhe bashkëpunëtorët, të cilët për anëtarët e ekipit hulumtues i kanë hapur dyert e 16 shkollave në të tri komunat. Qëndrimet dhe përvojat e arsimtarëve dhe profesorëve të cilët e ligjërojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare për nxënësit e bashkësisë shqiptare kanë qenë shumë të rëndësishëm për shqyrtimin e të gjitha aspekteve kryesore të kësaj çështje.

Në fund të kësaj pjese shtojmë edhe disa argumente për të cilat Trupi koordinues ka vendosur ta përpilojë këtë Studim. Çështja e njohjes së gjuhës serbe është relevante për të gjitha pakicat nacionale të cilat jetojnë në Republikën e Serbisë, posaçërisht kur është fjala për rolin integrativ të gjuhës në mjediset homogjene etnike. Problemi i njohjes së pamjaftueshme të gjuhës serbe nuk është karakteristikë vetëm për pakicën nacionale shqiptare, por me këtë çështje ballafaqohen edhe përfaqësuesit e pakicave tjera nacionale të cilat jetojnë në mjedise homogjene gjuhësore, ose ata, gjuha amtare e të cilëve dallon dukshëm nga gjuha serbe. Kjo është konfirmuar edhe në bisedat me përfaqësuesit e Sekretariatit krahinor për arsim, adminisratë dhe bashkësitë etnike të KA Vojvodinës, si dhe me përfaqësuesit e këshillave nacionale të pakicave nacionale të hungarezëve dhe sllovakëve. Analiza e të dhënave të fituara në hulumtimin intern[4] të cilën në vitin 2006 e ka realizuar Enti pedagogjik i Vojvodinës në shkollat në të cilat zhvillohet

4 Në hulumtimin i cili është realizuar në shkollat në Vojvodinë si problem më i madh në arsim është theksuar zhvillimi i pamjaftueshëm i kompetencave të komunikimit dhe mungesa e mjeteve mësimore bashkëkohore, si dhe niveli i ndryshëm i njohurive të fëmijëve të cilët fillojnë klasën e I të shkollës fillore. Në përputhje me rezultatet e hulumtimeve relevante për përvetësimin e gjuhës Enti pedagogjik i Vojvodinës, gjithashtu, implementon projektin e kultivimit të gjuhës amtare dhe joamtare në entet parashkollore në Vojvodinë. (Biseda me Lenka Erdelj, drejtoreshë e Entit pedagogjik në Vojvodinë, 9. maj 2014).

mësimi në gjuhën e pakicës nacionale, ka treguar se 76% e nxënësve dhe e nxënëseve të këtyre shkollave ka problem me mësimin e gjuhës serbe. Këta janë para së gjithash nxënësit dhe nxënëset të cilët e kanë gjuhë amtare gjuhën hungareze, ndërsa jetojnë në mjediset homogjene gjuhësore në të cilët kontaktin me gjuhën serbe e kanë vetëm në shkollë. Nga ana tjetër, pjesëtarët e pakicave nacionale gjuha e të cilëve është më e përafërt me gjuhën serbe (p.sh. Sllovakët, Rusinët, Kroatët, Bunjevikët, Malazezët) ose të cilët jetojnë në mjediset gjuhësore të përziera ose në mjediset dygjuhësore (p.sh. Rumunët), nuk kanë problem me të mësuarit e gjuhës serbe. Njohuritë e tyre para se të regjistrohen në shkollën fillore janë shumë më të mëdha në krahasim me fëmijët të cilët nuk ballafaqohen me gjuhën në mjedisin ku jetojnë ose në atë ku gjuha amtare nuk është e përafërt me gjuhën serbe, respektivisht, i takon grupit tjetër të gjuhëve, siç është rasti me gjuhën hungareze dhe gjuhën shqipe. Duke pasur parasysh se Trupi koordinues ka kompetenca për tri komunat në jug të Serbisë, vëmendja ka qenë e orientuar vetëm në hulumtimin në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Duke pasur parasysh faktin se në Serbi deri më tani nuk janë zbatuar hulumtime gjithpërfshirëse për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare ndër pjesëtarët dhe pjesëtaret e pakicave nacionale, ky studim paraqet përpjekjen e parë që në mënyrë sistemore të hulumtohen problemet dhe mundësitë për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës nacionale. Qëllimi i ekipit hulumtues ka qenë pikërisht kjo që të tregohet në problemet dhe të mundësohet hapësira për aktivitete konkrete të mbështetura në studimin, dhe në bashkëpunim me aktorët kryesor të ofrohen zgjidhje me të cilat do të avancohet kualiteti i mësimit të gjuhës serbe në shkollat fillore në jug të Serbisë.

Rezultatet kryesore të këtij studimi konfirmojnë se njohja e gjuhës serbe ndër nxënësit të cilët e vijojnë shkollën fillore në gjuhën shqipe në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë është në nivel shumë të ulët. Analiza e situatës të atyre pak nxënësve të cilët flasin mirë në gjuhën serbe tregon se njohja e gjuhës serbe më së shpeshti nuk është fituar në shkolla dhe se ajo është në lidhje direkte me atë se në çfarë mase e përdorin gjuhën serbe ose e mësojnë jashtë shkollës (p.sh. kontakti me moshatarët, mediat). Problemet më të mëdha me të cilin ballafaqohen shkollat janë mungesa e kuadrit profesional për këtë lëndë dhe mungesa e mjeteve për trajnimin dhe përsosjen e vazhdueshme të kuadrit ekzistues, pastaj përdorimi i metodave të vjetra mësimore dhe mungesa e mjeteve mësimore bashkëkohore, si dhe mundësitë e kufizuara për organizimin e takimeve dhe socializimin e fëmijëve të cilët vijojnë shkollën në gjuhën serbe dhe fëmijëve të cilët vijojnë shkollën në gjuhën shqipe.

Studimin e përbëjnë pesë kapituj dhe një shtojcë. Në kapitullin I, krahas përshkrimit të shkurtër të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe karakteristikave të tyre në asspektin e arsimimit dhe gjuhës, është përshkruar edhe konteksti relevant për përpilimin dhe leximin e rezultateve të këtij studimi.

Instrumentet ndërkombëtare, standardet dhe parimet në fushën e të drejtave gjuhësore të pjesëtarëve të pakicave nacionale, si dhe udhëzimet dhe rekomandimet relevante në lidhje me integrimin e bashkësive të ndryshme, të cilët e përbëjnë kornizën konceptuale për përpilimin e këtij studimi, janë paraqiturr në kapitullin II. Në të njëjtin kapitull është dhënë edhe pasqyra e shkurtër e kornizës legjislative të Republikës së Serbisë në lidhje me rregullat me të cilat është rregulluar çështja e arsimimit të pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicave nacionale dhe mësimi i gjuhës serbe si gjuhë joamtare.

Analiza e rezultateve të hulumtimit empirik përbën pjesën kryesore të këtij studimi dhe është paraqitur në kapitullin më voluminoz, kapitullin III. Në fillim është prezantuar korniza metodologjike e hulumtimit, dhe pastaj seksionet të cilat kanë për qëllim të ofrojnë përgjigje në këto pyetje: Si duket procesi mësimor, në çfarë kushte zhvillohet dhe kush janë arsimtarët dhe arsimtaret të cilët e ligjërojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë? Në çfarë niveli është njohja e gjuhës serbe si gjuhë joamtare e nxënësve dhe e nxënëseve në shkollat fillore në tri komunat? Përveç përgjigjeve në këto pyetje, kapitulli qendror i këtij studimi përmban edhe analizën e Planit dhe programit mësimor për lëndën e gjuhës serbe si gjuhë joamtare për shkollën fillore, si dhe pasqyrën dhe analizën e teksteve mësimore për këtë lëndë.

Qëndrimet, opinionet dhe nevojat e palëve të interesuara në lidhje me mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare – janë paraqitur në kapitullin IV.

Duke u udhëhequr me kornizën e standardeve ndërkombëtare dhe rregullave vendore në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe duke shfrytëzuar rezultatet e hulumtimit të cilët për nevojat e këtij studimi janë zbatuar në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, autoret dhe autorët kanë formuluar një varg të rekomandimeve afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat filore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Rekomandimet janë prezantuar në kapitullin V.

Në shtojcën 1 janë paraqitur përvojat e projekteve tjerë të realizuar në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me qëllim të mësimit të gjuhës serbe.

Ekipin hulumtues e përbëjnë: Dushanka Zvekiq-Dushanoviq, profesoreshë inordinare në Fakultetin filozofik në Universitetin e Novi Sadit; Millan Ajxanoviq, docent në Fakultetin filozofik në Universitetin e Novi Sadit; Vesna Krajishnik, docente në Fakultetin filozofik në Univerzitetin e Beogradit dhe drejtoreshë e Qendrës për gjuhën serbe si gjuhë e huaj në Fakultetin filozofik në Universitetin e Beogradit; Nikica Strizhak, lektore në Qendrën për gjuhën serbe si gjuhë e huaj në Fakultetin filozofik në Universitetin e Beogradit; Marija Stankoviq, hulumtuese, doktorante në Fakultetin filologjik në Universitetin e Beogradit;

Ivana Stanojev, hulumtuese; Dunja Polleti, sociologe, doktorante në Fakultetin filozofik në Universitetin e Beogradit; Rahim Salihi, këshilltar i drejtoreshës së Shërbimit të Trupit koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë; Millica Rodiq, këshilltare e drejtoreshës së Shërbimit të Trupit koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë; bashkëpunëtorët për hulumtim në terren: Raife Ibishi, studente në departamentin e Fakultetit ekonomik në Bujanoc; Fadil Azizi, kryeshef i departamentit për veprimtari shoqërore në komunën e Preshevës; Femi Isufi, drejtor i SHF „Sami Frashëri"; Nehat Aliu, profesor i gjuhës serbe në Shkollën e mesme „Sezai Suroi" në Bujanoc dhe anëtar i Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare; Natasha Boshkoviq, koordinatore e përpilimit të Studimit.

Studimin e kanë financuar Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Zyra e Komesarit të lartë për pakicat nacionale. Ndihma profesionale e Zyrës së Komesarit të lartë për pakicat nacionale, i cili është instrument kryesor i OSBE-së për „parandalimin e konflikteve në fazën më të hershme të mundshme" ka qenë e rëndësisë së posaçme. Dokumentet e Komesarit të lartë për pakicat nacionale, siç janë „Rekomandimet e Hagës për të drejtat në arsimim të pakicave nacionale", si dhe „Udhëzimet e Lublanës për integrimin e shoqërive të ndryshme" kanë shërbyer si bazë e kornizës konceptuale të këtij studimi.

Falënderim të madhë për mbështetje dhe bashkëpunim gjatë përpilimit të Studimit i kemi borxh Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik; Entit për avancimin e arsimimit dhe edukimit; Entit për vlerësimin e kualitetit të arsimimit dhe edukimit; Sekretariatit krahinor për arsim, administratë dhe bashkësi nacionale të KA të Vojvodinës; Mbrojtësit krahinor të qytetarëve të KA të Vojvodinës; Entit pedagogjik të Vojvodinës; Riza Halimit dhe Shaip Kamberit, deputetëve popullor në Kuvendin e Republikës së Serbisë; kryetarit të komunës së Bujanocit Nagip Arifit; kryetarit të komunës së Medvegjës Slobodan Drashkoviq; kryetarit të komunës së Preshevës Ragmi Mustafa; kryetarit të Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare Galip Beqirit; këshilltarit të arsimit nga administrata shkollore në Leskoc Belul Nasufit; përfaqësuesve të Këshillit nacional të pakicës nacionale hungareze dhe të Këshillit nacional të pakicës nacionale sllovake; drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të 16 shkollave fillore në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë; arsimtarëve dhe arsimtareve të gjuhës serbe si gjuhë joamtare; nxënësve dhe prindërve të tyre; përfaqësuesve të mediave, shoqërisë civile, sektorit ekonomik, organeve të administratës shtetërore dhe lokale në komunat Preshevë dhe Bujanoc.

I. KONTEKSTI– KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

I. KONTEKSTI – KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

Millica Rodiq

Presheva, Bujanoci dhe Medvegja janë komuna në jug të Serbisë të cilat i karakterizon heterogjeniteti etnik i përbërjes së popullësisë. Këto komuna janë edhe multikonfesionale, multikulturore dhe shumëgjuhësore. Medvegja është komunë në përbërje të rrethit të Jabllanicës, ndërsa Bujanoci dhe Medvegja komuna të rrethit të Pçinjës. Vëmendje të veçantë të Qeverisë së Republikës së Serbisë këto komuna kanë marrë në vitin 2000, me formimin e Trupit koordinues të Qeveisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, i cili merret me avancimin e kualitetit të jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e këtyre hapësirave. Themelimi i Trupit koordinues ka pasur për qëllim normalizimin e marrëdhënieve në komuna, zbutjen e tensioneve ndër pjesëtarët e entiteteve të ndryshme, por, para se gjithash – ndërprerjen e konflikteve të armatosura.

Vendosja e paqes afatgjate dhe të qëndrueshme në hapësirat e tri komunave ka qenë fokusi primar i Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Trupit koordinues. Zhvillimi i infrastrukturës dhe ai ekonomik janë të rëndësisë së veçantë për zhvillimin e preshevës, Bujaocit dhe Medvegjës, çka ka qenë edhe qëllimi primar i Trupit koordinues që nga fillimi. Përveç investimeve në infrastrukturë dhe ekonomi, aktivitetet dhe projektet e bashkësive në nivel lokal, Trupit koordinues, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe partnerëve ndërkombëtar dukshëm kanë ndryshuar pas vitit 2008, kur çështja e marrëdhënieve ndëretnike dhe integrimi i bashkësive në nivel lokal bëhet me rëndësi primare. Mekanizmat kryesor të integrimit të bashkësive realizohen kryesisht në fushën e punësimit dhe arsimimit, ndërsa parakusht i integrimit është njohja e gjuhës së shtetit.

Njëra nga fushat më prioritare të Trupit koordinues është puna me të rinjtë me qëllim të forcimit të tyre, lidhjes dhe sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përparimit të komunave. Arsimimi formal dhe joformal është në qendër të interesimit së pari të organeve shtetërore, e pastaj edhe i organizatave ndërkombëtare. Arsimi është i rëndësishëm për zhvillimin gjithëpëfshirës të mjedisve lokale, regjioale dhe shtetërore, ndërsa në këtë fushë identifikohen edhe potencialet e domosdoshme, jo vetëm për zhvillimin e bashkësive në nivel lokal por edhe integrimet shoqërore.

Gjatë viteve të fundit është bërë më e dukshme se njohja e pamjaftueshme e gjuhës serbe ndër pjesëtarët e bashkësisë shqiptare paraqet problem gjithnjë më të madhë në realizimin e iniciativave të drejtuara në përmirësimin e situatës në lëmitë e punës, punësimit, vazhdimit të shkollimit dhe mobilitetit në përgjithësi. Njohja e gjuhës së shtetit është parakusht për integrimin e suksesshëm dhe pjesëmarrjen e barabartë të të gjitha bashkësive, posaçërisht atyre të pakicave, në nivel lokal dhe qendror në marrjen e vendimeve.

Presheva, Bujanoci dhe Medvegja

Komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë bëjnë pjesë në kategorinë e komunave të pazhvilluara[5] dhe ballafaqohen me një varg pengesash dhe sfidash. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë, e përcjellur me trendin e dukshëm migrues negativ,[6] me zhvillim ekonomik dhe infrastrukturor të ngadalësuar dhe mungesë të fuqisë punëtore të trajnuar, janë vetëm disa nga dobësitë dhe mangësitë strukturore dhe të resurseve.[7]

Për t'i kuptuar rrethanat në sferën e arsimit në këto komuna në jug të Serbisë i rëndësishëm është shënimi se këto komuna etnikisht të përziera i karakterizojnë shkollat të cilat janë monoetnike dhe të ndara. Puna edukative – arsimore zhvillohet në tri ente parashkollore,[8] 24 fillore[9] dhe pesë të arsimit të mesëm.[10] Puna gati në të gjitha institucionet arsimore zhvillohet në mjediset etnike homogjene, dhe se mësimi në këto zhvillohet kryesisht ose në gjuhën serbe ose në gjuhën shqipe. Përjashtim bëjnë shkollat fillore multietnike „9. maj" në fshatin Leran (komuna e Preshevës), „Jabllanica e Epërme" dhe „Banja e Sijarinës" (komuna e Medvegjës), të cilat nxënësit nga dy bashkësitë i vijojnë në të njëjtën kohë, por mësimin e për-

5 Komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë bëjnë pjesë në grupin e komunave ekonomikisht të pazhvilluara karakteristika e të cilave është „pazhvillueshmëria dhjetravjecare dhe dukuria e varfërisë së re të tranzicionit [...] problemet e akumuluara ekonomske (pa kapacitete industriale, kolapsi i sistemeve të mëdha, ndërmarrësia e pazhvilluar, procesi i ngadalshëm i privatizimit), sociale dhe demografike", Kancelarija za razvoj nedovoljno razvijenih područja: www.kornrp.gov.rs/site/page/3/nerazvijena-podrucja (i vizituar 16.05.2014)

6 Trendi migrues negativ është pasojë e rënies së natalitetit dhe procesit të zbrazjes demografike me largimin në pjesë të tjera të Republikës së Serbisë ose në shtete të huaja- më së shpeshti shtetet anëtare të Unionit evropian, në kërkim të punësimit dhe sigurisë financiare.

7 Podaci o strukturi nezaposlenih lica ukazuju na to da je najveći broj nekvalifikovane radne snage: www.kornrp.gov.rs/images/SLIKE/Uredbe/brosura/brosura%20sve%20zajedno%20sa%20koricom-print.pdf (i vizituar 16.5.2014). Kur është fjala për kuadrin mësimor që është i domosdoshëm për komunat për lëndën e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, sipas të dhënave të Shërbimit nacional për punësim, ada je reč o nastavnom kadru koji je neophodan opštinama za predmet Srpski kao nematernji jezik, prema podacima Nacionalne službe za zapošljavanje, dega në Vranjë, e cila është kompetete për territorin e Vranjës, Bujanocit, Trgovishtës, Preshevës, Surdulicës, Bosilegradit dhe Vladicin Hanit, vetëm një person është paraqitur me kualifikime të profesorit të mësimit klasor, dhe ka punuar si profesor i gjuhës dhe letërsisë serbe në Vranjë. Nëndega në Vladicin Han i ka të regjistruar dy filolog të diplomuar të cilët janë të papunësuar (gjuha serbe).

8 Në territorin e komunës së Bujanocit ekziston një ent parashkollor (EP) në të cilin programi për përgatitjen e fëmijëve për ta vijuar shkollën zhvillohet ndaras në gjuhën serbe dhe shqipe. Për fëmijët e moshës parashkolllore nga bashkësia rome mësimi për përgatitjen për vijimin e shkollës zhvillohet në gjuhën serbe në shkollën fillore në Bujanoc, në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, ku më vonë e vijojnë mësimin e rregulltë. Në entin parashkollor në komunën e Preshevës programet përgatitore janë të organizuar ndaras në gjuhën serbe dhe shqipe. Edhe në kounën e Medvegjës situata është e njëjtë: në të vetmin EP në territorin e kësaj komune puna edukative – arsimore zhvillohet në grupe të ndara për fëmijët nga bashkësitë e ndryshme.

9 Prej dhjetë shkollave fillore në tërritorin e komunës së Bujanocit mësimi në gjuhën serbe organizohet në katër, ndërsa në gjashtë shkollat tjera zhvillohet në gjuhën shqipe. Në vitin shkollor 2013/14, në shkollën fillore në Bilaç, për katër nxënës të klasëve të ndryshme mësimi në gjuhën serbe është organizuar ndaras. Arsimi fillor është i organizuar në tetë skolla në territorin e komunës së Preshevës: në gjashtë shkolla nxënësit e vijojnë mësimin në gjuhën shqipe, në njërën në gjhën serbe, derisa në një sëkollë nxënësit e vijojnë mësimin në gjhën serbe dhe shqipe. Në atë, të vetmën shkollë multietnike, nxënësit nuk e vijojnë mësimin bashkë, por secili në gjuhën e vet amtare. Nga gjashtë shkolla në territorin e komunës së Medvegjës mësimi në tri shkolla vijohet në gjuhën serbe, në një në gjuhën shqipe, ndërsa në të të dy gjuhët, me vërejtjen se nuk ka klasë etnikisht të përziera.

10 Dy janë shkolla të mesme në Bujanoc në të cilat mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën serbe, respektivisht në gjuhën shqipe dhe shkolla e muzikës me mësim në gjuhën serbe. Në Preshevë ekzistojnë dy shkolla të mesme – gjimnazi dhe shkolla e mesme teknike, me klasët në të cilat nxënësit e përcjellin mësimin në gjuhën amtare. Në Medvegjë ekziston një shkollë e mesme në të cilën nxënësit e përcjellin mësimin në gjuhën amtare (nuk ka paralele etnike heterogjene).

cjellin ndaras. Përjashtim bëjnë edhe dy departamentet e fakultetit në Medvegjë, në të cilët studentët e përcjellin mësimin në gjuhën serbe me përkthim simultan në gjuhën shqipe, dhe departamenti i Fakultetit ekonomik në Bujanoc, në të cilin mësimi zhvillohet në dy gjuhë, ndërsa sudentët nga të gjitha bashkësitë gjatë studimit së bashku e përcjellin mësimin për lëndët të cilat janë në gjuhën serbe.

Përveç rasteve të rralla të enteve arsimore multietnike, serbët, shqiptarët dhe romët etnik në jug të Serbisë nuk e ndajnë hapësirën e përbashkët pasi që nuk i vijojnë shkollat e njëjta. Prandaj nxënësit kanë mundësi të rralla të takohen, socializohen dhe t'i shkëmbejnë përvojat, sepse në disa shkolla mësimi zhvillohet në gjuhën serbe (ato shkolla kryesisht i vijojnë edhe romët), ndërsa në shkollat tjera mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Të pakëta janë aktivitetet e përbashkëta jashtëmësimore dhe ato kryesisht i organizojnë organizatat joqeveritare dhe klubet sportive, ndërsa interesimi për pjesëmarrje është i madh.

Njohja e gjuhës së shtetit është me rëndësi të posaçme si në nivelin mikro dhe të mesëm (për individin, respektivisht bashkësinë në nivel lokal), ashtu edhe në nivelin makro, i cili në këtë kontekst nënkupton integrimin e bashkësive të ndryshme etnike. Njohja e gjuhës serbe është bazë për punësim në shërbimin publik. Me hapjen e vendeve të reja të punës, posaçërisht pas vitit 2010, është paraqitur mundësia e re për punësim.[11] Në konkurset e shpallura të organeve shtetërore është vërejtur se një numër i vogël i kandidatëve nga bashkësia shqiptare e kuptojnë dhe e flasin gjuhën serbe.

Mundësi të reja iu janë dhënë edhe të rinjëve të cilët e përfundojnë shkollën e mesme dhe regjistrojnë fakultete. Prej vitit 2011, Trupi koordinues jep bursa për të rinjtë nga këto komuna që të studiojnë në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit. Dhënia e provimit pranues, dhe pastaj edhe vet studimi, nënkupton njohjen e mirë të gjuhës serbe, duke pasur parasysh se ajo është gjuha në të cilën zhvillohet mësimi.

I njëjtë është rasti edhe me departamentin e Fakultetit ekonomik nga Subotica në Bujanoc. Mësimi në departamentin në Bujanoc, zhvillohet në dy gjuhë, prandaj sudentët nga bashkësia shqiptare duhet ta mbizotërojnë gjuhën për ta përjellur mësimin dhe me sukses t'i japin provimet të cilët janë të organizuar në gjuhën serbe. Për bursistët e Trupit koordinues të cilët gjuhën serbe nuk e kanë gjuhë amtare dhe për studentët e departamentit të Fakultetit ekonomik nga bashkësia shqiptare,[12] ky organ qeveritar disa herë ka organizuar ad hoc kurse disa mujore të gjuhës serbe.

Iniciativat e para për organizimin e mësimit të gjuhës serbe kanë rrjedhur nga sektori civil, së pari në Preshevë, dhe pastaj në Bujanoc. Organizatat joqeveritare nga dy komunat me mjetet e Trupit koordinues, të përcaktuara për punën e sektorit joqeveritar, kanë organizuar orë të gjuhës serbe.

11 Vendimi për ndryshimin e vendimit për numrin maksimal të punësuarve në organet e administratës shtetërore, agjencionet publike dhe organizatat për sigurim social të obligueshëm, Qeveria e Republikës së Serbisë, 2010.

12 Orët e gjuhës serbe për studentët e departamentit të Fakultetit ekonomik të organizuar me mbështetjen e Zyrës së Komësarit të lartë për pakicat nacionale (Hag) dhe Misionit të OSBE në Serbi.

Liderët shqiptar nga jugu i Serbisë e kanë identifikuar rëndësinë për avancimin e mësimit të gjuhës serbe. Në korrik të vitit 2013, Qeveria e Republikës së Serbisë e ka aprovuar Raportin nga mbledhja e kryetarit të Trupit koordinues prof. Zoran Stankoviq dhe liderëve të partive politike nga jugu i Serbisë. Raporti përmban shtatë tema të cilat liderët shqiptar i kanë propozuar bër bisedime me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Serbisë. Njëra prej temave të propozuara është arsimi, në kuadër të cilës është propozuar që të shqyrtohet edhe mundësia e përmirësimit të mësimit të gjuhës serbe.

Mësimi i gjuhës serbe është lëndë e obligueshme për nxënësit nga të gjitha bashkësitë e pakicave dhe ajo mësohet gjatë arsimimit fillor dhe të mesëm. Qëllimi kryesor i mësmit të gjuhës është, së pari, fitimi i aftësive të pjesëtarëve të bashkësisë jo shumicë t'i arrijnë njohuritë e gjuhës serbe për ta përdorur atë në komunikimin e përditshëm.

Qëllimi i këtij Studimi është që t'i prezantojë rezultatet e hulumtimit dhe në ato t'i mbështesë rekomandimet konkrete për avancimin e kualitetit të mësimit në arsimimin fillor. Nëse modeli i propozuar tregohet efikas dhe i qëndrueshëm, ai më vonë mund të aplikohet edhe në nivelin e arsimimit të mesëm.

Puna me nxënësit dhe arsimtarët në sistemin e arsimimit fillor është rrjedhë logjike për shumë arsye: (1) aprovimi i përmbajtjeve të reja është shumë më i lehtë në fazat e hershme të ciklit arsimor; (2) programet mësimore për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat e mesme supozojnë se nxënësit në shkollën fillore kanë fituar njohuritë themelore të cilat definohen dhe priten nga programet për shkollën fillore. Nëse anashkalohet niveli i ulët i njohurisë së gjuhës serbe të nxënësve të cilët e përfundojnë shkollën fillore, arsimtarët e shkollave të mesme nuk do të kenë mundësi ta realizojnë programin i cili është definuar për punë me nxënësit; (3) thelbi i problemit qëndron në fazat fillestare të procesit arsimor. Prandaj nevojitet që kualiteti i mësimit të avancohet dhe të përmirësohet pikërisht në fazat primare me qëllim që nxënësve në fazat e mëvonshme të zhvillimit t'i mundësohet plotësimi dhe përsosja e njohurive të cilat i kanë fituar në fazat e hershme të arsimimit dhe zhvillimit; (4) nëse merret parasysh fakti se Ligji për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit përcakton arsimimin fillor si të obligueshëm, për dallim nga arsimimi i mesëm, me intervenimet në arsimimin fillor do të përfshihet numër më i madh i nxënësve. Me këtë do t'i mundësohet numrit më të madhë të pjesëtarëve të bashkësisë shqiptare t'i zotërojnë bazat e gjuhës serbe.

Njohja e dobët e gjuhës serbe paraqet pengesë të konsiderueshme për shqiptarët dhe shqiptaret që të punësohen ose vazhdojnë shkollimin në Republikën e Serbisë, të komunikojnë në rrethana të ndryshme dhe të kryejnë punë të shumëta. Pasojë e mosnjohjes së gjuhës zyrtare është integrimi i vështirësuar rezultat i të cilit mund të jetë segregacioni dhe ndarja e një tërësie etnike nga shumica. Me ndarjen e dy tërësive krijohet hendeku, mosnjohja dhe moskuptimi i ndërsjellë, edhe përkundër faktit se e ndajnë hapësirën e përbashkët jetësore.

II. KORNIZA LEGJISLATIVE DHE KONCEPTUALE

II.1. Korniza konceptuale - rëndësia e gjuhës në integrimin e shoqërive të ndryshme

II. KORNIZA LEGJISLATIVE DHE KONCEPTUALE

II.1. KORNIZA KONCEPTUALE – RËNDËSIA E GJUHËS NË INTEGRIMIN E SHOQËRIVE TË NDRYSHME

Natasha Boshkoviq

Përmbajtjen e koncepteve qendrore në të cilat mbështetet ky studim duhet vështruar në kontekstin e normave ndërkombëtare në fuqi dhe standardeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, dhe në përputhje me standardet të cilat kanë të bëjnë me integrimin e shoqërive të ndryshme. Standardet ndërkombëtare në të gjitha fushat janë të definuara me një varg të dispozitave të konventave ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Republika e Serbisë, si dhe në deklaratat dhe dokumentet tjera të Kombeve të Bashkuara (KB), Këshilli i Evropës (KE) dhe Organizata për bashkëpunim evropian dhe siguri (OSBE). Duke pasur parasysh nevojën që standardet të aplikohen në kontekstin e shoqërisë konkrete dhe momentit konkret, autorët dhe autoret e Studimit për mundësitë e avancimit të mësimidhënies dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë i kanë përpiluar rekomandimet në bazë të hulumtimit teorik dhe empirik të realizuar, duke marrë parasysh jo vetëm perspektivën pedagogjike të mësimdhënies/mësimit të gjuhës joamtare por edhe faktin se gjuha është faktorë i rëndësishëm i integrimit shoqëror.

Integrimi shoqëror

Integrimi mundet të kuptohet si „proces dinamik në të cilin marrin pjesë më shumë aktorë dhe të gjithë ata angazhohen për të siguruar pjesëmarrje efektive të të gjithë pjesëtarëve e shoqërive të ndryshme në jetën ekonomike, politike, sociale dhe kulturore dhe në forcimin e ndjenjës së përkatësisë së përbashkët dhe inkluzive si në nivelin nacional, ashtu edhe në atë lokal.“[13] Integrimi nënkupton procesin e ndërtimit të bashkëjetesës së harmonizuar të më shumë bashkësive në kushtet e dialogut të përhershëm dhe respektimit të të drejtave në identitet dhe pikërisht për këtë dallohet prej asimilimit, i cili nënkupton shkrirjen e dhunshme të pjesëtarëve të bashksisë pakicë në kulturën, gjuhën dhe zakonet e shumicës dhe humbjen ose anulimin e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

13 *Udhëzimet Lublanës për integrimin e shoqërive të ndryshme, Komesari i lartë OSBE për pakicat nacionale,* 2012 (përkthimi Misioni OSBE në Serbi, Beograd 2012).

Neni 5. al. 2. e Konventës kornizë të Këshllit të Evropës për mbrojtjen e pakicave nacionale (në tekstin në vijim: Konventa kornizë), gjithashtu merret me këtë çështje: „Pa dëmin për masat e ndërmarra në përputhje me politikën e tyre të përgjithshme të integrimeve, palët kontraktuese do të përmbahen nga politika ose praktika të cilat kanë për qëllim asimilimin e pjesëtarëve të pakicave nacionale kundër vullnetit të tyre dhe duhet t'i mbrojnë këta persona prej çdo aktiviteti të drejtuar kah asimilimi i tillë." Është më rëndësi të theksohet se shtetet nuk pengohen të ndërmarrin masa në kuadër të politikës së vet të përgjithshme të integrimeve, me çka pranohet rëndësia e kohezionit social dhe shprehet përpjekja e theksuar në preambulën e Konventës kornizë se llojllojshmëria kulturore në çdo shoqëri duhet të jetë burim dhe faktor i pasurimit, dhe jo ndarjes.[14]

Politikën e integrimit, pra, e karakterizon pjesëmarrja vullnetare e të gjithë anëtarëve në atë proces me respektimin dhe ruajtjen e kulturës dhe identitetit të pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicave nacionale.[15] Integrimi është proces dinamik, dhe, krahas kësaj, politika e integrimeve duhet gjithnjë të plotësohet dhe t'i përshtatet ndryshimeve në shoqëri, me synimin që të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Prandaj në politikat publike të integrimit është me rëndësi të ndërtohen në kontinuitet elementet e reja të cilat shprehin nevojat dhe rrethanat shoqërore të cilat janë në procesin e ndryshimeve konstante. Në ato korniza duhet vështruar edhe procesin e integrimit të pakicave nacionale në shoqëritë e ndryshme etnike dhe gjuhësore. Standardet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me atë proces janë përpunuar në kuadër të konceptit dhe praktikës „integrimet duke respektuar llojllojshmëritë" të Komesarit të lartë të OSBE-së për pakicat nacionale,[16] për çka do të bëhet më shumë fjalë në tekstin e mëtejmë.

E drejta në arsimim dhe të drejtat gjuhësore

E drejta në arsimim është në lidhje të ngushtë me të drejtat gjuhësore. Deklarata univerzale për të drejtat e njeriut (1948) është dokumenti i parë ndërkombëtar në të cilin theksohet arsimimi si e drejtë e njeriut, ndërsa arsimimi fillor në nenin 26. përcaktohet si i obligueshëm. Në të njëjtin nen theksohet edhe ajo se arsimimi duhet t'a avancojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë ndër të gjithë popujt, grupet racore dhe fetare, si dhe t'i kontribuojë ruajtjes së paqes. Në nenin 13. të Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore këto parime janë përpunuar në mënyrë të detajuar dhe janë pjesë e të drejtës ndërkombëtare. Të drejtat e pakicave në fushën e arsimimit janë të rregulluara në mënyrë të detajuar në

14 Sqarimet me Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale (1995): http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/157.htm

15 Konventa kornizë Këshillit të Evropës për mrojtjen e pakicave nacionale, neni 5.

16 Koncepti „Integrimet me respektimin e llojllojshmërive" paraqet parimin udhëheqës të punës së Komesarit të lartë të OSBE për pakicat nacionale kur është fjala për angazhimin në konfliktet etnike potenciale.

këto dokumente ndërkombëtare: neni 5. i Konventës së UNESCO-s kundër diskriminimit në arsimim (1960); neni 4. i Deklararatës së KB për të drejtat e pjesëtarëve të pakicave nacionale ose të pakicave etnike, gjuhësore dhe fetare (1992.); neni 14. i Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale të Këshillit të Evropës (1995). Në dokumentet e lartëpërmendura janë përpunuar dhe plotësuar dispozitat e nenit 26. të Deklaratës univerzale për të drejtat e njeriut të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave që ta kultivojnë identitetin e vet kolektiv, duke përdorur gjuhën amtare, para së gjithash përmes arsimimit. Në të njëjtat dokumente është paraparë edhe ajo se e drejta për kultivimin e identitetit kolektiv përmes gjuhëve të pakicave duhet të barazpeshohet me përgjegjësinë ndaj integrimit dhe pjesëmarrjes në shoqërinë e gjerë.

Duke vepruar në përputhje me normat e brendshme dhe ato ndërkombëtare dhe standardet me të cilat rregullohet mbrojtja e të drejtave të pakicave dhe ruajtja e identitetit të pakicave nacionale, shtetet ndërmarrin masa të cilat kanë të bëjnë me arsimimin e pjesëtarëve të pakicave nacionale në gjuhën amtare. Me këtë plotësohen kërkesat në fushën e të drejtave të njeriut dhe vërtetohet përcaktimi i shtetit ta kultivojë llojllojshmërinë si vlerë dhe pasuri e shoqërisë së vet. Shtetet obligohen që në territorin në të cilin janë në përdorim gjuhët regjionale ose të pakicave, në përputhje me situatën të secilës prej këtyre gjuhëve dhe pa kurrfarë pengesa të mësimit të gjuhës zyrtare/shtetërore, pjesërisht ose plotësisht ta mundësojnë arsimimin parashkollor, fillor, të mesëm, teknik ose specialistik, universitar ose ndonjë tjetër të lartë, si dhe arsimimin e të rriturve në gjuhët regjionale ose të pakicave (Karta evropiane për gjuhët regjionale ose të pakicave, neni 8. al. 1.).

Procesi i integrimit shoqëror nënkupton fitimin e njohurive për bashkësinë e gjerë shoqërore dhe mësimin e gjuhës shtetërore. Për shembull, në nenin 5. al. 1. Konventës së UNESCO-së kundër diskriminimit në fushën e arsimit, thuhet se njohja e të drejtës në arsimimin e pjesëtarëve të pakicave në gjuhën amtare është me rëndësi thelbësore, me kusht „që kjo e drejtë të mos ushtrohet në mënyrën e cila pamundëson pjesëtarët e këtyre pakicave ta kuptojnë kulturën dhe gjuhën e tërë bashkësisë dhe të marrin pjesë në aktivitetin e saj“. Siç ruhen gjuhët e pakicave në mënyrën më të mirë përmes arsimimit, ashtu edhe për mësimin e gjuhës zyrtare në shkollat në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën e pakicës procesi i arsimimit është me rëndësi të madhe, posaçërisht gjatë arsimimit të obligueshëm fillor.

Në vendet në të cilat, në përputhje me standardet ndërkombëtare, realizohet e drejta në shkollim të pjesëtarëve të pakicave nacionale në gjuhën amtare, mësohet edhe gjuha zyrtare e atij shteti. Në „Rekomandimet nga Haga për të drejtat e pakicave nacionale në arsimim“ të Komesarit të lartë të OSBE-së për pakicat nacionale, e drejta në shkollim në gjuhën amtare është pranuar në funksion të integrimit, respektivisht, pjesëmarrja në rrjedhat shoqërore, ekonomike dhe politike.

Përveç asaj që paraqet shtyllën dhe pjesën e pandashme të ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit të pjesëtarëve të pakicave nacionale, përdorimi vetëm i gjuhës amtare mund të jetë edhe faktor i vetizolimit të pakicës nacionale, posaçërisht në mjediset ku ekspozimi i kulturës dhe gjuhës së shumicës nuk është i madh. Sipas „Udhëzimeve të Lublanës për integrimin e shoqërive të ndryshme", arsimimi shumëgjuhësor rritë vlerat e arsimimit të nxënësve në të gjitha bashkësitë dhe në shoqërinë në tërësi dhe duhet të inkurajohet si për pakicat, ashtu edhe për shumicën.

Të drejtat gjuhësore në kontekstin e integrimit shoqëror

Duke pasur parasysh faktin se gjuha paraqet veçorinë kyçe të identitetit nacional, roli i saj është me rëndësi të madhe për respektimin dhe gëzimin e të drejtave të pakicave. E drejta në përdorimin e gjuhës amtare është paraparë në nenin 10. të Konventës kornizë, me të cilën është përcaktuar se „çdo pjesëtarë i pakicës nacionale ka të drejtën ta përdorë lirshëm dhe pa kufizime gjuhën e vet të pakicës, në mënyrë private dhe publike, me gojë ose me shkrim", derisa me nenin 7. al.1. të Kartës evropiane për gjuhët regjionale dhe të pakicave janë definuar parimet dhe qëllimet në të cilat shtetet e ndërtojnë politikën, legjislacionin dhe praktikën e vet në lidhje me gjuhët regjionale ose të pakicave të cilat përdoren në kuadër të territoreve të veta.

Për nevojat e këtij studimi shkurtimisht janë prezantuar përmbajtja dhe relacionet ndër nocionet gjuha amtare – joamtare – e pakicës – e huaj – zyrtare/shtetërore, sipas „Udhëzuesit për zhvillimin e politikave arsimore gjuhësore në Evropë"[17] të Departamentit për politikën gjuhësore të Këshillit të Evropës. Sipas këtij dokumenti „gjuha e parë" është termin shkencor i cili ka të bëjë me atë që zakonisht quhet „gjuha amtare". Ka të bëjë me gjuhën e cila është përvetësuar e para në fëmijëri.[18] Dallimi në mes të „gjuhës

17 *From Linguistic Diversity to Plurilingual Education: Guide for the Development of Language Education Policies in Europe,* [Nga llojllojshmëria gjuhësore deri te pluraliteti gjuhësor i arsimimit: udhëzuesi për zhvillimin e politikave në Evropë] Executive Version 2007. Language Policy Division, DGIV, Council of Europe. Pluraliteti gjuhësor është nocion të cilin Këshilli i Evropës e ka aplikuar dhe e ka përpunuar më së pari në Kuadër të përbashkët evropian për mësimin e gjuhëve të gjalla (Common European Frameëork of Reference for Languages), pastaj edhe në dokumente tjera të cilat dokumentima kanë të bëjnë me politikat gjuhësore arsimore. Sipas kornizës së përbashkët evropiane, aftësitë plurigjuhësore dhe plurikulturore paraqesin aftësinë e përdorimit të gjuhës në komunikimin dhe pjsëmarrjen në aktivitetet interkulturore, me ç'rast personi ka shkallë të ndryshme të njohurisë së disa gjuhëve dhe përvojë të disa kulturave. Kjo është bazë për dallim të plurigjuhësisë si kompetenca të folësit (i cili është në gjendje të përdor më shumë se një gjuhë) nga shumëgjuhësia si prezencë e më shumë gjuhëve në një territor të caktuar. Është fjala për lëvize kualitative- nga përqendrueshmëria në gjuhë (një shtet mund të konsiderohet njëgjuhësore ose dygjuhësore) kah përqendrueshmëria te folësit (fq.8). Më shumë për këtë koncept dhe për dallimin në mes të plurigjuhësisë dhe shumëgjuhësisë të shikohet në: *Common European Frameëork of Reference for Languages dhe From Linguistic Diversity to Plurilingual Education: Guide for the Development of Language Education Policies in Europe.*

18 Për personat dygjuhësor/ shumëgjuhësor, „gjuha e parë" mund të jenë dy ose më shumë gjuhë, nëse me rastin e zbulimit dhe njohurisë së botës, fëmiu është në kontakt me folësit e më shumë gjuhëve.

tjetër“ dhe „gjuhës së huaj“ është shumë i rëndësishëm sepse e përshkruan mjedisin shoqëror në të cilin fitohen njohuritë gjuhësore. Gjuha e përvetësuar në mjedisin e afërt quhet „gjuha tjetër“ dhe më së shpeshti është prezent në përdorim të përditshëm. „Gjuhë e huaj“ më së shpeshti quhet gjuha e cila është në përdorim si gjuhë zyrtare në shtetin tjetër. Shprehja „gjuha e pakicës“ ka të bëjë me gjuhët të cilat i përdorin bashkësitë e pakicave, para së gjithash në arsim, por edhe në komunikim me institucionet shtetërore, gjykatat, dhe në media. Gjuha zyrtare, e cila ndryshe quhet edhe gjuhë shtetërore, është term i cili përdoret për ta theksuar gjuhën përdorimi i së cilës është dominant në të gjitha fushat publike në shtetin e caktuar. Gjuha shtetërore shpesh në ligje dhe kushtetuta e ka të pranuar statusin e gjuhës zyrtare. Në përputhje me terminologjinë të cilën e ka përcaktuar ligjdhënësi në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Serbisë, për nevojat e këtij studimi përdoret shprehja „gjuha joamtare“ në kuptimin i cili është më i përafërt me nocionin „gjuha tjetër“.

Politika arsimore gjuhësore si element i politikës integruese

E drejta dhe obligimi i pjesëtarëve të pakicave nacionale të marrin pjesë në procesin e integrimit shoqëror është përcaktuar në më shumë dokumente ndërkombëtare.[19]

Në „Udhëzimet e Lublanës për integrimin e shoqërive të ndryshme“ të Komesarit të lartë të OBSE-së për pakicat nacionale thuhet „politika e integrimeve duhet të përfshijë masat të cilat stimulojnë dialogun ndër bashkësitë dhe interakcionin e tyre në bazë të tolerancës dhe respektimit të ndërsjellë. Kjo përfshinë spektrin e gjerë të iniciativave në fushat e ndryshme, përfshirë politikën arsimore, gjuhësore dhe mediale“.[20] Përveç kësaj thuhet edhe se „shtetet kanë obligim t'i mbrojnë dhe avancojnë gjuhët e pakicave dhe të drejtat e personave të cilët i takojnë pakicave që t'i mësojnë dhe përdorin ato gjuhë, ndërsa pakicat në të njëjtën kohë ndajnë me shumicën përgjegjësinë për pjesëmarrjen në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në punët publike [...] Kjo pjesëmarrje nënkupton që personat të cilët i takojnë pakicave duhet të fitojnë njohuri të caktuara të gjuhës shtetërore ose zyrtare“.[21]

Njohja e pamjaftueshme ose mosnjohja e gjuhës zyrtare të shtetit sjell deri te zvogëlimi i mundësive të pjesëmarrjes së pjesëtarëve të bashkësive të pakicave në arsimim në gjuhën zyrtare të shtetit, në aftësimin profesional, në shfrytëzimin e masave stimuluese të cilat i ndërmerr shteti në fushën e arsimit (bursat

19 Dokumenti nga Kopenhaga, fq. 34; Rekomandimet nga Haga të komesarit të lartë të OSBE-së për pakica nacionale, rekomandimi nr. 1; Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, sqarimi në nenin 14; Konventa e UNESCO-s kundër diskriminimit në fushën e, nenit. 5 al. 1; Deklarata e Kombeve të bashkuara për të drejtat e pjesëtarëve të pakicave nacionale dhe etnike, pakicave fetare dhe gjuhësore, neni 4.

20 *Udhëzimet e Lublanës për integrimin e shoqërive të ndryshme,* udhëzimet nr. 11, Komesari i lartë i OSBE-së për pakicat nacionale, 2012.

21 *Ibid.,* komenti me udhzimet 42;

për nxënësit e shkollës së mesme dhe studentët), pastaj në punësim (posaçërisht në sistemin e administratës shtetërore) dhe, përfundimisht, zvogëlimin e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes dhe në jetën e gjerë shoqërore. Nëse situata e tillë e pjesëmarrjes së zvogëluar është afatgjate, ajo gjeneron ekspozim dhe kontakt sa më të vogël me gjuhën, dhe me këtë edhe mundësi gjithnjë më të vogla që ajo të mësohet.

Komunikimi dhe interakcioni ndër anëtarët e shoqërive heterogjene inkurajon kontakt me gjuhën dhe mundësi për avancimin e njohurive për kulturat, historitë dhe religjionet, si të pakicave nacionale ashtu edhe të popullsisë shumicë. Prandaj edhe në instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave theksohet nevoja për avancimin e njohjes së gjuhës, mes tjerash, edhe me qëllim të krijimit të klimës së tolerancës dhe dialogut (neni 6. Konventës kornizë). Parimet dhe vlerat e shumëgjuhësisë dhe interkulturalizmi në arsimim, me mësimin e obligueshëm të gjuhës zyrtare të shtetit, nënkuptojnë edhe mësimin e gjuhëve të pakicave.[22] Prandaj gjithsesi nuk duhet anashkaluar mësimin e dyanshëm kur është fjala për procesin e integrimit në mjediset e përziera gjuhësore.

Duke qenë se gjuha është aspekt i veçantë i identitetit grupor, ajo lehtë bëhet simbol për grupin e caktuar, posaçërisht në situatat e tensioneve dhe konflikteve. Rëndësia e komunikimit dhe mirëkuptimit është edhe më e madhe kur bëhet fjalë për procesin e pajtimit dhe ndërtimit të paqes. Në kushtet e shoqërive paskonfliktuoze ai rol i gjuhës është shumë i shprehur duke marrë parasysh atë se nevojitet përsëri të ndërtohet besimi, si dhe parakushtet politike dhe ekonomike për bashkëjetesë.

Krahas kësaj, „njohja e gjuhës zyrtare është faktor i kohezionit social dhe integrimit".[23] Prandaj nevojitet që shtetit t'i harmonizojë përpjekjet lidhur me mësimin e gjuhëve të pakicave dhe gjuhës zyrtare, posaçërisht në mjediset ku procesi arsimor zhvillohet në gjuhën e pakicës nacionale dhe ku janë mundësitë për mësimin e gjuhës zyrtare në masë të madhe të lidhura për sistemin arsimor, siç është në mjediset ku pjesëtarët e pakicave nacionale përbëjnë popullsinë shumicë. „Politika e shtetit duhet të jetë e atillë që ta vendosë barazpeshën në mes të nevojës për një ose më shumë gjuhë të përbashkëta të cilat paraqesin bazën e përbashkët për integrimin dhe funksionimin e shoqërive dhe obligimet në pikëpamjen e ruajtjes dhe avancimit të shumëllojshmërisë gjuhësore, në mes tjerash edhe me ruajtjen e të drejtës gjuhësore të pakicave. Qeveritë duhet të gjithëve ti mundësojnë qasje për të mësuar gjuhën shtetërore."[24] Duke kon-

22 *Rekomandimi 1740* (2006) Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës për vendin e gjuhës amtare në arsimimin shkollor (Parliamentary Assembly Council of Europe (PACE) – Recommendation on the place of the mother tongue in school education (Recommendation 1740 (2006)).

23 *Komenti nr. 1 – Arsimimi në bazë të Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave naconale,* ACFC/25DOC(2006)002. Komiteti ligjdhënës për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, KëshilliEvropës: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_fcnmdocs/PDF_CommentaryEducation_sr.pdf

24 *Ljubljanske smernice za integraciju raznolikih društava,* Zyra e komesarit të lartë për pakica nacionale, Hagë, 2012.

sideruar se çdo situatë konkrete përmban edhe një varg të specifikave të cilat duhet të merren parasysh, nevojitet të shqyrtohen karakteristikat e secilës shoqëri konkrete në mënyrë që në kuadër të politikës ekzistuese të integrimit të aplikohen standardet në mënyrë adekuate.

Duhet pasur parasysh edhe atë se pjesëmarrja në procesin e integrimit është përgjegjësi e të gjithë aktorëve shoqëror dhe institucional, mediave dhe shoqërisë civile. Obligimi i shteteve është që të mundësojnë kushte[25] për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët dhe qytetaret, pa diskriminim.

Në shtetet evropiane në të cilat politikat publike në fushën e arsimimit dhe gjuhës gjithnjë e më shumë bazohen në kërkesat e konkurrencës ekonomike dhe dhënies prioritet mësimit të gjuhëve të huaja, gjithnjë e më shumë identifikohet edhe nevoja që fëmijët dhe të rinjtë nga bashkësitë e pakicave dhe migruese ta mësojnë edhe gjuhën zyrtare të shtetit në të cilin jetojnë. Kur një pjesë e madhe e popullsisë për shkak të mosnjohjes së gjuhës nuk është në gjendje të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe ekonomike, distribuimi i kompetencave gjuhësore në mënyrë negative ndikon në kohezionin shoqëror.[26]

Duke marrë parasysh të gjitha elementet e përmendura, rezultatet e hulumtimit të realizuar në terren për nevojat e përpilimit të këtij studimi është me rëndësi t'i vështrojmë në kontekstin e integrimit shoqëror, dhe jo si intervenime rreptësisht pedagogjike për avancimin e mësimit të gjuhës.

25 Shtetet nënshkruese të Konventës për mbrojtjen e pakicave nacionale obligohen se, aty ku është e nevojshme, të ndërmarrin masa në fushën e arsimimit dhe hulumtimit për të kultivuar kulturën, gjuhën dhe religjionin e pakicave nacionale dhe popullatës shumicë (neni. 12 al. 1 dhe 2). Në atë kontekst folëset e huaja në mes tjerash do të sigurojnë mundësi të përshtatshme për trajnimin dhe qasjen e mjeteve mësimore dhe të lehtësojnë kontaktet në mes të nxënësve dhe arsimtarëve nga bashkësitë e ndryshme.

26 Pádraig Ó Riagáin and Georges Lüdi, *Bilingual Education: Some Policy Issues,* Language Policy Division DG IV – Directorate of School, Out-of-School and Higher Education Council of Europe, Strasbourg.

II.2. Pasqyra e legjislacionit në Republikën e Serbisë në fushën e mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare

II.2. PASQYRA E LEGJISLACIONIT NË REPUBLIKËN E SERBISË NË FUSHËN E MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE

Marija Stankoviq

II.2.1. Kornizat legjislative në Republikën e Serbisë me të cilat rregullohen të drejtat dhe liritë e pjesëtarëve të pakicave nacionale

Kushtetuta e Republikës të Serbisë[27] garanton të drejtat e pakicave nacionale në Republikën e Serbisë, të cilat realizohen në përputhje me mbrojtjen juridike-ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Pjesëtarët e pakicave nacionale kanë të drejta individuale dhe kolektive, të drejta të cilat realizohen në mënyrë individuale ose në bashkësi me të tjerët në përputhje me standardet dhe ligjet ndërkombëtare. Të drejtat kolektive nënkuptojnë që pjesëtarët e pakicave nacionale, drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të vet të zgjedhur, të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes ose të vendosin për çështjet e caktuara të cilat janë të lidhura me kulturën e tyre, arsimimin, informimimin dhe përdorimin e gjuhës dhe shkrimit, me qëllim të realizimit të drejtave në vetqeverisje në fushën e kulturës, arsimimit, informimimit dhe përdormit të gjuhës dhe shkrimit. Përvec kësaj, pjesëtarët e pakicave nacionale mund ti zgjedhin këshillat e veta nacionale, në përputhje me Ligjin për këshillat nacionale të pakicave nacionale.[28]

ZPër fushën e realizimit të të drejtave të pakicave, posaçërisht kur është fjala për arsimimin, rol të rëndësishëm kanë edhe një varg i ligjeve të posaçme: Ligji për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit,[29] Ligji për shkollën fillore,[30] Ligji për këshillat nacionale të pakicave nacionale, Ligji për përdorimin e gjuhës dhe shkrimit,[31] Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale.[32]

27 Kushtetuta e Republikës të Serbisë (*Fl.zyrtare RS,* nr. 83/2006).

28 Ligji për këshillat nacionale të pakicave nacionale (*Fl.zyrtare RS,* nr. 20/2014).

29 Ligji për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit (*Fl.zyrtare RS,* nr. 55/2013).

30 Ligji për shkollën fillore (*Fl. zyrtare RS,* nr. 22/2002).

31 Ligji për përdorimin zytarë të gjuhës dhe shkrimit (*Fl.zyrtare RS,* nr. 30/2010).

32 Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale (*Fl. zyrtare RS,* nr. 97/2013).

II.2.2. Përshkrimi i sistemit të arsimimit në Republikën e Serbisë

Me kushtetutën e Republikës të Serbisë të gjithëve, me kushte të barabarta, iu garantohet e drejta në arsimim. Strukturën e sistemit të arsimimit në Serbi e përbëjnë:

- arsimimi parashkollor i obligueshëm dhe falas, në kohëzgjatje më së paku nëntë muaj;
- arsimimi themelor tetëvjeçar i obligueshëm dhe falas;
- arsimimi i mesëm falas, i cili varësisht nga lloji i shkollës së mesme zgjatë prej tri deri në katër vjet
- arsimimi i lartë, i cili është në dispozicon, për të gjithë qytetarët, në kushte të barabarta.

Arsimimi themelor i obligueshëm dhe falas është i rregulluar me Ligjin për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit dhe Ligji për shkollën fillore. Arsimimi themelor zgjatë tetë vjet dhe është i ndarë në dy cikle. Cikli i parë përfshinë katër klasët e para, të cilat janë të organizuara me mësim lëndor. Cikli i dytë përfshinë klasën e pestë deri në klasën e tetë, për të cilat organizohet mësimi lëndor, në përputhje me programin shkollor.

Arsimimi i mesëm nuk është i obligueshëm. E drejta në arsimim të mesëm falas është e rregulluar me Ligjin për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit, Ligjin për shkollën e mesme dhe Ligjin për arsimimin e mesëm dhe edukimin.[33]

Arsimimi i lartë është i rregulluar me Ligjin për arsimimin e lartë.[34] Në përputhje me nenin 80. të Ligjit për arsimimin e lartë, enti për shkollim të lartë i organizon dhe zhvillon studimet në gjuhën serbe por mundet të organizojë provime dhe të zhvillojë studime, respektivisht pjesë të caktuara të studimeve, si dhe të organizojë përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës përfundimtare të specializimit, magjistarturës dhe disertacionit të doktoraturës, në gjuhën e pakicës nacionale dhe në gjuhën e huaj, në përputhje me statutin e atij enti për shkollim të lartë. Enti për shkollim të lartë mund të zhvillojë program studimor në gjuhën e pakicës nacionale dhe në gjuhën e huaj nëse programi i tillë është i lejuar, respektivisht i akredituar.

II.2.3. Përdorimi i gjuhës në sistemin e arsimimit në Republikën e Serbisë

Sipas Ligjit për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit, puna edukativo-arsimore zhvillohet në gjuhën

33 Ligji për arsimimin e mesëm dhe edukimin (*Fl.zyrtare RS,* nr. 55/2013).

34 Ligji për arsmimin e lartë (*Fl.zyrtare RS,* nr. 89/2013).

serbe. Për pjesëtarët e pakicave nacionale puna edukativo-arsimore zhvillohet në gjuhën amtare, ndërsa me përjashtime mund të zhvillohet në dy gjuhë ose në gjuhën serbe (neni 9. al. 2.). Sipas Ligjit për shkollën fillore, kur plani mësimor dhe programor zhvillohet edhe në gjuhët e pakicave nacionale, nxënësi e përvetëson planin mësimor dhe programor të gjuhës serbe (neni 5. al. 4.). Gjithashtu, me nenin 12 al. 4. të Ligjit për bazat e arsimimit dhe edukimit[35] është paraparë që kur puna edukativo-arsimore zhvillohet në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, shkolla është e obliguar që për nxënësit të organizojë mësimin në gjuhën serbe. Çështja e të drejtës në përdorimin e gjuhës për pjesëtarët e pakicave nacionale është rregulluar me alinenë 5. të të njëjtit nen me të cilin parashihet që nëse mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, për pjesëtarët e pakicës nacionale mësimi organizohet në gjuhën e pjesëtarëve të pakicës nacionale me elementët e kulturës nacionale si lëndë e zgjedhur.

II.2.4. Përgatitja profesionale e arsimtarëve – kompetencat e nevojshme dhe kualifikimet

Punën edukativo-arsimore në ent e zhvillojnë: arsimtari, edukatori dhe bashkëpunëtori profesional, respektivisht personi i cili e ka fituar arsimimin e lartë përkatës, dhe i cili duhet ta ketë arsimimin nga disciplinat psikologjike, pedagogjike dhe metodike (PPM) të fituar në entin e lartë shkollor gjatë studimeve ose pas diplomimit, prej së paku 30 poena dhe gjashtë poena të praktikës në ent, në përputhje me Sistemin evropian të bartjes së poenave (neni 8. Ligji për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit).[36] Në zhvillimin e punës edukativo-arsimore arsimtarit, edukatorit dhe bashkëpunëtorit profesional munden t'i ndihmojnë edhe personat tjerë, në përputhje me këtë ligj.

Ligji për shkollën fillore (neni 69.) përcakton që mësimin prej klasës së I deri në klasën e IV mundet ta zhvillojë arsimtari me përgatitje të lartë profesionale ose me përgatitje superiore. Mësimin në gjuhën serbe, si edhe mësimin në gjuhët e pakicave nacionale prej klasës së I deri në klasën e IV, mund ta zhvillojë arsimtari i cili e ka fituar përgatitjen e caktuar shkollore në gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi, ose i cili e ka dhënë provimin nga gjuha me metodikën në shkollën e lartë përkatëse, respektivisht në fakultetin përkatës. Për zhvillimin e punës edukativo-arsimore është e domsodoshme, që gjatë ose pas përfundimit të studimeve, të zhvillohet praktika në disciplinën e metodikës dhe të fitohen së paku 30 poena nga disciplinat PPM. Mësimin lëndor mund ta zhvillojë arsimtari i cili e ka përgatitjen e lartë shkollore përkatëse.

Arsimimin të cilin duhet ta kenë arsimtarët, edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesional është përcaktu-

35 Ligji për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit (*Fl.zyrtare RS,* nr.55/2013).

36 Arsimimi superior përkatës paraqet arsimimin e fituar në studimet e shkallës së dytë (studimet akademike mastere, studimet akademike të specializuara ose studimet e specilazuara profesionale) ose arsimimi i fituar në studimet themelore në kohëzgjatje së paku prej katër viteve. Përjashtimisht, arsimtar dhe edukator është edhe personi i cili e ka fituar arsimimin superior përkatës në studimet e shkallës së parë (themelore akademike, respektivisht studimet profesionale), studimet në kohëzgjatje prej tre vjetëve ose me arsimim të lartë.

ar me Ligjin për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit (neni 121.), në përputhje me të cilin punët e edukatorit në entin parashkollor mund t'i zhvillojë personi i cili e ka fituar përgatitjen e caktuar arsimore në studimet në shkallë të parë, në studimet në shkallë të dytë, në studimet me kohëzgjatje pre tre vjetëve, me arsimim të lartë, respektivisht me arsimim të mesëm përkatës. Punët e edukatorit në entin parashkollor dhe të arsimtarit të mësimit klasor, përveç në gjuhën rome, mund t'i zhvillojë personi i cili e ka fituar arsimimin në gjuhën në të cilën zhvillohet kjo punë ose e ka dhënë provimin nga gjuha me metodikën, sipas programit të entit përkatës për shkollim të lartë. Respektivisht, punët e edukatorit në entin parashkollor dhe të arsimtarit të lëndës klasore në komunat serbe në të cilat popullsia e nacionalitetit shqiptar e përbënë shumicën (e cila arsimohet në gjuhën shqipe si gjuhë e pakicës nacionale) mund ta zhvillojnë personat të cilët e kanë fituar arsimimin përkatës në gjuhën shqipe ose personat të cilët e kanë dhënë provimin nga gjuha shqipe me medotikën, sipas programit të entit përkatës për shkollim të lartë. Në të njëjtën mënyrë, punët e arsimitarit dhe bashkëpunëtorit profesional mund t'i zhvillojë personi i cili e ka fituar arsimimin e mesëm, arsimimin e lartë dhe arsimimin superior në gjuhën në të cilën zhvillohet puna edukativo-arsimore ose e ka dhënë provimin nga kjo lëndë sipas programit të entit përkatës për shkollim të lartë.

Njëra nga zgjidhjet e mundshme për zbatimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe është punësimi i arsimtarit ndihmës, edukatorit ndihmës ose bashkëpunëtorit profesional ndihmës. Kushtet taksative në kuptimin e shkallës dhe llojit të arsimimit të arsimtarit, edukatorit, bashkëpunëtorit profesional, bashkëpunëtorit në entin parashkollor i cili zbaton programe të posaçme dhe të specializuara (siç është programi i mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare), të asistentit pedagogjik dhe arsimtarit ndihmës, programi i trajnimit për aftësimin e arsimtarit, bashkëpunëtorit profesional dhe programi i trajnimit për asistentin pedagogjik – i përcakton ministri (neni 121. Ligji për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit).

Punët e arsimtarit, edukatorit dhe bashkëpunëtorit profesional mund t'i zhvillojë personi i cili e ka lejen e punës, respektivisht liçencën,[37] kur mund të realizojë planin arsimor individual për punë me fëmijët dhe nxënësit me të meta në zhvillim nëse është i aftësuar për këtë, sipas programit dhe në mënyrën të cilën e përcakton ministri (neni 122. Ligji për bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit). Pa liçencë punët e arsimtarit, edukatorit dhe bashkëpunëtorit profesional (më së gjati dy vjet nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës) në ent, mund t'i zhvillojë:

1) praktikanti;

37 Licenca është dokument publik. Ministria e lëshon licencën dhe e mbanë regjistrin e arsimtarëve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional të cilëve iu është lëshuar licenca.

2) personi i cili i plotëson kushtet për arsimtarë, edukatorë dhe baskëpunëtorë profesional, me përvojë të punës të fituar jashtë entit, nën kushtet dhe mënyrën e përcaktuar për praktikantët;

3) personi i cili e ka themeluar marrëdhënien e punës në kohë të caktuar për ta zëvendësuar të punësuarin në mungesë;

4) bashkëpunëtori në entin parashkollor;

5) asistenti pedagogjik dhe arsimtari ndihmës.

Bashkëpunëtori në entin parashkollor mund ta zhvillojë punën edukativo-arsimore edhe pa liçencë nëse posedon arsimimin e përcaktuar me ligj.

II.2.5. Arsimimi i pjesëtarëve të pakicave nacionale

Në përputhje me Kushtetutën, pjesëtarëve të pakicave nacionale iu garantohet e drejta në shkollim në gjuhën e vet në entet arsimore, themelues i të cilëve është shteti, si dhe e drejta për përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të vet. Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale i garanton pjesëtarëve të pakicave nacionale të drejtën në arsimimim dhe edukim në gjuhën e vet në institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme të arsimit dhe edukimit (neni 13. al. 1.), ndërsa arsimimi në gjuhën e pakicës nacionale nuk e përjashton obligimin e mësimit të gjuhës serbe (neni 13. al. 4.). Plani mësimor duhet t'iu përshtatet pakicës nacionale konkrete dhe të përmbajë tema të cilat kanë të bëjnë me historinë, artin dhe kulturën e saj. Në përpilimin e planit mësimor patjetër duhet të marrin pjesë këshillet nacionale të pakicave.

Për realizimin e të drejtës në arsimim në gjuhën e vet amtare për pakicat nacionale në kuadër të arsimimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, mund të përcaktohet numri minimal i caktuar i nxënësve, me atë që ky numër mundet të jetë më i vogël se numri minimal i nxënësve i cili është përcaktuar me ligj për sigurimin e formave përkatëse të mësimit dhe arsimimit (Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, neni 13.). Neni i njëjtë i Ligjit përcakton që secili ent arsimor përkatës të caktojë se sa është numri minimal i nxënësve i nevojshëm për ta siguruar arsimimin në gjuhën e pakicës.

Sipas Ligjit për arsimimin dhe edukimin parashkollor („Fletorja zyrtare e RS" numër 18/2010) puna edukative – arsimore zhvillohet në gjuhën serbe, ndërsa për pjesëtarët e pakicës nacionale e njejta zhvillohet në gjuhën amtare, por mundet edhe në dy gjuhë ose në gjuhën serbe, nëse për këtë përcaktohen së paku 50 % e prindërve, respektivisht kujdestarëve të fëmijëve (neni 5. al. 1 dhe 2.).

Ligji për arsimimin dhe edukimin fillor gjithashtu i garanton të drejtën pjesëtarëve të pakicave nacionale në zhvillimin e punës edukativo-arsimore edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, respektivisht në dy gjuhë, nëse, gjatë regjistrimit në klasë të parë, për këtë përcaktohen së paku 15 nxënës (neni. 12. al. 1.). Me përjashtim, puna edukative-arsimore mund të zhvillohet edhe në gjuhën dhe shkrimin e pjesëtarëve të pakicës nacionale edhe nëse në klasën e parë regjistrohen më pak se 15 nxënës, pas marrjes së pëlqimit të ministrit përkatës kompetent për punët e arsimit dhe pas marrjes paraprake të pëlqimit të këshillit nacional të caktuar (neni 12. al. 2.). Pëlqimin për zhvillimin e programit shkollor në gjuhët e pakicave nacionale për më pak se 15 nxënës, ministria e jep pasi që ta marrë mendimin e këshillit nacional të pakicës nacionale përkatëse në kuadër të kompetencave të këshillave nacionale të definuara me Ligjin për këshillat nacionale të pakicave nacionale. Nëse këshilli nacional i pakicës nacionale nuk e dërgon mendimin në afatin prej 15 ditëve nga dita kur e ka pranuar kërkesën, konsiderohet se mendimi është dhënë (neni12. al. 3.).

Kur puna edukativo-arsimore zhvillohet në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, shkolla është e obliguar që për ata nxënës të organizojë mësimin e gjuhës serbe (neni 12. al. 4.), ndërsa kur mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, për pjesëtarët e pakicës nacionale organizohet edhe mësimi i gjuhës së pakicës nacionale me elementet e kulturës nacionale si lëndë e zgjedhur (neni 12. al. 5.).

Kur bëhet fjalë për arsmimin e mesëm, për pjesëtarët e pakicës nacionale puna edukativo-arsimore gjithashtu zhvillohet edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, respektivisht në dy gjuhë, nëse gjatë regjistrimit në klasë të parë përcaktohen së paku 15 nxënës, respektivisht edhe më pak se 15 nxënës me pëlqimin e ministrit përkatës kompetent për çështjet e arsimit, pas marrjes së pëlqimit të këshillit nacional të pakicës nacionale përkatëse (neni 5. al. 2 dhe 3. Ligji për arsimimin dhe edukimin e mesëm).

Kur puna edukativo-arsimore zhvillohet në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, shkolla është e obliguar që për ata nxënës të organizojë mësimin e gjuhës serbe (neni 5. al. 4.), ndërsa kur mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, për pjesëtarët e pakicës nacionale organizohet edhe mësimi i gjuhës së pakicës nacionale me elementet e kulturës nacionale (neni 5. al. 5.).

Për zhvillimin e arsimit fillor dhe të mesëm në gjuhët e pakicave nacionale është esenciale të sigurohen arsimtarët të cilët mund të ligjërojnë në këto gjuhë. Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut parasheh themelimin e katedrave dhe fakulteteve për arsimimin e nxënësve dhe arsimtarëve në gjuhët e pakicave nacionale. Në Strategjinë nacionale për hyrjen e Serbisë në Unionin evropian theksohet se, në fushën e arsimimit të pjesëtarëve të pakicave nacionale, nevojitet që me akte nënligjore të rregullohet para

së gjithash çështja e arsimimit dhe përsosjes së arsimtarëve të pjesëtarëve të pakicave nacionale.[38] Çështja e akteve nënligjore, gjithashtu, është theksuar edhe në ndryshimin dhe plotësimin e Programit nacional për integrimin e Republikës së Serbisë në Unionin evropian (2009).

Kur puna edukativo-arsimore zhvillohet në gjuhën dhe shkrimin shqip, siç është rasti me shkollat në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, shkolla është e obliguar që për nxënësit të organizojë mësimin e gjuhës serbe.

II.2.6. Tekstet mësimore për shkollën fillore të cilat i përdorin pjesëtarët e të gjitha pakicave nacionale

Sipas Ligjit për tekstet dhe mjetet tjera mësimore, tekstet, mjetet tjera mësimore dhe ndihmëse botohen në gjuhën serbe me shkrimin qirilik. Tekstet, mjetet tjera mësimore dhe ndihmëse botohen edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale për nxënësit për të cilët puna edukativo-arsimore zhvillohet edhe në atë gjuhë.[39] Pjesëtarët e pakicës nacionale mund t'i shfrytëzojnë edhe tekstet mësimore nga shteti amë, por vetëm në bazë lejes të ministrit të arsimit.[40]

Këshilli nacional për arsim, me propozimin e Entit për avancimin e arsimit dhe edukimit dhe të këshillit nacional të pakicës nacionale, në këtë rast Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare (KNPNSH), miraton planin e teksteve, mjeteve tjera mësimore dhe ndihmëse, në këtë rast të gjuhës shqipe, dhe për tekstet mësimore nga lënda me interes për pakicat nacionale.

Përveç së paku tri recenzioneve profesionale individuale, elaborati për tekstet, mjetet tjera mësimore dhe ndihmëse në gjuhën e pakicës nacionale, përmban edhe mendimin e këshillit nacional të pakicës nacionale. Disa nga zgjidhjet e mundshme janë përkthimi i teksteve mësimore ekzistuese nga gjuha serbe në gjuhën e pakicës nacionale, importimi i teksteve mësimore nga shteti amë dhe, natyrisht, përpilimi i teksteve të reja.

Këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare duhet ta konstatojë nevojën për tekstet, mjetet tjera mësimore dhe ndihmëse në gjuhën shqipe si dhe tirazhin e nevojshëm për vitin e ardhshëm shkollor dhe për këtë në afat ta njoftojë botuesin publik.

38 Ligji për tekstet dhe mjetet tjera mësimore (*Fl.zyrtare RS,* nr.72/2009)

39 Ligji për tekstet dhe mjetet tjera mësimore, neni 20 dhe 28 (*Fl. zyrtare RS,* nr. 72/2009)

40 http://www.mpn.gov.rs/prosveta/udzbenici/skolska-2013-2014-god/679-izvod-iz-registra-odobrenih-udzbenika-skolska-2013-2014-godina

Sipas çertifikatës nga regjistri i Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit tenologjik[41] për vitin shkollor 2013/2014, për lëndën e gjuhës serbe si gjuhë joamtare janë lejuar tekstet mësimore për shkollën fillore të paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1. – Tekstet mësimore për lëndën e gjuhës serbe si gjuhë joamtare

Klasa	Teksti mësimor	Autorët	Viti i botimit (ISBN)
parë	*Učimo srpski 1*, gjuha serbe si gjuhë joamtare	N. Dobrić, B. Maksimović	650-02-00090/2005 prej 3.10.2005.
dytë	*Učimo srpski 2*, gjuha serbe si gjuhë joamtare	N. Dobrić	650-02-00025/2005 prej 15.4.2005.
tretë	*Čarolija reči,* libra e leximit për klasën 3. të shkollës fillore	N. Dobrić	650-02-00098/2007-06 prej 17.5.2007.
tretë	*Pouke iz jezika,* për gjuhën serbe si gjuhë joamtare	N. Dobrić	650-02-00126/2007-06 prej 31.8.2007.
tretë	*Radna sveska uz čitanku,* për gjuhën serbe si gjuhë joamtarek,	N. Dobrić, M. Živković	650-02-00131/2010-06 prej 30.6.2010.
katërt	*Daj mi zvezdu jedan krug,* libra e leximit për klasën 4. të shkollës fillore	N. Dobrić, G. Štasni	650-02-00163/2007-06 prej 10.7.2007.
katërt	*Pouke iz jezika,* për klasën 4. të shkollës fillore	D. Zvekić-Dušanović, N. Dobrić	650-02-00174/2007-06 prej 16.7.2007.
katërt	*Radna sveska uz čitanku „Daj mi zvezdu jedan krug”*, për klasën 4. të shkollës fillore	N. Dobrić, G. Štasni	650-02-00132/2010-06 prej 13.4.2010.
pestë	*Pouke iz jezika,* për klasën 5. të shkollës fillore	M. Burzan, J. Jerković	650-02-00044/2008-06 prej 4.6.2008.
pestë	*Pegavo detinjstvo* – libra e leximit për gjuhën serbe si joamtarei	J. Ljuštanović	650-02-00233/207-06 prej 26.6.2008.
pestë	*Radna sveska uz čitanku „Pegavo detinjstvo“* për klasën 5. të shkollës fillore	N. Dobrić	650-02-00145/2010-06 prej 30.6.2010.
gjashtë	*Pouke iz jezika i pravopisa,* gjuha serbe si joamtare	M. Burzan, J. Jerković	650-02-.00310/2008-06 prej 30.6.2008.
gjashtë	*Pletivo od reči,* libra e leximit për gjuhën serbe si joamtare	N. Dobrić, D. Zvekić-Dušanović, G. Štasni	650-02-00311/2008-06 prej 1.7.2008.

41 http://www.mpn.gov.rs/prosveta/udzbenici/skolska-2013-2014-god/679-izvod-iz-registra-odobrenih-udzbenika-skolska-2013-2014-godina

gjashtë	*Radna sveska uz čitanku Pletivo od reči,* për klasën 6. të shkollës fillore	N. Dobrić, D. Zvekić-Dušanović, G. Štasni	650-02-319/2013-06, prej 7.11.2013.
shtatë	*U ogledalu sunca,* libri i leximit për gjuhën serbe si joamtare për klasën 7. të shkollës fillore	N. Dobrić, D. Zvekić-Dušanović, G. Štasni	650-02-00192/2009-06 prej 8.7.2009.
shtatë	*Gramatika za srpski jezik,* si gjuhë joamtare për klasën 7. të shkollës fillore	M . Burzan, J. Jerković	650-02-00181/2009-06 prej 7.7.2009.
shtatë	*Radna sveska za srpski jezik,* si gjuhë joamtare	N. Dobrić, D. Zvekić-Dušanović, G. Štasni	650-02-00177/2009-06 prej 7.7.2009.
tetë	*Gramatika 8* – gjuha serbe si joamtare për klasën 8. të shkollës fillore	M. Burzan, J. Jerković	650-02-00128/2010-06 prej 13.4.2010.
tetë	*Nedokučive tajne uma i srca* – libra e leximit për gjuhën serbe si joamtare për klasën 8. të shkollës filloree	G. Štasni, N. Dobrić	650-02-00155/2010-06 prej 21.7.2010.
tetë	*Radna sveska za srpski,* si gjuhë joamtare për klasën e 8. të shkollës fillore	D. Zvekić-Dušanović, N. Dobrić, G. Štasni	650-02-00584/2010-06 prej 21.9.2010.

II.2.7. Përgatitja profesionale e arsimtarëve për realizimin e arsimimit në kontekst të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në gjuhët e pakicave nacional

Sipas Rregullores për shkallën dhe llojin e arsimimit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollën fillore,[42] mësimin dhe format e punës edukativo-arsimore nga lënda e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në ciklin e parë të arsimimit dhe edukimit fillor – mund ta zhvillojnë këto persona:

1) profesori i gjuhës serbe dhe letërsisë në paralelet për pakicat nacionale;

2) profesori i gjuhës serbokroate dhe i letërsisë jugosllave për mësimin në gjuhën mësimore hungareze, rusine ose rumune;

3) filologu i diplomuar (serbist – gjuha serbe dhe linguistika) – mastër;

42 Rregullorja për shkallën dhe llojin e arsimimit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollën fillore, *Fl.zyrtare RS – Fletorja arsimit*, nr. 11/2012

4) profesori i gjuhës dhe letërsisë serbe;

5) profesori i gjuhës dhe letërsisë serbe me linguistikën e përgjithshme;

6) profesori i letërsisë dhe gjuhës serbe;

7) profesori i letërsisë dhe gjuhës serbe me letërsinë e përgjithshme;

8) filologu i diplomuar i gjuhës serbe me gjuhët jugosllave:

9) filologu i diplomuar i letërsisë serbe me letërsinë jugosllave;

10) profesori, respektivisht filologu i diplomuar për gjuhën serbokroate dhe letërsinë jugosllave;

11) profesori, respektivisht filologu i diplomuar për letërsinë jugosllave dhe gjuhën serbe;

12) profesori i gjuhës serbokroate dhe lingustikës së përgjithshme;

13) profesori për gjuhën serbokroate me gjuhët jugosllave;

14) profesori i gjuhës serbokroate me gjuhët sllovene perëndimore lindore;

15) profesori, respektivisht filologu i diplomuar për letërsitë jugosllovene dhe letërsinë e përgjithshme;

16) profesori i letërsisë jugosllovene me gjuhët e huaja;

17) filologu i diplomuar për gjuhën dhe letërsinë serbe;

18) filologu i diplomuar në gjuhën serbe dhe letërsinë;

19) profesori i mësimit klasor;

20) arsimtari i mësimit klasor;

21) filolog mastër (programi studimor: Gjuha serbe dhe letërsia, Letërsia serbe dhe gjuha, Letërsia serbe dhe gjuha me letërsinë e përgjithshme, Gjuha serbe, Letërsia serbe, Filologjia serbe (gjuha serbe dhe linguistika);

22) profesor mastër i gjuhës dhe letërsisë (programi studimor: Gjuha serbe dhe letërsia, Letërsia serbe dhe gjuha, Letërsia serbe dhe gjuha me letërsinë e përgjithshme, Gjuha serbe, Letërsia serbe, Filologjia serbe (gjuha serbe dhe linguistika);

23) mësues mastër;

24) mësues i diplomuar-mastër.

Personat të cilët diplomën e kanë arritur në gjuhën e pakicës (pik. 19), 20), 23) dhe 24) duhet të posedojnë njohuri të gjuhës serbe së paku në nivelin C1 (të kornizës së përbashkët evropiane) (Rregullorja për shkallën dhe llojin e arsimimit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollën fillore, al. 8.). Niveli i dijes C1 dëshmohet me çertifikatën për dhënien e provimit përkatës në ndonjë fakultet të mësuesisë/pedagogjik ose në katedrën për gjuhën serbe të fakulteteve përkatëse në Republikën e Serbisë. Personat nga pik. 3)–24) të këtij neni janë të obliguar ta japin provimin nga Metodika me bazat e glotodidaktikës, Metodikat e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare ose Linguistikën e kontaktit (lingustikën kontaktuese, Teorinë e gjuhës në kontakt) për pakicat tjera naconale dhe ta zotërojnë trajnimin për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në kohëzgjatje prej 20 orëve nën organizimin e Entit për avancimin e arsimimit dhe edukimit.

Mësimin dhe format tjera të punës edukativo-arsimore nga lënda e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në mësimin lëndor mund ta zhvillojë personi i cili e ka arritur arsimimin e lartë, edhe atë:

1) profesor i gjuhës serbe dhe letërsisë në paralelet për pakicat nacionale;

2) profesor i gjuhës serbokroate dhe letërsisë jugosllave për mësim në shkollat me mësim gjuhësor hungarez, rusin ose rumun;

3) filolog i diplomuar (serbist – gjuha serbe dhe linguistika) – mastër;

4) profesor i gjuhës serbe dhe letërsisë;

5) profesor i gjuhës serbe dhe letërsisë me linguistikën e përgjithshme;

6) profesor i letërsisë serbe dhe gjuhës;

7) profesor i letërsisë serbe dhe gjuhës me letërsinë e përgjithshme;

8) filolog i diplomuar i gjuhës serbe me gjuhët jugosllave;

9) filolog i diplomuar i letërsisë serbe me letërsitë jugosllave;

10) profesor, respektivisht filolog i diplomuar për gjuhën serbokroate dhe letërsinë jugosllave;

11) profesor, respektivisht filolog i diplomuar për letërsinë jugosllave dhe gjuhën serbokroate;

12) profesor i gjuhës serbokroate dhe linguistikës së përgjithshme;

13) profesor për gjuhën serbokroate me gjuhët jugosllave;

14) profesor i gjuhës serbokroate dhe gjuhëve perëndimore sllovene;

15) profesor, respektivisht filolog i diplomuar për gjuhët letërsitë jugosllave dhe letërsinë e përgjithshme;

16) profesor i letërsisë jugosllave me gjuhën e huaj;

17) filolog i diplomuar për gjuhën serbe dhe letërsinë;

18) filolog i diplomuar për letërsinë dhe gjuhën serbe;

19) filolog mastër (program studimor: Gjuha serbe dhe letërsia, Letërsia serbe dhe gjuha, Letërsia serbe dhe gjuha me letërsinë e përgjithshme, Gjuha serbe, Letërsia serbe, Filologjia serbe (gjuha serbe dhe linguistika),

20) profesor mastër i gjuhës dhe letërsisë (programi studimor: Gjuha serbe dhe letërsia, Letërsia serbe dhe gjuha, Letërsia serbe dhe gjuha me letërsinë e përgjithshme, Gjuha serbe, Letërsia serbe, Filologjia serbe (gjuha serbe dhe linguistika).

Personat nga pik. 3)–20) të këtij neni të Rregullorës për shkallën dhe llojin e arsimimit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollën fillore janë të obliguar ta japin provimin nga Metodika me bazat e glotodidaktikës, Metodikat e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare ose Linguistikën në kontakt (Linguistikën kontaktuese, Teorinë e gjuhës në kontakt) për të gjitha pakicat nacionale, përveç asaj sllovake dhe hungareze, dhe ta zotërojnë trajnimin për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në kohëzgjatje prej 20 orëve, në organizimin e Entit për avancimin e arsimimit dhe edukimit – Qendra për zhvillim profesional të të punësuarëve në arsim.

III. ANALIZA E GJENDJES, PROBLEMEVE DHE REZULTATEVE TË MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE NË SHKOLLAT FILLORE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

III.1. Korniza metodologjike dhe përshkrimi i studimit

III. ANALIZA E GJENDJES, PROBLEMEVE DHE REZULTATEVE TË MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE NË SHKOLLAT FILLORE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

III.1. KORNIZA METODOLOGJIKE DHE PËRSHKRIMI I STUDIMIT

Millica Rodiq, Dunja Polleti dhe Natasha Boshkoviq

Çështjet kryesore në të cilat janë bërë përpjekje të jepen përgjigje gjatë përpilimit të këtij Studimi kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike dhe mundësitë e avancimit të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në territoret e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Ekipi hulumtues e ka realizuar hulumtimin dhe ka ofruar analizën dhe konkluzionet tek të cilat ka ardhur me qasjen e kombinuar, respektivisht me aplikimin e metodave kualitative dhe kuantitative. Duke pasur parasysh se mësimi i gjuhës zyrtare të shtetit në kontekstin e integrimit të shoqërive të ndryshme është fushë e cila kërkon konsultimin e njohurive nga disa lëmi, dhe duke vlerësuar nevojën se vendimmarrësit dhe kreatorët e politikave publike veprimin e vet e mbështesin në fakte, është përzgjedhur qasja multidisciplinore.

Janë identifikuar aktorët kryesor, bashkëpunëtorët dhe palët e interesuara në nivelin lokal dhe qendror, është bërë analiza e gjendjes në terren, dhe pastaj janë hartuar kahjet e zhvillimit të ardhshëm. Është realizuar hulumtimi empirik në të gjitha shkollat fillore në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe (gjithsej 16 shkolla) në territorin e tri komunave. Me qëllim të analizimit të gjendjes në terren është testuar niveli i njohurisë së nxënësve në shkollat fillore dhe janë grumbulluar të dhënat për perceptimin e tyre të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare, vështirësive në të cilat hasin dhe nevojave të tyre në procesin e arsimimit formal. Të dhënat për mësimin dhe kuadrin mësimor janë grumbulluar me monitorimin e mësimit dhe intervistimin e arsimtarëve dhe drejtorëve. Të dhënat për qëndrimet dhe nevojat në lidhje me mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare janë grumbulluar nga përgjigjet të cilat i kanë dhëne nxënësit, prindërit, arsimtarët, drejtorët, vendimmarrësit në nivelin lokal dhe nacional dhe aktorët tjerë të rëndësishëm në mjediset lokale (kryetarët e tri komunave, kryetari KNPNSH, deputeti në Kuvendin e Republikës së Serbisë nga bashkësia shqiptare, këshilltari i arsimit nga drejtoria shkollore në Leskoc, përfaqësuesit e mediave, organizatat e shoqërisë civile, organet shtetërore, administratat komunale dhe sektori ekonomik). Rekomandimet për avancimin e mësimit janë përpiluar në bazë të analizës së të dhënave

të grumbulluara në përputhje me kornizën legjislative në fuqi, normat ndërkombëtare dhe standardet, duke marrë parasysh iniciativat të cilat në territorin e tri komunave janë realizuar me qëllim të avancimit të mësimit të gjuhës serbe, dhe përvojat e vendeve të caktuara në rajon.

Aktorët kryesor të ngarkuar për procesin e arsimimit janë:

- Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik,
- Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit,
- Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimimit dhe edukimit.

Aktorët në nivelin qendror të cilët marrin pjesë në krijimin e politikave publike nga fusha e arsimit për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë janë:

- Trupi koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë,
- Deputetët popullor në Kuvendin e Republikës së Serbisë nga komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Aktorët kryesor në nivelin lokal janë:

- Vetqeverisjet lokale të komnave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (kryetarët e komunave, kryeshefat për veprimtari shoqërore);
- Këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare;
- Shkollat (drejtorët, arsimtarët, nxënësit);
- Prindërit;
- Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe mediat;
- Përfaqësuesit e organeve shtetërore, administratat komunale dhe sektorit ekonomik.

Puna për grumbullimin e të dhënave në terren është realizuar në periudhën prej muajit mars deri në muajin qershor të vitit 2014, kur ekipi hulumtues ka qëndruar në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë.

Për nevojat e grumbullimit të të dhënave janë përpiluar instrumentet (pyetësorët dhe udhëzuesit) të cilët janë aplikuar sipas modelit metodologjik të cilin e paraqesim në vazhdim.

Procedura metodologjike për grumbullimin e të dhënave në shkolla:

1. **Testet për nxënësit** – Për vërtetimin e njohurive momentale të gjuhës serbe tek nxënësit dhe formulimin e bazave të ardhshme për përcaktimin e kahjeve të ardhshme të avancimit të mësimit – janë përpiluar teste të posaçme. Testet i kanë përpiluar ekspertët nga Fakulteti filologjik në Beograd, anëtarë të ekipit hulumtues. Përpilimit të testeve i ka paraprirë analiza e programit mësimor dhe teksteve mësimore, në bazë të së cilës është përpiluar testi dhe është përcaktuar shkalla e matjes së rezultateve të arritura.[43] Janë testuar nxënësit e klasës së katërt dhe klasës së tetë të të gjitha shkollave fillore në territorin e tri komunave në të cilat është organizuar mësimi në gjuhën shqipe.[44] Baza metodologjike nismëtare për përzgjedhjen e klasës njohuritë e të cilës janë testuar qëndron në modelin sistemor të definuar që klasa e katërt paraqet përfundimin e ciklit të parë të arsimimit, ndërsa e teta përfundimin e ciklit të dytë. Si rrjedhojë e kësaj supozohen dhe priten të arritura të caktuara të nxënësve në fund të këtyre dy cikleve. Janë testuar njohuritë e 438 nxënësve edhe atë të 224 nxënësve të klasës së katërt dhe 214 nxënësve të klasës së tetë.

2. **Bisedat me nxënësit** – Pas vlerësimit të rezultateve të testeve është përcaktuar numri i nxënësve (33) me rezultate të kënaqshme. Me ata ekipi hulumtues më vonë ka zhvilluar biseda, në prezencën e pedagogëve, arsimtarëve ose drejtorëve, për t'i vërtetuar faktorët ose agjentët e socializimit të cilët i kanë kontribuar nivelit më të lartë të njohjes së gjuhës serbe.[45]

3. **Pyetësori për nxënësit e shkollave fillore** – Pyetësorët i kanë plotësuar nxënësit e klasës së katërt dhe klasës së tetë, të cilët kanë marrë pjesë në testim,[46] dhe nxënësit e klasëve më të larta sipas përzgjedhjes së shkollave. Me qëllim të grumbullimit të sa më shumë shënimeve për perceptimin e nxënësve në lidhje me mësimin e lëndës së gjuhës serbe si gjuhë joamtare, ka qenë me rëndësi të përfshihen edhe nxënësit, njohuritë e të cilëve nuk janë testuar. Duke marrë parasysh se qëllimi i hulumtimit

43 Testi nuk është vlerësuar në sistemin e rregullt të arsimimit por është përpiluar vetëm për nevojat e hulumtimit. Numri më i madh i poenave i cili ka mund të fitohet në test ka qenë 100. Nxënësit të cilët kanë krijuar rezultat prej 60 e më shumë poenave, thënë kushtimisht, mirë e kanë punuar testin. Për shkak të numrit të vogël të nxënësve të cilët sipas shkallës dhe kriteriuemeve të definuara më parë mirë e kanë punuar testin, ekipi i ekspertëve e ka zbutur shkallën matëse, kështu që nxënësit që kanë realizuar 50 e më shumë poena janë marrë si shembull i nxënësve të cilët kanë arritur rezultate të kënaqshme dhe kanë treguar njohuri të gjuhës serbe. Më shumë për vet procesin e përpilimit dhe strukturës së tëstit shih në seksionin – III.5. Analiza e rezultateve të testimit.

44 Në komunën e Bujanocit – gjashtë shkolla fillore (një në qytet dhe pesë nëpër fshatra), në komunën e Preshevës shtatë shkolla fillore (një në qytet dhe gjashtë nëpër fshatra), në komuën e Medvegjës tri shkolla fillore (një në qytet dhe dy nëpër fshatra). Hulumtimi ka përfshirë shkollat qendrore, jo edhe paralelet e tyrë të ndara. Prej disa paraleleve të ndara nxënësit kanë ardhur në hapësirat e shkollave qendrore.

45 Njohuritë e nxënësve dhe faktorët shoqëror shtesë të cilët i kontribojnë mësimit të gjuhës serbe janë paraqitur në tekstin e mëtejmë në këtë kapitull.

46 Kjo është me rëndësi edhe për komparacionin e mëvonshëm të përgjigjeve të dhëna në pyetësorë me njohuritë e treguara të gjuhës serbe.

ka qenë identifikimi i mundësive për avancimin e kualitetit të punës me nxënësit e shkollave fillore dhe modernizimin e metodave të mësimit, është shumë me rëndësi që në hulumtim të përfshihen opinionet, qëndrimet dhe nevojat e nxënësve të klasëve të ndryshme, që më vonë të mund të përcaktohet prej cilës klasë do të aplikohet qasja tjetër e punës. Nxënësit e klasëve tjera më të ulëta nuk i kanë plotësuar pyetësorët ngase ajo mënyrë e grumbullimit të të dhënave është e papërshtatshme për fëmijët e asaj moshe. Pyetësori përbëhet prej 23 pyetjeve, të llojit të hapur dhe të mbyllur.[47] Me aplikimin e pyetësorit janë grumbulluar opinionet e nxënësve për mënyrën se si janë organizuar orët e gjuhës serbe, metodat të cilat i aplikojnë arsimtarët/et gjatë orës së mësimit; qëndrimet e nxënësve lidhur me atë se si dëshirojnë të organizohen orët e mësimit të gjuhës serbe, njësitë mësimore dhe përmbajtjet të cilat i synojnë dhe më lehtë i mësojnë; të dhënat për mënyrat shtesë, në çfarë rrethana dhe me cilët persona jashtë shkollës e përdorin (dëgjojnë, flasin) gjuhën serbe; perceptimi i nxënësve në lidhje me njohuritë e tyre të gjuhës serbe dhe aplikimit funksional të saj në të ardhmen. Gjithsej 733 nxënës të shkollave fillore i kanë plotësuar pyetësorët. Në mostër kanë hyrë 208 nxënës të klasës së katërt, 80 nxënës të klasës së pestë, 61 nxënës të klasës së gjashtë, 157 nxënës të klasës së shtatë dhe 227 nxënës të klasës së tetë. Në mostër ka pasur më shumë nxënës nga komuna e Preshevës (365), pas të cilës, me 345 nxënës, pason komuna e Bujanocit. Numër më i vogël i nxënësve vijnë nga komuna e Medvegjës (23 nxënës).

4. **Intervista me anë të anketimit**[48] **me arsimtarët** – Arsimtarët janë identifikuar si faktorë kryesor në procesin e transferimit të njohurive. Pyetësori për arsimtarët përmbanë 43 pyetje, të cilat kanë shërbyer për grumbullimin e të dhënave demografike në lidhje me kualifikimet e fituara dhe përgatitjen profesionale të arsimtarëve, mënyrat dhe qasjet në punën me nxënësit; opinionet në lidhje me tekstet mësimore, planin dhe programin, trajnimin dhe rekomandimin për përsosjen e mësimit për këtë lëndë. Pyetësori përmban pyetje të llojit të hapur dhe të mbyllur. Numri i arsimtarëve i përfshirë në këtë intervistë anketuese është 41.[49]

5. **Intervista anketuese me drejtorët e shkollave** – Janë intervistuar 15 drejtorë/drejtoresha të shkollave fillore dhe një zëvendës drejtor. Pyetësori me ndihmën e të cilit është zhvilluar intervista është përbërë prej 36 pyetjeve të llojit të hapur, të cilat janë ndarë në tërësitë tematike themelore: konteksti (numri i nxënësve në shkollë të cilët gjuhën serbe nuk e kanë gjuhë amtare), perspektivat (informacionet për raportin e prindërve ndaj mësimit të gjuhës serbe, vlerësimi i mënyrës në të cilën ligjërohet gjuha),

47 Pyetjet e llojit të mbyllur janë pyetjet tek të cilat paraprakisht janë definuar përgjigjet, derisa tek pyetjet e llojit të hapur të anketuarit/et përgigjen në formë të hapur.

48 Forma e intervistës anketuese nënkupton përpilimin e pyetësorit të cilin e plotëson hulumtuesi/ja gjatë intervistës me të anketuarin/en.

49 Analiza e përgjigjeve është përfshirë në kapitullin III. Gjatë përzgjedhjes së arsimtarëve me të cilët janë zhvilluar intervistat kemi bërë përpjekje që ta përfshijmë të gjithë kuadrin mësimdhënes i cili e ligjeron gjuhën serbe si gjuhë joamtare në këto shkolla.

mësimi (profili i kuadrit mësimor, materialet të cilët përdoren në mësim, metodat të cilat zbatohen në punë me nxënësit, trajnimi i kuadrit mësimor, qasja e kuadrit të kualifikuar, inovimi i mësimit me aplikimin e metodave të reja dhe propozimet për avancimin e mësimit), resurset (resursët të cilët i posedon shkolla dhe të cilët i kanë në dispozicion arsimtarët për ligjerimin e orëve të gjuhës serbe), mbështetja (investimi në kuadrin mësimor me organizimin dhe pjesëmarrjen në trajnime), aktivitetet (gatishmëria e drejtorëve të shkollave për organizimin e aktiviteteve të cilat do t'i ndihmojnë nxënësve që t'i avancojnë njohuritë e gjuhës serbe).[50]

6. **Vëzhgimi i mësimdhënies** – Ekipi hulumtues gjatë punës në terren dhe grumbullimit të të dhënave e ka vëzhguar mësimin e gjuhës serbe. Në secilën shkollë është vëzhguar zhvillimi i mësimit të klasës së ulët dhe të lartë. Për grumbullimin sa më të lehtë të të dhënave dhe sistematizimin e mëvonshëm dhe analizën e materialit të grumbulluar është përpiluar udhëzuesi për vëzhgimin e mësimit, i cili përmabn tri tërësi tematike themelore: përfaqësimi i gjuhës amtare dhe joamtare në orë, aktiviteti i nxënësve, llojet e detyrave dhe ushtrimeve të cilat u jipen nxënësve gjatë orës së mësimit. Përveç pyetjeve të lidhura me vet përmbajtjen dhe mënyrën e zhvillimit të mësimit, udhëzuesi për vëzhgimin e mësimit përmban edhe pyetje në lidhje me vijimin e rregullt të orëve të gjuhës serbe. Udhëzuesin për vëzhgimin e mësimit e kanë plotësuar hulumtuesit/et duke aplikuar metodën e vëzhgimit pa pjesëmarrje. Janë vëzhguar 32 orë mësimi të gjuhës serbe, 16 orë të klasëve të ulëta dhe 16 orë të klasëve të larta.[51]

7. **Intervista anketuese me prindërit** – Prindërit kanë rol aktiv në menaxhimin e shkollës duke marrë pjesë në punën e këshillit të shkollës. Prindërit të cilët janë anëtarë të këtij trupi janë ftuar në intervistë me hulumtuesit/et për perceptimin e rëndësisë së të mësuarit të gjuhës serbe për nxënësit. Ftesës për intervistë iu kanë përgjigjur prindërit e të gjitha shkollave, respektivisht 34 prej tyre. [52]

Procedura metodologjike për grumbullimin e të dhënave – intervistat me vendimmarrësit në nivel lokal dhe nacional:

Kryetarët e tri komunave, si përfaqësues të komunave, janë aktorë kryesor për marrjen e vendimeve dhe realizimin e tyre në përputhje me kompetencat e besuara nga fusha e arsimit në nivel lokal. Kryetari i KNPNSH, si përfaqësues i këtij trupi, ka rol shumë të rëndësishëm në definimin e politikave arsimore në përputhje me kompetencat e besuara me ligj. Deputetët popullor nga bashkësia shqiptare, në përputhje me mandatin në Kuvendin e Republikës së Serbisë, ndikojnë në krijimin e politikave publike nga fusha

50 Qëndrimet dhe propozimet e drejtorëve të shkollave janë përfshirë në kapitullin IV.

51 Analiza e materialit të fituar gjatë vëzhgimit të mësimit është prezantuar në kapitullin III.

52 Qëndrimet e prindërve janë prezantuar në kapitullin IV.

e arsimit. Këshilltari i arsimit i Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik i cili është kompetent për vlerësimin e punës profesionale të punëtorëve të arsimit dhe enteve. Në kompetencë të tij është edhe vlerësimi i kualitetit të mësimit, arsyeshmëria e vlerësimit dhe profesionaliteti i arsimtarëve. Me këta aktorë të lartëpërmendur është biseduar edhe për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, pastaj për profesionalitetin e kuadrit mësimor për këtë lëndë, për rëndësinë e të mësuarit të gjuhës serbe dhe rekomandimet për avancimin e kualitetit të mësimit. Të dhënat janë grumbulluar me ndihmën e udhëzuesit gjenerik për intervista i cili është përdorur në intervistë me secilin akter të lartëpërmendur veç e veç. [53]

Procedura metodologjike për grumbullimin e të dhënave dhe prezantimi i projekteve qëllimi i të cilëve është avancimi i njohurive të gjuhës serbe:[54]

1. Intervista anketuese me profesorët në projektin „Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë nga bashkësia shqiptare nga komunat Bujanoc dhe Preshevë“ – Për prezantimin e përvojave të fituara gjatë punës në projekt dhe përmbledhja e rekomandimeve për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare, është përpiluar pyetësori me të cilin janë zhvilluar intervistat me tri profesoresha të gjuhës serbe. Pyetësori përbëhej prej pyetjeve të hapura dhe të mbyllura. Tri profesoreshat e gjuhës serbe që janë intervistuar janë tw angazhuar në atë projekt.

2. Intervista anketuese me asistentët në projektin „Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë nga bashkësia shqiptare nga komunat Bujanoc dhe Preshevë“ – Është përpiluar pyetësorë i posaçëm për intervista me asistentët. Janë intervistuar dy nga katër asistentët në projekt. [55]

3. Fokus grupet me pjesëmarrësit „Shkolla e gjuhës serbe“ – Me pjesëmarrësit e projektit janë mbajtur fokus grupet për t'i fituar të dhënat në lidhje me motivimin dhe avancimin e njohurive të gjuhës serbe. Nga një fokus grup është organizuar në Bujanoc dhe Preshevë nga dhjetë pjesëmarrës.

4. Intervista anketuese me asistentët në projektin „Avancimi i aftësive gjuhësore të popullsisë pakicë në jug të Serbisë“ – Janë intervistuar gjashtë asistentë të cilët në kuadër të projektit të Misionit të

53 Analiza e intervistave me kryetarët e tri komunave, kryetarin e Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare dhe me deputetin popullor është prezantuar në kapitullin IV.

54 Shih Shtojcën 1.

55 Prej gjithësej katër asistentëve, dy janë të punësuar në shkollën fillore, si arsimtar të mësimit klasor, respektivisht në shkollën e mesme si profesor të gjuhës frenge. Nën supozimin e mësimit të dyanshëm dhe ndikimit të projektit dhe zhvillimin shtesë të kapaciteteve të personelit mësimor, janë zhvilluar intervista me dy asistentët në projekt. Opinionet e tyre për mësimin e gjuhës serbe dhe për mënyrën në të cilën ka ndikuar projekti në ndryshimin e qasjes në mësim, përmbahen në Shtojcën 1.

OSBE-së në Serbi kanë zhvilluar mësimin e gjuhës serbe në Skollën e mesme „ Sezai Surroi“ në Bujanoc. Në këtë mënyrë janë grumbulluar të dhënat në lidhje me përvojën e tyre gjatë punës gjashtë mujore me nxënësit. Pyetësori për intervista me asistentët përmban pyetje të llojit të hapur dhe të mbyllur.

5. Intervista anketuese me profesorët e gjuhës serbe në Shkollën e mesme „Sezai Suroi“ – Dy profesorë të cilët kanë marrë pjesë në realizimin e projektit të Misionit të OSBE-së në Serbi janë intervistuar nga hulumtuesit/et e angazhuar në përpilimin e Studimit. Pyetësori i përpiluar për këtë rast ka përmbajtur pyetje për grumbullimin e të dhënave në lidhje me komparacionin e metodave të ndryshme të punës në arsim dhe rekomandimet për punën e mëtejme në avancimin e mësimit të rregullt të gjuhës serbe.

6. Intervista anketuese me drejtorin e Shkollës së mesme „Sezai Suroi“ – hulumtueset e kanë intervistuar drejtorin e shkollës mesme. Janë grumbulluar të dhënat në lidhje me gjendjen momentale të mësimit dhe njohjes së gjuhës, qasjen e kuadrit arsimor i cili e ligjeron këtë lëndë, metodikën e mësimit, nevojat dhe rekomandimet në lidhje me përmirësimin e kualitetit të zhvillimit të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare.

7. Intervista anketuese me përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së në Serbi- Intervistat janë bërë nga tre anëtar të ekipit të projektit dhe shefin e zyrës lokale në Bujanoc. Për nevojat e bisedës me përfaqësuesit e OSBE-së është hartuar një pyetësor i posaçëm ku janë përmbledhur përvojat dhe janë dhënë rekomandime për të punuar në planin e përpilimit dhe përmirësimit të mësimit të gjuhës serbe për nxënësit nga bashkësia shqiptare.

Procedura metodologjike për grumbullimin e të dhënave lidhur me mendimet e përfaqësuesve të mediave[56] dhe shoqërisë civile[57] lidhur me mësimin e gjuhës serbe:

Rol të rëndësishëm në krijimin e opinionit publik kanë mediat dhe sektori civil. Prandaj studimi ka përfshirë edhe analizën e mendimit të përfaqësuesve të mediave lokale dhe organizatave të shoqërisë civile. Qëndrimet e tyre lidhur me mësimin e gjuhës serbe janë dhënë në kapitullin IV.

56 Në Bujanoc janë kryer biseda me përfaqësuesit e Radio-televizionit të Bujanocit dhe televizionin Spektri, si dhe përfaqësuesit e internet Titulli dhe Lugina lajm. Në Preshevë është biseduar me përfaqësuesin e internet portalit Presheva.com dhe RTV Preshevë. Përfaqësuesi i TV Aldi (Preshevë) nuk iu ka përgjigjur ftesës për të marrë pjesë në studim. Medvegja nuk e ka të zhvilluar sektorin medial lokal.

57 Në studim janë përfshirë përfaqësuesit e organizatave aktive joqeveritare (*Iniciativat qytetare* në Bujanoc dhe *Këshilli për të drejtat e njeriut* në Preshevë) dhe ata të clët në periudhën e kaluar janë marrë me cështjet e mësimit të gjuhës serbe (*International Human Center* në Preshevë dhe *Dituria* në Bilac, fshat në komunën e Bujanocit).

Qasja metodologjike për grumbullimin e të dhënave lidhur me mendimin e përfaqësuesve të organeve shtetërore[58] dhe sektorit privat[59] lidhur me mësimin e gjuhës serbe:

Njohja e gjuhës serbe është e domosdoshme për punësim dhe për të punuar në administratën shtetërore, por njëkohësisht është me rëndësi edhe për kryerjen kualitative të punëve në sektorin ekonomik. Për domethënien dhe rëndësinë e njohjes së gjuhës serbe është biseduar me përfaqësuesit e organeve shtetërore në këto komuna dhe përfaqësuesit e ekonomisë. Për rëndësinë e njohjes së gjuhës serbe për punën të cilën e kryejnë është biseduar edhe me të punësuarit në organet shetërore dhe komunale.[60] Për grumbullimin e të dhënave janë organizuar intervista me përfaqësuesit e administratës shtetërore dhe komunale dhe afaristët, kurse me të punësuarit është biseduar në kuadër të grupit qëllimor. Qëndrimet e tyre janë dhënë në kapitullin IV.

Qëllimet e studimit kanë përcaktuar metodat e grumbullimit të të dhënave dhe mënyrën e përpunimit të tyre. Një pjesë e informatave të cilat janë grumbulluar me anë të intervistimit me anketë në numër më të vogël të të pyeturve/pyeturave, respektivisht vëzhgimin e mësimit, është përpunuar në mënyrë kualitative. Metodologjia kualitative mundëson qasje thelbësore të gjendjes në terren, të kuptuarit e problemeve ekzistuese, kufizimet, por edhe interpretimin e propozimeve për tejkalimin e tyre.

Qasja kuantitative është përdorur për përpunimin e të dhënave të fituara me anë të pyetësorit për nxënës të shkollave fillore dhe intervistën e anketimit me arsimtarë/e. Janë përdorur metoda themelore deskriptive, si tabelar dhe grafikone për të treguar distribuimin e frekuencës së përgjigjeve ose prezantimin e të dhënave përmes tabelës së kontingjencës. Të dhënat më së shpeshti janë krahasuar sipas klasëve dhe komunave. Kurdo që është dhënë mundësia, pyetjet e hapura janë mbyllur në kategori më frekuente, që ka mundësuar që edhe këto përgjigje të marrin shprehje numerike.

Gjithashtu, statistikisht janë përpunuar edhe testet e njohjes së gjuhës serbe, ndaras për nxënësit e klasës së katërt, respektivisht të klasës së tetë. Janë krahasuar dallimet në mes të notave mesatare të marra sipas kompetencave për komunat Bujanoc dhe Preshevë, kurse rëndësia statistike e këtyre dallimeve është

58 Intervistat janë bërë me përfaqësuesit e Administratës tatimore, Shërbimit nacional për punësim, Stacionet e drejtorateve të policisë, përfaqësuesit e organeve të administratave komunale.

59 Janë intervistuar përfaqësuesit e ndërmarrjeve private – „Agro Adria“ (Bujanoc), „Saba Belča“ (Preshevë). Ftesa iu është dërguar edhe „Industrisë së Duhanit në Bujanoc“, „Elektrodistribucionit“ dhe „Bi voda“.

60 Të punësuarit në Administratën tatimore, Administratën e doganave, Stacionin e drejtorisë së policisë, administrata komunale dhe shërbimit të ofiqarisë janë pjesëmarrës të këtij grupi qëllimor.

verifikuar me T-teste.[61] Për shkak të dallimit në përbërjen etnike në komunën e Medvegjës,[62] me hulumtimin e atjeshëm është përfshirë numër dukshëm më i vogël i nxënësve se sa në Bujanoc dhe Preshevë. Prandaj rezutatet e marra në Medvegjë nuk janë metodologjikisht të përshtatshme për komparacion statistikor me rezultatet nga dy komunat tjera.

Përveç pjesës empirike dhe grumbullimit të të dhënave në terren, Përpilimi i studimit ka nënkuptuar aplikimin e metodës së analizës së të dhënave sekundare (desk analiza). Janë analizuar planet dhe programet për të gjitha klasët e shkollës fillore për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare dhe tekstet dhe manualet ekzistuese për arsimtarët e shtëpisë botuese "Enti për tekste dhe mjete të tjera mësimore". Studimi përmban përshkrimin e pjesëve relevante të kornizës legjislative në fuqi, lidhur me mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe vështrim i shkurtër në standardet ndërkombëtare në fushën e integrimit të shoqërive të ndryshme dhe mësimit të gjuhës zyrtare të shtetit në atë proces.

61 T-testet janë teknikë statistike me anë të së cilës verifikohet nëse mjediset aritmetike të dy grupeve të cilat i krahasojmë statistikisht, dallojnë dukshëm nga njëra tjera ose bëhet fjalë për variacion të rastësishëm në rezultate. Në rastin konkret, është verifikuar nëse notat mesatare sipas kompetencave në njërën komunë janë vërtet më të mëdha nga notat mesatare në tjetrën, respektivisht nëse mund të thuhet se nxënësit nga Bujanoci e kanë zgjidhur testin më mirë se sa nxënësit nga Presheva.

62 Në Shtojcën 2 janë paraqitur të dhënat e marra nga shkollat me numrin e nxënësve në secilën komunë.

III.2. Analiza e planit dhe programit mësimor për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për shkollën fillore

III.2. ANALIZA E PLANIT DHE PROGRAMIT MËSIMOR PËR GJUHËN SERBE SI GJUHË JOAMTARE PËR SHKOLLËN FILLORE

Dushanka Zvekiq-Dushanoviq

III.2.1. Pasqyrë e historisë së mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe programit për këtë lëndë

Në mjedisin tonë shumë nacional dhe shumëgjuhësor mësimi i gjuhës serbe si gjuhë joamtare ka rëndësi shumë të madhe dhe traditë të gjatë. Ajo rrjedh nga nevoja që nxënësve të cilët gjuhën serbe nuk e kanë gjuhë amtare t'iu sigurojë arsimim adekuat dhe të barabartë, me këtë edhe mundësi të përfshirjes në bashkësinë e gjerë shoqërore. Vihet re kontinuiteti në përpjekjet që këtyre nxënësve t'iu mundësohet arsimim në gjuhën amtare, duke mësuar gjuhën serbe si gjuhë joamtare (respektivisht gjuhës serbokroate si gjuhë të ambientit shoqëror, siç quhej në periudha të caktuara). Mësimi në gjuhët e pakicave nacionale, me mësim të domosdoshëm të gjuhës serbe, synon drejt dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë aditive[63] (sepse këta nxënës, përveç gjuhës amtare dhe gjuhës serbe mësojnë më së paku edhe një gjuhë të huaj) që nënkupton pasuri gjuhësore (dhe jo vetëm pasuri gjuhësore), e jo marrjen e një pjese të "terrenit" të një gjuhe në llogari të tjetrës.

Gjuha serbe/serbokroate si gjuhë joamtare ka filluar të mësohet si lëndë mësimore obligative në shkollën fillore dhe të mesme menjëherë pas Luftës së dytë botërore (Burzan 1984: 5). Që nga fillimi një nga qëllimet e këtij mësimi ka qenë që nxënësit të përvetësojnë gjuhën serbe në mënyrë produktive (më herët gjuhën serbokroate) dhe që të aftësohen për komunikim të përditshëm. Por, përmbajtja e mësimit të kësaj lënde deri në vitin shkollor 1966/67 nuk ka qenë e përshtatur ndaj qëllimeve të vëna. Programi i cili ka përcaktuar mësimin e numrit të caktuar të fjalëve në kuadër të tematikës së vënë dhe mësimi i bazave

63 Për dallimet në mes të dygjuhësisë additive dhe subtractive flet R. Bugarski (1997: 126–127). Dygjuhësia additive nënkupton shtesën e diturisë së arritur në gjuhën tjetër aftësive të përvetësuara më herët në gjuhën e parë, deri te e cila arrin në "rrethana të përshtatshme dhe me parashenjë pozitive psikologjike: gjuha tjetër përvetësohet sepse dëshirohet" (Bugarski 1997: 126). Përkundër kësaj, tipi subtraktiv i dygjuhësisë shënon situatën në të cilën "njohuritë në gjuhën tjetër arrihen në llogari të gjuhës së parë, të cilës kështu iu merret një pjesë e terrenit (...). Kjo mund të ndodhë në kushte të papërshtatshme, që bartin parashenjë negative: gjuha tjetër mësohet sepse është e domosdoshme" (Bugarski 1997: 126). Shembuj të dygjuhësisë suptraktive "janë të shpeshta te pakicat autoktone, të rrezikuara, të cilëve gjuha e dytë iu nevojitet në mënyrë pragmatike por është emocionalisht i padëshirueshëm si kërcënim ndaj identitetit etnik; kjo ndarje mundet negativisht të reflektohet edhe në gjuhën e parë " (Bugarski 1997: 127). Autori thekson se këto dukuri janë të përcjellura edhe me qëndrime të ndryshme ndaj gjuhës, dhe varësisht nga ato në mënyrë afatgjate mund të sjellin deri te ruajtja ose zgjerimi i gjuhës, por edhe deri te zëvendësimim tërheqja por edhe shuarja e gjuhës.

të gramatikës së gjuhës serbe, i cili është i përshtatur me metodën gramatikore-përkthyese të mësimit të gjuhës së huaj, nuk ka sjellur rezultate të dëshiruara, përkundër përpjekjeve që të aplikohen metodat bashkëkohore të mësimit. Deri në vitin 1966 nxënësit e gjuhës serbe si gjuhë joamtare kanë qenë të vendosur para materies së tërësishme gjuhësore të gjuhës serbe, përmbajtja nuk ka qenë e përpunuar në mënyrë sistemore për nevojat e mësimit të gjuhës tjetër. Janë përdorur tekste mësimore për gjuhën serbe si gjuhë joamtare, për një klasë- ose dy më të ulëta se sa ajo në të cilën janë nxënësit të cilët e kanë gjuhë joamtare.

Rëndësia e integrimit të njohurive bashkëkohore nga glotodidaktika (teoria e mësimit të gjuhës, parimisht të gjuhës së huaj/joamtare), psikologjisë, linguistikës dhe disciplinave tjera të ngjashme në konceptin e mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare, si dhe nevojën që mësimi i kësaj lënde të diferencohet varësisht nga gjuha amtare e nxënësve dhe ambientit në të cilin jetojnë, e kanë vënë re dhe e kanë aplikuar qysh në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit XX (më saktë në vitin 1966) anëtarët e Departamentit studimor të Entit Krahinor të Vojvodinës për botimin e teksteve për përpilimin e programit (atëherë të ri) për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare. Me këtë rast struktura e gjuhës serbe është shqyrtuar nga këndi i nevojës së mësimit të tij si gjuhë joamtare.Me këtë rast për herë të parë struktura e gjuhës serbe është sqyrtuar nga këndi i nevojës së mësimit të tij si gjuhë joamtare, nga i tërë materiali janë ndarë ato modele dhe elemente gjuhësore të cilat paraqesin minimumin e domosdoshëm për komunikim të përditshëm, janë dhënë udhëzime për realizimin e tipit të tillë të mësimit dhe janë paraqitur vështirësitë themelore në përvetësimin e gjuhës serbe varësisht nga gjuha amtare e nxënësit. Autorët e kësaj qasje, njëkohësisht edhe autorët e teksteve të para për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare, gjatë atyre viteve kanë organizuar seminare të numërta për arsimtar dhe në kontinuitet kanë përcjellur rezultatet e aplikimit të konceptit të ri. Sipas dëshmisë së autorëve,[64] nga të cilët disa në atë kohë kanë qenë profesor të Fakultetit filozofik në Novi Sad dhe themeluesit e grupit studimor në të cilin arsimohen profesorët e specializuar për mësim të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare (në përbërje të Departamentit të tanishëm për gjuhë serbe dhe linguistikë), këto aktivitete kanë tejkaluar kornizat e shtetit të atëhershëm. Në fakt, seminaret dhe ligjëratat janë mbajtur edhe në shtetet fqinje dhe kanë hasur në interesim të madh, duke qenë se koncepti ka qenë inovativ dhe ka paraqitur aplikim të konkretizuar të diturive më aktuale nga glotodidaktika. Ka qenë ky programi i parë i llojit të tillë në regjion i cili në disa qendra ka shërbyer si model sipas të cilit janë bërë programe për gjuhët e ngjashme dhe situata nacionale.

64 Intervista është zhvilluar në vitin 2007, me prof. dr Jovanom Jerkovićem, koautor i *Programit për gjuhën serbokroate si gjuhë joamtare*, manuali *Gjuha serbokroate në shkollat e kombësive – Manuali për mësuesit dhe arsimtarëte*, dhe teksteve të shumëta për gjuhën serbe si gjuhë joamtare dhe njërin nga iniciatorët dhe themeluesit e grupit studimor dhe programit *Gjuha serbokroate dhe letërsia jugosllave për profesorët në shkollat me mësim gjuhësor hungarez* (më vonë *Gjuha serbe dhe letërsia në departamentet për pakicat nacionale*, ndërsa tani *Filologjia serbe në kontakt me filologjinë hungareze/sllovake*) në kuadër të Seksionit për gjuhën serbe dhe linguistikën në Fakultetin filozofik në Novi Sad.

Viti 1966 ka qenë pra, kthesë në mësimin e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Në plan të parë vihet formimi dhe zhvillimi i shprehive folëse. Esencën e mësimit nuk e përbën as mësimi i fjalëve të izoluara as mësimi i gramatikës, respektivisht "nëse përvetësojmë çfarëdo fjalori të madh dhe mësojmë gramatikën, ende nuk do të arrijmë aftësinë e shfrytëzimit të gjuhës së re. Ato do të na ofrojnë njohuri për gjuhën, por jo edhe aftësinë që t'a përdorim atë" (Kočiš 1966: 13). Në këtë koncept merret qëndrimi "se përvetësimi i plotë i strukturës së gjuhës së re me anë të numrit minimal të fjalëve është mënyra më e mirë që të mësohet gjuha " (Kočiš 1966: 13). Mësimi i rregullave gramatikore zëvendësohet me aprovimin e formave themelore. Në shkallët e ulëta (deri në klasën e IV të shkollës fillore) parashikohet e ashtuquajtura "faza paragramatikore". Gjatë kësaj periudhe parashikohet që nxënësi të arrijë bazën e nevojshme të përvetësimit praktik të gjuhës. Gjuha parimisht mësohet me përvetësimin e aplikimit të drejtë të formave gjuhësore në kuadër të tërësive folëse në situatë reale folëse, pa sqarime gramatikore eksplicite. Pas kësaj gramatika në mësim futet gradualisht, por edhe më tutje punohet në ushtrimin e formave. Duke u mbështetur në njohjen e gramatikës së gjuhës amtare, fillojnë të jepen edhe përgjithësime më të vogla teorike, aplikohet terminologjia e nevojshme dhe bëhet sistematizimi. Gramatika duhet të jetë në funksion të përvetësimit të gjuhës, ajo nuk është qëllim për vetvete, por njohuritë nga ajo duhet të kenë vlerë praktike.

Programi i cili është përpunuar në bazë të konceptit nga viti 1966, për herë të parë jep sistemin e zotërimit gradual të elementeve thelbësore të sistemit të gjuhës serbe nga klasa fillestare deri në klasën përfundimtare të shkollimit të obligueshëm. Përmbajtja e mësimit është shpërndarë sipas parimit të ashtuquajtur "konceptet vertikale", që nënkupton se një numër i caktuar i strukturave nga klasa në klasë zgjerohet, ato zhvillohen dhe kombinohen, shkohet nga e thjeshta te e ndërlikuara, kurse materiali i ri mbështetet në atë të mëparshmen.

Zyrtarisht, me disa ndryshime të vogla në radhitjen e materialit dhe ndarjen në "themelore" dhe "të zgjeruar" është pjesë e programit për nxënësit e gjuhëve amtare edhe nga mjediset e ndryshme, ky koncept është prezent edhe sot.

Në ndërkohë ka qenë një përpjekje e ndryshimeve esenciale në shkollim. Në fakt, në vitin 2003 në Serbi ka filluar reforma e sistemit shkollor, janë planifikuar ndryshime rrënjësore si në sistemin e tërësishëm ashtu edhe në qasjen ndaj mësimit për çdo lëndë veç e veç. Në kuadër të kësaj janë hartuar programe të reja për klasën e parë të shkollës fillore. Por, në krahasim me lëndët tjera, programi për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare ka mbetur i papërpunuar, në fakt ka mbetur në vërejtjet hyrëse (Bazat e posaçme të programit shkollor 2003: 55; Fletorja Zyrtare e RS – Fletorja e Arsimit, 23 gusht 2003). Në ato theksohet rëndësia e kësaj lënde për arritjen e vetëdijes për të tjerët në ambientin përreth, për zhvillimin e vetëres-

pektit dhe vetëbesimit, për kualitetin e komunikimit nga i cili varet prosperiteti i individit dhe shoqërisë në tërësi. Rekomandohet që në mësimin e kësaj lënde gjuha të paraqitet si mjet natyror i komunikimit, theksohest se ky mësim duhet të paraqesë burim të mjaftueshmërisë, që duhet të stimulohet përmes qasjeve të "reja" në mësim, të bazuara në shkencë dhe metodologji dhe të harmonizuara mirë. Theksi është në marrjen parasysh të shkallës dhe llojit të dallimit në mes të gjuhës serbe dhe gjuhës amtare të fëmijëve, mjedisit gjuhësor dhe karakteristikave të mjedisit të drejtëpërdrejtë në të cilin fëmiu jeton, dhe dallimeve individuale në zotërimin e kompetencave gjuhësore në pikëpamje të gjuhës serbe në moshën parashkollore. Qëllimet dhe rezultatet nuk janë definuar, kurse në vend të kësaj rekomandohet që të merren parasysh Bazat themelore të Gjuhës së huaj dhe që "gjatë përpunimit të programit shkollor të gjejë atë masë në mes të këtyre dy modeleve që më së shumti iu përgjigjet nevojave specifike të fëmijëve në shkollën e dhënë". Është paralajmëruar edhe që programet për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare, gjatë implementimit, do të recenzohen dhe në rast të nevojës plotësohen me udhëzime profesionale. Përmbajtje të programit nuk ka, janë dhënë vetëm këto udhëzime të përgjithshme.

Ky process është ndaluar qysh në vitin 2004. Është vënë re kthimi në modelin paraprak të tërë sistemit, kurse sa i përket lëndës së Gjuhës serbe si gjuhë joamtare, kjo do të thoshte kthim në konceptin paraprak. Programet, rradhazi, nga viti në vit respektivhst nga klasa në klasë janë inovuar pak. Ndryshimi më i madh përbëhet në shtesën e teksteve mësimore të domsdoshme për përpunim (d.m.th. lektyrës). Verzionet e mëparshme të programit për shkollën fillore nuk kanë përmbajtur tekstet e përshkruara, zgjedhja është varur nga autorët e teksteve të cilët janë udhëhequr parimisht me seksionin në të cilin rekomandohen fusha të caktuara tematike dhe udhëzime për realizimin e programit. Në periudhën 2005–2010 janë shtypur komplete të reja të teksteve mësimore për të gjitha klasët e shkollës fillore me manualet përcjellëse për arsimtarë, të harmonizuara me programet novatore, kurse në edicionin e Entit për tekste të Beogradit.

III.2.2. Gjuha serbe si gjuhë joamtare në planin mësimor të arsimit dhe edukimit fillor sot

Sipas planit mësimor të arsimimit dhe edukimit themelor,[65] lënda e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare është përfaqësuar në të gjitha klasët e shkollës fillore dhe është e domosdoshme për të gjithë nxënësit të cilët mësimin e ndjekin në gjuhën e pakicave nacionale. Në klasën e parë dhe të dytë plani mësimor për këtë lëndë përcakton dy orë shkollore në javë (72 orë në nivel vjetor) nga klasa III deri në klasën e VII tri orë në javë (108 orë në nivel vjetor), si dhe në klasën e VIII dy orë në javë (68 orë në nivel vjetor, duke qenë se viti shkollor për nxënësit e klasës VIII përfundon më herët). Nga këto të dhëna shihet se numri i përgjithshëm

65 http://www.zuov.gov.rs/novisajt2012/naslovna_nastavni_planovi_programi.html

i orëve për pjesëtarët e pakicave nacionale në krahasim me pjesëtarët e popullatës shumicë është më i madh për respektivisht tri orë në javë.

III.2.2.1. Struktura e programit mësimor për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare

Programi për lëndën Gjuhë serbe si gjuhë joamtare është unik për të gjithë nxënësit të cilët mësimin e ndjekin në një nga gjuhët e pakicave nacionale.[66] Në kuadër të kësaj ekziston diferencimi i cili përbëhet nga fakti se në kllapa të pjerrëta janë shënuar "përmbajtje të zgjeruara programore për të cilat orientohet organizata edukativo-arsimore me propozim të arsimtarëve varësisht nga niveli i njohurive të nxënësve, përbërjes nacionale të mjedisit, afërsisë së gjuhës së nxënësve dhe gjuhës joamtare, etj.".[67]

Në fillim të programit janë dhënë *Qëllimet dhe detyrat* e lëndës Gjuha serbe si gjuhë joamtare nga klasa e I deri në klasën e VIII të shkollës fillore. Pas kësaj, në kuadër të programit për çdo klasë veç e veç, janë dhënë Detyrat operative, të cilat qëllimet e përgjithshme dhe detyrat, të dhëna për tërë shkollën fillore i shpërndan në tetë segmente. Segmentin qendror të programit e përbëjnë Përmbajtjet e rradhitura në seksione.

Në fund të programit për çdo klasë gjendet kapitulli *Mënyra e realizimit të programit*, në të cilin sqarohet vetë struktura dhe koncepti i programit për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare, shprehen sqarimet lidhur me mësimin e kësaj lënde si dhe në mënyrë të detajuar tregohen funksionet dhe mënyra e përpunimit të fushave të caktuara.

III.2.2.2. Qëllimi dhe detyrat e lëndës Gjuha serbe si gjuhë joamtar

Në programet prej klasës së I deri në klasën e VI[68] qëllimi dhe detyrat e lëndës Gjuha serbe si gjuhë joamtare janë formuluar në këtë mënyrë:

„**Qëllimi** i mësimit të gjuhës serbe është që nxënësit të zotërojnë gjuhën serbe në mënyrë produktive në kuadër të materies së parashikuar gjuhësore dhe leksike, të njohin elementet kulturore të popullit i cili

66 Në Republikën e Serbisë mësimi, përvec në gjuhën serbe, zhvillohet edhe në gjuhën shqipe, bullgare, hungareze, rumune, rusine, sllovake dhe kroate.

67 Se si pasqyrohet kjo në program, do të ilustrohet me shembujtë në tekstin e mëtejmë të analizës.

68 http://www.zuov.gov.rs/novisajt2012/naslovna_nastavni_planovi_programi.html

flet me këtë gjuhë dhe të aftësohen për marrëveshje, socializim dhe afrimitet me pjesëtarët e popullatës shumicë dhe nacionaliteteve tjera.

Detyrat e mësimit të gjuhës serbe janë që nxënësit:

- në mënyrë produktive të zotërojnë gjuhën e folur në kuadër të strukturave themelore gjuhësore dhe fjalorin prej rreth 2000/3000/[69] fjalëve dhe shprehjeve frekuente;
- kuptojnë bashkëbiseduesin dhe shprehjet gojore për temat nga jeta e përditshme;
- miratojnë shqiptim të saktë dhe intonacion gjatë të shprehurit me gojë dhe leximit;
- aftësohen për bisedë për temat nga jeta e përditshme;
- mësojnë dy shkrimet serbe dhe bazat e drejtshkrimit për shkak të shprehjes korrekte brenda kufinjve të strukturave të aprovuara gjuhësore dhe leksikës;
- njohin ligjshmëritë elementare të gjuhës serbe;
- kuptojnë tekste të zhanreve të ndryshme në kuadër të tematikës së caktuar;
- njihen me karakteristikat themelore të kulturës së popullit gjuhën e të cilit e mësojnë;
- arrijnë shprehi të përdorimit të pavarur të fjalorit dhe doracakëve gjuhësor dhe aftësohen për informim, arsimim dhe vetarsimim në gjuhën serbe;
- zhvillojnë interesime dhe motivim për mësimin e gjuhës serbe dhe kështu arrijnë kompetenca më të mëdha komunikative dhe aftësi të të menduarit në atë gjuhë".

Në periudhën e viteve 2001–2003 në programet për klasën e VII dhe të VIII janë inovuar kërkesat dhe standardet e arritjeve arsimore:[70]

„**Qëllimi** i mësimit të Gjuhës serbe është që të sigurohet që të gjithë nxënësit të arrijnë shkrim leximin bazë dhe të përparojnë drejt realizimit të Standardeve të përshtatshme të arritjeve arsimore, që të aftësohen për të zgjidhur probleme dhe detyra në situata të reja dhe të panjohura, të shprehin dhe të shpjegojnë mendimet e veta dhe të diskutojnë me të tjerët, zhvillojnë motivimin për mësim dhe interesim për përm-

69 Në kllapat e pjerrëta gjendet numri i fjalëve të cilat duhet të aprovohen nëse punohet sipas programit të zgjeruar.

70 Qëllimet të cilët në këto klasë janë risi janë formuluar ngjajshëm si për lëndën Gjuha serbe, dhe vërehet se, me dallime të vogla, janë vendosur për të gjitha lëndët. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se edhe standardet për gjuhën serbe si gjuhë joamtare nuk janë bërë ende.

bajtje të lëndëve, si dhe në mënyrë produktive të zotërojnë gjuhën serbe në kuadër të materies gjuhësore dhe leksike, të njohin elementet e kulturës së popullit të cilët flasin me atë gjuhë dhe të aftësohen për mirëkuptim, socializim dhe afrimitet me pjesëtarët e popullatës shumicë dhe nacionaliteteve tjera."

III.2.2.3. Pasqyra e programit sipas seksioneve

Përmbajtja e programit për çdo klasë përfshin më shumë seksione, me ç'rast në të theksohet se të gjitha elementet e tij janë të ndërlidhura në mes veti dhe kështu duhet të realizohen.

Tabela 2.2.1. – Pasqyra e seksionit dhe përfaqësimi i tyre sipas klasëve:

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Tematika	+	+	+	+	+	+	+	+
Materia gjuhësore	+	+	+	+	+	+	+	–
Ushtrime foljore	+	+	+	+	+	+	+	+
Leximi dhe shkrimi	–	/+/	+	+	+	+	+	+
Drejtshkrimi	–	–	+	+	+	+	+	+
Gramatika	–	–	–	+	+	+	+	+
Formimi i fjalëve	–	–	–	–	+	+	+	–
Lektyra	–	–	–	–	+	+	+	+

Seksioni **Tematika** përmban tema dhe situata në të cilat përvetësohet gjuha. Përfshin më shumë fusha tematike (p.sh. shkolla, familja dhe shtëpia, rrethi i ngushtë dhe i gjerë, natyra dhe shoqëria, temat aktuale, koha e lirë e nxënësve, nga jeta e të rinjëve…), nga të cilët disa paraqiten në klasë të ndryshme. Por, kjo përsëritje është krejtësisht e arsyetuar, duke qenë se pritet që fusha e njëjtë tematike, varësisht nga njohja e gjuhës, interesimi dhe mosha e nxënësit, realizohet me përmbajtje të ndryshme dhe mjete të ndryshme gjuhësore. Kështu, për shembull, fusha tematike *Shkolla* në klasën e I përfshin ambientin dhe lëndët me të cilat hasin nxënësit e kësaj moshe, si edhe situata në të cilat gjenden (mësonjtorja, mobiljet, mjetet themelore shkollore; oborri shkollor, ndërtesa shkollore; personeli i shkollës, nxënësit; situatat

gjatë kohës së mësimit dhe gjatë kohës së pushimit, solemnitetet dhe festat), përderisa fusha e njëjtë tematike në klasën e VIII përfshin situata të cilat janë më të përshtatshme për nxënësit e kësaj moshe (shkollat fqinje- në vend ose ambientin përreth; takimet e ndërsjella të nxënësve– bashkëpunimi, konkurrenca, korrespondenca; llojet e sporteve; përjetimet e nxënësve nga jeta e përditshme, nga pushimet verore dhe dimërore).

Në kuadër të këtij seksioni janë dhënë edhe format e trajtimit (përshëndetja, adresimi, prezantimi, lutja, falënderimi…), që aprovohen gradualisht, nga më të thjeshtat deri te më të ndërlikuarat, si dhe shërbejnë për përvetësimin e gjuhës autentike dhe realizimin e komunikimit natyral.

Funksioni themelor i këtij seksioni respektivisht fushave tematike të dhëna në të, është që të sigurojë aprovimin e modeleve gjuhësore dhe aprovimin e leksikës së caktuar. Me këtë rast, modelet gjuhësore janë dhënë në mënyrë precize në program (në kuadër të seksionit Materia gjuhësore) dhe rekomandimi është që modeli i caktuar gjuhësor të aprovohet në materien më të përshtatshme tematike. Nga ana tjetër, në program nuk janë dhënë fjalët dhe shprehjet të cilat duhet të përvetësohen. Seksioni Tematika ka për qëllim edhe të orientojë arsimtarët dhe autorët e teksteve për zgjedhjen e leksikës së përshtatshme. Lidhur me zotërimin e fondit të caktuar të fjalëve në program, në fazën e parë, përparësi i jep fondit minimal produktiv në procesin e mësimit të elementeve të rëndësishme të gjuhës. Pasurimi i fjalorit duhet të shkojë gradualisht, paralelisht me zhvillimin e përgjithshëm dhe me zhvillimin e të shprehurit në gjuhën amtare. Programi jep edhe rekomandime për semantikën e fjalëve (= sqarimi i kuptimit) dhe asimilimi i tyre (= përvetësimi). Në semantikën e fjalëve sugjerohet përdorimi i lëndëve konkrete dhe mjeteve të ndryshme vizuele. Sa i përket asimilimit, theksohet nevoja e përvetësimit të fjalëve në kontekst, në fjali, lidhur me situatën e caktuar folëse. Tërhiqet vëmendja edhe në dallimin e fondit produktiv dhe receptive të fjalëve dhe shprehjeve.

Seksioni **Materia gjuhësore** përmban modele gjuhësore të cilat janë ilustruar me fjali konkrete. Në program janë dalluar modele të cilat duhet të sigurojnë zotërimin e një pjese të madhe të gjuhës së folur. Përvetësimi i gjuhës fillon me ushtrimin e modelit në formën themelore, pastaj parashikohet zgjerimi i tyre gradual dhe kombinimi i ndërsjellë. Materia është kumulative sepse e reja gjithmonë mbështetet në atë të mëparshme. Modelet nga klasa në klasë jepen me mjete të tjera gjuhësore dhe leksike. Radhitja e aplikimit të elementeve të reja parashikon shkallshmërinë dhe aplikimin e elementeve të reja një nga një në modelin gjuhësor. Për përvetësimin e materies gjuhësore programi rekomandon shfrytëzimin e llojeve të ndryshme të ushtrimeve manipulative (ushtrime të përsëritjes gojore, përgjigjet në pyetje, supstitucionet,

transformimet, plotësimet, përpilimin e fjalive nga elementet e dhëna dhe fjalëve të dhëna sipas modelit, lidhja e fjalive, variacioni i modelit, zgjerimi dhe shkurtimi i fjalive…) funksioni i të cilit është ushtrimi, forcimi dhe automatizimi i modeleve gjuhësore. Ato duhet të jenë të kontrolluara rreptësisht për të ushtruar përdorimin e drejtë gramatikor. Pritet që pas automatizimit të modelit gjuhësor nxënësi do të mund të ndërtojë konstrukcione analoge dhe t'i përdorë me përmbajtje të re konkrete në harmoni me qëllimin komunikativ. Kusht për të kaluar në ushtrimin e modelit të ri është përvetësimi i modelit të mëparshëm, kurse koha e cila duhet kushtuar ushtrimit të një modeli varet nga karakteristikat e gjuhës amtare, d.m.th. ndikimit të mundshëm të gjuhës amtare në elementet e gjuhës e cila mësohet. Në seksionin Materia gjuhësore përmbajtjet e caktuara janë shënuar me kllapa të drejta, me çka theksohet se janë parashikuar për përvetësim në mjediset në të cilët ekziston mundësia e mësimit të shpejtë të gjuhës serbe.

Shkallëzimi në aplikimin e elementeve të reja në model, si dhe dallimin e pjesës themelore dhe të zgjeruar të Programit e ilustrojmë në shembullin e modelit për shprehjen e marrëdhënieve hapësinore:

Modeli gjuhësor: Shprehja e marrëdhënieve hapësinore[71]

Klasa I: Ushtrohen ndajfoljet themelore të kohës (psh. *këtu, atje, afër, largë*), rasa vendore me parafjalët *te* dhe *në* (që përgjigjet në pyetjen *ku*?) dhe rasën kallëzore me parafjalët *te* dhe *në* (që përgjigjet në pyetjen ku?). Shembujt: *Maria ulet këtu. Tavolina është në dhomë. Gota është në tavolinë. Zorani vrapon në park. Jelena ngutet për në postë.*

Klasa II: Ushtrimi i ndajfoljeve të reja të vendit (psh. *përpara, mbrapa, këtu, atje, majtas, djathtas, drejtë*) *dhe formave të shumësit të emrit në* rasën vendore dhe rasën kallëzore. Shembuj: *Ata shkojnë djathtas. Nxënësit ulen në karriga. Ata vendosin fletoret në banka.*

Klasa III: Ushtrimi i ndajfoljeve të reja të vendit (psh. andej, këndej, atje), dhe emrave dhe përemrave vetor në rasën gjinore me ndajfoljet *përpara, mbrapa, afër, te*. Shembuj: *Jelena kaloi këndej. Maria ulet mbrapa Ivankës (asaj). Ulet afër Petrit (atij).* Ai është në shtëpi. Petri ishte te mjeku. Pjesa e zgjeruar e Programit për këtë model në klasën e 3 përfshin: /Ushtrimin e emrave në rasën dhanore pa ndajfolje. Shembuj: *Ajo shkon te mjeku. Jovani iu ofrua plakut. Treni poi u ofrohet detit*./

71 Në secilën klasë është paraparë edhe ushtrimi i modeleve nga klasët e mëparshme. Pasqyra e formave dhe modeleve këtu është më e thjeshtë dhe më e shkurtër në krahasim me tekstin origjinal në Program me qëllim të shmangies së shikimit dhe përsëritjes. Me klasën e gjashtë përfundon koncepti i zotërimit të gjuhës përmes ushtrimit të modeleve gjuhësore, kurse lënda në klasën e shtatë dhe të tetë sistemohet nga këndi i gramatikës eksplicite. Në klasën e shtatë, për shembull, për shprehjen e hapësirës mësohet në kuadër të kuptimit dhe funkcionit të rasave, ndërsa në klasën e tetë në kuadër të fjalive të varura (fjalitë vendore).

Klasa IV: Ushtrimi i rasës gjinore, emrave dhe përemrave vetor me ndajfoljet *mbi, nën, nga prej*. Shembuj: *Jovani banon nën Petrin (nën atë). Zogu fluturon mbi shtëpi. Fëmijët kthehen nga shëtitja. Nxënësit dalin prej klasës. Nën neve është uji.* Pjesa e zgjeruar e Programit për këtë model në klasën e 4 përfshin: /Ushtrimin e rasës dhanore me ndajfoljet *te* dhe *kah*. Shembuj: *Vajza noton kah bregu. Treni shpejton kah Beogradi.*

Klasa V: Ushtrimi i rasës gjinore të shumësit të emrave dhe përemrave vetor. Shembuj: *Milica qëndron prapa shokëve (prapa tyre). Zogjët fluturojnë mbi shtëpi. Nxënësit dalin nga klasët.* Pjesa e zgjeruar e Programit për këtë model në klasën e 5 përfshin: / Ushtrimin e rasës kallzore me ndajfoljet nën, para, gjatë. Përcaktimi i emrave me mbiemra. Shembuj: Vuri çantën nën ulëse. U përkul përgjatë tavolinës. Ai doli para shtëpisë. Vuri kashtë nën kuajt e lodhur.

Klasa VI: Ushtrimi i rasës kallzore me ndajfoljen *me anë të*. Me emrin në funksion të klauzolës për kohën (vendore, kallzore, gjinore) të përdoren edhe mbiemra të cilët përshtaten me ato në gjini, numër dhe rasë. *Shkon nëpër mal. Treni kalon nëpër tunelet e errëta. Fëmijët lozin në livadhin e gjelbër. Shkoi në oborrin e madh fqinj. Ai banon afër fqinjit tonë të parë.* Pjesa e zgjeruar e programit për këtë model në klasën e 6 përfshin: /Ushtrimi i instrumentalit me dhe pa parafjalë *nën, para, mbi* dhe kallzore me parafjalët *me, një sërë.* Emrat të caktohen me mbiemër. Shembuj: *Milani shkon rrugës. Maca është nën tavolinë. Djali qëndron para shtëpisë. Alpinistët janë ngjitur rrugës së pjerrët. E pritën arsimtarin para oborrit të shkollës. Mbi oxhakun e lartë qarkullonin lejlekët. Ai shkon tatëposhtë (tatëpjetë) shkallëve të pjerrëta.*

Seksioni **Gramatika** është përfaqësuar nga klasa IV. Nga kjo shihet se koncepcioni i programit për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare niset nga qëndrimi se gjuha dhe rregullat e saj së pari përvetësohen në mënyrë intuitive (më së shumti me anë të përvetësimit të modeleve gjuhësore në moshë më të re), kurse sqarimet gramatikore dhe udhëzimet aplikohen gradualisht, kur sistemi gjuhësor në vëllim të caktuar është përvetësuar globalisht dhe kur mundësitë psikofizike të nxënësve e lejojnë këtë. Por, është me rëndësi që të kuptohet drejtë roli i gramatikës në këtë mësim sepse ajo duhet të jetë mjet që të mësohet gjuha, dhe jo që të arrihen dituri mbi atë. Kjo do të thotë se nxënësit nuk duhet të mësojnë rregullat gramatikore, paradigmat dhe definicionet përmendësh, por që të aftësohen për përdorimin e tyre në komunikim. Përveç kësaj, qëllimi i mësimit të gramatikës është edhe zhvillimi i aftësisë për vetë-korrigjim. Në mësimin e gramatikës programi rekomandon metodën induktive, udhëzimin e nxënësve për të nxjerrë përfundime për ligjet dhe rregullat e funksionimit të gjuhës, ndihmën e arsimtarëve në pikëpamje të udhëzimeve të shkurtëra dhe ushtrimet. Programi sugjeron edhe qasjen e arsimtarit në karakteristikat e gjuhës amtare që të mund të sqarojë nocionet të cilat dallohen në ato dy gjuhë. Sqarimet duhet t'iu përshtaten moshës dhe njohurive të nxënësit. Edhe në këtë seksion është parashikuar pjesa e zgjeruar për nxënësit të cilët përparojnë më shpejtë në zotërimin e gjuhës serbe.

Seksionet **Ushtrimet foljore** dhe **Leximi dhe shkrimi** kanë për qëllim që të tejkalohen kufinjtë e mësimit receptiv-reproduktiv dhe të mos ngecet vetëm në përgjigjen e pyetjeve të pazhvilluara, të ngushtuara dhe të varfëruara. Me të folur dhe me të shkruar zhvillohet aftësia e të shprehurit më të gjatë të mendimeve të ndërlidhura dhe aftësia e komunikimit në situatë reale. Në program insistohet në krijimin e situatave reale komunikative që do të stimulojnë nxënësit në iniciativë verbale. Ushtrimet komunikative ndërlidhen në ato manipulative[72] ashtu që në to në mënyrë të lirë, funksionale përdoren modelet e ushtruara paraprakisht.

Synimi i seksionit **Drejtshkrimi** është në ato kategori në të cilat ekzistojnë dallime në krahasim me normën drejtshkrimore të gjuhës amtare, kurse është parashikuar edhe ushtrimi i i atyre rregullave të cilat janë identike në dy gjuhë për të evituar gabimet që janë evidentuar në detyrat me shkrim të nxënësve. Për përpunimin e materies me shkrim janë planifikuar 2–3 orë në vit, me ç'rast është rekomanduar që ai fond të zhvillohet në numër më të madh (10–12) ushtrime që do të përputhen në orët e gramatikës dhe ushtrimeve me shkrim. Përveç kësaj parashikohet, edhe kontrollimi i normave drejtshkrimore (diktimet, fletushkat mësimore në të cilat duhet të bëhen përmirësimet, etj.).

Në seksionin **Formimi i fjalëve** (klasa V–VII) janë përfshirë prapashtesat produktive për ndërtimin e: emrave të cilat përcaktojnë kryesin e veprimit, emrat që përcaktojnë personat e gjinisë femërore, etnika, diminutiva, augmentativa, hipokoristika, emrat e përgjithshëm dhe përemrat pronor. Përvetësimi i këtyre modeleve formuese ka për qëllim pasurimin e fjalorit të nxënësve dhe aftësimin e tyre për formimin e fjalëve të tyre me analogji ndaj atyre ekzistuese.

Seksioni **Lektyra** (klasa V–VIII) është parashikuar të jetë punë dore dhe të ketë funksionin që nxënësit të mësohen të lexojnë në vete dhe të aftësohen që në mënyrë të pavarur të arrijnë deri te njohuria në gjuhën serbe. Programi përshkruan një numër të caktuar të teksteve (letrare dhe shkencore-popullore, si dhe nga fletushkat për fëmijë dhe të rinjë) të cilat duhet të lexohen sipas zgjedhjes personale apo rekomandimit të arsimtarëve.[73] Edhe në këtë seksion theksohet rëndësia e motivimit. Propozohet, për shembull leximi i fragmentit të zgjedhur gjatë orës si stimulim për leximin e tërë tekstit në shtëpi. Diferencimi varësisht nga mundësia e nxënësve mund të bëhet në mënyra të ndryshme: me ndarjen e tekstit më të gjatë në pjesë,

72 Llojet themelore të ushtrimeve manipulative janë theksuar në pasqyrën e seksionit Materia gjuhësore. Qëllimi primar i tyre është krijimi i shprehive për përdorimin e drejtë të elementeve gjuhësore, d.m.th. zhvillimi i aftësive për përdorimin e drejtë të shprehjeve gramatikore, pavarësisht nga konteksti komunikativ.

73 Formulimi i tillë qëndron në fund të Programit, në kuadër të rekomandimeve për organizimin e punës edukativo-arsimore. Në përmbajtjen e Programit për klasën e pestë, gjashtë dhe të shtatë, ku jipet lista e lektyrës (lista e autorëve dhe titujtë e veprave), nuk është theksuar nëse të gjithë titujtë janë të obliguar të përpunohen në të gjitha paralelet apo duhet të interpretohet si listë nga e cila bëhet përzgjedhja. Në klasën e tetë, pas listës së lektyrës (me autorët dhe titujtë e theksuar) qëndron vërejtja „përzgjedhja e obliguar e së paku pesë titujve për përpunim".

me dhënien e detyrave të rëndësisë së ndryshme, me zgjedhjen e teksteve më të shkurtëra dhe më të lehta, etj. Nxënësit të cilët më mirë e njohin gjuhën serbe dhe zotërojnë pjesën e zgjeruar të programit, gradualisht si edhe në orët e gjuhës amtare, futen në analizën e tekstit të lektyrës.

III.2.2.4. Udhëzimet e përcaktuara për mënyrën e realizimit të programit

Programi mësimor[74] për çdo klasë përmban udhëzime për mënyrën e realizimit të tij dhe organizimin e punës edukativo-arsimore. Parametrat kryesore, me pak fjalë mund të përmblidhen si më poshtë:

- rëndësia e pjesëmarrjes aktive në mësim;
- rëndësia e planifikimit të arsimtarit, udhëheqjes dhe organizimit të procesit mësimor;
- aktivitet verbale sa më të shpeshta të çdo nxënësi;
- respektimi i parimeve të individualizimit në punë;
- uniteti i programit për të gjitha nacionalitetet, por edhe nevoja për t'u përkujdesur për marrëdhënien e gjuhës serbe dhe gjuhës së nxënësit;
- dëshira për njohjen e strukturës së gjuhës së nxënësit nga ana e arsimtarit;
- aplikimi i metodës direkte (gjuha e komunikimit në orë është gjuha serbe) për shkak të zvogëlimit të ndikimit të gjuhës amtare në gjuhën serbe;
- rëndësia e motivimit të nxënësit;
- përdorimi funksional i mjeteve të ndryshme mësimore;
- ndërlidhja e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare me mësimin e gjuhës amtare të nxënësve dhe korrelacioni me lëndët tjera;
- përvetësimi i diturisë dhe nocioneve nga fushat e ndryshme së pari në mësimin e lëndëve në gjuhën amtare, pastaj aplikimi edhe në gjuhën serbe.

74 http://www.zuov.gov.rs/novisajt2012/naslovna_nastavni_planovi_programi.html

Në këtë kapitull sqarohen edhe specifikat e fazave në përvetësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare:

- Faza e parë përfshin klasën e I dhe të II. Qasja në esencë është orale. Parashikon: përvetësimin e karakteristikave gjuhësore fonetike- fonologjike, artikulimin e zërave të reja, theksin, ritmin dhe intonacionin e llojeve të ndryshme të fjalive komunikative, strukturat themelore të fjalive dhe fondin themelor të fjalive (500 /600/ njësi leksike) në kuadër të tematikës së parashikuar; aftësimi për të kuptuar deklaratat e thjeshta me anë të dëgjimit, reagimi korrekt ndaj deklaratave imperative dhe pyetjeve, përdorimi dhe dallimi i strukturave të përvetësuara dhe leksikës në dialogje të shkurtëra lidhur me situatën e njohur, përshkrimi i pasqyrimeve dhe situatave në bazë të elementeve të përvetësuara, përdorimi i drejtë i formave më themelore të komunikimit.

- Faza e dytë përfshin klasën e III–VI. Në atë vazhdohet puna në zhvillimin e aftësive folëse të nxënësve: përvetësohen modele të reja gjuhësore (zgjerohen, kombinohen dhe dallojnë modelet e reja dhe të përvetësuara më herët) dhe leksiku i ri (900 /1600/ njësi leksike), zotërohen elementet e shqiptimit, korrigjohen gabimet në të gjitha nivelet gjuhësore. Nxënësit aftësohen për përdorimin e modeleve të përvetësuara gjuhësore dhe leksikut në formë më të gjatë dialogu dhe monologu, për të kuptuar me dëgjim deklaratat e komplikuara gjuhësore. Punohet në ushtrimin dhe aplikimin e funksioneve të reja komunikative. Nga klasa e IV nxënësit gradualisht fillojnë të përfitojnë dituri gjuhësore (aplikohet gramatika eksplicite), kurse nga klasa e V njihen me prapashtesat më të frekuentuara. Përveç aftësive të gjuhës gojore (të folurit dhe kuptimi i të folurit) zhvillohen edhe dy – shkrimi dhe leximi. Shkrimi i parë, grafemat e të cilit më pak dallojnë nga grafemat e gjuhës amtare të nxënësve, përvetësohet në klasën e III, kurse i dyti në klasën e IV. Nxënësit aftësohen për shprehje me shkrim në pajtim me normat drejtshkrimore të gjuhës serbe. Nga klasa e V fillojnë me vetëleximin e lektyrës. Kujdes iu kushtohet edhe njohjes së elementeve kulturore të popullit i cili flet gjuhën serbe.

- Faza e tretë përfshin klasën e VII dhe VIII. Ka për qëllim formimin e aftësive komunikative të nxënësve. Edhe më tutje punohet në arritjen e kompetencave komunikative gjuhësore, përvetësohen modele më të komplikuara gjuhësore (klasa e VII). Materiali gjuhësor sistematizohet dhe krahasohet me gjuhën amtare të nxënësit. Vazhdohet puna në korrigjimin e gabimeve ndërgjuhësore dhe brendagjuhësore. Përvetësohet leksiku i ri dhe frazeologjia, zhvillohet të shpehurit me shkrim, sistematizohet materiali drejtshkrimor. Nxënësit aftësohen për analizën e tekstit.

III.2.3. Pasqyra dhe komenti i mendimit të arsimtarëve për planin dhe programin mësimor për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare

1. Arsimtarët, gjithsej 41 prej tyre, të cilët mësojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë kanë pasur mundësi të sqarohen për përparësitë e planit dhe programit për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për shkollën fillore, të theksojnë përmbajtjet për të cilat mendojnë se nuk janë të përshtatshme për nxënësit e moshave të caktuara dhe të propozojnë plotësime/ndryshime në planin dhe programin mësimor. Tabelat tregojnë se 53,7% e arsimtarëve kanë theksuar se plani dhe programi ekzistues është i përshtatshëm, por edhe që 73,2% e tyre mendon se duhet të plotësohet ose të ndryshohet. Në bazë të kësaj mund të konkludohet se disa arsimtar, të cilët kanë theksuar se plani dhe programi ekzistues është i përshtatshëm, megjithatë duhet të plotësohet ose të ndryshohet.

Tabela 2.2.2. – Pasqyra përgjigjet në pyetjen: A ka përmbajtje në plan dhe program për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare që nuk janë të përshtatshme për nxënësit e moshave të caktuara?

Përgjigjet	Frekuencat	Përqindjet
Jo, mendoj se plani dhe programi ekzistues është i përshtatshëm	22	53.7
Po	19	46.3
Gjithsej	41	100

Tabela 2.2.3. – Pasqyra përgjigjet në pyetjen: A mendoni se plani dhe programi duhet të plotësohet ose të ndryshohet?

Përgjigjet	Frekuencat	Përqindjet
Jo	11	26.8
Po	30	73.2
Gjithsej	41	100.0

2. **Pyetja nga pyetësori:** *Cilat janë përmbajtjet nga plani dhe programi për të cilat mendoni se nuk janë të përshtatshme për nxënësit e moshave të caktuara?*

Nga përmbajtjet të cilat konsiderohen të papërshtatshme për nxënësit e kësaj moshe më së shumti është dalluar fusha e gramatikës (7 arsimtar), që është theksuar si shumë i gjerë. Vërejtje janë dhënë edhe lidhur me lektyrën (4 arsimtar gjithsej), kurse si përmbajtje e papërshtatshme theksohet përzgjedhja e tregimeve (1 arsimtar), poezia analiza e të cilës është e komplikuar dhe vështirë e kuptueshme (1 arsimtar) dhe disa tekste që janë shumë të gjata (1 arsimtar). Për tematikën janë shprehur 3 arsimtar dhe si të papërshtatshme për nxënësit kanë dalluar temat për rënien në dashuri për klasën e VI dhe VIII (2 arsimtar), temat për luftëra (1 arsimtar) dhe njësia mësimore për Pashkët (1 arsimtar).

Në këtë pyetje 2 arsimtar kanë dhënë koment i cili ka të bëjë me metodën e punës: Metoda e punës dhe forma duhet të modernizohet. Duhet më shumë vëmendje t'iu kushtohet kulturës dhe gjuhës" dhe "Përkthimi i teksteve nga fletoret e punës është i vështirë për nxënësit e klasëve të ulëta".

3. **Pyetje nga pyetësori:** *Me çfarë përmbajtje duhet të plotësohet/ndryshohet plani dhe programi?*

Vërejtje të përgjithshme në plan dhe program kanë 4 arsimtar, të cilët sugjerojnë thjeshtësimin e tij, zvogëlimin e vëllimit, lehtësimin dhe përshtatjen ndaj moshës. Dy arsimtar kanë vënë re disharmoninë e planit dhe programit për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare me planin dhe programin për Gjuhën shqipe (si gjuhë amtare) dhe sa i përket vëllimit të materialit dhe përvetësimit të mësimit (disa njësi në gjuhën serbe janë më kërkuese dhe përpunohen më përpara se që është e parashikuar në Gjuhën shqipe).

Pasqyra e sugjerimeve lidhur me disa segmente të planit dhe programit tregon si në vijim:

Zvogëlimin e vëllimit dhe thjeshtësimin e gramatikës e sugjerojnë 3 arsimtar. Sugjerime lidhur me zgjedhjen e lektyrës kanë dhënë 4 arsimtar edhe atë në drejtim të modernizimit të teksteve, shtojcës së teksteve që do të ishin në harmoni me kulturën dhe zakonet e pakicës nacionale shqiptare dhe zgjedhjen e teksteve të cilat janë të qarta dhe të shkurtëra, kurse heqjen e teksteve dialektike. Plotësimet e programit që kanë të bëjnë me zgjedhjen e temave sugjerojnë 5 arsimtar ashtu që do të futeshin përmbajtje nga jeta e përditshme në mjediset fshatare, përmbajtjet lidhur me kulturën lokale, ambientin jetësor, tema më të mira dhe më të qarta dhe në përgjithësi përmbajtje të cilat fëmijëve do t'iu ndihmonin të zotërojnë komunikimin në jetën e përditshme. Rekomandohet heqja e përmbajtjeve të vjetra dhe të panevojshme, si dhe njësia me përmbajtje fetare ose futjen e festave që janë prezente në ato bashkësi (Bajrami). Lidhur me shkrimin janë evidentuar sugjerime të cilat kanë të bëjnë me fillimin e përvetësimit të shkrimit qirilik ("me përvetësimin e shkrimit qirilik duhet të fillohet më herët, dhe jo nga gjysëmvjetori II i klasës IV"), koha e parashikuar për zotërimin e shkrimit qirilik ("fëmijët për 4 orë duhet të zotërojnë shkrimin qirilik në klasën IV") dhe numrin e përgjithshëm të ushtrimeve ("të plotësohen me ushtrime me shkrim- sipas planit janë vetëm 4").

Edhe në këtë pyetje janë dhënë komente të cilat nuk janë të lidhura direkt për përmbajtjen e planit dhe programit. Disa kanë të bëjnë me mënyrën e realizimit të tij, përfaqësimin e fushave të caktuara në praktikën mësimore, aplikimin e veprimeve të caktuara metodike dhe llojeve të ushtrimeve ("t'iu kushtohet rëndësi kulturës dhe gjuhës", duhet të aplikohet më shumë dialog", "diktimet duhet të jenë më të përfaqësuara dhe shpjegimet", "më shumë të aplikohen ushtrimet foljore, komunikimi dhe ushtrimet nga gramatika, analiza e pjesës letrare, reprodukimi i teksteve të lexuara dhe leximi", "Nuk duhet që nxënësit e Vojvodinës dhe të jugut të punojnë në të njëjtën mënyrë"), kurse të tjerët në mjete mësimore: ("në tekste mësimore të futen edhe emrat shqiptar", "nevojitet përkthimi i fjalëve të reja në gjuhën shqipe; të bëhet gramatika e ilustruar") dhe mjetet tjera mësimore ndihmëse ("të aplikohen më shumë përmbajtje vizuele siç janë ilustrimet dhe vizatimet", "të përdoren filma dhe materiale tjera të cilat do të mundësonin që fëmijët të bisedojnë më tepër dhe të avancojnë njohuritë e tyre").

4. Opinionet e arsimtarëve për planin dhe programin për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për shkollën fillore mund të kontribuojnë në avancimin e mësimit të kësaj lënde dhe suksesin më të mirë të nxënësve për përvetësimin e gjuhës serbe ashtu që përmbajtjet e caktuara do të ndryshoheshin dhe korrigjoheshin.

Padyshim, vërejtjet relevante janë për nevojën që t'i kushtohet më shumë kujdes kushteve specifike në të cilat kryhet ky mësim dhe që në mënyë të barabartë të përfaqësohen elementet e kulturave të ndryshme. Këto momente janë dhënë në program, por mund t'iu kushtohet rëndësi më e madhe. Gjithsesi duhet pasur parasysh edhe disharmoninë e vënë re në mes të programit për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare dhe programit për gjuhën shqipe

Ka, megjithkëtë sugjerime të cilat tregojnë se disa arsimtar nuk janë mjaft të njohur me konceptin, strukturën dhe rekomandimet për realizimin e programit.

Ky konkludim më së shumti dedikohet në bazë të komenteve për vëllimin shumë të madh të përmbajtjeve gramatikore. Në fakt, është përshtypja se ka arsimtar të cilët nuk dallojnë dy seksione të ngjashme Materien gjuhësore dhe Gramatikën, respektivisht që përmbajtjeve të programeve të cilat i përkasin Materies gjuhësore t'i qasen nga këndi i gramatikës eksplicite. Vërejtjet lidhur me vëllimin, ndërlikueshmërinë dhe përfaqësimin e tepruar të materialit gramatikor mund të jenë edhe pasojë e ndikimit të interpretimit të këtyre dy seksioneve në tekste mësimore.

Ndikimi i teksteve mësimore sigurisht është prezent edhe në propozimet të cilat kanë të bëjnë me modernizimin e temave, posaçërisht në klasë më të larta, duke qenë se në mësim përdoren librat e leximit

të gjeneratave të mëparshme e jo komplete të reja. Me këtë rast, duhet pasur parasysh se me program është përshkruar një pjesë e teksteve (në seksionin Lektyra), kurse tekstet tjera në librat e leximit janë rezultat i përzgjedhjes së autorëve në bazë të seksionit Tematika dhe nuk janë të domosdoshme.

Propozimet për plotësimin dhe ndryshimin e plan programit që kanë të bëjnë me metodat e punës dhe mjetet mësimore gjithashtu flasin për nevojën që arsimtarët në mënyë më të detajuar të njihen me udhëzimet për realizmin e programit, duke qenë se shumica e propozimeve në to ekziston.

III.2.4. Vërejtjet për progamin e Gjuhës serbe si joamtare

1. Struktura dhe përmbajtja e programit, si dhe rekomandimet për mënyrën e realizimit, padyshim tregojnë se në bazën e tij ekzistojnë edhe elemente të përmbajtjes dhe metodës së mësimit të gjuhës së huaj dhe elemente të përmbajtjeve dhe metodave të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë amtare. Orientimi i tillë në esencë nuk është i gabuar nëse merret parasysh se mësimi i gjuhës serbe si gjuhë joamtare realizohet në kushte shumë të ndryshme, si dhe është e domosdoshme t'iu ofrohet veprimeve që janë karakteristike për mësimin e gjuhëve të huaja aty ku gjuha e huaj nuk është prezente në komunikimin e përditshëm dhe ku gjuha amtare e nxënësve nuk është e ngjashme me gjuhën serbe. Përveç kësaj ajo është e mundur dhe e nevojshme t'iu ofrohet edhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë amtare në mjediset dygjuhësore, të përziera dhe në ato me gjuhë amtare të ngjashme.

2. Shikuar nga perspektiva e metodave të mësimit të gjuhëve të huaja, vihet re se programi për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare paraqet kombinimin e dy parimeve themelore të përfaqësuara nga gjysma e shekullit XX deri më sot: 1) qasjes sipas të cilës gjuha parimisht përvetësohet me anë të ushtrimit të modeleve themelore gjuhësore të ushtrimeve të ndryshme strukturore funksioni primar i të cilit është ushtrimi, përforcimi dhe automatizimi i modeleve gjuhësore, respektivisht arritja e kompetencave gjuhësore (aftësitë e konstruktimit të shprehjeve të drejta gramatikore) dhe 2) qasjes komunikative, që synon kah formimi i kompetencave komunikative (aftësitë e aktivitetit adekuat verbal, varësisht nga situate komunikative) me përdorimin e gjuhës autentike në komunikimin natyral.

Prandaj, formimi i shprehive gjuhësore gramtikisht korrekte dhe aftësia e përdorimit të gjuhës në situatat e jetës së përditshme duhet të kuptohet si dominante në mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në funksionet e të cilit janë të gjitha elementet tjera të programit. Duke pasur parasysh këtë, posaçërisht është me rëndësi që në mënyrë të përshtatshme të kuptohet roli i gramatikës dhe tregimeve për lexim dhe të mos barazohen me funksionet të cilat këto pjesë të programit kanë në gjuhën amtare, posaçërisht në mjediset me njohuri të dobëta të gjuhës serbe. Në fakt, nëse mësimit të gramatikës iu qasemi ashtu siç

iu qasemi gjuhës amtare, rëndësi shumë e madhe do t'iu kushtohet sqarimeve, mësimit të terminologjisë gramatikore, analizës morfologjike dhe sintaktike, etj. për çka nuk do të mbetet mjaft kohë për ushtrimin e aplikimit praktik të rregullave. As përpunimit të teksteve në ambiente të tilla nuk mund t'iu qasemi si përpunimit të teksteve në gjuhën amtare. Në fakt, insistimi në përpunimin e një numri të madh të teksteve, posaçërisht të atyre më të gjatë dhe më të vështirë, domosdo sjell deri te përkthimi i tyre, me çka humbet roli i tyre themelor, që përbëhet nga ofrimi i bazës për bisedë. Përkthimi merr shumë kohë, shpesh sjell deri te të mbajturit mend mekanik të konstrukcioneve të gatshme dhe nuk i kontribuon aftësimit të nxënësve për komunikim spontan, kurse pikërisht është mundësi e komunikimit spontan fakti që dëshirohet të arrihet me mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare sepse vetëm në këtë mënyrë mund të thuhet se fëmiu ka zotëruar gjuhën serbe, që si rezultat përfundimtar dhe më i rëndësishëm, do t'i mundësojë që arsimimin e vet ta vazhdojë (edhe) në atë gjuhë dhe të ndjehet anëtar i barabartë i bashkësisë së gjerë.

3. Lidhja e drejtpërdrejtë me gjuhën serbe si gjuhë amtare posaçërisht është e dukshme në lektyrën e përcaktuar. Në fakt, nëse krahasohet lista e teksteve për këto dy lëndë, shihet se Gjuha serbe si gjuhë joamtare është bërë nga përzgjedhja e teksteve të parashikuara për gjuhën serbe si gjuhë amtare. Përzgjedhja e lektyrës gjithsesi është në harmoni me kriteret edukative, letrare-artistike dhe të moshës, përmbushet ajo pjesë e qëllimit dhe detyrës që ka të bëjë me njohjen e elementeve të kulturës të popullit serb, por duhet të konstatohet se në disa mjedise kurrsesi nuk është në harmoni me mundësitë e nxënësve njohuria e gjuhës serbe e të cilëve është e dobët, prandaj është e domosdoshme të inkuadrohen edhe tekstet të cilët janë më të lehtë në gjuhë dhe përmbajtje dhe më të përafërt me nxënësit nga mjediset e tilla.

4. Disa përmbajtje të programit janë të përgjithësuara dhe lejojnë transpozicion të ndryshëm në tekste mësimore, si dhe interpretime të ndryshme me rastin e realizimit në orë, që është shumë e theksuar në seksionin Gramatika. Kjo mund të ketë efekte pozitive por edhe negative. Përgjithësimi i tillë mund të jetë shprehje e synimit që programi të jetë fleksibil dhe të lihet mjaftë hapësirë për përpunim më të saktë dhe më të detajuar të pjesëve të caktuara të materialit, prapë varësisht nga rrethanat në të cilat zbatohet mësimi. Nga ana tjetër, efekte negative mund të ketë, nëse gjatë mosnjohjes së mjaftueshme të konceptit të këtij mësimi, pikërisht në këto njësi insistohet në përpunimin e detajuar. Është i domosdoshëm, pra, interpretimi adekuat i atyre segmenteve të materialit dhe përshtatshmëria e tyre ndaj kushteve të punës. Në fakt, është vënë re se në praktikën mësimore shpesh nuk bëhet zgjedhja optimale dhe koha e disponueshme, që është e kufizuar me fondin e orëve, shpenzohet në përmbajtjet të cilat nuk janë primare.

5. Programi përcakton tempo të caktuar në zotërimin e gjuhës serbe, por edhe sugjeron që mos të

kalohet në njësinë e re mësimore deri sa të mos jetë përvetësuar ajo e mëparshmja. Në mjediset në të cilat kushtet për mësimin e kësaj lënde janë të vështirësuara (para së gjithash mjediset homogjene në të cilat gjuha serbe nuk është e përfaqësuar dhe ku gjuha amtare nuk është e ngjashme me gjuhën serbe) kjo mund të sjellë deri te situata që, në përpjekje që të respektohen kërkesat programore, disa pjesë të njësive mësimore kalohen pa përvetësimin e tyre të plotë. Situata e tillë është mjaft e dëmshme, duke qenë se në bazë të konceptit të programit ndërlidhja e pjesëve të njësive mësimore nga njëra tjera, d.m.th çdo element nënkupton njohjen e elementit të mëparshëm. Materia e papërvetësuar kështu grumbullohet, kërkesat bëhen gjithnjë e më të mëdha, e me këtë edhe suksesi- gjithnjë më i dobët.

6. Edhe pse në program është theksuar se ai, përveç përmbajtjes themelore përmban edhe përmbajtje të zgjeruara, dallimi në fakt është në numrin e ndryshëm të fjalëve të cilat duhet të përvetësohen gjatë një viti shkollor (dhe gjithsej gjatë tetë klasëve) dhe pjesë të përmbajtjes në seksionin Materia gjuhësore. Diferencimi përmendet edhe në kërkesat në mënyrën e përpunimit të tekstit, respektivisht lektyrës. Mund të konkludohet se diferencimi në kërkesat programore dhe përmbajtjet nuk është në harmoni me dallimet e mëdha ekzistuese në njohuritë dhe mundësitë e tempos dhe vëllimit të përvetësimit të gjuhës serbe në mjedise të ndryshme. Me fjalë të tjera, dallimet esenciale të cilat ekzistojnë në mundësinë e zotërimit të gjuhës serbe në mes të nxënësve me gjuhën amtare të ngjashme me gjuhën serbe dhe atyre gjuha amtare e të cilëve në të shumtën dallon nga gjuha serbe, nuk reflektohen mjaft edhe në program. Kërkesat të cilat paraqiten në të janë shumë të ngjashme.

7. Pasqyra e detajuar e përmbajtjes së programit imponon përshtypjen që është më adekuat për përdorim në ambientet e përziera dhe që është më i përshtatshëm për nxënësit me gjuhën amtare të ngjashme me gjuhën serbe. Për mjediset homogjene dhe gjuhët jo të ngjashme është i domosdoshëm kuptimi esencial i konceptit të mësimit të kësaj lënde nga ana e të gjithë atyre që marrin pjesë në krijimin e tij dhe realizimin në klasë. Në kushte të tilla është me rëndësi të madhe marrëdhënia aktive ndaj programit i cili nënkupton përzgjedhjen e atyre pjesëve të njësisë mësimore dhe aplikimin e atyre metodave dhe veprimeve të cilat më së shumti i kontribuojnë realizimit të qëllimit dhe detyrave.

III.3. Mënyra e realizimit të programit në shkollat fillore në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

III.3. MËNYRA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT NË SHKOLLAT FILLORE NË KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

Dushanka Zvekiq-Dushanoviq dhe Millan Ajxanoviq

Vërejtjet hyrëse. Gjatë disa qëndrimeve të ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve në rajonin e komunave Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, në mars dhe prill 20014, një nga segmentet padyshim më të rëndësishme të cilëve iu është kushtuar kujdes i posaçëm ka qenë vështrimi i realizimit të mësimit në gjuhën serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore të cilat kanë qenë të përfshira në studim. Materiali për këtë pjesë të studimit është grumbulluar me plotësimin e udhëzuesit të përshtatshëm, me vëllim proporcional për vështrimin e mësimit gjatë mbajtjes së orëve në klasë të ndryshme.[75] Në rolin e vështruesit, të cilët në asnjë mënyrë nuk kanë marrë pjesë në vetë zhvillimin e orës, kanë qenë anëtarët e grupit të ekspertëve dhe bashkëpunëtorët, më rrallë nga një e më shpesh për shkak të dhënies së pasqyrës më të mirë në zbatimin e orës nga dy, për çka dëshmon edhe fakti se vështrimit 32 orësh iu janë dedikuar 48 udhëzues të plotësuar për vëzhgimin e mësimit.

Vetë udhëzuesi për vëzhgimin e mësimit përbëhej nga 28 pyetje, të klasifikuara në katër pjesë, të cilat janë të dedikuara për grumbullimin e informatave të ndryshme, që iu kushtohen para së gjithash marrëdhënies së gjuhës amtare dhe joamtare gjatë realizimit të orës, aktivitetit të nxënësve, llojeve të detyrave dhe ushtrimeve të përdorura gjatë mësimit si dhe numrit të nxënësve që është shënuar gjatë orës. Natyrisht, nëse situata e ka lejuar, secili vëzhgues ka shtuar disa nga vështrimet e veta të cilat nuk kanë qenë përgjigje në pyetjet e dhëna më herët. Është interesante se jo rrallë pikërisht këto observime kanë qenë me rëndësi të madhe për përshkrimin e realizimit të orëve, për çka do të bëhet fjalë më shumë më poshtë në tekst.

Pjesa e parë e udhëzuesit për vëzhgimin e mësimit (*Përfaqësimi i gjuhës amtare dhe joamtare në orë*), me gjithsej 12 pyetje të ndryshme, njëkohësisht është edhe më e gjera, gjë që edhe nuk është për tu habitur duke pasur parasysh, siç shihet nga titulli i tij, iu është kushtuar elementit kryesor dhe mjetit të çdo mësimi- gjuhe. Pjesët tjera janë më pak vëllimore, që është përsëri me rëndësi në korrelacion me temën të cilës iu janë kushtuar: kanë tetë (Aktiviteti i nxënësve), respektivisht pesë (Llojet e detyrave dhe ushtrimeve) dhe tri pyetje (Nxënësit ([plotësuar pas përfundimit të orës]).

75 Në lidhje me këtë, një vërejtje: edhe pse paraprakisht ka qenë e planifikuar që vetëm disa klasë të jenë në fokus, për shkak të specifikacitetit të organizimit të mësimit (njëra prej tyre, gjithësesi, edhe mësimi i kombinuar për të gjitha klasët e ulëta) dhe përkufizimet kohore – me këtë hulumtim, edhe pse jo me ndërhyrje të njëjtë në shkollat e ndryshme, janë përfshirë të gjitha klasët.

Në fokusin e pjesës së parë të udhëzuesit për vëzhgimin e mësimit, atij rreth gjuhës, ka qenë grumbullimi i të dhënave për nivelin e përfaqësimit të gjuhës amtare dhe joamtare, d.m.th. gjuhës shqipe dhe serbe në orë si dhe rasti në të cilin arsimtarët përdorin njërën nga dy gjuhët e dhëna.

III.3.1. Përshkrimi i gjendjes aktuale

Shkurtimisht të dhënat deri te të cilat kemi arritur me këtë segment të studimit (gjatë vështrimit të mësimit) do të prezantohen në radhët në vijim. Së pari, duhet theksuar se është vënë re korrelacioni në mes të gjuhës amtare të ligjëruesit dhe përfaqësimit të përdorimit të gjuhës shqipe gjatë mësimdhënies: nëse gjuha amtare e arsimtarit është gjuha shqipe, ajo gjuhë ka qenë (dukshëm) dominante gjatë mësimdhënies. Dhe e kundërta. Natyrisht edhe një nga faktorët që ka ndikuar në pjesën e përdorimit të njërës nga dy gjuhët është edhe mosha e nxënësve: sa më të rinjë që kanë qenë nxënësit, gjuha amtare e tyre ishte më shumë prezente gjatë mësimit. Nga ana tjetër, te arsimtarët, shprehimisht me numër më të vogël (gjithsej janë gjashtë të tillë) të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare- përdorimi i kësaj gjuhe ka qenë dukshëm më i shpeshtë se sa përdorimi i gjuhës shqipe., që ka qenë më shumë prezente te ata arsimtar të cilët gjuhën shqipe nuk e flasin fare.

Gjuha shqipe e nxënësve ka qenë mjet kryesor me të cilin iu janë sqaruar fjalët e panjohura nga gjuha serbe, me ç'rast, gati pa asnjë përjashtim kjo bëhej duke përdorur metodën tradicionale: duke shkruar fjalët në gjuhën serbe dhe përkthimi i tyre ekuivalent në gjuhën shqipe, në tabelë, ose nëse situata e lejonte, me përkthimin gojor të teksteve nga gjuha serbe në gjuhën shqipe.[76] Ndonjë arsimtar, në fakt më rrallë përdorte metodën semantike: tregonte ilustrime dhe/ose gjësende për të sqaruar fjalët e panjohura, që ishte prezente para së gjithash në klasët më të ulëta.

Duke pasur parasysh gjithë këtë, nuk është për tu habitur fakti se nxënësit e arsimtarëve të cilët në realizimin e mësimit japin sqarime në gjuhën shqipe- dhe kur gjatë orës kanë shtruar pyetje, këtë e kanë bërë gati pa përjashtim në gjuhën amtare, shqipe. Nga ana tjetër, ata të cilët gjatë orës kanë qenë më shumë të eksponuar ndaj gjuhës serbe në këtë situatë kanë vepruar ose nuk e kanë bërë as në gjuhën shqipe dhe as në guhën serbe.

Lidhur me mjetet mësimore duhet thënë se tabela dhe shkumësi në shumicën e shkollave janë mjeti i vetëm në disponim të arsimtarëve, kështu që përdorimi i ndonjë mjeti tjetër është para së gjithath çështje e kreativitetit dhe të menduarit, por edhe motivimit të vetë arsimtarëve. Por, asnjë nga këto tri në orët

76 Sigurisht, nga kjo praktikë përjashtim paraqesin arsimtarët të cilët nuk e flasin (mirë) gjuhën shqipe, prandaj fjalët e panjohura i kanë sqaruar duke dhënë sinonime në gjuhën serbe.

e vëzhguara nuk është vënë re në masë më të madhe.[77] Përveç kësaj, dhe jo më pak me rëndësi, asnjë arsimtar gjatë udhëheqjes së orës nuk ka pasur asistent në zbatimin e mësimit, që, siç ka treguar qasja më e vonshme në situatë, nuk është karakteristikë vetëm e orëve të vëzhguara.

Gjithashtu, është vënë re se nxënësit e klasëve më të ulëta kanë përdorur tekste mësimore më bashkëkohore, dukshëm më të pasura prandaj edhe më të përshtatshme për moshën e tyre, çka ndonjëherë nuk vihet re, pa dyshim më tërheqëse. Nga ana tjetër, në mësimin e gjuhës serbe në klasët e larta janë përdorur edhe tekstet mësimore të cilat, dukshëm kanë ngecur mbrapa në kohë dhe sa i përket formës edhe më me rëndësi sa i përket përmbajtjes. Marrëdhënia në mes të teksteve mësimore në klasët e ulëta dhe të larta mund të sqarohet me faktin se Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik i siguron libra të reja[78] klasave të ulëta, përderisa ato të klasëve të larta janë të obliguar që vetë të sigurojnë tekstet mësimore, që për pasojë ka trashëgimin e librave nga gjeneratat e mëparshme ose kopjimin e tyre. Kjo, në masë të madhe ndikon negativisht në efikasitetin e mësimit.

Përfundimisht, në fund të kësaj pasqyre ndaj gjuhëve të cilat përdoren në orë, duhet thënë edhe diçka për gjuhën serbe të atyre të cilët realizojnë mësimin. Edhe pse kjo ndoshta nuk do të pritej duke pasur parasysh kontekstin, edhe te arsimtarët të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare si dhe te ata të cilët gjuhën shqipe e kanë gjuhë amtare- janë regjistruar devijime të vogla ose të mëdha nga normat standarde gjuhësore të gjuhës serbe. Natyrisht, te disa kjo është dukshëm më e theksuar, me ç'rast parregullsitë e caktuara janë prezente si në vetë artikulimin[79] dhe metrikës ashtu edhe në segmentet tjera gjuhësore. Megjithatë, edhe në këtë grup paraqiten përjashtime të rralla, d.m.th. arsimtar të cilët sipas dëshmive të vëzhguesve, kanë justifikim të mirë me ç'rast gjuha e tyre serbe është pa asnjë gabim gramatikor.[80] Nga ana tjetër, as në mesin e atyre arsimtarëve, të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare, gjatë ndikimit të dialektit, nuk janë të rralla devijimet e ndryshme nga norma, që kanë të bëjnë në radhë të parë me metrikën, por jo vetëm me atë.

77 Megjithatë, nga kjo nuk duhet nxjerrë konkluzionin se nuk ka fare arsimtarë të cilët ndryshe i qasen punës së vet – përkundrazi, ka të tillë, por janë në pakicë.

78 Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik prej vitit 2009, nxënësve të klasëve të ulëta nga territori i Republikës së Serbisë ia siguron falas tekstet mësimore. Vitin e parë ministria ia ka siguruar të gjithë nxënësve të klasës së parë të SHF falas tekstet mësimore (nxënësit nuk i kanë kthyer); 2010. ministria ia ka siguruar të ashtuquajturat tekstet e punës për klasën e parë dhe të dytë të SHF (nxënësit nuk i kanë kthyer); 2011. janë siguruar të ashtuquajturat tekstet e jopunës dhe fletoret e punës për klasën e parë, dytë dhe tretë të SHF (në fund të vitit nxënësit i kthejnë); 2012. janë siguruar të ashtuquajturat tekstet e jopunës dhe fletoret e punës për klasën e katërtë të SHF (në fund të vitit nxënësit i kthejnë); 2013. dhe 2014. janë siguruar fletoret e punës për ciklin e parë (prej klasës së I deri në klasën e IV).

79 Këtu mendohet për shembujtë si natyra specifike e zërit [l] në gjuhën serbe të këtyre bashkëbiseduesve, e cila është rezultat i interferencës me gjuhën shqipe.

80 Natyrisht, kualifikimi i tillë deri diku duhet të relativizoheti, të merret me rezerva të caktuara, duke pasur parasysh bazën dialektike të bashkëbiseduesve të atjeshëm në gjuhën serbe.

Kur bëhet fjalë për aktivitetin e nxënësve, vëzhgimi i orëve ka treguar se nxënësit kanë qenë aktiv aq sa i kanë stimuluar arsimtarët për këtë: nëse mësimi është organizuar në një drejtim, siç ka qenë zakonisht, nga arsimtarët kah nxënësit, këta të dytët jo rrallë kanë qenë vetëm vëzhgues në të. Nga ana tjetër, aty ku arsimtari përpiqej të përfshinte në mësim të gjithë nxënësit, dinamika e orës ishte dukshëm më e mirë, kurse nxënësit dukshëm më aktiv, qoftë edhe nëse ai lloj i angazhimit të tyre shëndrrohej në interakcion me shokët e tyre në gjuhën amtare me qëllim të përkthimit të fjalëve të panjohura ose në dhënien e përgjigjeve në pyetjet e shtruara. Megjithkëtë, edhe ata arsimtar të cilët kujdes më të madh i kushtonin përfshirjes së nxënësve në orë rrallë herë kanë lëshuar punën frontale në grup, që për pasojë ka pasur orën e cila nuk dallohej shumë nga modelet e zakonshme, nga e cila te fëmijët shumë më shpesh ka qenë nevoja reproduktive se sa produktive e gjuhës amtare. Me këtë rast është vënë re se gjinia e nxënësve në një masë të caktuar ka ndikuar në aktivitetin e tyre: edhe pse shumica e vëzhguesve ka thënë se njësoj (jo) aktiv kanë qenë edhe vajzat edhe djemtë, disa prej tyre i kanë dalluar si më aktiv dhe më të dalluar gjithmonë një grup të njëjtë të nxënësve- vajzat. Nga ana tjetër, gjinia nuk ka qenë kriter relevant për arsimtarët gjatë përfshirjes së nxënësve në mësim: shumica e arsimtarëve njësoj i kanë trajtuar edhe djemtë edhe vajzat.

Gjatë zbatimit të orës, disa arsimtar kanë përdorur, kurse disa jo, detyra dhe ushtrime nga tekstet mësimore, me ç'rast kjo para së gjithash mund t'iu atribuohet natyrës së njësisë së përpunuar mësimore, përdersia nuk mund të vihet re matriksi eventual lidhur me moshën e nxënësve dhe/ose gjuha amtare e ligjëruesit. Megjithkëtë, ka pasur edhe arsimtar të tillë të cilët kanë treguar kreativitet, si dhe kanë dhënë detyra, ushtrime dhe shembuj edhe jashtë atyre që janë në tekste mësimore. Natyrisht, nuk duhet posaçërisht të theksohet se përdorimi praktik i gjuhës joamtare ka qenë dukshëm më i thjeshtë te nxënësit e arsimtarëve, nga ai grupi i dytë përderisa te ata të grupit të parë jo rrallë ka munguar plotësisht.

Megjithkëtë, në këtë pjesë duhet thënë qartë se shumica e arsimtarëve kanë treguar përpjekje posaçërisht duke pasur parasysh kufizimet e imponuara me situatën materiale të shënuar në disa shkolla, duhet vlerësuar, përdersia disa prej tyre[81] kanë treguar iniciativë dhe entuziazëm që janë për çdo lavdratë dhe të cilët mund të shërbejnë si model universal.

Kur bëhet fjalë për rregullsinë e vijimit të mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare, mund të thuhet se nxënësit kanë qenë të rregullt, gjë që ka treguar qasja në listat e nxënësve.

81 Këtu para se gjithash duhet të theksohet shembulli i një arsimtari, me profesion skulptor, i cili e ka përgatitur për botim fjalorin minimal shqip-serbishtë në fotografi.

Në fund duhet të jepet një vërejtje e rëndësishme: në fakt, edhe përkundër udhëzuesit mjaft të gjerë për vëzhgimin e mësimit, që iu ka kushtuar segmenteve të ndryshme të zbatimit të mësimit, si dhe profesionalitetit të dyshuar të gjithë atyre të cilët kanë përcjellur realizimin e orëve, shtrohet pyetja nëse të gjitha të dhënat mund të merren pa asnjë rezervë. Në fakt, në disa raste në observimet e shënuara në margjina të pyetësorit[82] ose në bisedë pas përshtypjeve lidhur me atë që është parë, lindi dyshimi (si duket i justifikuar) se ora e vëzhguar në fakt është përgatitur më herët në marrëveshje me të gjithë aktorët prandaj përpara syve të vëzhguesve është luajtur një lloj shfaqjeje në të cilën edhe pyetjet edhe përgjigjet kanë qenë të njohura dhe të fiksuara më parë. Megjithkëtë, shpeshherë orët e tilla pikërisht për shkak të mungesës së dukshme të spontanitetit nuk mund të arrinin nivelin e pritur, me ç'rast as në rrethana të dhëna nuk mund të evitoheshin gabimet e ndryshme në gjuhën joamtare si te nxënësit ashtu edhe te ata të cilët e udhëhiqnin orën, që është posaçërisht brengosëse nga ana profesionale. Natyrisht, nga njëra anë është i qartë motivimi i arsimtarëve të cilët kanë marrë përsipër përgatitjen e orës së tillë: qëllimi ka qenë që punën e vet t'a tregojnë në mënyrë sa më të mirë, posaçërisht për shkak se siç kanë dëshmuar edhe ata vetë e kanë konsideruar këtë si një farë kontrolli të punës së tyre (edhe pse, gjithsesi as nuk ka qenë ashtu e menduar dhe as e prezantuar te personeli i shkollës) – krejt të rrallë. [83] Është e qartë se vëzhgimi i orës domosdo ndikon negativisht në nivelin e spontanitetit të arsimtarëve dhe nxënësve, me çka në të shumtën e rasteve jepet pasqyrë e gabueshme në terren, por nga ana tjetër ajo është e domosdoshme dhe e dobishme për grumbullimin e informatave të nevojshme.

Është një fakt i padyshimtë se ky segment i studimit të kushtuar mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare, qoftë edhe nëse lihen anash dyshimet për spontanintetin e të parit, nuk ka mundur të ketë qasje gjithpërfshirëse në organizimin e mësimit të gjuhës serbe si joamtare në 16 shkolla të vizituara në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, por ka qenë më se e mjaftueshme të vihen re mangësitë në zbatimin e mësimit.

Nga e gjithë kjo mund të konkludohet diçka që deri diku ka qenë edhe e pritur dhe që nuk është vetëm karakteristikë e mjedisit të përfshirë në studim. Në fakt, qasja e ligjëruesve të gjuhës serbe si gjuhë joamtare shpesh është intuitive, ndonjëherë edhe thelbësore, me ç'rast detyrat e caktuara dhe qëllimi janë planifikuar mirë me Program- nuk zbatohen plotësisht. Aq më tepër, ekziston përshtypja se disa arsimtar kurrë nuk janë njoftuar hollësisht me vetë Programin.

82 Dy prej tyre janë të radhës: „Kam dyshim të caktuar se ora paraprakisht është inskenuar, të paktën në një farë mase", „Të gjithë janë të përfshirë, shumë të motivuar, por sikur kemi të bëjmë me përmbushjen e detyrave dhe roleve të dhëna më parë."

83 Megjithatë, edhe këto përpjekje vetvetiu flasin mjaft për vetën.

III.3.2. Analiza e përgjigjeve nga pyetësori për arsimtar

Arsimtarët në pyetësor janë sqaruar për aspekte të ndryshme të realizimit të mësimit (metodat të cilat i aplikojnë, mjetet mësimore, matjen dhe vlerësimin e rezultateve të mësimit dhe njohuritë e nxënësve) dhe kanë dhënë propozime për avancimin e mësimit, që sipas mendimit të tyre do të sillte deri te suksesi më i mirë i nxënësve në përvetësimin e gjuhës serbe.

Në tekstin e mëtejmë do të përmenden së pari pyetjet nga pyetësori, pastaj të dhënat statistikore dhe komentet e të dhënave të marra.

Tabela 3.2.1. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: Kur gjatë orës përdorni gjuhën amtare të nxënësve tuaj?

Përgjigjet	Frekuenca	Përqindja
Nuk njoh gjuhën amtare të nxënësve të mi	4	9.8
Tërë kohën	2	4.9
Kur jap sqarime për njësinë e re mësimore	30	73.2
Shmang përdorimin e gjuhës amtare të nxënësve të mi	4	9.8
Diçka tjetër	1	2.4
Gjithsej	41	100.0

Gjuhën amtare të nxënësve arsimtarët më së shpeshti e përdorin gjatë orës kur sqarojnë njësinë e re mësimore (30 arsimtar), 4 arsimtar shmangin përdorimin e gjuhës amtare gjatë orës, 4 arsimtar nuk e njohin gjuhën amtare të nxënësve, kurse 2 arsimtar e përdorin tërë kohën gjatë orës. Në krahasim me rekomandimet për realizimin e programit, në të cilët sugjerohet metoda direkte, është vënë re se shumica e arsimtarëve konsideron të domosdoshme dhënien e sqarimeve në gjuhën amtare, respektivisht që përdorimi i gjuhës amtare nuk mund të përjashtohet nga ora. Qasjet më të reja ndaj gjuhës tjetër (të huaj/joamtare) nuk përjashtojnë në tërësi përdorimin e gjuhës amtare në orë; megjithkëtë, sugjerojnë prezencën e gjuhës e cila përvetësohet jo vetëm në fazën e ushtrimit të njësisë mësimore, por edhe kur ajo prezantohet si njësi e re, d.m.th. kur sqarohet. Në këtë kuptim rekomandohen veprimet e prezantimit të njësisë së re mësimore që nuk kërkojnë gjuhën amtare (mjetet vizuele, parafrazat, përfundimet induktive, etj.), që do të ishte shumë e dobishme të aplikohet në orë, kurse gjuha amtare të lihet si mjet për situatat kur asnjë mjet tjetër nuk është efikas. Në këtë mënyrë forcohen lidhjet në mes të elementeve të sistemit të gjuhës e cila mësohet dhe zvogëlohen ndikimet eventuale negative të gjuhës amtare.

Tabela 3.2.2. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: Sa kohë gjatë një ore mesatarisht ia kushtoni sqarimeve, dhe sa kohë për ushtrimin e njësisë së re mësimore nga gjuha/gramatika?

Përgjigjet	Frekuenca	Përqindja
Sqarim 15 minuta,pjesa tjetër është ushtrime	15	36.6
Gati njësoj	15	36.6
Sqarimet marrin pjesën kryesore të orës, ushtrimet në pjesën përfundimtare të orës	11	26.8
Gjithsej	41	100.0

Diçka më shumë se një e treta e arsimtarëve (15) janë sqaruar se ushtrimi i njësisë nga gjuha/gramatika merr pjesën më të madhe të orës. Kohë të barabartë për sqarime dhe ushtrime kushtojnë gjithashtu më shumë se një e treta (15), përderisa një e katërta e arsimtarëve të anketuar (11) pjesën më të madhe të orës ia kushtojnë sqarimeve, kurse ushtrimeve pjesën përfundimtare të orës. Këto të dhëna çojnë në përfundimin se në më shumë se në gjysmën e orëve duhet të zvogëlohet pjesa teorike e mësimit të gjuhës/gramatikës dhe më shumë hapësirë t'iu kushtohet ushtrimeve dhe zbatimit praktik të njësisë, me çka pa dyshim do të përmirësohej përvetësimi i gjuhës joamtare.

Tabela 3.2.3. – Pasqyra përgjigjet në pyetjen: Sa është prezente të shprehurit me gojë e sa me shkrim e nxënësve në orën tuaj?

Përgjigje	Frekuenca	Përqindja
Njëjsoj	16	39.0
Shkrimi është më shumë i përfaqësuar (duke përfshirë zbatimin e detyrave)	6	14.6
Të folurit është më shumë prezent	19	46.3
Gjithsej	41	100.0

Gati gjysma e arsimtarëve (19) janë sqaruar se gjatë orës aktivitetet foljore janë të përfaqësuara në masë më të madhe se sa aktivitetet me shkrim. Pyetësori nuk ka përmbajtur pyetjen lidhur me aktivitetin foljor, prandaj mund të konkludohet nëse arsimtarët me aktivitet foljor ka nënkuptuar edhe reprodukimin përmendësh të teksteve të mësuara në prozë/poezi dhe përgjigjeve në pyetje, shprehja e tekstit pa kontekst, por edhe leximi me zë. Njësoj, sipas vetë vlerësimit, aktivitetet gojore dhe të shkruara janë prezente te 16

arsimtar. Përparësi të të shprehurit me shkrim të nxënësve i japin 6 arsimtar. Në jetën e përditshme, megjithkëtë, është shumë më prezent përdorimi gojor i gjuhës, prandaj edhe në mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare kësaj aftësie joamtare duhet t'i jepet prioritet edhe në aplikimin praktik, funksional. Nuk duhet, natyrisht të anashkalohen as aktivitetet me shkrim, por në masë të cilën e lejon koha që është në disponim.

Tabela 3.2.4. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: Si i përpunoni përmbajtjet e reja gjuhësore, më së shpeshti.

Përgjigje	Frekuenca	Përqindja
Kryersisht përcjell materien e dhënë në tekstin mësimor, radhitjen dhe vëllimin	13	31.7
Sjell material shtesë (tekste, ilustrime, muzikë…)	3	7.3
Kombinoj përmbajtje nga tekstet mësimore dhe materialet shtesë	24	58.5
Tjetër	1	2.4
Gjithsej	41	100.0

Më shumë se gjysma e arsimtarëve të anketuar (24) gjatë përpunimit të përmbajtjeve të reja gjuhësore përdorin tekste mësimore në kombinim me materialet shtesë, një e treta (13 arsimtar) kryesisht përcjellin materien ashtu siç është e interpretuar në tekste mësimore, kurse tre prej tyre sjellin materialin e vet. Duhet pasur parasysh se interpretimi i përmbajtjes së programit në tekste mësimore është vetëm nga mundësitë të cilat gjenden para arsimtarëve, si dhe që tekstet mësimore janë shkruar për të gjithë nxënësit të cilët në territorin e Republikës ndjekin mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Me fjalë të tjera, edhe dhënia e përparësisë vetëm një mjeti mësimor është dukuri e shpeshtë në praktikën tonë arsimore, padyshim është se kjo mund të jetë kontraproduktive sepse mësimet e caktuara dhe pjesët e tyre duhet t'iu përshtaten ambientit kulturor dhe gjuhësor nga i cili vijnë nxënësit në mënyrë që njësia mësimore të përvetësohet më lehtë. Kjo, gjithsesi, kërkon përpjekje shtesë të arsimtarëve, por që pozitivisht do të reflektohej në kualitetin e mësimit.

Tabela 3.2.5. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: A i sqaroni nxënësve fjalë të reja, të panjohura? Nëse në pyetjen e mëparshme jeni përgjigjur me po, përmendni në çfarë mënyra nxënësve ia sqaroni fjalët e reja, të panjohura.

Përgjigjet	Frekuenca	Përqindja
Përkthimi në gjuhën amtare	25	61.0
Përdor ilustrime (ilustrime të përgatitura ose vizatoj në tabelë)	5	12.2

Me anë të metodës deskriptive dhe metodës së asocijimit ua sqaroj rëndësinë	10	24.4
Të tjera	1	2.4
Gjithsej	41	100.0

Në këtë pyetje të gjithë të pyeturit janë përgjighur me po, të gjithë sqarojnë fjalët e reja, të panjohura. Me këtë rast shumica e arsimtarëve përdorin metodën e përkthimit në gjuhën amtare, që në mësimin e gjuhës joamtare konsiderohet si veprim që duhet të shmanget dhe të aplikohet dhe të përdoret vetëm nëse nuk është e mundur të semantizohet me veprime të tjera, respektivisht kur veprimet tjera janë të pasigurta ose joekonomike. Rekomandohet që, kurdo që është e mundur të përdoren mjete vizuele, demonstrime, deskriptime, respektivisht të gjitha veprimet të cilat zvogëlojnë asocijimet me gjuhën amtare dhe te nxënësit forcojnë sistemin e gjuhës serbe.

Tabela 3.2.6. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: A bëni gjatë orës ushtrime të stimulimit të situatave nga jeta reale?

Përgjigjet	Frekuenca	Përqindja
Në orë nuk bëjmë ushtrime të stimulimit	5	12.2
Shumë rrallë, disa herë në vit	4	9.8
Më rrallë se një herë në muaj	5	12.2
1–2 herë në muaj	13	31.7
Një herë në javë	11	26.8
Gati se në çdo orë	3	7.3
Gjithsej	41	100.0

Ushtrimet në të cilat me nxënësit stimulohen situata të ndryshme jetësore janë shumë të dobishme, jo vetëm për arsye se në këtë mënyrë nxënësit aftësohen të komunikojnë me bartësit e gjuhës tjetër në situata të cilat janë reale dhe të pashmangshme por edhe për arsye se në këtë mënyrë, duke krijuar artificialisht ambient folës autentik, stimulohet kreativiteti, zgjerohet dhe përvetësohet rreth i ri leksik. Nxënësit në këtë mënyrë aftësohen që jashtë shkollës në situate reale jetësore të përdorin gjuhën e vet joamtare duke përdorur dhe duke aktivizuar dituritë, aftësitë dhe shprehitë e arritura në kuadër të mësonjtores. Nga kjo, pyetje e posaçme ka qenë përkushtimi pikërisht ndaj këtyre ushtrimeve. Analiza ka treguar se ato i organizon shumica e arsimtarëve, por jo me frekuenca të njëjta: më së shumti zbatohen 1-2 herë në muaj (13), pastaj një herë në javë (11), kurse 9 arsimtar rrallë (disa herë në vit, më rrallë se një herë në muaj).

Këtë lloj të ushtrimeve nuk e organizojnë 5 arsimtar, kurse vetëm 3 nga ata i aplikojnë gati në çdo orë. Arsimtarët të cilët nuk organizojnë ushtrime të tilla, kanë arsyetuar këtë me moshën e nxënësve ("janë të vegjël, nuk kuptojnë"), duke u mbështetur në përdorimin e teksteve mësimore, mungesën e kohës dhe mospërvojën e vet në mësimin e kësaj lënde.

Situatat të cilat merren si shembuj më së shpeshti janë "në shitore"/ "në treg" dhe "te mjeku", kurse përveç tyre edhe "trafiku", "marrëdhëniet familjare"dhe "situata në shkollë", "festat dhe ditëlindjet". Disa arsimtar kanë përmendur situatat të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me sjelljen kulturore; „sjelljet në jetën e përditshme", „trajtimi i pleqëve", „për respektin e ndërsjellë", „sjellja e nxënësve në shkollë dhe jashtë saj", kurse me ato në lidhje direkte janë edhe funksionet komunikative gjatë njoftimit, takimit në rrugë, komunikimit me personat zyrtar, shprehja e lutjeve dhe ankesave. Njësoj janë përmendur edhe: posta, teatri, biblioteka, sjellja në qytet, sporti, stinët e vitit, zakonet serbe, tregimi i karakteristikave të njerëzve dhe gjësendeve, tema nga kultura, datat e rëndësishme.

Disa arsimtar nuk kanë precizuar situata, por përgjigjen e kanë formuluar në përgjithësi: "temat jetësore në harmoni me moshën e nxënësit", "tema nga jeta e përditshme", "tema nga tekstet mësimore të cilat i përgjigjen situatave reale", "tema dhe situata të përgjithshme", "tema të lira të cilat i përkasin situatave të përgjithshme", "përpiqet të harmonizojë situata të ndryshme jetësore me mësimet në orë".

Ushtrimet e tilla kanë rëndësi të madhe në mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, posaçërisht në ambiente në të cilat gjuha serbe nuk është gjuhë që flitet drejtpërdrejtë në atë mjedis. Me nxënësit të cilët me gjuhën serbe ballafaqohen vetëm në këto orë, rekomandohet që sa më shpesh të organizohen, që në këtë mënyrë të përgatiten për përdorimin e gjuhës jashtë mësonjtores. Është shumë me rëndësi që të aftësohen nxënësit për aplikim praktik të materies e cila mësohet në orë.

Tabela 3.2.7. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: Cilat mjete mësimore i përdorni në zbatimin e mësimit?

Përgjigjet	Frekuenca	Përqindja
Përdor kryesisht tekstet mësimore	23	56.1
Kryesisht përdor mjete të tjera vizuele (fotografi, libra, etj.)	1	2.4
Kryesisht përgatis materialin tim	1	2.4
Qasje e kombinuar	16	39.0
Gjithsej	41	100.0

Më shumë se gjysma e të anketuarve kryesisht përdorin tekste mësimore (23), përderisa të tjerët kombinojnë tekste mësimore me mjete të tjera (16). Nga një arsimtar ka theksuar se kryesisht përdorin mjete të tjera vizuele, respektivisht përgatisin materialin e vet.

Në pyetjen cilat tekste mësimore i përdorin në zbatimin e mësimit janë përgjigjur7 arsimtar të cilët thonë: "gjuha serbe si gjuhë joamtare", "libri i leximit, fletorja e punës, mësimet nga gjuha", „libri i leximit, gramatika, fletorja e punës", "gjuha serbe si gjuhë joamtare- libri i leximit, mësimet nga gjuha dhe drejtshkrimi, teksti mësimor Mësojmë serbisht", "„Magjia- libri i leximit, fletorja e punës, mësime nga gjuha dhe gramatika", "libri me fotografi mësojmë serbisht për klasën I dhe II". Duke pasur parasysh faktin se nuk janë dhënë informata të plota për tekstet mësimore, mundemi vetëm të supozojmë se këto janë tekstet mësimore të Entit. Se bëhet fjalë për tekstet mësimore të Entit, ka thënë një arsimtar, duke shtuar se përdor edhe tekstet mësimore "por për gramatikë në gjuhën shqipe - korrelacion me gjuhën serbe". Gjithashtu, në bazë të këtyre përgjigjeve nuk mund të dihet çfarë përqindje e arsimtarëve përdor komplete të reja mësimore dhe as sa prej tyre përdorin të gjitha njësitë e teksteve mësimore, kurse sa prej tyre përdorin vetëm disa.

Arsimtarët të cilët, përveç teksteve mësimore, përdorin edhe mjete të tjera mësimore- përmendin: mjetet vizuele (ilustrimet, vizatimet, fotografitë, pikturat, pikturat e murit- 11 arsimtar), audio materiali (3 arsimtar), realitetet (gjësendet në mësonjtore dhe materiali i vetëpërgatitur në shtëpi- 4 arsimtar) dhe internet (1 arsimtar).

Rezultatet e përgjigjeve në këtë pyetje tregojnë për nevojën e përgatitjes së materialit mësimor shtesë për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare.

Tabela 3.2.8. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: Në cilën mënyrë matni nivelin e arritur të diturisë te nxënësit?

Përgjigjet	Frekuencat	Përgjigjet
Me anë të testeve[84]	28	68,3
Me kontrollimin e detyrave shtëpiake	25	61
Me ushtrime gojore në orë	35	85,4
Me ushtrime me shkrim dhe detyra në klasë	32	78
Diçka tjetër	1	2,4
Gjithsej	121	295,1

84 Detyrat e obliguara me shkrim organizohen dy herë në vit, në gjysmëvjetorin e parë dhe të dytë.

Siç shihet nga radha e fundit në tabelë, në këtë pyetje arsimtarët kanë mundur të japin më shumë se sa një përgjigje. Përvec pesë përgjigjeve të dhëna në tabelë, arsimtarëve iu është ofruar dhe një përgjigje ("Nuk kontrolloj diturinë e nxënësve të mi"), të cilën asnjë prej tyre nuk e zgjodhi, siç edhe ishte pritur.

Të dhënat tregojnë se arsimtarët kryesisht kombinojnë më shumë mënyra të matjes së diturisë së arritur të nxënësve. Duke pasur parasysh se programi parashikon zotërimin e diturive dhe aftësive të përdorimit të gjuhës, kombinimi i veprimeve të ndryshme në kontrollimin e rezultateve të arritura është i domosdoshëm.

Megjithkëtë, kontrollimi gojor duhet të jetë kriter primar, duke qenë se përdorimi gojor i gjuhës është dominant në komunikimin e përditshëm dhe rëndësia e saj është aq sa cdo arsimtar duhet t'a përfshijë (14,6% e arsimtarëve nuk mat diturinë me anë të të folurit gojor).

Duke pasur parasysh se pyetësori nuk ka pasur pyetje lidhur me dituritë dhe aftësitë të cilat maten, nuk mund të vlerësohet nëse arsimtarët para së gjithash matin njohuritë reproductive, teorike ose produktive apo praktike.

Tabela 3.2.9. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: Sipas vlerësimit tuaj, a dijnë nxënësit tuaj mirë gjuhën serbe?

Përgjigje	Frekuenca	Përqindja
Lexojnë shkëlqyeshën, shkruajnë dhe komunikojnë në gjuhën serbe	3	7.3
Janë të mirë në komunikim me gojë, nevojitet përmirësim i shkrimit dhe leximit	5	12.2
Janë të mirë në lexim dhe shkrim, iu nevojitet përmirësim i komunikimit gojor	20	48.8
Nevojiten përmirësime të komunikimit me shkrim dhe me gojë	13	31.7
Gjithsej	41	100.0

Gjysma e arsimtarëve (20) janë të kënaqur me aftësimin e nxënësve për lexim dhe shkrim, por konsiderojnë se nevojitet të përmirësohet komunikimi me gojë. Situatë të kundërt, nevojën për përmirësimin e leximit dhe shkrimit, kurse kompetenca të mjaftueshme në komunikim me gojë vërejnë shumë më pak arsimtar (5). Rezultat të shkëlqyeshëm në të gjitha fushat e përdorimit të gjuhës vërejnë 3 arsimtar, kurse nevojë për përmirësim 13. Rezultati i tillë gjithsesi është pasojë e mënyrës së punës gjatë orës. Të dhënat e fituara tregojnë për nevojën e ndryshimit të prioriteteve në mësimin e gjuhës serbe, dhe në përgjithësi avancimin e të gjitha aftësive gjuhësore.

Pyetje nga pyetësori: *Cilat veprime tuaja në orë (metoda, teknika të punës, lloje të detyrave dhe ushtrimeve, etj.) motivojnë nxënësit për mësimin e gjuhës serbe?*

Numri më i madh i arsimtarëve ka përmendur dialogun si veprim i cili i motivon nxënësit. Shpesh theksojnë edhe lojërat të cilat ndihmojnë në përvetësimin më të shpejtë dhe më të lehtë të gjuhës- dramatizimet, lojërat sipas roleve, kuizet, asocijimet, etj. Më shumë arsimtar kanë dalluar metodën e ilustrimit dhe demonstrimit si shumë stimuluese. Disa, nga ana tjetër, vërejnë se nxënësit me dëshirë mësojnë vjershat dhe kanë dëshirë të recitojnë.

Disa prej tyre kanë theksuar rëndësinë e marrëdhënies se arsimtarit ndaj punës dhe krijimit të atmosferës pozitive në orë: "vendosja e marrëdhënieve të mira në mes të arsimtarit dhe nxënësit, që motivon fëmijët të mësojnë më shumë", "komunikimi i lirë në mes të arsimtarit dhe nxënësit ofron nxënësve mundësi të jenë më aktiv në orë", "afrimiteti dhe kontakti i mirë me nxënësit", "qasja miqësore", "Përkushtimi ndaj punës".

Për shkak të ilustrimit duhet theksuar edhe disa vërejtje: "detyrat nga fletoret e punës menjëherë pas kalimit të njësisë, testet", "kanë dëshirë të lexojnë dhe të shkruajnë, posaçërisht të shënojnë nga tabela", "hartimi me shkrim me temë të caktuar, simulimi i situatave jetësore- takimi me policin, ushtarin, mysafirët", "shpesh përdor edhe shembuj real dhe përpiqem t'i sqaroj fëmijëve pse është e domosdoshme të mësohet gjuha serbe", "asgjë nuk i motivon ata".

Një numër më i vogël i arsimtarëve ka dhënë përgjigje të përgjithësuar duke mos konkretizuar veprimin: "me anë të detyrave dhe ushtrimeve", "varet nga tema e cila përpunohet", "metodat verbale, metodat frontale, mësimi aktiv", "ushtrimet gjatë orës dhe analiza e teksteve", "përpjekjet që fëmijëve t'iu ofrohen përmbajtjet", "kushtimi i kohës përmbajtjeve të ndryshme nga mësimi i gjuhës serbe".

Pyetje nga pyetësori: *Për cilat veprime në orë konsideroni se më pak sjellin rezultate të dëshiruara?*

Përgjigja më e shpeshtë në këtë pyetje ka qenë "gramatika, kurse disa arsimtar këtë edhe e kanë arsyetaur: "kjo më shumë ka të bëjë me përmbajtjen e jo me veprimet- mësimi i gramatikës sjell rezultate më të dobëta", "gramatika shumë voluminoze, mësimet nga gjuha- nuk arrij që t'i përpunoj dhe ti përdor", "shpjegimi i përmbajtjes nga gramatika që është shumë voluminoze për klasën e VIII". Gjithashtu shumë e shpeshtë është edhe përgjigja se rezultate të dobëta jep edhe "leximi i teksteve të gjata", kurse diçka më rallë "temat abstrakte"dhe "nocionet abstrakte". Përderisa dy arsimtar theksojnë problemin e mësimit të qirilicës dhe leximin e teksteve qirilicë, dy të tjerë theksojnë joefikasitetin e metodave të cilat janë karakteristike për metodën tradicionale: "të folurit frontal, nxënësit duhet të aktivizohen më shumë", "zbatimi klasik i mësimit- metoda monologjike". Tre arsimtar theksojnë rrethanat të cilat nuk varen nga ata: "kërkesa shumë të mëdha – në kuadër të lëndës por edhe rrethana të tjera", "nuk kanë kushte", "zhurma".

Shembuj të përgjigjeve të caktuara janë: “kur mjetet mësimore të llojit të ndihmesave përdoren më pak (për shembull sot ka sjellur vezë të ngjyrosur sepse tema ka qenë Pashkët)“, „mospërgatitja për orë”. Si veprime të cilat më pak sjellin deri te rezultatet e dëshiruara janë shënuar edhe disa shembuj që janë përmendur edhe në veprimet të cilat i motivojnë nxënësit: “nuk dëshirojnë të mësojnë vjershat përmendësh”, “të shkruarit e hartimit”. Kjo, gjithsesi është kushtëzuar me dallimet në mes të nxënësve, me tema të ndryshme, përzgjedhjen e vjershave, moshën, që flet në dobi të asaj se arsimtari duhet të njohë mirë nxënësit e vet. Vërtetohet gjithashtu se ekzistojnë aktivitete të cilat nuk munden në përgjithësi të klasifikohen në të rekomanduara dhe jo të rekomanduara, por është me rëndësi të merren parasysh të gjitha rrethanat në të cilat realizohen.

Frekuenca e ndërlidhjes së gramatikës dhe leximit të teksteve të gjata me veprime të cilat më pak sjellin deri te rezultatet e dëshiruara mund të interpretohet relativisht me ndërlidhshmëri më të madhe të arsimtarit për përmbajtjet e programit në bazë të interpretimit të atyre përmbajtjeve në tekste mësimore.

Tabela 3.2.10. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: A korrigjoni metodat për mësimin e gjuhës serbe në bazë të notave ose njohurive të nxënësve tuaj (për të arritur rezultate sa më të mira)?

Përgjigjet	Frekuenca	Përqindjet
Po, pas cdo ore vërtetoj cila qasje iu nevojitet	33	80.5
Herë pas here	7	17.1
Definoj metodën time e cila më përshtatet pavarësisht nga rezultati	1	2.4
Gjithsej	41	100.0

Tabela tregon se shumica e arsimtarëve, sipas vetë vlerësimit, në mënyrë konstante përcjell efikasitetin e veprimeve të veta në bazë të vlerësimit të njohurive të nxënësit dhe me vetë korrigjimin e metodave përpiqet të avancojë mësimin.

Tabela 3.2.11. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: A jeni të gatshëm të aplikoni metoda të reja dhe mënyra të reja të punës në zbatimin e mësimit për Gjuhën Serbe si gjuhë joamtare?

Përgjigjet	Frekuenca	Përqindja
Jo	2	4.9
Po	39	95.1
Gjithsej	41	100.0

Numri më i madh i arsimtarëve është shprehur se janë të domosdoshme mjetet mësimore bashkëkohore dhe pajisjet përcjellëse: materiali audio-vizual, kompjuterët, tabelat e zgjuara, CD për mësimin e gjuhës. Disa kanë theksuar se rrethana të vështirësuara paraqet fakti që nuk kanë kabinet për këtë lëndë. Kjo e dhënë tregon se shumë arsimtar konsiderojnë se metodat mësimore janë të kushtëzuara me mjetet mësimore. Shumë prej tyre përmendin edhe metoda aplikimi i të cilave nuk varet nga mjetet, por kryesisht nga vetë arsimtarët: "metoda e të menduarit kritik", "më shumë metoda të bisedimit e jo t-ë të shprehurit, dialog, loja e roleve, etj. ", "më shumë punë interaktive, mësimi aktiv i arsimtarëve arrin rezultate më të mira", "më shumë komunikim në mes të nxënësve", "puna në grupe dhe në cift", "metoda më relaksuese". Disa prej tyre kanë vënë re se nevojitet korrelacion me përmbajtjet nga lëndët e ndryshme. Dy prej tyre kanë theksuar nevojën që të marrin pjesë në seminare, kurse dy kanë theksuar që aplikojnë metoda të reja. Nevojën për më shumë kontakte me mjedisin serb ka theksuar një arsimtar ("të dërgohen nxënësit në mjedisin serb dhe të realizohen kontake"), kurse një ka rekomanduar organizimin e kampeve dhe punëtorive. Një arsimtar pa rezervë ka përkrahur cdo iniciativë ("cdo risi është e mirë"), përderisa dy janë përmbajtur ("nëse është në interes të nxënësve", "nëse ëhtë në interest ë mësimit").

Dy arsimtar të cilët në këtë pyetje janë përgjigjur negativisht kanë arsyetuar këtë me shkuarjen në pension dhe aplikimin e metodave të cilat japin rezultate të mira.

Megjithkëtë, nëse këto dhe të dhënat e theksuara më herët të lidhura me vetëkorrigjimin e arsimtarëve krahasohen me ato të dhëna lidhur me përdorimin e mjeteve mësimore, vihet re një mospërputhje. Në të vërtetë, edhe pse arsimtarët janë të vetëdijshëm se vetëevaluimi dhe me të i ndërlidhur avancimi i kualitetit të mësimit në pikëpamje të metodave të reja të rëndësishme për arritjen e qëllimit themelor të lëndës Gjuha serbe si joamtare, fakti që më shumë se gjysma prej tyre përdor tekstet mësimore si mjeti i vetëm mësimor si dhe vetëm çdo i dhjeti shmang përdorimin e gjuhës shqipe në mësim- tregojnë se gatishmëria e tyre e sinqertë për avancimin e mësimit ka mbetur pa ndryshime në praktikë. Nuk duhet, natyrisht, posaçërisht të theksohet që pa këtë të fundit nuk do të ketë përparim real në arritjet e nxënësve.

Pyetje nga pyetësori: *Nëse keni, ndani me neve propozimet tuaja për përmirësimin e suksesit në përvetësimin e gjuhës serbe te nxënësit.*

Shumë rekomandime të dhëna këtu përputhen me ato të mëparshmet. Edhe ato më së shpeshti kanë të bëjnë me nevojën e sigurimit të kushteve më të mira të punës. Arsimtarët theksojnë se është e rëndësishme të krijohen kushte më të mira për modernizimin e mësimit: të sigurohet kabineti për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare me pajisjen përcjellëse për të përdorur teknologji moderne. Nevojiten edhe mjete mësimore audio vizuele, TV, internet, video-bim, filma, kasetofon, CD, piktura në mure, posterrë, etj.

Lidhur me tekstet mësimore tregohet për nevojën e korrigjimit të tyre, modernizimin (edhe përmbajtësisht dhe vizuel) përshtatshmëria ndaj fëmijëve dhe harmonizimi me mjedisin. Ekziston edhe nevoja për fjalorët serbisht-shqip që do t'iu përshtateshin fëmijëve. Por, disa arsimtar nuk kanë pasur vërejtje në tekste mësimore, por kanë theksuar se nxënësve duhet siguruar kompletet ekzistuese të teksteve mësimore. Një vërejtje ("mungon teksti mësimor për arsimtar") flet për faktin se nuk dijnë se ekziston manuali për arsimtar.

Një numër rekomandimesh ka të bëjë edhe me nevojën e përfshirjes së prindërve dhe bashkësisë së gjerë: "edhe prindërit duhet t'ia tërheqin vëmendjen se është me rëndësi të njohin gjuhën serbe, nuk varet gjithçka vetëm nga nxënësit", "që përfaqësuesit e komunave t'i vizitojnë shkollat dhe t'i motivojnë nxënësit pse është me rëndësi të mësojnë gjuhën e mjedisit, të përfshihen prindërit në motivim dhe punën me fëmijët për rëndësinë e gjuhës së ambientit". Janë shënuar edhe propozime për vendosjen e bashkëpunimit me shkollat tjera, organizimin e ekskurzioneve dhe dërgimi i nxënësve në mjedise serbe, kurse është përsëritur edhe nevoja për korrelacion me lëndët tjera.

Disa rekomandime individuale janë edhe: "marrja e asistentëve", "duhet të rritet fondi i orëve", "zgjedhja e temës e cila iu është përshtatur moshës, afiniteteve dhe disponimit të nxënësve", "që nxënësit të cilët më mirë njohin gjuhën t'i ndihmojnë fëmijëve të cilët flasin më dobët", "të aplikohen parime si te mësimi i gjuhës së huaj, p.sh. gjuhës angleze", „leximi i rubrikave sportive sepse nxënësit janë të interesuar për sport", "më shumë orë t'i kushtohen ushtrimeve dhe përsëritjeve", "puna në grupe dhe aktiviteteve jashtëmësimore, teatri si pjesë e mësimit në mësimin e rregullt".

Është evidentuar edhe një sugjerim drejtuar Ministrisë së arsimit, shkencave dhe zhvillimit teknologjik: "Ministria duhet të organizojë orë eksperimentale në shkollë. Trajnimet për arsimtar bazohen vetëm në njohuritë teorike, kurse nuk kanë aplikim praktik."

III.3.3. Përgatitja profesionale e arsimtarit

Nga gjithsej 41 arsimtar, 15 arsimtar japin mësim vetëm në klasët e ulëta (I–IV), 7 arsimtar njëkohësisht japin mësim në klasë të ulëta dhe në klasë të larta, kurse 19 japin mësim vetëm në klasë të larta (V–VIII).

Tabela 3.3.1. – Pasqyra e përga.titjes profesionale të arsimtarëve që mbajnë mësim në klasë të ulëta

Shkalla profesionale e arsimtarëve	Frekuenca	Përqindja
Shkolla e mesme	1	6.7
Shkolla e lartë	6	40.0
Fakulteti, studimet themelore	8	53.3
Gjithsej	15	100.0

Nga 15 arsimtar të cilët japën gjuhë serbe si gjuhë joamtare vetëm në klasë të ulëta, 1 ka të mbaruar shkollën e mesme, 6 prej tyre kanë mbaruar shkollën e lartë, kurse studimet themelore në fakultet kanë mbaruar 8 arsimtar. Arsimtari me shkollë të mesme është komercialist, arsimtarët me shkollë të lartë kanë përfunduar shkolla të lartë pedaggjike (3 në Gjilan, 1 në Gjakovë dhe 1 në Vranjë; prej tyre 1 ka përmendur gjuhën shqipe dhe 1 gjuhën serbe dhe letërsinë). Katër arsimtar me studimet themelore të përfunduara kanë studiuar në fakultetet e mësuesisë (2 në Vranjë, 1 në Prishtinë dhe dhe në Vranjë- precizon Gjuha serbe dhe metodika dhe 1 në Shkup), dy kanë mbaruar Fakultetin filologjik në Prishtinë (Gjuha serbe dhe letërsia/ jugosllovene), 1 Fakultetin ekonomik (Ndërmarrësia) në Preshevë dhe një FMN (fakulteti matematiko natyrorë) në Prishtinë (Biologjia) dhe ka të dhënë provimin profesional për thirrje arsimtar (në Nish). Te një arsimtar nuk është shkruar as emir i fakultetit, as vendi.

Profesionalisht, në bazë të këtyre të dhënave, për mësimin e gjuhës serbe (si gjuhë amtare) në klasë të ulëta janë arsimuar 4 arsimtar (1 në shkollën e lartë, 1 në fakultetin e mësuesisë dhe 2 në filologjik), por asnjë për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare.

Tabela 3.3.2. – Pasqyra e përgatitjes profesionale të arsimtarëve të cilët mbajnë mësim në klasë të larta

Përgatitja profesionale e arsimtarëve	Frekuenca	Përqindja
Shkolla e mesme	1	3.8
Shkolla e lartë	13	50.0
Fakultet, studimet themelore	10	38.5
Fakultet, studime të magjistraturës, master ose specialistike	2	7.7
Gjithsej	26	100.0

Në klasët e larta japin mësim gjithsej 26 arsimtar (19 vetëm në klasët e larta, kurse 7 edhe në klasët e ulëta): 1 me shkollë të mesme, 13 me shkollë të lartë, 10 me fakultet- studime themelore dhe 2 me diplomë të studimeve të magjistraturës/master/studime specialistike.

Shkollën e lartë pedagogjike e kanë mbaruar 8 arsimtar (më së shumti në Gjilan- 4, dhe nga një në Vranjë dhe Prizren, dy nuk kanë përmendur emrin), prej tyre 3 përmendin gjuhën serbe dhe letërsinë (Gjilan). Një arsimtar me shkollë të lartë ka mbaruar drejtimin Biologji dhe kimi (në Shkollën e lartë Kliment Ohridski). Fakultetin e mësuesisë e kanë mbaruar 4 arsimtar (2 në Vranjë, 1 në Prishtinë dhe në Vranjë- profesor i mësimit klasor, te njëri mungon vendi). Gjuhën serbe/serbokroate dhe letërsinë e kanë mbaruar 2 arsimtar, 1 në Fakultetin filologjik në Prishtinë dhe 1 në Fakultetin filozofik në Gjilan. Në këto klasë gjuhën serbe si gjuhë joamtare zhvillon edhe 1 arsimtar i cili ka përfunduar Sociologjinë në Fakultetin filozofik në Prishtinë dhe 1 me diplomë të Fakultetit të artit figurative në Prishtinë. Për arsimtarët tjerë nuk kemi të dhëna të plota, janë përmendur ekonomia (1), matematika (1), pedagogjia (1), gjuha shqipe (1) dhe një arsimtar i gjuhës serbe (1) - pa të dhëna për atë nëse bëhet fjalë për arsimimin e lartë.

Sipas këtyre të dhënave, për mësimin e gjuhës serbe (si joamtare) në klasë më të larta të shkollës fillore përgatitjen e duhur profesionale e kanë 2 arsimtar, por asnjë nuk përmed edhe kushtet tjera të cilat duhet plotësuar për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare.

III.3.4. Analiza e përgjigjeve nga pyetësori për nxënës

Nxënësit në pyetësor janë sqaruar për llojet e aktiviteteve dhe mënyrën e punës në orë (çka bëjnë, çka iu pëlqen, çka nuk iu pëlqen dhe çka do të dëshironin të bëjnë), për njësinë mësimore dhe fushat të cilat iu duken më interesante, më të vështira, për detyrat e shtëpisë dhe punën në shtëpi si dhe për gjatësinë e orës së gjuhës serbe.

Së pari, në këtë analizë tregohen rezultatet e përgjigjeve në pyetje të caktuara, pastaj edhe përmbledhja.

Tabela 3.4.1. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: Çka bëni në orët e gjuhës serbe, si duken ato?

KLASA	Përgjigjet									
	Arsimtari kryesisht flet, kurse ne përgjig-jemi kur na bën pyetje	Këndojmë këngë, recitojmë	Shikojmë filma dhe video material tjera	Vizato-jmëng-jyrosim, bëjmë kolazhe, stripa, fotografi, etj.	Mjaft komu-nikojmë në gjuhën serbe, krijojmë situata konkrete dhe aktrojmë role të ndryshme	Shkru-ajmë këngë, hartime, artikuj, etj.	Lexojmë	Punojmë sipas tekstit mësimor (mëso-jmë nga libri dhe bëjmë detyra)	Mësojmë shkronjat dhe fjalët e panjohura	Të tjera
4	77.7%	20.8%	7.1%	8.1%	33.0%	14.2%	13.7%	3.0%	5.6%	3.0%
5	95.0%	6.3%	7.5%	1.3%	20.0%	26.3%	12.5%	8.8%	10.0%	.0%
6	80.0%	5.0%	.0%	3.3%	28.3%	11.7%	3.3%	.0%	1.7%	3.3%
7	92.9%	3.2%	4.5%	1.9%	33.3%	17.3%	3.8%	1.9%	5.1%	1.3%
8	87.2%	5.8%	3.1%	1.8%	33.2%	13.7%	7.1%	1.8%	2.2%	.0%
Gjithsej	86.09%	9.32%	4.73%	3.62%	31.29%	15.86%	8.48%	2.78%	4.59%	1.39%

Nxënësit kanë mundur të rrethojnë më shumë përgjigje.

Në bazë të përgjigjes në këtë pyetje, në orët e gjuhës serbe kryesisht flet arsimtari, kurse nxënësit përgjigjen kur iu shtrohet pyetja. Kështu janë shprehur gjithsej 86,09% nxënës, kurse sipas klasëve: IV – 77.7%, V – 95.0%, VI –80.0%, VII – 92.9%, VIII – 87.2%.

Nga kjo informatë shihet se arsimtarët më së shumti përdorin metodën monologe, e cila është njëkahëshe dhe nuk stimulon nxënësit që të marrin pjesë në mësim në mënyrë aktive.

Në vendin e dytë, por me frekuencë dukshëm më të vogël në krahasim me përgjigjen e mëparshme, gjendet komunikimi në gjuhën serbe, krijimi i situatave konkrete dhe aktrimi sipas roleve (31.29%), që është e përfaqësuar njësoj në klasët IV, VII dhe VIII (rreth 33%), diçka më pak në klasën VI (28,3%), dhe më së paku në klasën V (20,0%).

Vijon shkrimi (vjersha, hartime, artikuj etj.) që kanë shënuar 15.86% e nxënësve prej të cilëve më së shumti në klasën V (26.3%), dhe më së paku në VI (11.7%).

Me përqindjen prej 9.32% është përfaqësuar këndimi dhe recitimi, më së shpeshti në klasën e IV (20,8%), kurse në klasë të tjera në dallim prej 3,2% deri 6,3%. Përqindje gati identike e nxënësve ka theksuar leximin (8,48%), më shumë në klasën e IV (13.7%)dhe klasën e V (12.5%), diçka më pak në klasën e VIII (7.1%), VII (3.8%) dhe VI (3.3%).

Më pak se 5% bartin aktivitete të tjera të ndryshme, siç janë: shikimi i filmave dhe video-materialeve (4.73%) – më shumë në klasën e IV dhe V (7.1% dhe 7.5%), më pak në VII dhe VIII (4.5% dhe 3.1%), kurse në klasën e VI – 0%; mësimi i shkronjave dhe fjalëve të panjohura (4,59%) – më së shumti në klasën e V (10,0%), në gjysmë më pak në klasën e IV dhe të VII (5,6% dhe 5, 1%) dhe shumë më pak në klasën e VIII dhe të VI (2.2% dhe 1.7%); vizatimi, ngjyrosja, përgatitja e kolazheve, stripave, fotografive etj. (3.62%) – më së shumti të përfaqësuara në klasën e IV (8.1%), kurse dukshëm më pak në të klasët tjera (1,3% – 3,3%). Gjithashtu përqindje shumë e vogël e nxënësve (2,78%) është shprehur se punojnë nga tekstet mësimore (mësojnë nga tekstet mësimore dhe bëjnë detyra) - më së shumti në klasën e V (8,8%) dhe dukshëm më pak në klasët tjera (në klasën e VI – 0%).

Tabela 3.4.2. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: Çka të pëlqen më së shumti në orët e gjuhës serbe?

KLASA	Përgjigjet				
	Mënyra si punon arsimtari me neve	Tekstet mësimore të cilat i kemi	Materiali shtesë	Përgjigjet lidhur me vetë gjuhën dhe letërsinë	Tjetër
4	77.2%	37.1%	12.9%	8.9%	1.5%
5	89.9%	45.6%	5.1%	7.6%	.0%
6	81.7%	23.3%	6.7%	5.0%	.0%
7	92.9%	29.7%	5.8%	5.2%	1.3%
8	91.1%	22.2%	5.8%	4.4%	.0%
Gjithsej	86.70%	30.70%	7.80%	6.20%	0.70%

Në këtë pyetje nxënësit kanë mundur të rrethojnë më shumë përgjigje.

Shumica dërmuese e nxënësve (86,70%) është shprehur se në orët e gjuhës serbe më së shumti i pëlqen mënyra e punës së arsimtarit, diçka më shumë se kjo mesatare në klasën VII (92,9%), VIII (91,1%) dhe klasën V (89,9%), kurse diçka më pak në klasën VI (81,7%) dhe klasën IV (77.2%).

Përqindje dukshëm më e vogël (30,70%) ka theksuar tekstet mësimore të cilat i kanë. Me këtë rast për tekstet mësimore pozitivisht janë shprehur më së shumti nxënës të klasës së V (45,6%), kurse më së paku nxënës të klasës së VIII (22,2%) dhe pak më shumë në krahasim me ata nxënësit e klasës së VI (23,3%).

Materiali shtesë më së shumti i pëlqen 7,80% të nxënësve, përgjigje pak më e madhe e nxënësve në klasën e IV (12,9%), kurse më pak nxënësve të klasëve të tjera (5,1% – 6,7%). Punën lidhur me vetë gjuhën dhe letërsinë e ka shënuar 6,20% nxënës, prej tyre më së shumti prapë në klasën e IV (8,9%), kurse bie me rritjen e klasëve (V – 7,6%, VI – 5,0%, VII – 5,2%, VIII – 4,4%). Të tjerat marrin gjithsej 0,70%.

Tabela 3.4.3. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: Çka të pëlqen më së paku në orët e gjuhës serbe?

KLASA	Përgjigjet				
	Mënyra në të cilën arsimtari punon me neve	Tekstet mësimore të cilat i kemi	Materiali shtesë	Gjërat të cilat i bëjmë në orë	Mungesa e mjeteve të punës
4	35.7%	32.4%	40.0%	8.6%	1.6%
5	29.1%	41.8%	38.0%	8.9%	.0%
6	20.0%	40.0%	38.2%	10.9%	.0%
7	24.3%	31.3%	45.1%	6.3%	.7%
8	17.7%	35.4%	40.2%	11.5%	1.0%
Gjithsej	25.60%	34.82%	40.77%	9.23%	0.89%

Në këtë pyetje nxënësit kanë mundur të rrethojnë më shumë përgjgje.

Nxënësve, në krahasim me përgjigjet tjera të ofruara, në orët e gjuhës serbe më së paku u ka pëlqyer materiali shtesë (40,77%) dhe në këtë nuk ka devijim të dukshëm sipas klasëve (38,0% – 45,1%) dhe tekstet mësimore të cilat i përdorin(34,82%), në distancë prej 31,3% (klasa VII) deri 41,8% (klasa V). Mënyrën e punës së arsimtarëve e ka shënuar 25,60% e nxënësve. Në krahasim me klasët tjera dhe në këtë mesatare, me mënyrën e punës së arsimtarëve më pak janë të kënaqur nxënësit e klasës IV (35,7%), kurse më të

kënaqur janë nxënësit e klasës së VIII (17,7%). Me përqindjen 9,23% janë shënuar „sgjërat të cilat i bëjmë në orë", më shumë në klasën VIII (11,5%) dhe të VI (10,9%), kurse më së paku në klasën e VII (6,3%). Është interesante se gjithsej 0,89% shënon pakënaqësi të shkaktuar nga mungesa e mjeteve të punës, në klasën e V dhe të VI asnjë nxënës nuk ka shënuar këtë përgjigje.

Kur krahasohen të dhënat e marra nga arsimtarët me ato të marra nga nxënësit, shihet se ata në disa raste janë në kundërshtim. Në të vërtetë, arsimtarët si gjëra të cilat janë të domosdoshme të ndryshohen me qëllim të përmirësimit të kualitetit të mësimit shohin kryesisht gjërat të cilat nuk kanë të bëjnë direkt me ata: përmirësimin e kushteve të punës, sigurimin e teksteve mësimore më bashkëkohore dhe mjeteve të reja, angazhim më të madh të prindërve dhe bashkësisë, etj. përderisa shpesh në tërë këtë situatë nuk njohin rëndësinë e rolit të vet dhe ndryshimin e mënyrës së realizimit të orës, edhe pse, gati pa përjashtim, të gjithë (qoftë edhe në mënyrë deklarative) janë të gatshëm për aplikimin e metodave të reja të zhvillimit të mësimit. Nga ana tjetër, gati se çdo i katërti nxënës si gjënë e cila është më pak tërheqëse në orën e gjuhës serbe kanë theksuar mënyrën e punës së arsimtarëve, gjë që edhe nuk befason kur merret parasysh informata se shumica e nxënësve, me anë të vetë dëshmisë, më së shpeshti (vetëm) dëgjon arsimtarin dhe përgjigjet në pyetjet e shtruara. Nga kjo është e qartë se mënyra në të cilën diçka mund të ndryshojë esencialisht është ajo që domosdo do të ndryshojë kushtet e mësimit, por çka është edhe më me rëndësi, vetë qasjen e mësimit.

Tabela 3.4.4. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: Çka dëshiron të bësh më së shumti në orët e gjuhës serbe?

KLASA	Përgjigjet							
	Këndojmë këngë, recitojmë	Shikojmë filma dhe video-materiale tjera	Vizatojmë, ngjyrosim, përgatisim kolazhe, stripa, fotografi, etj.	Komunikojmë mjaft në gjuhën serbe, krijojmë situata konkrete dhe aktrojmë role të ndryshme	Shkruajmë këngë, hartime, artikuj, etj.	Të lexojmë	Të mësojmë gjuhën dhe gramatikën (nga tekstet mësimore) dhe të bëjmë detyra	Të tjera
4	44.6%	18.8%	14.5%	38.7%	18.3%	7.0%	7.0%	2.7%
5	20.3%	29.1%	10.1%	34.2%	34.2%	8.9%	8.9%	1.3%
6	16.7%	21.7%	8.3%	50.0%	15.0%	11.7%	1.7%	.0%

7	15.1%	25.0%	11.2%	48.0%	25.7%	2.6%	3.3%	2.0%
8	14.8%	32.3%	5.4%	48.0%	21.5%	4.0%	5.4%	1.8%
Gjithsej	23.57%	25.86%	9.86%	44.14%	22.43%	5.71%	5.43%	1.86%

Më së shumti nxënës kanë shprehur dëshirën që në orë të komunikojnë në gjuhën serbe, krijojnë situata konkrete dhe të aktrojnë role të ndryshme (44,14%), diçka më pak nga kjo mesatare në klasën e IV (38,7%) dhe klasën e V (34,2%), kurse më shumë në klasët tjera (në klasën e VII dhe VIII – 48.0%, në klasën VI – 50,0%).

Me 25,86% është shënuar shikimi i filmave dhe video-materialit tjetër, më së paku në klasën e IV (18,8%), kurse më së shumti në klasën e VIII (32,3%). Megjithkëtë, nuk është rregull që nxënësit më të mëdhenj të propozojnë më shumë këto aktivitete, duke qenë se edhe nxënësit e klasës së V kanë shënuar këtë përgjigje me përqindje më të madhe nga mesatarja për këtë pyetje (29,1%).

Vijon këndimi i këngëve dhe recitimi (23,57%), me dallim të dukshëm në mes të nxënësve më të rinj dhe më të vjetër: IV – 44,6%, V – 20,3%, VI – 16,7%, VII – 15,1%, VIII – 14,8%. Këto dallime mund t'iu shënohen karakteristikave të moshës.

Shkrimin e këngëve, hartimeve dhe artikujve, pra shkrimin kreativ e rekomandojnë 22,43% nxënës, më së shumti në klasën e V (34,2%), më së paku në klasën e VI (15,0%), që tregon për faktin se dallimet nuk janë të kushtëzuara me moshën.

Vizatimi, ngjyrosja dhe përgatitja e materialeve të ndryshme vizuele është shënuar me 9,86%, më së shumti në klasën e IV (14,5%), kurse më së paku në klasën e VIII (5,4%), që gjithashtu mund të jetë pasojë në moshë.

Dëshirën për lexim e shprehin 5,71% e nxënësve, më së shumti në klasën e VI (11,7%), kurse më së paku në klasën e VII (2,6%). Është e qartë se dallimet nuk janë shkaktuar me moshën, mund t'iu shënohen përvojave të leximit të teksteve nga tekstet mësimore, respektivisht me zgjedhjen e teksteve dhe qasjen në përpunimin e tyre. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se me pyetje nuk ka qenë precizuar lloji i leximit (për shembull ushtrimi i teknikës së leximit ose leximi informativ), nuk mund të dihet me siguri se çka kanë menduar disa nxënës.

Mësimi i gjuhës dhe gramatika nga librat dhe përpunimi i detyrave bart 5,43%, më shumë punë të tillë propozojnë nxënësit IV (7,0%) dhe klasa e V (8,9%), më së paku nxënësit e klasës së VI (1,7%), përderisa

në klasën e VII dhe VIII kanë qenë më të përafërt me mesataren e përgjigjes në këtë pyetje (VII – 3,3%, VIII – 5,4%). Edhe në këto dallime mund të ndikojnë karakteristikat e teksteve mësimore dhe qasja ndaj këtij lloji të njësisë mësimore.

„Të tjera“ kanë shënuar1,86% e nxënësve, në dallim prej 0% do 2,7%, me ç’rast vihet re rregullsia në krahasim me moshën

Tabela 3.4.5. – Pasqyra e përgjigjes në pyetjen: Cila pjesë nga gjuha serbe të duket më interesante?

KLASA	Përgjigjet					
	Gramatika	Leximi (ushtrimi i leximit në orë)	Shkrimi dhe përkthimi	Komunikimi gojor	Letërsia	Të tjera
4	40.1%	59.4%	18.8%	16.3%	10.4%	1.5%
5	40.0%	53.8%	12.5%	23.8%	25.0%	2.5%
6	27.6%	37.9%	5.2%	31.0%	8.6%	.0%
7	45.5%	30.1%	9.6%	32.7%	22.4%	2.6%
8	32.3%	31.0%	5.3%	38.5%	15.5%	.0%
Gjithsej	37.81%	41.83%	10.80%	28.81%	16.07%	1.25 %

Për përqindjen më të madhe të nxënësve (41,83%) pjesa më interesante e mësimit është leximi (ushtrimi i leximit në orë). Shikuar nga klasët, më së shpeshti e kanë shënuar nxënësit e klasës së V (59,4%). Përqindjet gradualisht zvogëlohen me rritjen e klasëve (V – 53,8%, VI – 37,9%, VII – 30,1%, VIII – 31,0%), që është në harmoni me pritjet nëse përgjigjet interpretohen si teknikë e ushtrimit të leximit. Megjithkëtë, të dhënat se nxënësit me dëshirë lexojnë tekste në gjuhën serbe duhet të merren me rezervë. Në bazë të pyetësorit nuk mund të dihet me siguri nëse nxënësit këtë pyetje e kanë interpretuar si lexim të zëshëm të përkthyer nga teksti i panjour (me qëllim që mekanikisht të ushtrohet shkathtësia e leximit me zë) ose me këtë kanë nënkuptuar leximin e tekstit të pasigurtë me qëllim të arritjes së diturive të reja.

Befasisht, një përqindje e madhe e nxënsve ka shënuar gramatikën si më interesante (37,81%). Ky është rezultat i papritur, duke qenë se këtë fushë njëkohësisht e kanë dalluar edhe si më të vështirë, kurse gramatika në mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare shpesh kualifikohet si shumë voluminoze dhe e papërshtatshme për këta nxënës. Gramatika është më interesante për nxënësit e klasës së VII (45,5%).

Në krahasim me ata, kjo pjesë e mësimit është më pak interesante për nxënësit e klasës IV (40,1%), V (40,0%) dhe të klasës së VIII (32,3%) kurse më së paku për nxënësit e klasës së VI (27,6%).

Sipas shkallës së interesimit diçka më i vogël është komunikimi me gojë (28,81%), që është më interesante për nxënësit e klasës së VIII (38,5%). Të dhënat tregojnë se ajo është më së paku e rëndësishme për nxënësit e klasëve më të ulëta dhe se rritet gradualisht (IV – 16,3%, V – 23.8%, VI –31.0%, VII – 32.7%). Është e mundur se në këtë ndikon qasja ndaj mësimit.

Për nxënësit, në krahasim me të mëparshmet, më pak interesante është letërsia (16,07%). Përqindjet shkojnë nga më e madhja në klasën e V (25.0%) deri te më e vogla në klasën e VI (8.6%), por nuk mund të vihet re rregullsia sipas klasëve (IV –10.4%, VII –22.4%, VIII – 15.5%). Ka shumë mundësi që në këto rezultate të ndikojë përzgjedhja e teksteve dhe mënyra e përpunimit të tyre.

Shkrimi dhe përkthimi dukshëm mbeten mbrapa nga leximi, sa i përket interesimit të nxënësve. Si më interesante këto fusha i kanë shënuar gjithsej 10.80% nxënës. Këto aktivitete diçka më shumë i dëshirojnë nxënësit më të ri, kurse më pak të vjetrit (IV – 18.8%, V – 12.5%, VI – 5.2%, VII – 9.6%, VIII – 5.3%).

Tabela 3.4.6. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: Cila njësi mësimore të duket më e vështirë nga gjuha serbe?

KLASA	Përgjigjet						
	Gramatika	Leximi (ushtrimi i leximit në orë)	Shkrimi dhe përkthimi	Komunikimi me gojë	Letërsia	Të tjera	Cdo gjë është e lehtë
4	34.9%	12.8%	19.5%	27.7%	17.9%	2.6%	3.1%
5	53.8%	6.3%	12.5%	15.0%	17.5%	3.8%	.0%
6	46.6%	6.9%	10.3%	25.9%	8.6%	5.2%	.0%
7	46.8%	5.2%	24.0%	17.5%	5.2%	2.6%	6.5%
8	57.4%	4.0%	15.7%	11.2%	12.6%	.4%	3.6%
Gjithsej	47.61%	7.18%	17.75%	18.73%	12.68%	2.25%	3.38%

Përqindja më e madhe e nxënësve ka shënuar gramatikën si njësia më e rëndë mësimore (47,61%). Dallimi shkon prej 34,9% në klasën e IV deri 57,4% në klasën e VIII, që është informatë e cila nuk befason duke pasur parasysh se njësia mësimore, gradualisht nga klasa në klasë, rritet dhe ndërlikohet.

Në përqindje, numër shumë më i vogël konsideron komunikimin me gojë më të vështirë (18,73%). Shikuar nga klasët, këtë segment më shpesh e kanë dalluar nxënësit e klasës IV (27,7%) dhe të VI (25,9%), kurse më së paku nxënësit e klasës së VIII (11,2%). Kjo informatë mund të tregojë për rritjen e aftësisë së komunikimit në pajtim me moshën.

Përqindje gati e njëjtë e nxënësve shënon shkrimin dhe përkthimin (17,75%), me ç'ast këto aktivitete si më të vështirat më së shpeshti janë shënuar te nxënësit e klasës së VII (24,0%), kurse më së paku te nxënësit e klasës së VI (10,3%). Në klasët tjera dallon (IV – 19,5%, VIII – 15,7%, V – 12,5%). Të dhënat e marra nuk tregojnë për rregullsinë sipas klasëve.

Sipas frekuencës vijon fusha e letërsisë, të cilën gjithsej e kanë shënuar 12,68% nxënës. Më shpesh e kanë shënuar nxënësit e klasës IV (17,9%) dhe klasës së V (17,5%), me frekuencë pak më të vogël nxënësit e klasës së VIII (12,6%), kurse më së paku nxënësit e klasës së VI (8,6%) dhe VII (5,2%). Kjo mund të jetë e kushtëzuar me llojin dhe mënyrën e përpunimit të teksteve letrare.

Përqindja e nxënësve të cilët leximin (të ushtruarit e leximit në klasë) e kanë shënuar si më të vështirë, më e madhe është në klasën e IV (12,8%) dhe gradualisht zvogëlohet deri në klasën e VIII (4%), që është rezultat i pritur. Gjithsej 7,18% nxënës kanë shënuar leximin si njësi mësimore më të vështirë. Kjo është përqindje relativisht e vogël dhe mund të ndërlidhet me përqindje të madhe të nxënësve të cilët këtë aktivitet e kanë shënuar si më interesant.

Se gjithçka iu duket e lehtë e kanë shënuar 3,38% nxënës, më së shumti në klasën e VII (6,5%), përderisa në klasën e V dhe VI askush nuk është shprehur ashtu (0%). Informata se, në krahasim me klasët tjera, pikërisht në klasën e VII më së shumti nxënës konsideron se asgjë nuk është e vështirë, nuk është pritur, duke qenë se materiali mësimor për këtë klasë është relativisht voluminoz dhe i vështirë. „Të tjera" kanë shënuar 2,25%, më së shumti në klasën e VI (5,2%), kurse më së paku në klasën e VIII (0,4%).

Tabela 3.4.7. – Pasqyra e pëgjigjeve në pyetjen: A ju jep arsimtari detyra të shtëpisë të punoni në shtëpi?

KLASA	Përgjigjet	
	PO	JO
4	98.5%	1.5%

5	81.0%	19.0%
6	85.0%	15.0%
7	87.9%	12.1%
8	97.8%	2.2%
Gjithsej	93.0%	7.0%

Mesatarisht 93,0% e nxënësve thekson se marrin detyra shtëpiake. Shënohet, megjithkëtë dallim i madh përqindjesh në mes të klasëve, por ajo sipas të dhënave të marra, nuk është e kushtëzuar me moshën sepse më shumë nxënës kanë shënuar se marrin detyra të shtëpisë në klasën e V (19.0%), VI (15.0%) dhe VII (12.1%), përderisa numër shumë më i vogël është përgjigjur kështu në klasën e IV (1.5%) dhe të VIII (2.2%).

Tabela 3.4.8. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: Cilin lloj të detyrave shtëpiake e bëni më së shpeshti në shtëpi?

KLASA	Përgjigjet					
	Detyra lidhur me njësinë e fundit mësimore, nga fletoret e punës dhe librat e leximit	Shkruajmë hartime nga tema të ndryshme	Detyra lidhur me mësimin e fundit dhe shkruajmë hartime	Mësojmë fjalët e panjohura	Mësojmë këngë	Të tjera
4	69.4%	24.6%	3.3%	.5%	1.6%	.5%
5	45.9%	28.4%	8.1%	14.9%	.0%	2.7%
6	78.4%	17.6%	2.0%	2.0%	.0%	.0%
7	72.1%	22.4%	2.0%	2.0%	1.4%	.0%
8	72.2%	20.3%	2.4%	5.2%	.0%	.0%
Gjithsej	69.0%	22.6%	3.1%	4.0%	.7%	.4%

Lidhur me pyetjen për llojin e detyrave shtëpiake, të dhënat tregojnë për:

Rreth dy të tretat e nxënësve (69,0%) kanë shënuar se këto janë të dhëna lidhur me mësimin e fundit nga teksti mësimor (fletoret e punës dhe librat e leximit). Nga kjo më së paku detyra shtëpiake të këtij lloji theksojnë nxënësit e klasës së V (45,9%), kurse më së shumti nxënësit e klasës së VI (78, 4%).

Me përqindje vijojnë detyrat e shtëpisë, shkrimit të hartimeve në tema të ndryshme (22,6%). Mund të vihet re se ato janë të përfaqësuara pikërisht në klasët në të cilat është diçka më e vogël përqindja e detyrave lidhur me tekstet mësimore – klasën e V më së shumti (28,4%), kurse më së paku VI (17,6%). Është e mundur se këto detyra janë rezultat i vlerësimit të përgjithshëm të arsimtarëve për efikasitetin e teksteve mësimore për disa klasë, por edhe përshtatshmëri të disa njësive nga tekstet mësimore për punë në shtëpi.

Mësimi i fjalëve të panjohura në shtëpi është evidentuar te gjithsej 4,0% e nxënësëve, më së shumti në klasën e V (14,9%), kurse më së paku në klasën e IV (0,5%). Prej klasës VI deri në klasën e VIII përqindja sillet në dallim prej 2,0% deri 5,2%. Mësimi i vjershave në shtëpi është relativisht pak i përfaqësuar në të gjitha klasët (0,7%), plotësisht mungon në klasën e V, VI dhe VIII, kurse në klasën e IV dhe VII është e përfaqësuar me 1.6%, respektivisht 1.4%.

Lloje të tjera të detyrave shtëpiake, përveç atyre të parashikuara në pyetësor, nuk kanë shënuar nxënësit e klasëve VI, VII dhe VIII, në klasën e IV shënojnë 0,5%, kurse në klasën e V – 2,7%. Do të ishte interesante të dinim cilat lloje të detyrave janë këto.

Tabela 3.4.9. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: A ushtroni në shtëpi atë që e keni mësuar në orët e gjuhës serbe?

KLASA	Përgjigje	
	PO	JO
4	97.5%	2.5%
5	100.0%	.0%
6	98.3%	1.7%
7	98.7%	1.3%
8	96.0%	4.0%
Gjithsej	97.6%	2.4%

Gati të gjithë nxënësit (97,6%) shënojnë se në shtëpi ushtrojnë atë që e kanë mësuar në orët e gjuhës serbe. Në këtë nuk ka devijime të shumëta sipas klasëve. Është vënë re se në krahasim me klasët tjera, diçka më shumë nxënës të klasës së VIII nuk ushtrojnë në shtëpi (4,0%), por as kjo nuk është përqindje e lartë.

Tabela 3.4.10. – Pasqyra e përgjigjeve në pyetjen: A konsideron se gjatësia e orës së gjuhës serbe është e përshtatshme?

KLASA	Përgjigje		
	Kohëzgjatja e orës është e përshtatshme	Kohëzgjatja e orës është shumë e gjatë	Kohëzgjatja e orës është shumë e shkurtër
4	84.8%	8.8%	6.4%
5	93.8%	2.5%	3.8%
6	90.0%	8.3%	1.7%
7	98.1%	1.3%	.6%
8	92.5%	.9%	6.6%
Ukupno	91.5%	4.0%	4.5%

Ora e gjuhës serbe zgjat 45 minuta, siç kanë shënuar 96,2% e nxënësve.

Me gjatësinë e orës janë të kënaqur 91,5% e nxënësve. Nga kjo devijime më së shumti ka në klasën e IV, në të cilën 8,8% e nxënësve kanë shënuar se ora është shumë e gjatë, kurse 6,4% se është shumë e shkurtër. Në klasën e VI për pak më shumë nxënës ora është shumë e gjatë (8,3%) në krahasim me ata të cilët thonë se ora është shumë e shkurtër (1,7%), përderisa në klasën e VIII situata është e kundërt- ka më shumë nxënës të cilët konsiderojnë se ora duhet të zgjatet (6,6%), kurse më pak nga ata të cilët mendojnë se do të ishte më mirë të jetë më e shkurtër (0,9%). Në klasën e VIII kjo mund të jetë edhe pasqyrë e rritjes së vetëdijes për nevojën e njohjes së gjuhës serbe, por edhe planit dhe programit për këtë lëndë sipas të cilit nxënësit e klasës së VIII kanë një orë në javë më pak në krahasim me klasët tjera.

III.3.5. Vërejtjet përmbledhëse për rezultatet e përgjigjeve të nxënësve

Për mënyrën e punës, përfaqësinë e fushave të caktuara dhe aktivitetet, rëndësinë e tyre dhe interesimet

Në bazë të përgjigjeve në pyetjen *Çka bëni në orët e gjuhës serbe, si duken ato?* në të cilën 86,9% e nxënësve kanë shënuar përgjigjen “arsimtari kryesisht flet, kurse ne përgjigjemi kur na bën pyetje”, mund

të konkludohet se në orë dominon puna frontale dhe komunikimi i njëanshëm të cilin e inicon arsimtari me shtruarjen e pyetjeve. Në favor të kësaj flet edhe fakti se komunikimi në gjuhën serbe dhe simulimi i situatave të përditshme jetësore në përqindje dukshëm mbetet mbrapa nga ajo që u theksua më lartë, kanë rrethuar shumë më pak nxënës-– 31,29%.

Me mënyrën e tillë të punës dhe organizimin e orës, duke u nisur përgjigjet në pyetjen *Çka të pëlqen më së shumti në orët e gjuhës serbe?* shumica e nxënësve janë të kënaqur, duke qenë se ka përqindje shumë të madhe (86,70%) që kanë rrethuar „mënyra në të cilën arsimtari punon me neve"dhe kjo përgjigje dukshëm paraprin në krahasim me të gjitha përgjigjet tjera të dhëna (tjetri në radhë merr 30,70% dhe ka të bëjë me tekstet mësimore). Në fakt, nuk ëhtë e lënë pas dore as përqindja e nxënësve të cilët mënyrën e punës së arsimtarëve ekanë ndarë si diçka që iu pëlqen më së paku në orët e gjuhës serbe (25,60%).

Përqindja e madhe e nxënësve të cilët janë të kënaqur me mënyrën e punës së arsimtarëve nuk nënkupton se komunikimit në gjuhën serbe nuk dëshirojnë t'i japin vend të rëndësishëm sepse, në krahasim me përgjigjet tjera të ofruara në pyetjen *Çka dëshiron të bësh më së shumti në orët e gjuhë serbe?* pikërisht komunikimi është vënë në vend të parë (44,14%) dhe dukshëm dallon në krahasim me përqindjen e përgjigjeve tjera (i dyti sipas përqindjes ka të bëjë me shikimin e filmave dhe video materialit tjetër- 25,86%). Në favor të mendimit se mënyra e organizimit të aktiviteteve të komunikimit gojor në orë mund të ndryshojë, të bëhet më interesante dhe më adekuate, flet fakti se ky aktivitet ka marrë vendin e tretë në shkallën e pjesëve interesante të gjuhës serbe- – 28,81% (si më interesante nga kjo janë dhënë leximi 41,83% dhe gramatika 37,81%).

Qasja në marrëdhënien në mes të situatës ekzistuese (*Çka bëni në orët e gjuhës serbe?*) dhe situatës së dëshiruar (Çka do të dëshironit më së shumti të bënit në orën e gjuhës serbe?), përveç dëshirës së përmendur për përfaqësueshmëri më të madhe të komunikmiit, tregon se nxënësit, gati se nga të gjitha që janë përmendur, më së shumti kanë dëshirë të: shikojnë filma dhe videomateriale tjera (përfaqësuar – 4,73%, dëshiruar – 25,86%), këndojnë këngë dhe recitojnë (përfaqësuar– 9,32% dëshiruar – 23,57%, në fakt shumë më tepër në moshë më të re), shkruajnë këngë, hartime, artikuj (përfaqësuar – 15,86%, dëshiruar – 22,43%), si edhe të mësojnë nga tekstet mësimore dhe të bëjnë detyra nga teksti mësimor (përfaqësuar – 2,78%, dëshiruar – 5,43%). Të kushtuarit më shumë vëmendje dhe kohë këtyre aktiviteteve do të zvogëlonte prezencën e punës frontale, të bazuar në të shprehurit dhe pyetjet e arsimtarit dhe përgjigjes së nxënsit.

Vetëm në lidhje me leximin diçka më ndryshe është situata: me 8,48% kanë shënuar se lexojnë në orët e gjuhës serbe, kurse me 5,71% se kanë dëshirë të lexojnë. Në krahasim me pyetjet tjera për njësinë mësimore më të vështirë, leximin më së paku nxënës e kanë shënuar si më të vështirin (7,18%), dhe ajo është

njëkohësisht edhe më së shpeshti e rrethuar si pjesa më interesante e gjuhës serbe (41,83%).

Tregues janë edhe rezultatet e përgjigjes në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me mësimin e materies gjuhësore dhe gramatikës. Nga njëra anë, përqindje relativisht e vogël rrethon përgjigjen se iu pëlqen puna në orë e cila është e lidhur me gjuhën (6,20%), gjithashtu një përqindje e vogël do të donte mësimin e gjuhës dhe gramatikës dhe përpunimin e detyrave të tilla (5,43%), një përqindje e madhe gramatikën e shënon si njësinë mësimore më të vështirë përpara të gjitha përgjigjeve të tjera të cilat janë propozuar si njësia mësimore më e vështirë) 47,61%, dhe kjo përqindje është dukshëm përpara të gjitha përgjigjeve tjera të cilat janë propozuar si njësia mësimore më e vështirë), kurse nga ana tjetër, 37,81% shënon gramatikën si më interesante (menjëherë pas mësimit – 41,83%).

Për mjetet mësimore

Nuk ka dallime të dukshme në numrin e nxënësve të cilët librat i kanë shënuar si diçka që iu pëlqen më së shumti dhe numri i atyre të cilët kanë shënuar si diçka që iu pëlqen më së paku (30,70% - iu pëlqen më së shumti, 34,82% – iu pëlqen më së paku). Duke u nisur nga rezultatet e këtij pyetësori, nxënësit janë më pak të kënaqur me materialin shtesë (40,77% kanë shënuar se më pak iu pëlqen, kurse 7,80% se iu pëlqen më së shumti). Nxënësit nuk ndjejnë mungesë të mjeteve për punë, gjithsej 0,89% kanë shënuar këtë përgjigje, në kuadër të pyetjes për atë çka iu pëlqen më së paku.

Për detyrat e shtëpisë dhe ushtrimeve në shtëpi

Detyrat e shtëpisë janë të përfaqësuara, siç shprehen 93,0% e nxënësve. Më së shpeshti këto janë detyra lidhur me mësimin e fundit nga teksti mësimor. Në shtëpu, sipas rezultateve të pyetësorit 97,6% e nxënësve ushtrojnë atë që e kanë mësuar në orën e gjuhës serbe.

Për kohëzgjatjen e orës

Ora e gjuhës serbe zgjat 45 minuta. Se kjo është kohëzgjatje optimale kosniderojnë 91,5% e nxënësve, kurse afërsisht përqindje e barabartë konsiderojnë se ora është shumë e gjatë (4,0%), respektivisht shumë e shkurtër (4,5%).

Duke pasur parasysh tërë atë që u tha më lartë, është pa dyshim se situata e gjetur në terren duhet të avancohet, me ç’rast disa nga masat mund të përfshijnë përpunimin e teksteve mësimore të reja, moderne, respektivisht, që është zgjidhje më shpejtë e aplikueshme, pajisja e shkollave me disa komplete

të teksteve mësimore ekzistuese por më bashkëkohore të cilat momentalisht nuk janë në përdorim. Siç është, fundja, rasti edhe me bashkësitë tjera etnike- edhe te bashkësia shqiptare është e domsdoshme që prezenca e saj të bëhet më e dukshme si në tekstet mësimore ashtu edhe në mjetet tjera mësimore sepse në këtë mënyrë njësia mësimore do të bëhej më e përafërt dhe më e kuptueshme për fëmijët, kurse ata në njëfarë mënyre do të mund të identifikohen me personazhet e caktuara nga librat e vet. Nuk duhet as të anashkalohet hartimi i fjalorëve të cilët janë shumë të dobishëm për përvetësimin e gjuhës joamtare, si dhe përpilimin e mjeteve të ndryshme audi-vizuele. Natyrisht, në gjithë këtë nuk duhet harruar as ata të cilët zbatojnë mësimin- arsimtarët, të cilët janë të interesuar të ndjekin seminare të ndryshme dhe të avancojnë njohuritë e tyre. Më në fund, kujdes i posaçëm duhet t'iu kushtohet përpjekjeve që nxënësit gjuhën serbe ta përdorin edhe jashtë klasëve, që mund të arrihet qoftë me organizimin e ekskurzioneve të ndryshme nëpër Republikë qoftë me stimulimin e kontakteve me folësit lokal burimor të gjuhës serbe.

III.4. Analiza e teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare prej klasës I deri VIII të shkollës fillore

III.4. ANALIZA E TESKTEVE MËSIMORE PËR GJUHËN SERBE SI GJUHË JOAMTARE PREJ KLASËS I DERI VIII TË SHKOLLËS FILLORE

Vesna Krajishnik dhe Nikica Strizhak

III.4.1. Pasqyra e strukturës dhe përmbajtjes së teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare prej klasës I deri IV të shkollës fillore

Me planin dhe programin mësimor prej klasës I deri IV është paraparë mënyrë e ndryshme e prezantimit të planit mësimor pasi që një numër i madh i nxënësve në klasë të I për herë të parë takohet me këtë gjuhë, pranon melodinë e saj, intonacionin, shkrimin, dhe pastaj gradualisht zotëron edhe me pjesët tjera të sistemit gjuhësor. Për shkak të qasjes së ndryshme në përmbajtjet gjuhësore dhe letrare – nga dëgjimi në klasën e I, zotërimi i shkrimit latin (shkronjat e mëdha të shtypit) në klasën e II deri te përmbajtjet më të ndërlikuara gjuhësore dhe letrare në klasën e III dhe IV – kompletet e teksteve mësimore janë strukturalisht të ndryshme për klasën e I dhe II gjegjësisht III dhe IV. Pikërisht për këtë veçmas do të vështrohet dhe analizohet kompleti për secilën klasë, do të tregohen specifikat e tij, konzistenca në ndjekjen e Programit mësimor dhe do të propozohen zgjidhje më të mira.

III.4.1.1. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e I

Struktura

Kompleti për tekstet mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e I të shkollës fillore përbëhet nga teksti *Učimo srpski 1*, CD përcjellëse dhe *Priručnik za nastavnike*, i autoreve Nataša Dobrić dhe Biljana Maksimović.

Teksti mësimor është i hartuar si libër me ilustrime, pa përmbajtje tekstuale përveç titujve të mësimeve, të cilët janë gjithsej 25. Tekstit i janë shtuar edhe ushtrimet e ilustruara të parapara për punën manuale të nxënësve. Mësimet paraqesin tërësi tematike kryesisht të parapara me Planin dhe programin mësimor me të cilat autoret janë përpjekur të mbulojnë përmbajtjet dhe aktivitetet nga rrethi i ngushtë dhe veprimtaritë e përditshme të nxënësve: *Zdravo, deco, Susedi, Škola, Gde je učionica, Veliki odmor, Dan škole, Zaboravljeni pribor, Jedna porodica, Deca spremaju sobu, Ana i lutka, Nova godina, Deda Mraz, Na putu*

do škole, Tunel, Neuredan dečak, Na pijaci, Idemo u prodavnicu, Brojimo do 20, Vesna je bolesna, Pošta, Halo, ovde…, Dani u nedelji, Jutro u cvetnom vrtu, Gozba, A sada, svi na bazen.

Përmbajtja e përgjithshme gjuhësore e mësimeve e cila ndjek ilustrimet në tekst është paraqitur në formë të dëgjueshme, në CD. Tekstet janë dhënë në *Priručnik za nastavnike*, në ç'mënyrë nxënësit nuk mund të shohin shënimin tekstual të asaj që dëgjojnë.

Ushtrimet e ilustruara paraqesin mënyrë plotësuese të animacionit të nxënësve në lidhje me temat nga mësimet. Për klasën e I këto ushtrime janë të bazuara në prerjen e fotografive dhe bashkimin e tyre, grupimin, përshtatjen apo vendosjen në vendin adekuat.

Udhëzuesi për arsimtarët përmban tekstet të cilat i ndjekin ilustrimet, udhëzimet didaktiko-metodike dhe ushtrimet. Tekstet janë kryesisht të llojit të dialogut dhe i përbëjnë fjalitë e thjeshta subjektivo-kallëzore të zgjeruara me objekt apo përcaktim ndajfoljor. Në parathënien e *Priručnik*-ut autoret cekin se, duke respektuar kërkesat tematike nga Plani mësimor, ishin të detyruara që shumicën e teksteve ta konstruojnë, ku janë kujdesur posaçërisht që tekstet të jenë të ngopura me modelet gjuhësore të cilat i përmban pjesa e Materies gjuhësore në Programin mësimor.

Pas teksteve janë dhënë udhëzime didaktiko-metodike të menduara për arsimtarin me qëllimet dhe detyrat, aktivitetet e nxënësve, mjetet dhe ndihmesat mësimore të nevojshme për tejkalimin e përmbajtjes së mësimit, propozimin e aktiviteteve lidhur me mësimin, si dhe modelet gjuhësore të cilat përdoren në mësim.

Ushtrimet janë paraqitur si tërësi e veçantë në secilin mësim. Pasi që Programi mësimor nuk parasheh që nxënësit e kësaj moshe të lexojnë dhe të shkruajnë në gjuhën serbe, autoret i kanë përpiluar ushtrimet ashtu që t'i përmbushin qëllimet e komunikimit verbal: përgigjet në pyetje, shtruarja e pyetjeve, ushtrimet shtesë, ushtrimet e transformimit, ushtrime zëvendësimi, ushtrimet e monologut dhe dialogut, si dhe lojrat e ndryshme.

Në fund të secilit mësim janë dhënë fjalët dhe shprehjet e reja.

Në fund të tekstit mësimor janë dhënë 13 vjersha për fëmijë për recitim dhe këndim, të përshtatshme për moshën e nxënësve.

Analiza

Me programin për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e I të shkollës fillore nuk është i paraparë aftësimi i nxënësve që të lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën serbe, por përvetësimi i gjuhës në këtë nivel nënkupton ushtrim të shqiptimit të duhur dhe artikulimit të zërave, melodisë dhe intonacionit të fjalisë, si dhe modeleve kryesore komunikative të nevojshme për komunikim të përditshëm. Fondi i paraparë i fjalëve me të cilat duhet të zotërojë nxënësi në klasën e I është 200, për nxënësit më të përparuar 250. Me mjete gjuhësore është i paraparë emërimi i termeve dhe veprimeve kryesore nga jeta e përditshme, si dhe shprehja e gjendjeve dhe ndjenjave më të shpeshta.

Lidhur me këtë mund të themi se struktura e teksteve mësimore i përgigjet qëllimit dhe moshës së nxënësve, më së shumti për arsye se përdor ilustrimet si mjet komunikimi më efikas për këtë moshë, mësimet janë shpërndarë mirë dhe ndjekin fondin e paraparë të orëve, kurse teksti audio (CD) duhet të siguroj shqiptim kualitativ të termeve gjuhësore në pajtim me standardet e gjuhës letrare serbe.

Mirëpo, përmbajtja e tekstit mësimor në masë të madhe tejkalon mundësitë gjuhësore të nxënësve të klasës së I, në të gjitha aspektet gjuhësore:

1. Përmbajtjet e mësimeve, siç kemi thënë edhe më parë, janë dhënë përmes ilustrimeve (në tekstin mësimor) dhe në formë audio (në CD) dhe paraqesin dialogjet mes dy apo më shumë personazheve (përveç se në mësimin e parë). Tekstet janë të gjera dhe, duke marrë parasysh se nuk i njohin as fjalët as ndryshimet e tyre gramatikore, për nxënësit është vështirë që vetëm në bazë të melodisë të vërejnë vlerat semantike dhe të lidhin situatat e ilustruara në tekstin mësimor. Kjo para së gjithash ka të bëjë me ata nxënës gjuha amtare e të cilëve nuk është e përafërt me gjuhën serbe. Numri i njësive mësimore (559) dukshëm tejkalon vlerat e rekomanduara nga Programi. Edhe pse pas çdo mësimi është përmendur numri i fjalëve të reja (prej 13 deri 34 për mësim, gjë që i përgjigjet standardeve metodike), duhet patur parasysh se autoret si fjalë të reja kanë përdorur vetëm leksemat kuptimplote, por nuk kanë marrë parasysh fjalët ndihmëse (përemrat, parafjalët, lidhëzat), të cilat janë poashtu njësi të veçanta mësimore dhe kërkojnë mësimin e çfarëdo fjale tjetër. Me bashkangjitjen e tyre fondit të dhënë leksikor, numri i përgjithshëm i fjalëve do të rritej dukshëm. Prezantimi i numrit të madh të fjalëve në një njësi mësimore mund të paraqes rrethanë të vështirësuar në procesin e mësimit të gjuhës, sidomos tek nxënësit e kësaj moshe kur ende nuk është zotëruar aftësia e shkrimit.

2. Zgjedhja e leksikës shpeshherë del nga korniza e nevojave për moshën e nxënësve të klasës së I. Edhe pse autoret kishin parasysh mjediset e ndryshme nga të cilat rrjedhin nxënësit dhe, në pajtim me

këtë, kanë përfaqësuar leksikën dhe mjediset qytetare dhe fshatare, për nxënësit të cilët për herë të parë takohen me gjuhën serbe zgjedhja e fjalëve duhet të bazohet në termet dhe personat kryesor nga rrethi. Në atë kuptim nuk gjindet arsyetimi për fjalët siç janë: bëj me dorë, rojtar, duartrokas, katrori, ena, hedh, dëgjueset, bluza, kutia postare etj.

3. Zgjedhja e njësive gramatikore është tejet e gjerë, kurse shpërndarja e tyre shumë e ngushtë. Në mësimin e parë, sipas vëllimit më i vogli, gjejmë përmerat vetorë, përmerat dëftorë, emrat, kohën e tashme të foljes *jesam*, foljet *zvati se* dhe *prezivati se*, të dy numrat gramatikor dhe që të tri gjinitë gramatikore, bazën e zgjeruar gramatikore të emrave. Leksika e plotë (25 fjalë) dhe gramatika përsëriten në ushtrime. Gjatë mësimeve të ardhshme vazhdon prezantimi i formave të reja gramatikore – sistemit rasor, sistemit të kohës dhe mënyrës foljore, përdorimit të të dy formave foljore, modeleve fjalëfomuese etj, që në shumë raste tejkalon kornizat e parapara me Programin mësimor.

Të vetëdijshme për problemet e materialit të shumtë leksikor dhe gramatikor në tekstin mësimor për Gjuhë serbe si gjuhë joamtare për klasën e I të shkollës fillore, autoret tërheqin vëmendjen e arsimtarëve që „në disa elemente të Tekstit mësimor (mendohet fillimisht për tekstet të cilat ndjekin situatat dhe ngjarjet) disa përmbajtje të parapara e thejnë programin për këtë nivel të moshës. Kështu, në tekstet të cilat ndjekin situatat e ilustruara në Tekstin mësimor nganjëherë paraqiten modele gjuhësore të cilat nuk janë planifikuar në atë klasë, por në ndonjë klasë më të madhe. Natyrisht, nga nxënësit nuk pritet që me ato modele gjuhësore të zotërojnë edhe në mënyrë produktive. Edhe pse vëllimi i strukturës programore është i kufizuar, natyrshmëria e komunikimit nuk guxon të dëmtohet“.

Mirëpo, në Tekstin mësimor nuk ceket se cili është minimumi i strukturës gjuhësore me të cilin duhet të zotërojnë nxënësit dhe i cili shpie në drejtim të zotërimit funksional të gjuhës në nivelin fillestar. Përmbajtja gjuhësore në mënyrën e cila është hartuar deri më tani mund të ndiqet nga nxënësit të cilët tanimë kanë njohuri adekuate të gjuhës, të cilët çdo ditë edhe jashtë klasës janë në kontakt me gjuhën serbe apo gjuha amtare e tyre është e ngjashme me gjuhën serbe. Për të gjithë nxënësit tjerë duhet kufizuar përmbajtjen gjuhësore me mjetet plotësuese glotodidaktike në vijim, të cilat në mënyrë adekuate do t’ua mundësojnë nxënësve të kësaj moshe kompetencën e nevojshme gjuhësore:

- të emërohen termet dhe personazhet më shpesh të përdorura apo të pranishme në rrethin e nxënësve në formën kryesore gramatikore, duke filluar nga ato në klasë, pastaj në shtëpi, në rrugë, në fushën e lojërave, në shitore etj., duke u kujdesur për zgjedhjen e fjalëve në pajtim me moshën dhe aftësitë kognitive të nxënësit;

- format gramatikore të paraqiten si modele, në nivelin e frazës apo fjalisë (mirdita, mirëmëngjes, kam ftohtë, ma jep, bie shi, është kohë me diell etj.);

- në këtë nivel të diturisë të mos përdoren shprehjet e ndërlikuara gjuhësore – tekstet (përveç këngëve, lojërave të shkurtëra të cilat nxënësit mund t'i memorizojnë tërësisht apo pjesërisht);
- me kufizimin e strukturës gjuhësore krijohet hapësira për përsëritje më të shpeshtë, me të cilën sigurohet dituria aktive dhe produktive.

III.4.1.2. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e II

Struktura

Kompleti i teskteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e II të shkollës fillore përbëhet nga libri *Učimo srpski 2*, CD përcjellëse dhe *Priručnik za nastavnike*, të autores Nataša Dobrić.

Kompleti i teksteve mësimore sipas strukturës është identik me atë për klasën e I. Teksti mësimor përbëhet prej 28 njësive tematike (mësimeve): *Ponovo u školi, Na času, Anin i Ivanov radni dan, Maskenbal, Na pijaci u jesen, U prodavnici, Rođendan, U pozorištu, Lisica i gavran, Šta je Ana uradila?, Ručak, Mama i Ana prave kolače, Dolaze nam gosti, Nova godina, Hajde da brojimo, Zima, Novi drug, Ogledalce, Na igralištu, Igramo žmurke, U zoološkom vrtu, Uskrs, U kupovini, Na selu, Pokvaren sladoled, Cvrčak i mrav, Ribe na maminoj haljini, Idemo na raspust*. Ana dhe Ivani janë, sikur edhe në Tekstin për klasën e I, personazhët kryesor, të cilët janë shtyllat e të gjitha ngjarjeve dhe aktiviteteve në Tekstin mësimor.

Përmbajtja gjuhësore e mësimeve e cila përcjell ilustrimet në Tekstin mësimor është paraqitur në formë auditive, në CD. Tekstet janë dhënë në Udhëzuesin për arsimtarë. Përveç përmbajtjeve ilustrative, në tekst janë dhënë edhe përmbajtje tekstuale minimale – fjalët individuale me të cilat, në kombinim me ilustrimet, ushtrohet njohuria gramatikore dhe leksikologjike e nxënësve. Në kuadër të disa mësimeve janë dhënë edhe vjersha të shkurta për fëmijë të shkrimtarëve tanë të njohur për fëmijë, të cilat përshtaten në kornizën tematike të mësimit.

Ushtrimet e ilustruara në shtesën e Tekstit mësimor janë menduar si mënyrë plotësuese e animacionit të nxënësve në lidhje me temat nga leksionet. Janë bazuar në prerjen e fotografive dhe bashkimin e tyre, grupimin, përshtatjen apo vendosjen në vendin e duhur.

Udhëzuesi për arsimtarë përmban teskte të cilat përcjellin ilustrimet, udhëzime didaktiko-metodike dhe ushtrime. Tekstet janë kryesisht të llojit dialektik, por ka edhe nga ato deskriptive dhe narative të cilat përbëjnë fjalitë e thjeshta dhe të përbëra subjektivo-dëftore të zgjeruara me atribut, objekt apo shprehje ndajfo-

ljore. Sikur edhe në Tekstin mësimor për klasën e I, pas teksteve janë dhënë udhëzime didaktiko-metodike të dedikuara për arsimtarin. Ushtrimet janë paraqitur si tërësi e veçantë në çdo mësim. Në fund të çdo mësimi janë dhënë fjalët dhe shprehjet e reja. Në fund të Tekstit mësimor, por edhe brenda ushtrimeve, gjendet zgjedhja e disa vjershave për fëmijë për recitim dhe këndim, të përshtatshme për moshën e nxënësve.

Analiza

Programi mësimor për klasën e II parasheh që nxënësit në këtë moshë të përvetësojnë grafemat e shkrimit i cili është më i përafërt me gjuhën amtare (shkrim latin apo qirilik), si dhe të lexojnë dhe të shkruajnë tekste dhe vjersha të shkurta të shkruara me shkronja të mëdha të shtypit. Është paraparë që edhe të kuptojnë porositë më të gjata, tërësitë folëse (8–10 fjali) dhe dialogje të shkurta të cilat janë në pajtim me tematikën e paraparë, me ndihmën e mjeteve vizuale, si dhe të përvetësojnë rreth 200 (250 për nxënësit më të avancuar) fjalë dhe shprehje të reja. Prandaj, kompleti i teksteve mësimore është përpiluar mirë:

1. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e II paraqet vazhdimin e kompletit të teksteve mësimore për klasën e I – sipas strukturës, konceptit dhe përmbajtjes. Mirëpo, qasja në lëndën gjuhësore është më selektive me zgjedhje më të mirë të elementeve të rëndësishme.

2. Përmbajtja e mësimeve, gjithsej 28, është paraqitur në ilustrime (në Tekstin mësimor), në formë audio në CD dhe në formë tekstuale në Udhëzues.

3. Zgjedhja e njësive tematike dhe përmbajtjet e tyre leksike dhe gramatike kryesisht paraqesin zgjerim të programit të trajtuar në klasën e I, me shtimin e disa njësive të reja.

4. Më shumë kujdes i është kushtuar zgjedhjes dhe dozimit të leksikut të ri – prej pesë deri në 20 fjalë dhe shprehje të reja për një mësim, kurse fondi i përgjithshëm i njësive të reja leksikore është 407. Leksiku është shpërndarë dhe lidhur mirë në tërësitë tematike. Janë prezantuar edhe terme dhe shprehje të reja terminologjike lidhur me lëndët shkollore (trekëndëshi, bashkësia, rrethi, katrori, shtojcat…).

5. Nga mësimi 5 futet edhe shkrimi – së pari fjalë të shkurta, njërrokëshe, kurse pastaj edhe fjalë më të gjata dhe vjersha, kurse në mësimet e fundit edhe fjali dhe tregime të shkurta në kombinim me ilustrimet. Shkrimi është latin (është më i përafërt me gjuhën shqipe), shkronjat janë të mëdha të shtypit;

6. Ushtrimet në pjesën e parë të Udhëzuesit janë kryesisht tipike dhe shërbejnë për ushtrimin gojor të shkrim-leximit gramatikor, derisa në pjesën e dytë, kur nxënësit zotërojnë leximin dhe shkrimin, janë bërë më të llojllojshme dhe më imagjinative.

Edhe pse kompleti i teksteve mësimore për klasën e II është hartuar në pajtim me kërkesat e Programit mësimor, me përpjekjen e autores që përmbajtjen e ploë të paraparë t'ua afrohet nxënësve në mënyrë sa më të pranueshme dhe analitike, vërehen edhe disa mungesa, me eliminimin e të cilave do të arrihej efikasitet më i mirë në mësimdhënie dhe përvetësimin e lëndës:

- Nxënësit në klasën e II fillojnë të lexojnë dhe të shkruajnë në gjuhën serbe. Do të ishte e pritshme që atë proces ta fillojnë me zotërimin e shkronjave të gjuhës serbe (latine) të cilat kanë mjaft karakteristika të ndryshme të shkronjave (dhe fonemave) në krahasim me shkrim leximin e gjuhës shqipe. Kujdes i posaçëm duhet t'i kushtohet fonemave më të vështira të gjuhës serbe dhe grafemave të tyre, duke theksuar dallimin mes tyre. Mirëpo, kjo mungon në tekstin mësimor dhe menjëherë kalohet në shkruarjen dhe leximin e fjalëve, në ç'mënyrë e tërë ajo pjesë e rëndësishme e kompetencës gjuhësore i lihet arsimtarëve dhe stileve të tyre individuale të të shkruarit.

- Fondi leksikor është më i madh se sa është paraparë me Program, edhe pse është më mirë i prezantuar dhe i shpërndarë nëpër mësime se sa në Tekstin mësimor për klasën e I, për të cilën tregon numri i fjalëve dhe shprehjeve të reja për mësim – prej pesë deri 20. Theksojmë se edhe kësaj here ato janë vetëm fjalë semantike kuptimplote, derisa fjalët ndihmëse nuk janë të numëruara në listën e fjalëve të reja.

- Disa tekste janë shumë të gjerë dhe me shumë informacione, sidomos ato të llojit të dialogut, madje edhe nëse është siguruar kuptimi plotësues me anë të ilustrimeve, për nxënësit është vështirë apo madje edhe e pamundur të ndjekin rrjedhën e ngjarjes.

- Ushtrimet janë bazuar kryesisht në mësimin e gramatikës ku disa nga ato kërkojnë shumë përpjekje. Në të vërtetë, me një ushtrim (fjali) kontrollohet dituria e disa njësive gramatikore, gjë që, duke marrë parasysh faktin se fëmijët ende nuk dijnë të lexojnë dhe shkruajnë dhe se të gjitha ato fjalë dhe informacione gramatikore duhet mbajtur në mend (pa përkrahjen tekstuale) dhe duhet dhënë përgjigja e saktë, është shumë e vështirë për këtë moshë.

III.4.1.3. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e III

Struktura

Kompleti i teksteve mësimore për gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e III të shkollës fillore përbëhet nga *Pouka iz jezika*, e autores Nataša Dobrić, Libri i leximit *Čarolija reči*, i autores Nataša Dobrić,

Radne sveske me libri i leximit *Čarolija reči*, i autoreve Nataša Dobrić dhe Maja Živković, dhe *Priručnik za nastavnike srpskog kao nematernjeg jezika uz udžbenike 3. i 4. razreda osnovne škole*, i autoreve Dušanka Zvekić-Dušanović dhe Nataša Dobrić.

Mësimet nga gjuha janë të hartuara si praktikë gramatikore në të cilën bëhet fjalë për rregullat gramatikore dhe i jepet mundësi nxënësve që t'i ushtrojnë përmes ushtrimeve të ndryshme. Përbëhet nga më shumë se 20 mësime dhe 5 teste për kontrollimin e diturisë. Çdo mësim përbëhet nga tri pjesë: pjesa e parë me përmbajtjen tekstuale apo ilustrative paraqet hyrje tematike dhe gramatikore në mësim, pjesa e dytë tregon rregullat gramatikore dhe ndryshimet e formave gramatikore të fjalëve, kurse pjesa e tretë janë ushtrimet e njësive gramatikore. Autorja është kujdesur edhe për zgjedhjen dhe kuantitetin e fondit leksikor. Zgjedhja e fjalëve është bërë në bazë të kornizës tematike të mësimit dhe kryesisht ato janë fjalë të shpeshta nga mjedisi i përditshëm dhe interesimi i nxënësve.

Libri i leximit përbëhet nga tetë tërësi dhe gjithsej 32 mësime. Tërësitë janë tematikisht të caktuara: I. *A, B, C, mačka prede,* II. *Knjiga je najbolji drug,* III. *Porodični album,* IV. *Ima oči prozorčiće, a vrata joj kao usta,* V. *Rastemo, igramo se i družimo,* VI. *Pričam ti priču,* VII. *Na selu i u gradu,* VIII. *Čarolije prirode.*

Secila nga 32 mësimet përbëhet nga dy pjesë, tematikisht të lidhura, të cilat kanë strukturë të njëjtë: tekstin (tregimi apo vjersha e shkrimtarëve për fëmijë apo punimet e nxënësve), biseda mbi tekstin dhe ushtrimet në të cilat nga nxënësit kërkohet që të vizatojnë, shpjegojnë, aktrojnë apo shkruajnë përmbajtjet e duhura të lidhura me temat në tekst.

Fletorja e punës është shtesë e Librit të leximit. Përbëhet nga 32 mësime të cilat tematikisht ndjekin mësimet nga Libri i leximit. Funksioni i saj kryesor është ushtrimi i shkrimit dhe caktimi i leksikës nga Libri i leximit, dhe në fillim është dhënë alfabeti me shkronja të shtypit dhe të shkrimit. Mësimet përbëhen nga disa ushtrime në të cilat kërkohet që nxënësit të shkruajnë fjalë dhe fjali, të bëjnë pyetje, të rrethojnë përgjigjet e sakta, të zgjidhin enigmat, të lidhin terme të ngjashme etj. Disa nga mësimet kanë edhe ushtrime plotësuese „për ata që dëshirojnë më shumë".

Udhëzuesi përcjell kompletet e teksteve mësimore për klasën e III dhe IV dhe sjell pikëpamjet e disa mundësive të përpunimit të njësive mësimore të përpunuara në librat e leximit dhe mësimet. Autoret kanë zgjedhur 12 njësi mësimore, nga gjashtë në çdo klasë, nga të cilat tri janë të aplikueshme për mjedisin homogjen etnik, kurse tri për të përzier. Në ato janë dhënë llojet kryesore të orëve: përpunimi i tekstit, ushtrimi gojor dhe i shkruar, sistematizimi i njësisë mësimore. Siç cekin autoret, qëllimi i tyre është që të ilustrojnë mundësitë e aplikimit të sistemit dhe veprimeve metodologjike me dëshirë që të stimulojnë punën e vazhdueshme kreative në mësimin e gjuhës serbe.

Pjesa e dytë e Udhëzuesit paraqet Shtesën – Oraret orientuese të njësisë mësimore për klasën e III dhe IV të shkollës fillore. Në të është dhënë mënyra e hollësishme e planit të realizimit të mësimit për klasën e III dhe IV, për mjedisin etnik homogjen dhe heterogjen, për çdo gjysëmvjetor veçmas. Në të ceken përcaktuesit në vijim: *Broj časa, Nastavna jedinica, Tip časa, Nastavne metode, Nastavna sredstva* dhe *Domaći zadaci.*

Qasja e këtillë në përpunimin e njësive msimore ia lehtëson arsimtarit realizimin e mësimit, duke i lënë kështu hapësirë të mjaftueshme për kreativitetin e vet dhe përshtatjen e strukturës dhe rrjedhës së orës në pajtim me situatën në klasë.

Analiza

Me planin dhe programin mësimor është paraparë që nxënësit e klasës së III të zotërojnë shkrim leximin funksional të gjuhës serbe në kuptimin që të mund të shkruajnë me shkronja latine të shtypit dhe të shkrimit, të lexojnë dhe kuptojnë tekstet e shkurta të përshtatura për moshën e tyre, të njohin dhe të përdorin rregullat themelore gramatikore, të zgjerojnë fondin leksikor për 200 fjalë të reja. Kjo u mundëson që, në rrethana të kufizuara, të jenë pjesëmarrës aktiv në komunikim në gjuhën serbe, si në të shkruar ashtu edhe në të folur.

Kompleti i teksteve mësimore për klasën e III edhe për nga struktura edhe përmbajtja ndjek rekomandimet e Programit dhe nxënësve në mënyrë funksionale dhe dëfruese i ofron mundësinë që të zotërojnë aftësitë e nevojshme gjuhësore. Posaçërisht do të theksonim Udhëzimet nga gjuha dhe Fletoren e punës, përmbajtjet e të cilave paraqesin minimumin e njësisë mësimore të nevojshme dhe janë të rëndësishme pikërisht për ata nxënës të cilët nuk kanë pasur njohuri gjuhësore nga gjuha serbe, si dhe për ata gjuha amtare e të cilëve nuk është e ngjashme me gjuhën serbe, siç është rasti me nxënësit e bashkësisë shqiptare.

Mësimet në Mësime mbi gjuhën iu janë përshtatur moshës së nxënësve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga mënyra e distribuimit të përmbajtjes gjuhësore: (I) tekstet janë të shkurta dhe të kuptueshme, me përmbajtje të thjeshtë, të përcjellura me ilustrime, të cilat bashkë me tekstin janë bartëse të informacionit, (II) përmbajtjet gramatikore janë të ekspozuara gradualisht dhe qartë, kurse (III) ushtrimet e menduara në kombinim të tekstit dhe ilustrimit mundësojnë që nxënësit në mënyrë dëfruese të ushtrojnë gramatikën e nevojshme. Përmes 20 mësimeve përpunohet përmbajtja gramatikore e paraparë me Program: perfekti, koha e ardhme, koha e tashme e foljeve refleksive, përemrat pronor, mbiemrat pronor, format rasore të emrave dhe mbiemrave dhe kuptimi themelor i rasave. Mësimet nuk janë të stërngarkuara dhe përmbajtja e tyre i është përshtatur perceptimit të nxënësve.

Kontrollimi i njohurisë së fituar është paraparë përmes pesë testeve të cilët janë dhënë pas mësimit 5, 10, 14, 18 dhe 20. Cdo test përbëhet prej pesë detyrave me disa kërkesa. Secila kërkesë vlerësohet me numër të caktuar të poenave, kurse në bazë të poenave të përgjithshëm të fituar, autorja në vend të notave, jep komente sugjeruese: *Bravo! Shkëlqyeshëm i ke ushtruar të gjitha!, Mirë ësthë por mundesh ti edhe më mirë, Duhet të përpiqesh shumë m,-ë tepër, etj.*, të cilat mund veprojnë në mënyrë shumë stimuluese në nxënësit. Në këtë mënyrë është mundësuar vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, por edhe vlerësimi i diturisë së nxënësve nga ana e arsimtarit.

Ushtrimet në Fletoren e punës në mënyrë imagjinuese i nxisin nxënësit që të përdorin fjalë të reja, të krijojnë të reja duke shtuar vazhdime, të vërejnë relacionet dhe raportet mes fjalëve (lidhjet tematike, polisemi, antonimi), të shtrojnë pyetje, por edhe të zotërojnë me bazat e drejtshkrimit të gjuhës standarde serbe. E gjithë kjo është e pasuruar edhe me ilustrime, të cilat, siç kemi thënë edhe më herët, për nxënësit e kësaj moshe paraqesin ndihmë të vlefshme në kuptimin e përmbajtjeve të reja gjuhësore.

Përmbajtja e Libri i leximit është kushtëzuar me Programin mësimor dhe përbëhet nga tekstet e shumta (origjinale apo të adaptuara) autorët e të cilëve janë kryesisht shkrimtarët tanë të letërsisë për fëmijë, por edhe të teksteve veçmas të hartuara. Siç theksojnë autoret e Mwsimit, librat e leximit (mendohet edhe për klasën e III edhe për të IV) „përfshijnë ato pjesë të programit [...] të cilat caktojnë fushat tematike të cilat duhet të jenë të mbuluara në mësimin e kësaj lënde, ato të cilat drejtojnë në organizimin e e ushtrimeve të ndryshme gojore dhe të shkruara, si dhe ato të cilat kanë të bëjnë me leximin dhe përvetësimin e drejtshkrimit, pasi që theksi është vendosur pikërisht në tematikë dhe në ushtrimet gojore, kurse seksionet tjera fillimisht janë të përfaqësuara në fletoret e punës“.

Secili mësim në Librin e leximit, siç është thënë, përbëhet nga dy pjesë – a) dhe b) dhe dy tekste. Teksti nën a) është në mënyrë leksikore dhe strukturore më i thjeshtë dhe është paraparë për nxënësit me nivel më të ulët të kompetencës gjuhësore (zakonisht në mjediset etnike homogjene), derisa tekstet nën b) janë më të gjatë dhe më të ndërlikuar nga pikëpamja gjuhësore dhe, si të tillë, janë paraparë për nxënësit me kompetenca më të larta. Mirëpo, pavarësisht kësaj zgjedhjeje dhe përpjekjes që fëmijëve t’i lehtësohet zotërimi i tyre me prezantimin e një fjalori të vogël deskriptiv për fjalët e reja në çdo mësim, si dhe me ushtrime të menduara mirë me anë të të cilave stimulohet interakcioni mës nxënësve apo mes nxënësve dhe arsimtarit – shumë tekste, edhepse të përshtatur tematikisht, janë të vështirë për fëmijët të cilët vetëm në klasën e III kanë zotëruar bazat e shkrim leximit funskional. Numri më i vogël i fjalëve të panjohura me forma të njohura gramatikore do të çonte drejt produktivitetit më të madh gjuhësor dhe interesimit më të madh të nxënësve për përmbajtjet e reja. Mirëpo, ky mjet didaktik mundet dukshëm të pasurojë njohurinë gjuhësore të atyre nxënësve të cilët tanimë zotërojnë me gjuhën serbe apo të atyre gjuha amtare e të cilëve është e ngjashme me gjuhën serbe.

Me këtë rast duhet tërhequr vëmendjen në zgjedhjen e 12 mësimeve. Në të përshkruhet mënyra e festimit të Krishtlindjes dhe Shën Nikollës. Pasi që këto janë festa të rëndësishme të popullit serb, patjetër duhen të përmenden dhe fëmijët të mësojnë për karakteristikat e tyre të zakonshme, por gjithashtu është e rëndësishme të bëhet paralelja me festat e ngjashme të cilat i festojnë anëtarët e pakicave kombëtare. Mirëpo, në këtë mësim jo vetëm që nuk ceken ato, por në një ushtrim të paraparë për bisedë rreth mësimit shtrohet pyetja „Kur e feston ti Krishtlindjen?", ku nuk i lihet hapësirë faktit që nxënësi mund të jetë i përkatësisë tjetër fetare apo që aspak nuk i feston festat fetare. Në anën tjetër, janë dhënë emrat e Shën Nikollës në gjuhën hungareze, sllovake, rumune dhe ruse, por jo edhe në gjuhën shqipe. Ka mundësi që kjo të korrigjohet gjatë realizimit të njësisë mësimore në orë, por gjithsesi këto përmbajtje duhet përshtatur të gjitha bashkësive të cilat jetojnë në Serbi.

III.4.1.4. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e IV

Struktura

Kompleti i teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e IV të shkollës fillore është strukturalisht i njëjtë sikur ai për klasën III dhe përbëhet nga *Pouka iz jezika*, e autoreve Dušanka Zvekić-Dušanović dhe Nataša Dobrić, Libri i leximit *Daj mi zvezdu jedan krug,* i autoreve Nataša Dobrić dhe Gordana Štasni, *Radna sveska* me Librin e leximit, i autoreve Nataša Dobrić dhe Gordana Štasni dhe *Priručnik za nastavnike srpskog kao nematernjeg jezika uz udžbenike 3. i 4. razreda osnovne škole,* i autoreve Dušanka Zvekić-Dušanović dhe Nataša Dobrić.

Pasi që koncepti i këtij kompleti të teksteve mësimore është pothuajse i njëjtë me konceptin e kompletit për klasën e III, nuk do të shpjegohet struktura e çdo libri, por vetëm do të tregohen permbajtjet e reja dhe qasjet e ndryshme.

Mësimet nga gjuha përbëhen nga 20 mësime dhe katër teste për kontrollimin e diturisë, pas mësimit 4, 9, 14 dhe 20. Në mësime vazhdohet përpunimi i njësive gramatikore dhe sistematizimi i tyre në atë mënyrë që zgjerohet ajo që tanimë është mësuar, por futen edhe përmbajtje të reja gramatikore të parapara me Programin mësimor: imperativi dhe potenciali, kuptimet e reja të konstrukcioneve parafjaloro-rasore, forma foljore, foljet e lëvizjes, kuptimet e kundërta foljore, kuptimet distinktive të mbiemrave dhe parafjalëve etj. Leksika e nxënësve pasurohet edhe me terme gramatikore: koha e tashme, perfekti, e ardhmja, gjinia mashkullore, femrore dhe asnjanëse, emrat e llojit të fjalëve etj.

Libri i leximit përbëhet nga tetë tërësi dhe gjithsej 30 mësime. Tërësitë janë të caktuara tematikisht: I. *Školske reči*, II. *Moja porodica,* III. *Ovo sam ja,* IV. *Zimske slike,* V. *Деца воле смешне речи,* VI. *Спајај*

корисно и лепо, VII. *Сунчева златна рука,* VIII. *Шта је лепо да се ради лети.* Pasi që për klasën e IV me Program është paraparë prezantimi i shkrimit qirilik, 15 mësime janë shkruar në shkrim latin, kurse 15 në shkrim qirilik. Në fund të Librit të leximit janë dy fjalorë deskriptiv – njëri nga tekstet latine dhe tjetri nga shkrimi qirilik. Për fjalët emërore është dhënë edhe caktimi i gjinisë, kurse me fjalët foljore veta e parë njëjës e kohës së tashme.

Fletorja e punës në mënyrë strukturore dhe tematike e ndjek Librin e leximit: përbëhet nga 30 mësime, 15 në shkrim latin dhe 15 në atë qirilik. Koncepti i mësimeve është kryesisht i njëjtë sikur edhe në klasën e III.

Analiza

Nxënësit e klasës së IV të shkollës fillore, siç është paraparë me Planin dhe programin mësimor, duhet në mënyrë të duhur të zotërojnë me të gjitha aftësitë gjuhësore: të përvetësojnë 200 fjalë dhe shprehje të reja (nxënësit më të avancuar 250) dhe fillojnë t'i përdorin në mënyrë aktive në të kuptuarit, komunikimin verbal në pajtim me lëndën e përpunuar gjuhësore dhe tematike, kuptojnë tekstet të cilat përpunohen, lexojnë tekste të shkruara me shkrim latin, dhe pastaj qirilik, të shkruajnë në të dy shkrimet.

Autoret e kompletit të teksteve mësimore për klasën e IV zgjerojnë përmbajtjet gjuhësore, si ato gramatikore ashtu edhe ato leksikore, duke iu përmbajtur strukturës së njëjtë të teksteve mësimore dhe konceptit të mësimeve sikur në klasën e III. Përmbajtjet e reja gjuhësore, të kushtëzuara me Programin, kanë të bëjnë me një numër të madh të kuptimeve për realizimin e të cilëve, për shkak të strukturës morfosintaksore të gjuhes serbe, duhet të zotërohet lënda voluminoze gramatikore: sistemin e rasave, aspekti foljor, format enklitike të përemrave dhe foljeve, duke iu referuar me radhë fjalëve në fjali, fjalitë pa subjekte etj. Përkundër përpjekjes së dukshme të autoreve, si Mësime nga gjuha ashtu edhe Fletorja e punës, që të zgjedhin njësitë më të rëndësishme gramatikore dhe leksikore dhe të paraqesin kuptimet e tyre kryesore, shumica e mësimeve sidoqoftë kanë shumë përmbajtje të reja të cilat prezantohen dhe ushtrohen njëkohësisht.

Zgjedhja e teksteve në Librin e leximit, sikur edhe për klasën e III, është përshtatur për dy nivele të diturisë. Mirëpo, edhe këtu është i dukshëm përdorimi i teksteve të cilat, si duket, janë futur nën diktatin e Programit, ku duhet pasur parasysh që nxënësit në to nuk njohin shumë fjalë dhe as ndryshimet e tyre gramatikore, e as format foljore (pasivi, fjalitë kondicionale...), gjë që shpeshherë vë në pyetje kuptimin dhe qëllimin e tyre. Pavarësisht se në Librin e leximit gjenden dy lloje të teksteve dhe përpunimi i tyre është përshtatur për nxënësit nga struktura etnike heterogjene dhe homogjene, përshtypja është që të dy tekstet i dedikohen grupit të dytë të nxënësve, kurse grupi i parë, i cili vetëm tani e ka përvetësuar

shkrim leximin funksional, nuk është në gjendje që me kuptim të ndjekë përmbajtjet e atyre teksteve, përveç që mund t'i mësojë përmendësh (vjershat dhe lojërat). Mungesa e teksteve të cilat kanë të bëjnë me anëtarët e të gjitha pakicave kombëtare është evidente edhe në kompletin e teksteve mësimore për klasën e IV. Shembujt individual me këtë përmbajtje kanë të bëjnë kryesisht me pakicat e pranishme në Vojvodinë, në ç'mënyrë të gjitha tjerat vendosen në pozitë jo të barabartë.

Fletorja e punës është hartuar në mënyrë të mirë: të mundësojë prezantimin dhe kontekstualizimin e fjalëve të reja, si dhe prezantimin e shkrimit të ri – qirilik. Mirëpo, pavarësisht konceptimit të mirë, zgjedhja e përmbajtjeve (teksti apo fjalia) të cilat shërbejnë si kontekst për njësitë e reja leksikore, shpeshherë është tejet e vështirë dhe në to shpeshherë gjenden fjalët të cilat nxënësit nuk i kuptojnë apo përmbajtje gramatikore të cilat nuk janë punuar deri atëherë. Kështu që në vend se të shërbejnë si ndihmë gjatë sistematizimit dhe pozicionimit të të fjalëve të reja, ato shpiejnë nxënësit deri te ndjenja e pafuqisë dhe, siç u pa gjatë vështrimit të orëve, kthimit nga mënyra e vetme e marrjes së informacioneve adekuate – përkthimit në gjuhën shqipe nga ana e arsimtarit, gjë që gjithsesi nuk është metodë e mirë me të cilën mund të arrihen rezultatet e dëshirueshme.

III.4.1.5. Konkluzioni për kompletet e teksteve mësimore prej klasës I deri IV

Kompletet e teksteve mësimore prej klasës I deri IV janë bërë në pajtim me Planin dhe programin mësimor në kuptimin e zgjedhjes së lëndës gjuhësore dhe mënyrës së prezantimit të saj. Për nga përmbajtja dhe struktura janë të harmonizuar me moshën e nxënësve, nevojat dhe interesimet e tyre. Përmbajtjet e reja lidhen me ato te punuara më herët, kështu që, për shembull, njësia tematike e punuar në klasën e I plotësohet dhe zgjerohet në klasën e II. Tekstet nga librat e leximit, sidomos të autorëve, janë aktuale dhe të organizuara mirë nga pikëpamja metodike. Numri i madh i ushtrimeve të ndryshme didaktike në tekste mësimore dhe fletoret e punës i mundëson nxënësve që në mënyrë dëfruese dhe produktive të përvetësojnë lëndën e planifikuar. Mirëpo, pavarësisht konceptimit të mirë dhe përmbajtjeve të llojllojshme, kompletet e teksteve mësimore nga klasa e I deri IV nuk i mundësojnë të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë përvetësimin e kompetencës gjuhësore. Domethënë, ashtu siç theksojnë edhe vetë autoret e teksteve mësimore në udhëzuesit për arsimtarët, përmbajtjet duhet të përmbushin nevojat e dy grupacioneve të nxënësve – atyre që kanë predispozita për zotërimin e gjuhës serbe, për shkak të ngjashmërisë me gjuhën e tyre amtare apo prejardhjen nga mjedisi heterogjen gjuhësor, dhe atyre që nuk i kanë predispozitat e cekura. Në bazë të analizës së realizuar të kompleteve të teksteve mësimore fitohet përshtypja që përmbajtjet e tyre nuk janë plotësisht të përshtatura për nxënësit të cilët për herë të parë takohen me gjuhën serbe, për të cilën gjë do të bëhet më shumë fjalë në këtë analizë.

Tekstet mësimore për klasën e I dhe II janë të hartuara ndryshe në krahasim me tekstet mësimore për klasën III dhe IV. Arsyeja për këtë është që me Planin dhe programin mësimor është paraparë që nxënësit në mënyrë funksionale dhe sistemike (shkronja të shtypit dhe të shkrimit) të zotërojnë me aftësinë e shkrimit në klasën e III, kështu që e tërë përmbajtja mësimore për dy klasët e para bazohet në njohjen me sistemin e gjuhës serbe dhe adoptimin e modeleve të shumta të zgjedhura gjuhësore, por edhe përmbajtjeve të vështira gramatikore – përmendësh. Kështu, tërë përmbajtja gjuhësore në dy klasët e para i është paraqitur nxënësve pa tekst, përmes ilustrimeve të tërësive të shumta tematike. Teksti me ilustrime është dhënë në Udhëzuesin për arsimtarë dhe është detyra e arsimtarit që të verbalizojë ilustrimet dhe t'i njohtojë nxënësit me melodinë e gjuhës. Mirëpo, nëse nxënësit (para së gjithash mendohet në nxënësit e mjedisit gjuhësor homogjen, pa paranjohuri të gjuhës serbe) gjenden në situatë që të dëgjojnë tekstet, zakonisht të llojit të dialogut, dhe nuk e dijnë asnjë fjalë në gjuhën serbe, shtrohet pyetja çfarë rëndësie ka për ata njohja me melodinë dhe intonacionin, nëse nuk kuptojnë asgjë nga ajo që dëgjojnë. Në kuadër të atyre njësive tematike gjenden edhe pjesët në të cilat verbalizohen fjalët individuale, emrat dhe foljet, në forma të ndryshme gramatikore, por edhe ai verbalizim bazohet vetëm në memorizimin e melodisë së fjalëve, pa mbështetjen grafike. Në këtë mënyrë, numri i fjalëve të reja i cili futet nëpër mësime dhe ndryshimet e tyre gramtikore është tejet i madh për memorizimin e thjeshtë nga ana e nxënësve. Gjatë zgjedhjes së fjalëve të reja fitohet përshtypja se nuk i është kushtuar kujdes dy karakteristikave më të rëndësishme – frekuencës dhe nevojës. Fondi leksikor dukshëm tejkalon atë të rekomanduar në Programin mësimor dhe nuk lë mundësi të selektimit. Kjo qasje në lëndën gjuhësore sidomos në tekstet mësimore për klasën e I dhe II të gjuhës serbe si gjuhë joamtare shpie deri te arritja më e vështirë e rezultatit të dëshirueshëm – vështrim në sistemin e gjuhës së re dhe adoptimin e përmbajtjes gjuhësore minimale dhe produktive.

Tekstet mësimore për klasën e III dhe IV janë të strukturuara dhe të koncipuara në mënyrë të njëjtë dhe përmbajtjet e tyre mundësojnë shkrim-leximin e nxënësve në gjuhën serbe dhe përdorimin e dy shkrimeve. Në atë mënyrë krijohen kushtet që nxënësit të zotërojnë me të gjitha aftësitë gjuhësore. Mirëpo, kërkesat e Programit, para së gjithash ato të cilat kanë të bëjnë me shrkim leximin gramatikor, janë shumë ambicioze dhe të parregulluara me mundësitë e nxënësve të cilët sapo po mësojnë shkrim leximin në gjuhën serbe. Tempoja e prezantimit të tyre është e atillë që në tekstet mësimore nuk gjenden mësime në të cilat njësia mësimore do të ishte e relaksuar dhe e çngarkuar nga përmbajtjet e reja dhe në të cilat në tjetër mënyrë (tjetër situatë, metodë, teknikë) nxënësve do t'i prezantohej njësia mësimore tanimë e njohur.

Ushtrimet janë kryesisht të llojit strukturor dhe përmbajtjes tekstuale, të bazuara në plotësim, zëvendësim dhe transformim. Mirëpo, duke marrë parasysh se nxënësit e kësaj moshe zotërojnë, në nivel më të ulët, me të gjitha aftësitë gjuhësore, ushtrimet do të ishin shumë më praktike dhe më efikase nëse do

të kombinoheshin më shumë modelet strukturore dhe komunikative, me fokus në këto të fundit, dhe me anë të tyre më shpesh do të tregonin situatat aktuale të afërta me moshën e nxënësve në formë të animacioneve apo ilustrimeve: përmbajtjet tekstuale në kompjuter (mejl, fejsbuk...), telefona celular (SMS, bisedë), plotësimi i animacionit me përmbajtje tekstuale etj. Në këtë mënyrë shumë më lehtë do të prezantoheshin modelet komunikative dhe strukturore të cilat nuk kanë nevojë për kontekst në formë të përmbajtjes së madhe gjuhësore, ngase atë funksion e bën fotografia. Në këtë mënyrë do të fitoheshin informacionet më të rëndësishme të privuara nga përmbajtja e tepruar, e cila, në të vërtetë, ngarkon shumicën e teksteve mësimore nga klasa e I deri IV. Njëkohësisht në këtë mënyrë përmbajtjet e reja, sikur ato leksikore ashtu edhe ato gramatikore, do të arrinin efekt të nevojës, kurse nxënësit do të kyçeshin në mënyrë më aktive në mësimin dhe zgjidhjen e detyrave.

Programi në librat e leximit, sikur për klasën e III ashtu edhe për të IV, duhet të minimizohet në nivelin e disa fjalive të thjeshta, që do të thotë – ose maksimalisht të adaptohen ose të shkurtohen tekstet letrare për fëmijë, para së gjithash prozat, apo të përpilohen të reja të adaptuara për paranjohurinë e nxënësve dhe interesimin e tyre.

Tërë kohën duhet patur parasysh që është rekomandim i Programit që të selektohet lënda mësimore gjuhësore për dy grupet e nxënësve sipas përbërjes etnike të mjedisit, paranjohurisë gjuhësore dhe ngjashmërisë gjuhësore. Caktohet edhe programi minimal sipas të cilit cdo vit shkollor duhet të prezantohen nga 200 (për nxënësit e avancuar 250) fjalë dhe shprehje të reja me të cilat duhet të disponohet në mënyrë aktive, ku duhet pasur kujdes që në këto 800 fjalë të bëjnë pjesë edhe fjalët ndihmëse, pa kuptim të plotë. Ky numër i fjalëve të reja në masë të madhe i përgjigjet rezultateve për nivelin A1[85] (të gjuhës serbe si) të gjuhës së huaj dhe mundëson që me ndihmën e tyre të përvetësohet edhe minimumi gramatikor, i nevojshëm për zotërimin me njohurinë themelore, por produktive të gjuhës serbe.

Duhet theksuar se çasti më i ndjeshëm për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në një mjedis etnik homogjen, koha kur nxënësit për herë të parë takohen me atë gjuhë – është klasa e I. Në rast se përmbajtja gjuhësore e cila i prezantohet nxënësve të asaj moshe tejlakon mundësitë e tyre, me përmbajtje, vëllim apo metoda të prezantimit, ajo mungesë nuk do të mund të kompensohet në klasët e ardhshme dhe i tërë Programi do të mbesë në nivelin e teorisë, kurse nxënësit do të mbesin funksionalisht analfabetë, ashtu siç edhe kanë treguar rezultatet jashtëzakonisht të dobëta të testimit.

85 Korniza e përbashkët evropiane për mësimin e gjuhëve të gjalla.

III.4.2. Vështrimi i strukturës dhe përmbajtjes së teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare prej klasës V deri VIII të shkollës fillore

Kompletet e teksteve mësimore për të gjitha katër klasët e larta të shkollës fillore kanë përbërje identike. Secili ka librin e leximit, fletoren e punes dhe librin e gramatikës. Pavarësisht kësaj, për shkak të specificitetit të programit dhe dallimeve të shpjeguara në të mes etapës II dhe III të mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare, si dhe për shkak të vëllimit dhe përmbajtjes së pasur të çdo kompleti, do të analizojmë tekstet mësimore për çdo klasë veçmas.

Përveç librave të dedikuar për fëmijë, që të katër kompletet e teksteve mësimore për klasët e larta të shkollës fillore i përcjell edhe *Priručnik za nastavnike srpskog kao nematernjeg jezika uz udžbenike od 5. do 8. razreda osnovne škole*, të autoreve Dušanka Zvekić Dušanović dhe Nataša Dobrić.

III.4.2.1. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e V

Struktura

Kompleti i teksteve mësimore për gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e V të shkollës fillore përbëhet nga Libri i leximit *Pegavo detinjstvo*, i autorit Jovan Ljuštanovića; *Radna sveska uz čitanku Pegavo detinjstvo*, e autores Nataša Dobrić, dhe *Pouka iz jezika i pravopisa*, e autorëve Mirjana Burzan dhe Jovan Jerković.

Libri i leximit përmban gjithsej 64 tekste, nga të cilat 15 janë vjersha, 48 tekste prozë dhe një dramë. Tekstet janë të grupuara në gjashtë tërësi tematike: *Opet škola, Putujem, Grad i selo, Ploča svetlosti, Pegavo detinjstvo dhe Ljubav za oblak (izbor iz lektire)*. Tekstet në Librin e leximit janë me shkronja të shtypit në shkrim latin dhe qirilik, me shkrim latin janë gjithsej 12, kurse qirilik 52. Në dilaketin ijekav janë vetëm dy tekste, që të dy nga letërsia popullore.

Aparatura didaktiko-metodike përbëhet nga disa segmente të ndryshme. Gjithmonë janë dhënë pyetje mbi tekstin (*Razgovor o pesmi/Razgovor o tekstu*), në ç'mënyrë para së gjithash kontrollohet sa e kanë kuptuar nxënësit tekstin, dhe poashtu i sugjerohet nxënësve që të zbulojnë cilësitë e personazhëve dhe detajeve tjera në tekst. Nganjëherë teksti është i pajisur edhe me propozimin për dramatizim, biografinë e shkrimtarit dhe këshillën që të lexohet i tërë libri, pjesa e të cilit gjendet në Librin e leximit. Me gjithsej katër tekste gjendet segmenti i shënuar me yll, i titullit të ndryshëm (*Predlažemo vam..., Improvizujte, Uradite, ispričajte..., Glumite*), i cili përmban ide për shprehjen gojore të pavarur të inspiruar nga tema e tekstit.

Në fund të librit është dhënë *Rečnik nepoznatih reči,* në të cilin gjenden 527 determinantë, kurse me secilin tekst në Librin e leximit, brenda margjinës, janë dhënë shpjegime të fjalëve të panjohura, nganjëherë me ilustrimin e termit i cili shpjegohet. Ilustrimet në librin e leximit gjithmonë janë në lidhje tematike me tekstin dhe kanë funksion jashtëzakonisht motivues.

Fletorja e punës me Librin e leximit, siç është shpjeguar edhe në Udhëzue, dallohet në mënyrë konceptuale nga fletoret e punës për klasët e mëvonshme. Kështu, në klasën e pestë ajo është drejtpërdrejt e lidhur me librin e leximit. Në të janë dhënë ushtrime plotësuese, pyetje dhe detyra lidhur me 18 tekste nga Libri i leximit. Ushtrimet janë të llojllojshme, kurse ekzistojnë edhe ushtrime të shënuara me yje, të shënuara me *Za one koji žele više*.

Mësimet nga gjuha dhe drejtshkrimi përmbajnë 35 mësime, në të cilat përpunohen njësitë gramatikore dhe drejtshkrimore të parapara me Program. Secili mësim fillon me tekstin e shkurt metodik në të cilin paraqitet njësia gramatikore e paraparë për përpunim në mësimin e dhënë. Pas tekstit janë dhënë pyetje për analizën e tekstit, kurse pastaj kalohet në përpunimin e njësisë gramatikore, definicionin, rregullat e ndërtimit dhe shembujt. Pjesën e dytë të mësimit e përbëjnë ushtrimet.

Nëse njësia gramatikore është tanimë e njohur, përveç asaj në mësim gjenden edhe disa njësi drejtshkrimore apo mësime të shkurta nga formacioni i fjalëve. Secila nga këto segmente është shënuar në margjinë me shenjë grafike dhe leksikore. Definicionet dhe rregullat e ndërtimit janë në segmentin „gramatika“, shembujt në segmentin „forma“, drejtshkrimi në „drejtshkrim“, ushtrimet në „ushtrime“ dhe „përsëritje“.

Në fund të librit është dhënë *Gramatički i pravopisni pojmovnik*, në të cilin janë paraqitur termet e përpunuara në tekstin mësimor me përkthim në katër gjuhë.

Analiza

Përmbajtja e kompletit të teksteve mësimore plotësisht ndjek Programin mësimor për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e pestë të shkollës fillore.

Edhe pse libri i leximit përmban tekste të peshës dhe vëllimit të ndryshëm, gjë që është thene qartë në Udhëzuesin për arsimtarët, në Librin e leximit për klasën e V nuk është vendosur asnjë shenjë afër teksteve më të vështira, siç është bërë në tri klasët e ardhshme. Zgjedhja e tekstit për përpunim i është lënë zgjedhjes së arsimtarit. Në atë punë udhëzues shumë i dobishëm për arsimtarin mund të jetë Udhëzuesi për arsimtarë, i cili sjell orar orientues të njësisë mësimore në dy varianta, njëri për mjedisin heterogjen, tjetri për mjedisin homogjen.

Në mësimet nga gjuha të gjitha definicionet dhe të dhënat më të rëndësishme mbi njësinë e cila përpunohet janë dhënë në korniza të ndara, gjë që dukshëm përmirëson dukshmërinë e palës dhe lehtëson mësimin. Poashtu, në disa vende të caktuara në Mësime, përveç ilustrimeve motivuese (zbukuruese) të cilat ndjekin çdo mësim, janë të pranishme edhe ilustrimet funksionale me anë të të cilave me sukses tregohen elementet dhe raportet e ndryshme gjuhësore dhe gramatikore (numri dhe gjinia gramatikore, forma foljore etj.)

Orientimi në Mësimet nga gjuha dhe drejtshkrimi është shumë i vështirësuar për shkak të strukturës së shënuar në mënyrë joprecize dhe përmbajtjes së atij teksti mësimor. Përmbajtja në fund të librit është shumë e varfër, kurse mësimet nuk kanë tituj të cilët i përshtaten përmbajtjes së tyre, por i kanë fituar titujt sipas përmbajtjes së tekstit metodik me të cilin hapet ajo njësi mësimore. Për shembull, mësimi në të cilin përpunohet imperativi quhet Čaša vode, kurse në përmbajtje është shënuar vetëm si mësimi 25, edhe pse të dy termet edhe imperativi dhe mënyra urshëruese paraqiten në mësim dhe në definicionin a asaj forme foljore. Pasi që përdorimi i termeve në gramatikën eksplicite në këtë moshë shmanget, është e qartë se mësimet duhet të emërohen në ndonjë mënyrë tjetër, por ndoshta është më praktike që ajo në të cilën përpunohet rasa dhanore të quhet „Kujt?“, se sa „Këshilla“, siç qëndron tani.

Segmentimi i mësimit dhe markimi i segmenteve nëpër margjina është ide e shkëlqyer, por është realizuar në masë të caktuar në mënyrë joimpresionuese. Duke marrë parasysh moshën e fëmijëve për të cilët është dedikuar, ky tekst mësimor ndoshta do të mund të ishte më i pasur me ngjyrë dhe rradhitja e elementeve të cilat e përbëjnë çdo faqe mund të jetë më qartë e shënuar.

III.4.2.2. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e VI

Struktura

Kompleti i teksteve mësimore për gjuhën serbe si gjuhë joamtare për klasën e VI të shkollës fillore përbëhet prej tri librave. Ato janë: Libri i leximit *Pletivo od reči*, i autoreve Nataša Dobrić, Dušanka Zvekić-Dušanović dhe Gordana Štasni; *Radna sveska uz čitanku Pletivo od reči*, e autoreve të njëjta, si dhe *Pouke iz jezika i pravopisa*, Mirjana Burzan dhe Jovan Jerkovića.

Libri i leximit përmban gjithsej 58 tekste, 17 vjersha, 37 proza dhe katër drama. Tekstet janë grupuar në shtatë tërësi tematike: *Đačke ispovesti, Pletivo od stihova i priča, Dragoceni biseri mudrosti, Cvetni predeo*

u boji, Zrnca znanja, Još samo malo... dhe Përzgjedhja nga lektyra. Në shkrim latin janë shtypur 16 tekste, kurse në shkrim qirilik 42 tekste. Në dialektin ijekav janë gjithsej gjashtë tekste, të gjithë janë të shtypur në shkrim qirilik, dy tekste janë nga letërsia popullore, të tjerët janë autorial.

Aparatura didaktiko-metodike përbëhet prej segmenteve të shumta. Pjesën e parë gjithmonë e përbëjnë pyetjet rreth tekstit (*Të flasim rreth vjershës/Të flasim rreth tekstit/ Të flasim rreth përrallës/ Të flasim rreth dramës*), kurse përskaj tyre, varësisht nga tema dhe lloji i tekstit, janë dhënë edhe detyra dhe udhëzime të ndryshme plotësuese për punën e mëtejshme (psh. *Recito,../Aktro.../Shpjego.../Shpjego tekstin.../Shkruaj dhe krijo...*) Pjesë të rëndësishme paraqesin mënyrat për interpretimin e frazave dhe shprehjeve të cilat paraqiten në tekst, si dhe ushtrimet për zgjerimin e fjalorit dhe adoptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja (*Kërko në tekst.../ Zbulo kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve.../Të pasurojmë fjalorin.../Fjalë të reja- fjalori më i pasur*). Segmenti *Është mirë të dijsh..., E di tanimë, dhe Vë re, zbulo, mëso.*... sjellin përmbajtjet nga teoria e letërsisë – definicionin e termeve: tregimi në vetën e parë/tretë, tregimtari, përralla popullore dhe artistike, fabula, fabulisti, rradhitja kronologjike, përmbledhje, vepra dramatike, skena, poezia lirike, poezia përshkruese, motivi, kompozimi i këngëve, personifikimi, ritmi etj. Me disa tekste janë dhënë biografitë e shkurta të autorëve.

Në fund të librit janë dhënë dy fjalor të fjalëve të panjohura: *Rečnik iz ćiriličnih tekstova,* në të cilin gjenden 333 pika, dhe *Rečnik iz latiničnih tekstova,* me 88 pika. Sikur edhe në librin e leximit për klasën e pestë, me çdo tekst, brenda margjinës, janë dhënë shpjegime të fjalëve të panjohura. Ilustrimet janë në lidhje tematike me tekstin dhe zakonisht ato janë riprodhime të veprave të artit.

Mësimet nga gjuha dhe drejtshkrimi, sikur edhe në klasën e pestë, përbëhen nga 35 mësime. Çdo mësim përpunon nga një njësi mësimore nga gramatika, formimi i fjalëve dhe/apo drejtshkrimi. Koncepti i tekstit mësimor është shumë i ngjashëm me atë të klasës së pestë: pas tekstit të shkurtër jepet shpjegimi i njësisë gramatikore, nganjëherë me definicion grafikisht të veçuar në mënyrë të qartë, pastaj vijnë shembujt, nganjëherë me ilustrim, kurse pjesa e dytë e mësimit gjithmonë përbëhet nga ushtrimet e ndryshme.

Fletorja e punës për klasën e gjashtë më shumë dallohet nga ajo e klasës së pestë, kurse ai dallim, siç thuhet në Udhëzues, është aplikuar edhe në fletoret e punës për dy klasët e ardhshme. Kështu, Fletorja e punës nuk është më aq e lidhur me Librin e leximit (as me Mësimet nga gjuha). Në Fletoren e punës për klasën e gjashtë gjenden 16 mësime. Shtatë mësime janë me shkrim latin të shtypit, kurse nëntë me shkrim qirilik.

Analiza

Koncepti i Librit të leximit, pavarësisht dallimeve të caktuara, është shumë i ngjashëm me librin e leximit për klasën e pestë. Ai përmban shumë më shumë tekste se sa duhet të përpunohen gjatë vitit, kurse është e arsimtarit të zgjedhë tekstet të cilat do të vendosen në planin operativ vjetor të tij, varësisht nga vlerësimi i diturisë ekzistuese të nxënësve, mjedisi në të cilën mësohet gjuha etj. Dallimi kryesor në krahasim me klasën e mëparshme, është që tekstet „më të vështira“ janë shënuar me yll (*), në ç'mënyrë është lehtësuar zgjedhja e arsimtarit. Në secilën tërësi tematike ekzistojnë tekste më të lehta dhe më të vështira, që edhe me zgjedhjen eventuale të teksteve të vështirësisë së njëjtë të përpunohet leksika e llojllojshme e paraparë me Programin mësimor.

Duhet të ceket problemi specifik i ngjashëm me atë i cili lajmërohet në klasën e III. Nën tekstin mbi Pashkët, pyetja e parë mbi tekstin është „Kur festohen Pashkët në mjedisin tënd?“, kurse detyra për ushtrim me shkrim është „Propozojmë të përshkruash se si festohet kjo festë në familjen tënde“. Detyrat e formuluara në këtë mënyrë sugjerojnë që të gjithë fëmijët për të cilët është dedikuar teksti mësimor festojën festën e njëjtë, që sigurisht nuk është e vërtetë. Problem i njëjtë paraqitet në mësimin „Festat“ në Fletoren e punës, ku përshëndetjet dhe formulat për urimin e festës në gjuhën serbe jepen vetëm për festat e krishtlindjes dhe pashkëve.

Në Mësimet nga gjuha dhe drejshkrimi është një numër i madh i ushtrimeve, kurse njësitë e caktuara gramatikore (rasat, disa forma foljore) përpunohen edhe në klasën e pestë dhe të gjashtë, gjë që është shumë mirë, ngase i mundëson nxënësve që të zgjerojnë dhe të dëshmojnë njohuritë e fituara më parë. Për shembull, imperativi i cekur më parë paraqitet edhe në klasën e pestë dhe të gjashtë. Në klasën e pestë është shpjeguar ndërtimi i tij dhe është dhënë definicioni, kurse në klasën e gjashtë kujdesi i kushtohet ndryshimeve zanore brenda imperativit dhe mundëson ushtrimin plotësues të kësaj forme foljore. Në mënyrë të ngjashme, me anë të përsëritjes dhe zgjerimit, në klasën e gjashtë përpunohen edhe rasat, krahasimi, formimi i fjalëve etj.

Shumica e mësimeve në Fletoren e punës mund të përdoret pavarësisht nga Libri i leximit. Si qëndron në Udhëzuesin për arsimtarë, përvojat nga praktika kanë treguar se tekstet nga librat e leximit nuk sigurojnë leksikën e nevojshme për komunikimin e përditshëm, si dhe që nxënësit të cilët gjuhën serbe e mësojnë si gjuhë joamtare nuk kanë mundësi që të përvetësojnë terminologjinë nga lëndët tjera mësimore, gjë që paraqet vështirësi të madhe për shkollim të mëtutjeshëm. Prandaj mësimet në Fletoren e punës janë në lidhje me lëndët tjera mësimore të cilat i dëgjojnë nxënësit.

Në këtë fletore punë janë temat mbi shoqërinë, sportin, jetën falmiljare, artin, biologjinë, gjeografinë etj.

Mësimet janë të përshtatura për moshën e nxënësit, janë kreative dhe interesante. Detyrat janë dhënë me gjuhë relativisht të thjeshtë, kurse shumë pyetje kanë të bëjnë me jetën e nxënësit dhe botën dhe stimulojnë të shprehurit gojor dhe të shkruar mbi temat e afërta.

Lidhja me lëndët tjera është njëra nga karakteristikat më të rëndësishme të këtij teksti mësimor. Dituria të cilën e ka fituar nxënësi në lëndët tjera, në gjuhën amtare, „barten“ dhe ndihmojnë në mësimin e gjuhës serbe në përmbajtje tanimë të njohura.

III.4.2.3. Kompleti i teksteve mësimore për klasën VII

Struktura

Edhe në klasën e shtatë, kompleti i teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare përbëhet prej tri librave. Libri i leximit quhet *U ogledalu Sunca* dhe autoret e tij janë Nataša Dobrić, Dušanka Zvekić-Dušanović dhe Gordana Štasni. Grupi i njëjtë i autoreve ka punuar në *Radna sveska*. Në pajtim me ndryshimet e programit për etapën e III të mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare (të cilën e përbëjnë klasën VII dhe VIII), teksti mësimor gramatikor nuk quhet më *Pouke iz jezika* por *Gramatika.* Autorët janë të njëjtë sikur në klasën e mëparshme, Mirjana Burzan dhe Jovan Jerković.

Libri i leximit për klasën e shtatë i ofron arsimtarëve gjithsej 59 tekste, shtatë latine dhe 52 qirilike. Tekste prozë janë 42, poezi 17. Në Librin e leximit për klasën e shtatë nuk ka asnjë tekst dramë. Të gjitha tekstet janë të vendosura në nëntë tërësi tematike: *Ono lepo što nas mami..., Moćna pamet i milostivo srce..., U ogledalu sunca..., Varljivi predeli..., Da ne bude deljenja, protivnosti ni rastanka..., Slike svetla i nezaborava..., Pročitajmo i saznajmo* dhe *Lektira*. Tekste në dialektin ijekav janë gjithsej tetë, nga ato pesë janë letërsi popullore, dy tekste janë të Branko Ćopić dhe një i Vuk Karadžić.

Aparatura metodike përbëhet nga pjesët e ngjashme dhe detyrat sikur edhe në librin e leximit të mëparshëm, kështu që me të nuk duhet marrur në mënyrë më detajore. Termet dhe konceptet nga teoria e letërsisë definicionet e të cilit janë dhënë në këtë libër të leximit janë: biografia, autobiografia, vjersha epike heroike, poezi epike dhjetë strofshe, tema, hagiografia, strofa, çift vargjesh, tercet, simbol, poezia refleksive, piktura poetike, shkrime nga udhëtimet etj. Në fund të librit janë dhënë dy fjalorë të fjalëve të panjohura: *Rečnik iz ćiriličnih tekstova,* në të cilin gjenden 575 pika, dhe *Rečnik iz latiničnih tekstova,* në të cilin janë 95 pika. Sikur edhe në librat e leximit të mëparshëm, me secilin tekst, brenda margjinës, janë dhënë shpjegime të fjalëve të panjohura. Nuk ka shumë ilustrime, kryesisht janë në pyetje fotografitë dhe riprodhimet.

Gramatika është njësi e teksteve mësimore e cila futet nën atë emër për herë të parë në klasën e VII. Në dy klasët e mëparshme, gramatika është përpunuar pak a shumë në mënyrë implicite, që në klasën e VII të kalojë në gramatikë eksplicite. Prandaj titujt e mësimeve në Gramatikë, janë në të vërtetë tituj të njësive mësimore. Në klasën e shtatë përpunohen llojet e fjalive (emrat, mbiemrat, përemrat vetorë dhe numrat), fjalitë e papërcaktuara, si dhe shërbimet dhe kuptimet e rasave. Lënda është organizuar në 35 mësime, 22 janë të shtypyra në shkrim qirilik, kurse 13 në atë latin. Çdo mësim fillon me tekstin metodik, nën të cilin janë pyetjet mbi të. Vijojnë shembujt, definicionet dhe shpjegimet dhe ushtrimet. Shtesa në fund të librit sjell rregullat e transkriptit të emrave të huaj në gjuhën serbe.

Fletorja e punës është e koncipuar në mënyrë të ngjashme sikur ajo për klasën e gjashtë. Ka 15 mësime, 12 janë në shkrim qirilik, kurse tri tjerat janë në shkrim latin. Temat e pranishme në këtë fletore pune janë: jeta shkollore, koha e lirë, sporti, moda, marrëdhëniet familjare, festat, filmi, muzika etj.

Analiza

Në klasën e shtatë ndryshimi më i madh vërehet në fushën e gramatikës. Teksti mësimor i cili përfshin përmbajtjet mësimore: Materia gjuhësore, Gramatika, Formimi i fjalëve dhe Drejtshkrimi tani quhen Gramatika. Mënyra e prezantimit të lëndës dhe gjuha me të cilën bëhet ajo nuk janë ndryshuar dukshëm në krahasim me Mësimet e mëparshme nga gjuha dhe drejtshkrimi, vetëm se ka më shumë teori se sa në klasët e mëparshme. Më e rëndësishme është që në klasën e shtatë rasave „i jepen emra“ dhe se ato u prezantohen nxënësve si sistem i deklinacionit, me përjashtime dhe ndryshime të ndara fonetike. Ndryshimet fonetike nuk emërohen, gjë që është e mirë. Në të njëjtën mënyrë ky tekst mësimor kthehet edhe në krahasimin e mbiemrave.

Sistemizimi i njohurisë mbi kuptimin e rasave është bërë ashtu që secilës rasë i është dedikuar një mësim apo dy, në të cilat nxënësit përkujtohen për atë që tanimë e dijnë mbi rasat apo të cilën duhet ta dijnë. Teksti mësimor i koncipuar në këtë mënyrë i jep hapësirë arsimtarit që të kthehet tek ajo që e konsideron më të nevojshme dhe që, në klasët në të cilat niveli i përgjithshëm i gjuhës serbe është më i ulët, përsëri të përpunojë njësitë e caktuara.

Shtesa mbi transkriptin e emrave nga gjuhët e ndryshme është shumë e dobishme dhe praktikisht e përdorueshme.

Fletorja e punës vazhdon të jetë njësi e teksteve mësimore në lidhje më të madhe me jetën e përditshme dhe zhvillimin e kompetencës së drejtë komunikative. Temat e përfaqësuara në të janë shumë të afërta

me nxënësin. Mësimi në fletoret e punës funksionon si kombinim i ushtrimeve dhe informacioneve të reja. Ka shumë ushtrime për një mësim, kështu që edhe këtu arsimtarit i mundësohet që të zgjedhë ato të cilat mendon se më shumë i përshtaten klasës së caktuar.

III.4.2.4. Kompleti i teksteve mësimore për klasën e VIII

Struktura

Në klasën e tetë struktura dhe autorët e kompletit të teksteve mësimore janë të njëjta sikur në klasët e mëparshme. Gordana Štasni dhe Nataša Dobrić janë autore të Libri të leximitt *Nedokučive tajne uma i srca;* Dušanka Zvekić-Dušanović, Nataša Dobrić dhe Gordana Štasni janë autore të R*adne sveske za VIII razred osnovne škole*, kurse Mirjana Burzan dhe Jovan Jerković kanë shkruar Gramatika za 8. razred.

Libri i leximit përmban gjithsej 47 tekste, nga të cilat 10 janë në shkrim latin. Gjithësej 17 tekste bartin yllin (*) si shenjë që është fjala për tekst më të vështirë, gjë që mund të shihet në përmbajtje në fund, ngase edhe në të janë të shënuar tekstet. Në këtë libër të leximit janë 31 tekste prozë, 13 poezi dhe tri drama. Vetëm pesë tekste janë shkruar me dialekt ijekav (dy të shkrimtarit Ćopić, dy të Vuk Stefanović Karadžić dhe njëra është tregim popullor). Grupet tematike të teksteve në këtë libri i leximit janë këto: *Više um zamisli nego more ponese, Iskre svetlosti, Od kolevke pa do groba..., Nedokučive tajne uma i srca, Putovanje kroz lepotu i znanje* dhe *Iz lektire*. Në fund të librit janë dy fjalorë, në *Rečnik iz ćiriličnih tekstova* gjenden 265 pika, kurse në Rečnik iz latiničnih tekstova – 95 pika. Në librin e leximit janë edhe fotografitë dhe ilustrimet shumë interesante, të cilat mjaft mirë përshtaten me përmbajtjen e tekstit. Risi për dallim nga të gjithë librat tjerë të leximit paraqesin *Ključne reči* në margjinën afër tekstit, të cilat njëmend paraqesin fjalët dhe termet lidhur me tekstin afër të cilit gjenden. Aparatura didaktiko-metodike është, sikur edhe deri më tani, e pasur dhe vëllimore. Në të gjenden shumë pyetje lidhur me tekstin, ushtrime për zgjerimin e leksikës dhe përvetësimi i frazave të reja. Në të janë dhënë edhe: klasifikimi i letërsisë popullore, definicionet e metaforeve, alegorisë, ironisë, satirës, humorit, hiperbolës, tiparit të gjuhës poetike të lirikës, monologut të brendshëm, karakterizimit të personazhit letrar, llojit të dramës, etapës së veprës dramatike, llojit të komedisë.

Në klasën e tetë gramatika i është dedikuar foljeve dhe sistemit të fjalive të përbëra. Lënda është e shpërndarë në 22 mësime, nga të cilat ato që përpunojnë foljet janë në shkrim qirilik, kurse ato të dedikuara fjalive të përbëra – në shkrim latin. Secili mësim, përskaj shpjegimit dhe definicionit të njësisë gramatikore, përmban edhe numër të madh të ushtrimeve. Definicionet janë grafikisht të ndara dhe të dukshme. Në

fund të librit është dhënë *Gramatički i pravopisni pojmovnik*, në të cilin janë shënuar termet e përpunuara në tekstin mësimor me përkthim në katër gjuhë.

Fletorja e punës është pak më e shkurtër se në klasët e mëparshme: ka nëntë mësime dhe të gjitha janë të shtypura në shkrim qirilik. Në të njëjtën mënyrë është e përqëndruar në zhvillimin e aftësive për komunikim konkret, praktik. Mësimet të cilat janë më shumë të lidhura me Libri i leximitn janë ato mbi letërsinë popullore dhe mbi Vuk Karadžić-in.

Analiza

Pavarësisht ndryshimit të këndit nga i cili materia gjuhësore i prezantohet nxënësve dhe kalimit në gramatikë eksplicite, edhe më tutje më së shumti hapësirë në *Gramatika* dhe në *Radna sveska* i është kushtuar ushtrimeve me të cilat krijohet shprehia e përdorimit të drejt të formave të ndryshme, gjë që është e mirë.

Pasi që klasa e tetë është përfundimtare, shtrohet pyetja pse të paktën në atë nuk ekziston në asnjë tekst mësimor ndonjë test përfundimtar apo revizion i lëndës, ku nxënësit do të mund të përsërisin lëndën më të rëndësishme të mësuar dhe të testojnë diturinë formale.

Fletorja e punës edhe në këtë klasë ndoshta është më e afërmja me nxënësit, temat e tyre dhe interesimet. Posaçërisht interesante nga ai aspekt është mësimi *Tinejdžeri*, i cili i mundëson nxënësve që të mendojnë dhe të flasin për vitet e tyre, cilësitë e dëshiruara dhe ato negative dhe format e sjelljes, mbi atë se si i shohin të rriturit etj. Poashtu e rëndësishme për nxënësit mund të jetë edhe mësimi i fundit i titulluar *Kuda dalje?* Ngase problematizon zgjedhjet të cilat gjenden në të ardhmen e afërt të një filloristi. Në këtë mësim gjendet edhe, tematikisht i arsyetuar, teksti i një kënge të grupit Riblja čorba, që është edhe një mënyrë që kjo lëndë t'i afrohet jetës reale të nxënësve.

III.4.2.5. Konkluzion për kompletet e teksteve mësimore prej klasës V deri VIII

Me analizën e teksteve mësimore valide për klasët e larta të shkollës fillore, arrihet deri te disa konkluzione:

1. 1. Kompletet e teksteve mësimore ndjekin Planin dhe programin mësimor në të gjitha aspektet e tij dhe nga ajo anë paraqesin mbështetje të sigurt për arsimtarët.

2. Tekstet mësimore janë të koncipuara sipas modelit të teksteve mësimore për Gjuhën serbe si

gjuhë amtare dhe ndoshta pikërisht kjo është burim i mungesave të mëdha. Edhepse fondi i orëve dukshëm dallohet, për të dy lëndët janë të parapara nga tri njësi tekstesh mësimore për një vit. Patjetër shtrohet pyetja çfarë qëllimi ka kjo në një mjedis ku gjuha amtare dallohet shumë nga gjuha serbe.

3. Kompleti për klasët e larta, me përjashtim të pjesërishëm të fletoreve të punës, pothuajse tërë materialin gjuhësor e merr nga letërsia. Ndoshta do t'i ndihmonte zotërimit më funksional të gjuhës nëse nxënësit do të hapeshin më shumë ndaj burimeve tjera të lëndës gjuhësore.

4. Lidhur me tekstin më lartë, duhet thënë se ekziston mospajtimi mes peshës së teksteve mësimore në librat e leximit dhe njohurisë së supozuar gjuhëosre të nxënësve. Kjo vlen edhe për tekstet e shënuara si më të lehta. Ky mospajtim është i pranishëm në të gjitha katër klasët. Aoristi është shumë i pranishëm në tekste, edhepse ai nuk përpunohet në shkollën fillore, kurse shpeshherë janë të pranishme edhe ndajfolja e tashme, mbiemri foljor dhe fjalitë shumë të gjata, me radhitje të pazakontë të fjalëve. Shtrohet pyetja si të veprojë arsimtari kur përpunon tekstin në të cilin paraqitet, për shembull, aoristi. A t'ua shpjegojë nxënësve, edhepse ai nuk është në program, apo ta injorojë, duke lënë dyshime dhe paqartësi të cilat pengojnë kuptimin e plotë të tekstit nga ana e nxënësve?

5. Në Planin dhe programin mësimor qëndron se mësimi duhet të vendoset ashtu që nxënësit t'i mundësoj aktivitete të shpeshta verbale. Sidoqoftë, nga njëra anë, gjatësia e shumicës së teksteve në librat e leximit, dhe nga ana tjetër, mungesa e plotë e ushtrimeve të llojit të përshkrimit të fotografisë apo krahasimit të dy fotografive me qëllim të gjetjes të detajeve të ndryshme, dhe ushtrimeve dhe aktiviteteve tjera për të cilat nuk është i nevojshëm teksti – vështirësojnë arritjen e këtij qëllimi.

6. Në klasën e III dhe IV të shkollës fillore, *Pouke iz jezika i pravopisa* kanë sjellë edhe tekstet e radhitura mirë për testimin e diturisë. Kjo është një praktikë shumë e dobishme dhe do të ishte mirë që nga ajo të mos hiqej dorë edhe në klasët e larta. Duke marrë parasysh vëllimin e njësisë mësimore dhe kompleksitetin e gramatikës së gjuhës serbe, ato janë më se të nevojshme.

7. *Gramatički i pravopisni pojmovnik* sjellin përkthimet e termeve dhe shprehjeve në vetëm katër gjuhë të pakicave kombëtare në Serbi: hungareze, sllovake, rumune dhe ruse. Kur është vendosur që ky fjalor të jepet me përkthim, zgjidhja e vetme e mundshme është që të ofrohet përkthimi në gjuhët e të gjitha pakicave kombëtare. Fatkeqësisht, ky fjalor në asnjë klasë nuk funksionon edhe si indeks i termeve, gjegjësisht nuk udhëzon në numrat e faqeve, gjegjësisht mësimeve në të cilat jepet termi i dhënë.

8. Lënda Gjuha serbe si gjuhë joamtare është e përbashkët për anëtarët e të gjitha pakicave kombëtare të cilët jetojnë në Republikën e Serbisë. Kjo do të thotë se në kuadër të kësaj lënde do të mund

të „njiheshin të gjithë me të gjithë“. Duke parë kompletet e teksteve mësimore fitohet përshtypja se nuk i është dhënë mjaft hapësirë mësimit mbi Serbinë si shtet shumëkombësh dhe prezantimit të të gjitha pakicave kombëtare të cilat jetojnë në të. Kjo mund të tejkalohet me anë të zgjedhjes më të llojllojshme të autorëve dhe teksteve, prezantimin e përmbajtjeve specifike për kulturat e ndryshme, si dhe përdorimin e emrave dhe mbiemrave të ndryshëm në ushtrimet gramatikore dhe drejtshkrimore.

9. *Priručnik za nastavnike za srpski kao nematernji jezik od 5. do 8. razreda* është burim i vlefshëm i këshillave dhe udhëzimeve i cili mund t'i ndihmojë çdo arsimtari në realizmin e mësimit. Duke pasur parasyshë specifikat dhe sfidat e mëdha të cilat kjo lëndë i vendosë si para autorëve të programit dhe teksteve mësimore ashtu edhe para arsimtarëve, do të ishte e dobishme te jetë një udhëzues për secilën klasë veçmas.

10. Tekstet mësimore për klasët më të larta të shkollës fillore janë të përpiluara si tekste mësimroe pune, nuk janë të ngopura me shpjegime teorike, gjë që është e mirë. Mësimi nga shembujt është më efikas dhe mund të sjellë rezultate më të mira.

III.4.3. Përdorimi i teksteve mësimore në mësimin e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës

Në pajtim me vërejtjet e cekura janë edhe mendimet e arsimtarëve/mësuesëve, të cilët në 97,6% të rasteve kanë deklaruar se përdorin tesktete mësimore të Entit të teksteve mësimore. Nga kjo, madje 56,1% e arsimtarëve në pyetjen „Cilat mejet mësimore i përdorni në mësim?“ është përgjigjur se përdor vetëm tekstin mësimor.

Mirëpo, madje 53,7% e tyre mendon se lënda në tekstet mësimore është shumë e madhe, se ka tepricë të fjalëve të reja, se vëllimi dhe zgjedhja e përmbajtjeve gramatikore nuk janë të harmonizuara me moshën e nxënësve, se është i përfaqësuar një numër i tepruar i përmbajtjeve tekstuale, teksteve të stërgjata dhe se tri librat paraqesin material të tepruar për një lëndë.

Duke analizuar veçmas tekstet mësimore të cilat e përbëjnë kompletin për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare, kemi vërtetuar se 21 arsimtarë kanë theksuar se Libri i leximit është i dobishëm për ata dhe se u ndihmon në realizimin e mësimit nga aspekti i strukturës dhe përshtatshëmrisë së nxënësve moshës së caktuar, 17 arsimtarë, në anën tjetër, janë shprehur se janë pjesërisht të kënaqur me librin e leximit, kure një numër i vogël i tyre (dy) janë të pakënaqur me këtë mjet didaktik.

Si mungesa kryesore të tij janë cekur:

- tekstet shpeshherë nuk janë të harmonizuara me moshën dhe mundësitë gjuhësore të nxënësve;
- ka shumë drama, duhen më shumë tekste të thjeshta nga situatat reale të jetës;
- tekstet janë shumë të gjata;
- duhen tekste më të shkurta dhe më të qarta;
- në librat e leximit prej klasës V deri VIII tekstet janë të gjata: disa mësime kanë madje nga 3–4 faqe;
- temat nuk janë të rëndësishme për nxënësit nga mjedisi rural;
- librat duhet t'i përshtaten të gjitha strukturave nacionale dhe fetare, nuk duhet përmendur asnjë religjion, ajo është e tepërt në librat e leximit;
- shumë tekste nuk janë aktuale dhe nuk janë të afërta për fëmijët e bashkësisë shqiptare, si psh poezitë epike dhe fabulat, si dhe ato të lidhura me luftën e II botërore, ish Jugosllavinë apo tekstet të cilët implikojnë përmbajtjet fetare dhe kulturore (psh. tekstet nga libri i leximit për klasën e IV mbi Sveti Savën, fesitmin e Krishtlindjes etj.);

Kishte edhe komente të cilat tregojnë të kundërtën: 29,26% e arsimtarëve konsideron se Libri i leximit është koncipuar mirë, se është mirë që ka dy lloje të teksteve të cilat arsimtari i zgjedh vet, se teksti mësimor është i mirë dhe i kuptueshëm për fëmijët dhe se nuk ekzistojnë tekstet e tepërta.

Vlerat e ngjashme vërehen edhe në lidhje me *Pouke iz jezika*, me të cilat përpunohen përmbajtjet gramatikore. Rreth 90% e arsimtarëve të anketuar konsideron se janë shumë apo pjesërisht të mira nga aspekti i dobisë dhe strukturës, kurse një numër më i vogël i arsimtarëve është i kënaqur me *Pouke* nga aspekti i përshtatshmërisë së moshës së nxënësve, apo cekë edhe mungesat e tyre të rëndësishme:

- për klasën e tretë dhe të katërt teksti mësimor është shumë voluminoz;
- është e pranishme gramatika e tepërt;
- nuk janë të përshtatura për moshën e nxënësve;

- është i dukshëm mosharmonizimi i programit për Gjuhën shqipe dhe Gjuha serbe si gjuhë joamtare, dhe disa njësi gramatikore përpunohen në gjuhën serbe para se të përpunohen në gjuhën shqipe.

Nga ana e mësimdhënësve më së miri janë vlerësuar fletoret e punës, për të cilat mendojnë se më së shumti u janë përshtatur nxënësve.

Në pyetjen cilat përmbajtje gjuhësore janë më të vështira për mësim nga ana e nxënësve, vetëm 15 arsimtarë (prej gjithsej 41) janë përgjigjur se ajo është gramatika (gjë që aspak nuk përputhet me rezultatet e arritura në testim), kurse shumica e përgjigjeve kanë të bëjnë me tekstet nga libri i leximit dhe lektyra.

Ajo që i pëlqen nxënësve gjatë mësimit të gjuhës serbe është, sipas fjalëve të arsimtarëve, mësimi i vjershave dhe recitimi, përrallat, tregimet nga jeta e përditshme, mësimet mbi sportin dhe kafshët, puna në grupe, dramatizimi i teksteve dhe dramat në përgjithësi ngase kanë më shumë dialog, pastaj tekstet mbi shkollën, prindërit etj.

Në kundërshtim me këtë, nxënësve nuk i pëlqejnë mësimet me dialekt ijekav, gramatikën, tekstet informative, shkencore, njësinë mësimore nga gramatika në klasën e VIII – fjalitë e përbëra të varura, mësimet të cilat përpunohen si lektyrë – pjesët e gjata të cilat kuptohen më vështirë, tekstet e stërgjata, poezitë epike...

Përveç tekstit mësimor, arsimtarët kanë cekur se përdorin edhe materiale plotësuese në formë të katalogut, posterit dhe materialit tjetër glotodidaktik, që është natyrisht në pajtim me mësimin bashkëkohor të gjuhës, por nuk është në pajtim me rezultatet e arritura të nxënësve.

Ajo që ka parë ekipi hulumtues gjatë vizitës së shkollave në të tri komunat, dhe për të cilën ka folur me arsimtarët, është që përdorimi i teksteve mësimore për klasët e ulta është zgjeruar në mënyrë sistemike, ngase ato janë tekste mësimore të cilat i dhuron Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik. Njëkohësisht, përdorimi i teksteve të reja mësimore për klasët e larta është i rrallë.

III.5. Analiza e rezultateve të testimit

III.5. ANALIZA E REZULTATEVE TË TESTIMIT

Vesna Krajishnik dhe Nikica Strizhak

III.5.1. Testimi

Me testim janë mbuluar nxënësit e klasave IV dhe VIII në 13 shkolla fillore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe në komunat e Bujanocit dhe Preshevës (nga të cilat njëra është etnikisht heterogjene), si dhe në tri shkollat në komunën e Medvegjës (nga të cilat dy janë etnikisht heterogjene). Është vlerësuar dituria e gjithsej 433 nxënësve (206 në klasën e katërt dhe 227 në klasën e tetë). Testimi ishte anonim, kurse para testimit nxënësve u është treguar se rezultatet e këtij testi nuk ndikojnë në suksesin e tyre shkollor dhe as nuk do të shënohen në ndonjë mënyrë në dokumentet shkollore.

Testimi në komunat Bujanoc dhe Preshevë është bërë në periudhën prej 24 deri 28 mars të vitit 2014, në paralelet e shkollave amëz. Për këtë rast nga disa shkolla nga paralelet e shpërndara janë sjellë nxënësit në shkollat amëz. Pasi që mësimi në disa shkolla është organizuar në dy ndërrime, testimi është zhvilluar në përputhje me orarin e shkollës. Për zgjidhjen e testit nxënësit kanë pasur një orë mësimi, por ajo kohë sipas nevojës edhe është zgjatur. Testimi në komunën e Medvegjës është zhvilluar më 24 dhe 25 prill, në rrethanat e njëjta.

Testimin e kanë realizuar anëtarët e ekipit hulumtues, në praninë e mësuesit apo arsimtarit të lëndës. Udhëzimet për zgjidhjen e testit i janë dhënë nxënësve në gjuhën serbe dhe në shqip, kurse kërkesa e çdo detyre në test është shkruar në të dyja gjuhët. Me qëllim të kuptimit më të mirë, me çdo detyrë është dhënë nga një shembull i zgjidhur.

Vlerësimi i njohurisë së gjuhës serbe është bërë ashtu që janë testuar kompetencat e ardhshme:

- **shkrimi** – të dy shkrimet dhe shkruarja e tekstit të shkurtër në temën e dhënë;
- **kuptimi** – dëgjimi i tekstit të shkruar;
- **njohuria gramatikore** – përdorimi i drejt i formave gramatikore të gjuhës serbe;
- **fjalori** – njohja dhe përdorimi i fjalëve nga fushat e ndryshme tematike.

Produksioni verbal është testuar vetëm tek ata nxënës të cilët kanë realizuar më shumë se rezultatet mesatare të treguara në test.

III.5.2. Struktura e testit

SÇdo test është përbërë nga 10 detyra për zgjidhjen e të cilave është paraparë koha prej 45 minutave. Varësisht nga numri i kërkesave, detyrat bartnin prej 5 deri 20 pika. Numri maksimal i pikave i cili ka mundur të realizohej me zgjidhjen e detyrave është 100.

Llojet e detyrave i janë përshtatur përmbajtjes së detyrës dhe moshës së nxënësit dhe, me qëllim të arritjes së dinamikës së testit, si alternativë ishin të dhëna:

- zgjedhja e një apo më shumë mundësive: rrethimi i përgjigjes së saktë, lidhja e dy termeve;
- shkruarja e përmbajtjes së dhënë – fjalët, sintagmat, pjesët e fjalisë, fjalisë së plotë, tekstit – në formë të plotësimeve të ndryshme, shtruarja e pyetjeve në përgjigjen e dhënë apo dhënia e përgjigjes në pyetjen e shtruar;
- përshkrimi – fjalët apo fjalitë, nga njëri shkrim në tjetrin.

Edhepse detyrat e të dy testeve janë strukturuar në mënyrë shumë të thjeshtë dhe me shembull të obligueshëm për zgjidhje, në testin për klasën e katërt, pasi që është fjala për moshën e re fëmijërore, detyrat e caktuara janë paraqitur në mënyrë ilustruese në mënyrë që të sigurohet kuptimi sa më i mirë i përmbajtjes, dhe njëherit të nxisë kurreshtjen e nxënësve dhe të ruhet koncentrimi i tyre gjatë zgjidhjes së testit. Përdorimi i termeve gramatikore është tejkaluar me përdorimin e kontekstit të duhur gjuhësor dhe në atë mënyrë përgjigjet e nxënësve janë inicuar dhe drejtuar me qëllim të fitimit të njohurisë funksionale dhe jo teorike të gjuhës serbe.

III.5.3. Përmbajtja e testit

Gjatë caktimit të përmbajtjes së testit jemi udhëhequr me:

a) Planin dhe programin mësimor për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare prej klasës I deri IV dhe prej klasës V deri VIII;

b) Përmbajtjet e teksteve mësimore (librat e leximit, fletat e punës, gramatikat), të aprovuara nga ana e Minsitrisë së arsimit (mbi të cilën do të bëhet fjalë më shumë në këtë studim) dhe

c) Rezultatet e gjuhës serbe si gjuhë joamtare për nivelin A1 dhe A2 të Qendrës së gjuhës serbe si gjuhë të huaj në Fakultetin filologjik në Beograd, të cilat janë bërë sipas standardeve të rekomanduara të Kornizës së përbashkët evropiane për mësimin e gjuhëve të gjalla. Në Planin dhe programin mësimor ekzistojnë përmbajtje dhe metoda të cilat tregojnë si për mësimin e gjuhës amtare ashtu edhe për mësimin e gjuhës së huaj, kurse qasja e parë apo e dytë varen nga përfaqësimi i gjuhës serbe në mjedisin e nxënësve, por edhe afërsia e gjuhës serbe me gjuhën e tyre amtare. Pasi që në komunat Preshevë dhe Bujanoc është më e përfaqësuar gjuha shqipe (në Preshevë është sidomos dominuese), gjuha shqipe dhe serbe nuk janë gjuhë të ngjashme, dhe se ende nuk janë bërë rezultatet për gjuhën serbe si gjuhë e pakicës kombëtare, kemi vendosur që përmbajtjen e testit t'ua përshtatim rezultateve për gjuhën serbe si gjuhë e huaj, edhe atë për klasën e IV të nivelit A1, kurse për klasën e VIII niveli A2:

Tabela 5.3.1. – Pasqyra e rezultateve për gjuhën serbe si gjuhë e huaj për nivelin A1

Niveli A1					
KUPTIMI	SHKRIMI	LEKSIKA	GRAMATIKA		
			FONOLOGJIA	MORFOLOGJIA	SINTAKSA
– Kupton tekstin e lexuar të thjeshtë dhe të kufizuar leksikor, gjë që testohet me anë të përgjigjeve në pyetjet lidhur me tekstin. – Kupton udhëzimet e thjeshta, numrat, cmimet, orët, mesazhet e thjeshta nga jeta e përditshme. – Mund të lidhë situatën nga teksti me ndonjë situatë tjetër.	— Mund të thotë me grafema të gjitha 30 fonemat e gjuhës serbe. – Mund të shkruajë tekst të shkurtër i cili përbëhet nga fjalitë e thjeshta. – Mund të shërbehet me të dy shkrimet, në atë mënyrë që mund të përshkruajë tekstin nga shkrimi latin në atë qirilik dhe anasjelltas obrnuto.	– Kupton fond të kufizuar leksikor i cili është i mjaftueshëm për dhënien e informacioneve kryesore mbi veten dhe mjedisin, si dhe t'i bëjë pyetje themelore personit tjetër. – Kupton dhe përdorë shprehjet kryesore për përshëndetje	– Mund të dallojë të gjitha 30 fonemat e gjuhës serbe, si dhe t'i paraqes në formë të grafemave. – Vëren opozitën fonologjike të fonemave.	– Mund të dallojë llojet e fjalëve dhe llojet kryesore të ndryshimeve brenda tyre.	– Mund të formojë sintagmë të thjeshtë emërore, foljore apo mbiemrore të harmonizuar. – Mund të formojë formë pyetëse, mohuese apo pohuese të fjalisë së thjeshtë apo të zgjeruar.

Tabela 5.3.2. – Pasqyra e rezultateve për gjuhën serbe si gjuhë e huaj për nivelin A2

Niveli A2					
KUPTIMI	SHKRIMI	LEKSIKA	GRAMATIKA		
			FONOLOGJIA	MORFOLOGJIA	SINTAKSA
– Kupton tregime të thjeshta, të strukturuara mirë, letrat personale dhe tregimet mbi temat e përditshme dhe udhëzimet e thjeshta. – Kupton tekstet e thjeshta dhe tekstet në formë të dialogut dhe ato narative mbi temat e njohura.	– Mund të shkruajë një tekst të shkurtër i cili përbëhet prej fjalive të përbëra. – Mund të shërbehet me të dy shkrimet.	– Posedon fond të mjaftueshëm leksik që të mund të kuptojë dhe të ndajë informacionet kryesore nga tekstet dhe bisedat të cilat merren me tema të njohura. – Mund të përshkruajë situatën të cilën e shef, psh fotografinë, në mënyrë të thjeshtë.	– Vëren dallimin mes frikativave dhe afrikatave. – Dëgjon dhe shënon fonemën J.	– Njeh: 1. emërat më shpesh të përdorura të gjinisë femrore në bashkëtingëllore; nomina agentis na -l(a)c; 2. format enklitike të përemrave në shprehjet më të shpeshta komunikative; 3. krahasimin e mbiemrave; 4. kohën e tashme, perfekte, të ardhme, imperativin, potencialin; mbiemrat e foljeve më të shpeshta; pozitën e enklitikave foljore në fjalitë e thjeshta; forma fojlore e foljeve më të shoeshta; 5. parafjalët e frekuentuara, ndajfoljet, lidhëzat dhe pasthirrmat.	– Mund të formojë formën pyetësore, mohuese dhe pohuese të fjalisë së përbërë.

Përmbajtja e përgjithshme e testit është harmonizuar me Programin dhe planin mësimor për klasën e IV, gjegjësisht VIII, përveç se në detyrat me anë të të cilave testohet shkruarja e përmbajtjes – në të dy rastet është dhënë tema e cila nuk përpunohet në tekstet mësimore, por është plotësisht në përputhje me mundësitë gjuhësore të parapara të nxënësit.

Me anë të testit nuk është kontrolluar dituria nga letërsia, kultura dhe tradita, të parapara me programin mësimor, por vetëm kompetenca gjuhësore funksionale.

Tabela 5.3.3. – Pasqyra e detyrave të përfshira në testin për klasin e IV

TESTI PËR KLASËN E KATËRT			
Detyra	Përshkrimi i detyrës	Kompetenca e testuar	Nr. i pikave
1.	Nxënësve u është dhënë kohë më e shkurtër që të lexojnë pyetjet të cilat kanë të bëjnë me tekstin i cili më pas u është lexuar dy herë. Janë shtruar pesë pyetje lidhur me tekstin, dhe secili prej tyre kishte tri përgjigje të mundshme, nga të cilat vetëm një ishte e saktë.	Kuptimi i tekstit të dëgjuar	5
2.	Dhjetë fjalë të caktuara në të cilat plotësisht janë përfaqësuar të gjitha shkronjat e shkrimit latin, duhet të shkruhen në shkrim qirilik.	Shkrimi	10
3.	Janë dhënë 10 fjali të shkurta. Në secilën duhet shkruar fjalën e dhënë (në kllapa) në rasën adekuate.	Njohuria gramatikore	10
4.	Nga nxënësit kërkohet që për secilën nga pesë kërkesat të shkruajë nga tri fjalë: sporti, stina e vitit, instrumenti muzikor, lënda shkollore, lloji i perimeve.	Fjalori	15
5.	Lidhja e fjalëve nga kolona e djathtë dhe e majtë duke respektuar rregullat e gjinisë dhe numrit gramatikor.	Njohuria gramatikore	5
6.	Rrethimi i përgjigjeve të sakta, nga disa të ofruara, në kuadër të tekstit të dialogut.	Kuptimi i tekstit të shkruar	5

7.	Në bazë të të dhënave të dhëna në fotografi dhe kohën e saktë, nga nxënësit kërkohet që të plotësojnë fjalitë me forma të duhura të foljeve dhe emrave të dhënë.	Njohuria gramatikore	20
8.	Në pasqyrën tabelare janë dhënë pesë fjali të thjeshta, të shkruara në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme. Nga nxënësit kërkohet që të shkruajnë fjalitë në dy kohat e mbetura duke u udhëhequr me përcaktuesit dje – sot – nesër.	Njohuria gramatikore	10
9.	Janë dhënë pesë fjali të shkurta me një pjesë të fjalisë të nënvizuar, në bazë të cilit nxënësit duhet të shtrojnë pyetje.	Njohuria gramatikore	5
10.	Bashkë me foton e Kësulëkuqes dhe ujkut është shkruar një pjesë e kësaj përralle të njohur me theksimin e detajeve më të rëndësishme. Nga nxënësit kërkohet që sipas mendimit të tyre ta përfundojnë tregimin, me respektimin e vlerave të duhura sintaksore, leksikore dhe semantike të gjuhës serbe.	Shkrimi	15

Tabela 5.3.4. – Pasqyra e detyrave të përfshira në testin për klasën e VIII

TESTI PËR KLASËN E TETË			
Detyra	Përshkrimi i detyrës	Kompetenca e testuar	Nr. i pikave
1.	Nxënësve u është dhënë kohë e shkurtër që të lexojnë pyetjet të cilat kanë të bëjnë me tekstin i cili më pas u është lexuar dy herë. Janë shtruar pesë pyetje lidhur me tekstin, dhe secili prej tyre kishte tri përgjigje të mundshme, nga të cilat vetëm një ishte e saktë.	Kuptimi i tekstit të dëgjuar	10
2.	Janë dhënë pesë fjali me zbrazëtira në vendin e kallëzuesit. Duhet zgjedhur njërën nga tri zgjidhjet e ofruara, duke u kujdesur për formën e foljes.	Njohuria gramatikore	5
3.	Janë dhënë pesë fjali të cilat duhet plotësuar me një fjali të varur, në mënyrë që të formohet fjalia e përbërë.	Njohuria gramatikore	10
4.	Janë dhënë pesë fjali me zbrazëtira, tri duhet të plotësohen me zgjedhjen e sintagmës apo fjalës në rasën e duhur, kurse dy me zgjedhjen e emrit personal të transkriptuar drejt nga gjuha shqipe.	Njohuria gramatikore	5
5.	Në bazë të përshkrimit të termit të kërkuar në zbrazëtirë duhet shënuar leksemën e duhur. Në detyrë gjenden gjithsej 10 zbrazëtira.	Fjalori	10

6.	Nxënësve u janë dhënë pesë fjali me përgjegjen e pritur të nënvizuar për të cilën duhet shtruar pyetjen e duhur.	Njihuria gramatikore	10
7.	Teksti i dhënë i shkurtër duhet të shkruhet në shkrimin qirilik, të shkrimit apo shtypit, sipas zgjedhjes së nxënësit.	Shkrimi	10
8.	Në temën e dhënë (përshkrimi i shokut apo shoqes më të mirë) duhet shkruar përmbajtjen e shkurtër (12–13 rreshta). Me qëllim të precizimit të temës janë shtuar edhe katër pyetje ndihmëse lidhur me temën.	Shkrimi	20
9.	Pesë fjalitë e dhëna duhet të plotësohen me foljet e duhura, të cilat nxënësit vetë duhet t'i formojnë nga infinitivi i dhënë.	Njohuria gramatikore	10
10.	Teksti i shkruar në shkrim qirilik duhet të lexohet dhe të përgjigjet në pesë pyetje të shtruara lidhur me tekstin	Kuptimi i tekstit të shkruar	10

III.5.4. Analiza e rezultateve të testit

Rezultatet e testit në shkollat të cilat gjenden në komunat e Bujanocit dhe Preshevës dallohen pjesërisht mes vete, por dallimi posaçërisht i madh është i dukshëm në krahasim me rezultatet nga komuna e Medvegjës. Që të vijmë deri te të dhënat sa më precize mbi kompetencën gjuhësore të nxënësve, por edhe mbi kushtet të cilat ndikojnë në përvetësimin e gjuhës, rezultatet nga Bujanoci dhe Presheva i kemi analizuar bashkë, kurse rezultatet nga Medvegja veçmas.

III.5.4.1. Analiza e rezultateve të testit në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Me analizën e rezultateve të fituara kemi marrë informacione mbi mosnjohjen sistemike të gjuhës serbe nga ana e nxënësve të të gjitha shkollave fillore në komunat e cekura, sikur në klasën e katërt ashtu edhe në klasën e tetë.

Gjatë analizës së rezultateve duhet pasur parasysh dy fakte të cilat, gjatë përpunimit statistikor, çojnë deri te pasqyra pjesërisht e shtrembëruar: (1) rezultatet e mira individuale dukshëm dallojnë nga vlerat mesatare dhe nuk mund të sillen në lidhje as me paralelen as me shkollën dhe (2) është evidente që nxënësit me dituri më të dobët kanë kopjuar nga ata niveli i diturisë së të cilëve është më i mirë.

Nga numri i përgjithshëm i analizuar i nxënësve, pikat e realizuara sillen prej 1 deri 83, ku është i vogël numri i nxënësve të cilët kanë realizuar më shumë se 50 pikw,[86] gjë që duket edhe në rezultatin e realizuar mesatar prej 27,02. Dituri dukshëm më të dobët kanë treguar nxënësit e klasës së IV.

Tabela 5.4.1. – Pasqyra përmbledhëse e testeve për komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Bujanoc dhe Preshevë				
Klasa	Numri i përgjithshëm i testeve	Minimumi i poenave të realizuar	Maksimumi i poenave të realizuar	Rezultati mesatar në poena
Klasa e tetë	217	3	83	31,56
Klasa e katërt	203	1	75	22,18
Rezultati i përgjithshëm i testit	420	1	83	27,02

Nëse rezultatet e fituara shikohen sipas shkollave, mund të shihet se në asnjë shkollë nuk është realizuar rezultati mesatar prej 50%, në bazë të cilit mund të flitet mbi njohjen e gjuhës serbe nga ana e nxënësve të asaj shkolle. Rezultatin më të mirë, sidomos qartë të shprehur në klasën e tetë, e ka shkolla „Naim Frashëri“, e cila gjendet në pjesën e qëndrore të komunës.

86 Valorizimi i rezultatit fillimisht është caktuar në përputhje me standardet për valorizimin e gjuhës serbe si gjuhë e huaj – për realizimin e suksesshëm të testit duhet të fitoheshin minimum 60 poena (60%). Mirëpo, duke pasur parasysh rezultatet e arritura jashtëzakonisht të këqia, pragu i kalimit të testit ka rënë në 50%.

Tabela 5.4.2. – Pasqyra e testeve sipas shkollave në komunat e Bujanocit dhe Preshevës për klasën e IV dhe VIII

Bujanoc dhe Preshevë – klasa IV dhe VIII				
Shkollat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati i fituar minimal	Rezultati i fituar maksimal	Rezultati mesatar në poena
„Naim Frashëri“, Bujanoc	38	10	81	37,24
„Muharem Kadriu“, Tërrnoc i Madh, komuna e Bujanocit	56	12	80	35,36
„Zenel Hajdini“, Raincë, Komuna e Preshevës	29	4	71	32,93
„Ali Bektashi“, Nasalcë, Komuna e Bujanocit	23	13	83	32,65
„Sami Frashëri“, Llucan, Komuna e Bujanocit	34	2	79	30,21
„Abdula Krashnica“, Miratoc, komuna e Preshevës	32	7	68	28,41
„Selami Hallaci“, Rahovicë, Komuna e Preshevës	34	3	45	24,97
„9. maj“, Leran, Komuna e Preshevës	37	3	57	22,16
„Desanka Maksimović“, Bilac, komuna e Bujanocit	34	7	75	21,76
„Ibrahim Kelmendi“, Preshevë	52	6	59	20,38
„Migjeni“, Caravajkë, Komuna e Preshevës	13	3	34	17,38
„Dituria“, Corroticë, Komuna e Preshevës	25	7	28	16,40
„Migjeni“, Muhoc, Komuna e Preshevës	13	1	37	16,00

Analiza e rezultateve të testeve për klasën e IV në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Rezultatet e testimit të nxënësve të klasës së IV janë më të dobëta se mesatarja e përgjithshme. Vërehet barazia e konsiderueshme e vlerave mesatare, të cilat sillen prej 13% deri 27,67%. Me heqjen e rezultateve tejet të larta, dhe individuale (tri raste), këto vlera do të ishin dukshëm më të ulëta dhe do të reflektonin pasqyrën e vërtetë të diturisë së nxënësve. Rezultati më i mirë është arritur në shkollën „Muharrem Kadriu“, në Tërrnoc të Madh, komuna e Bujanocit (33.11/100), kurse më i keqi në shkollën „Migjeni“ në Muhoc.[87] Njëra nga vërejtjet e rëndësishme gjatë analizës së rezultateve është që shumica e nxënësve as nuk u përpoq t'i zgjidhë detyrat më të vështira, pavarësisht udhëzimeve të qarta të përkthyera në gjuhën shqipe dhe shembullit i cili tregonte mënyrën e zgjidhjes.

Tabela 5.4.3. – Pasqyra e testeve të nxënësve të klasës së katërt nëpër shkolla në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Bujanoc dhe Preshevë – klasa IV				
Shkollat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultatet e realizuara minimale	Rezultatet e realizuara maksimale	Rezultati mesatar në pika
„Muharrem Kadriu“, Tërrnoc i Madh, komuna e Bujanocit	27	12	71	33,11
„Ali Bektashi“, Nasalcë, komuna e Bujanocit	9	13	48	27,67
„Sami Frashëri“, Llucan, komuna e Bujanocit	13	2	64	26,31
„Zenel Hajdini“, Raincë, komuna e Preshevës	14	4	57	24,93
„9 maj“, Leran, komuna e Preshevës	17	6	52	21,47
„Desanka Maksimović“, Bilac, komuna e Bujanocit	18	7	75	20,61
„Naim Frashëri“, Bujanoc	20	10	33	20,60
„Selami Hallaci“, Rahovicë, komuna e Preshevës	18	3	27	20,50

87 Muhoci është fshat i izoluar monoetnik, në komunën e Preshevës.

„Abdulla Krashnica“, Miratoc, komuna e Preshevës	15	8	35	19,80
„Dituria“, Corroticë, komuna e Preshevës	13	9	28	16,85
„Ibrahim Kelmendi“, Preshevë	28	6	29	16,68
„Migjeni“, Caravajkë, komuna e Preshevës	7	7	22	16,57
„Migjeni“, Muhoc, komuna e Preshevës	4	1	37	13,00

Me anë të analizës më të thellë të rezultateve të testimit, janë zbërthyer llojet dhe nivelet e diturisë së nxënësve sa i përket kompetencave të analizuara. Për atë qëllim së pari janë analizuar rezultatet e detyrave të caktuara.

Tabela 5.4.4. – Pasqyra e rezultateve të testit të nxënësve të klasës së katërt në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Rezultatet e testit – Bujanoc dhe Preshevë – klasa IV				
Detyrat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati i realizuar minimal	Rezultati i realizuar maksimal	Rezultati mesatar në pika
Detyra 1	203	0	5/5	2,85
Detyra 2	203	0	10/10	3,93
Detyra 3	203	0	6/10	1,12
Detyra 4	203	0	15/15	6,52
Detyra 5	203	0	5/5	1,71
Detyra 6	203	0	5/5	2,78
Detyra 7	203	0	20/20	1,79
Detyra 8	203	0	9/10	,71
Detyra 9	203	0	5/5	,33
Detyra 10	203	0	12/15	,42
Rezultati i përgjithshëm	203	1	75/100	22,18

Në detyrën e parë – kuptimin e tekstit të dëgjuar – nga maksimalisht 5 janë realizuar mesatarisht 2,85 pikë. Gjatë vlerësimit janë marrë parasyshë vetëm përgjigjet e dhëna në pajtim me udhëzimet për zgjidhjen e detyrës – e rrethuar vetëm një nga tri përgjigjet e dhëna. Duke pasur parasysh moshën e nxënësve dhe nivelin më të ulët të kompetencës gjuhësore, përgjigjet e dhëna janë përbërë nga shprehjet e thjeshta, të përbëra nga një fjalë apo një sintagmë. Gjatë zgjidhjes së detyrës së parë është vërejtur mungesa e aftësisë për zgjidhjen e detyrave të këtij lloji ngase nxënësit në numër të madh kanë rrethuar dy apo madje edhe tri përgjigje të ofruara.

Vlera mesatare e pikave e realizuar **në detyrën e dytë** – transkriptin e fjalëve të caktuara nga shkrimi latin në atë qirilik – është 3,93 nga e mundura 10. Janë vlerësuar vetëm fjalët të cilat janë shkruar plotësisht drejt në shkrimin qirilik (një fjalë e shkruar drejt ka bartur një pikë), pa marrë parasysh a janë shkruar më shkronja të shkrimit apo të shtypit. Dallimi i përgjigjeve lëvizte nga mospërgjigja apsolute në detyrë, përmes përgjigjes pjesërisht të saktë, e cila nënkuptonte përzierjen e dy shkrimeve, deri te përgigja plotësisht e saktë, në të cilën të gjitha shkronjat janë shkruar në mënyrë të duhur në shkrim qirilik. Nxënësit më shpesh kanë përdorur shkronjat e shkrimit në krahasim me shkronjat e shtypit, por në numër të madh të rasteve është vërejtur shkruarja e ngathët e cila shpeshherë i ngjan vizatimit.

Në detyrën e tretë – përdorimi i duhur i formave rasore – për dallim nga dy detyrat e mëparshme, në asnjë rast nuk është realizuar numri maksimal i pikave, kurse vlera mesatare maksimale është shumë e ulët dhe e barabartë me 1,12 pika. Pavarësisht faktit se mënyra e zgjidhjes së detyrës është dhënë në shembull, nxënësit janë përgjigjur në mënyra të ndryshme të gabuara: me përsëritjen e formës së rasës të dhënë në shembull, zgjedhjen e formës së gabuar të rasës, përshkruarjen e fjalëve nga kllapat, zgjedhjen e fjalëve të reja sipas dëshirës së tyre, shkruarja e fjalëve në gjuhë shqipe... Janë pranuar vetëm ata shembuj të cilët janë shkruar në pajtim me rregullat fonetiko-morfologjike të gjuhës serbe.

Në detyrën e katërt – njohja e leksikës – është realizuar pothuajse rezultati i përgjysmuar: nga 15 pikat maskimale janë realizuar mesatarisht 6,52. Gjatë vlerësimit pjesërisht janë lejuar gabime ortografike në kuptimin e shkronjave të dyfishta, si dhe gabimet fonetiko-morfologjike gjatë mosrespektimit të parimit të harmonizimit. Gabimet më të shpeshta kishin të bëjnë me shkruarjen e leksemave të kërkuara në gjuhën shqipe apo dhënien e përgjigjeve të gabuara për shkak të moskuptimit të detyrës.

Në detyrën e pestë – lidhjen e mbiemrave dhe emrave duke respektuar kategorinë e gjinisë dhe numrit gramatikor – pavarësisht pritjes që kjo detyrë do të jetë e lehtë për t'u zgjidhur, është realizuar rezultat mesatar relativisht i ulët: 1,71 nga maksimumi 5.

Detyrën e gjashtë e valorizoi kuptimi i tekstit të shkruar. Edhepse nxënësit nuk kishin zgjidhje të madhe gjatë caktimit të përgjigjes së saktë (rrethimit të shkronjës para përgjigjes së saktë), rezultati i treguar është nën atë të pritur: 2,78 nga maksimumi 5. Në teorinë e testimit të nxënësve detyra me më shumë përgjigje të ofruara konsiderohet e lehtë ngase e udhëzon përgjigjen e nxënësit dhe nuk kërkon asnjë lloj produkcioni.

Detyra e shtatë është njëra nga më të vështirat dhe paraqet kombinimin e të dhënave ilustruese dhe tekstuale. Nga nxënësit është kërkuar që, duke lidhur njërat dhe tjetrat, të përgjigjen në kërkesat të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e rregullt të formave foljore dhe numrave. Duke pasur parasysh vështirësinë e saj, kjo detyrë bartte edhe më së shumti pika – 20. Mirëpo, vetëm një nxënës arriti të realizojë të gjitha 20 pikat, kurse rezultati mesatar ishte vetëm 1,79. Gabimet më të shpeshta të bëra nga ana e nxënësve ishin përdorimi joadekuat i formave foljore apo parregullsitë në shkruarjen e numrave. Gjatë kontrollimit nuk kemi vërejtur që nxënësit kanë pasur problem në kuptimin e detyrës.

Në detyrën e tetë – kontrollimin e njohjes së radhitjes së fjalëve dhe kohës adekuate foljore (koha e tashme, perfekti, e ardhme) në kontekstin e dhënë të fjalisë – nga maskimumi prej 10 pikave është realizuar rezultati mesatar prej 0,71 pikave. Kjo është njëra nga detyrat në të cilën në shumicën e rasteve nxënësit as nuk kanë bërë përpjekje që të përgjigjen pavarësisht shembujve të qartë të dhënë, në bazë të së cilës mund të konkludojmë se ata nuk zotërojnë me këtë nivel të njohurisë gramatikore.

Në detyrën e nëntë – konstruimin e fjalisë pyetëse në përgjigjen e dhënë me përdorimin e duhur të parafjalës apo konstruimit rasor-ndajfoljor – është treguar rezultati më i dobët në test: 0,33 nga 5. Gjatë analizës së rezultateve është vërejtur ndikimi i madh i formave jostandarde tipike për këtë regjion dialektit të gjuhës serbe, por edhe gabimeve të shumta që rrjedhin nga njohja e pamjaftueshme e gjuhës.

Detyra e dhjetë – përfundimi i tregimit të filluar – ishte më e vështira në test, por edhe më e lira sa i përket zgjedhjes së mënyrës së zgjidhjes së saj. Nxënësve u është lejuar që në mënyrë të pavarur të zgjedhin fjalët, të formojnë fjali dhe pjesërisht të ndryshojnë rrjedhën narative, por duhet respektuar strukturën semantike të tregimit. Zgjedhja e tregimit „Kësulëkuqja“ është motivuar në atë mënyrë që ajo është e njohur për të gjithë fëmijët e kësaj moshe, por motivet e saj paraqiten në materialin mësimor për klasën e I. Që nxënësit të udhëzohen sa më mirë në përmbajtjen e tregimit, me tekst është dhënë edhe ilustrimi. Sidoqoftë, numri mesatar i pikave prej 0,12 nga 15 të mundurat tregon për dy gjëra. Së pari, për mosnjohjen[88] e këtij tregimi dhe, e dyta, ndjekjen jo të shkathët të tregimit madje edhe te numri i vogël i nxënësve të cilët janë përpjekur t'i përgjigjen kësaj detyre. Vetëm një nxënës arriti të përfundojë tregimin në mënyrë të kënaqshme, me devijime të pjesërishme nga norma e gjuhës serbe, duke realizuar

88 Shpesh ka ndodhur që nxënësit të cilët e kanë bërë testin të na thonë që nuk e njohin këtë tregim, edhepse motivet e tregimit paraqiten në materialin e teksteve mësimore të parapara për klasën e I.

12 pikë, gjë që është njëherit edhe rezultati maksimal për këtë detyrë. Në shumicën e rasteve nxënësit as nuk janë përpjekur të shkruajnë diçka, kurse ata të cilët së paku kanë filluar zgjidhjen, më së shpeshti kanë përdorur fjalë në gjuhën shqipe apo vetëm kanë „hedhur“ fjalët duke mos i lidhur në fjali.

Me analizën e rezultateve individuale për çdo detyrë është arritur konkluzioni se nxënësit kanë arritur rezultate më të dobëta në detyrat ku është dashur në mënyrë të pavarur të shkruajnë tërë fjalitë, pa marrë parasysh a është fjala për detyrat me anë të të cilave kontrollohet kompetenca gramatikore apo shkruarja e përmbajtjes. Këto ishin njëherit edhe detyrat më të ndërlikuara me të cilat është vlerësuar aftësia e konstruimit të fjalisë nga aspekti gramatikor, leksikor dhe semantik.

Me grupimin e detyrave nëpër kompetenca, kemi fituar të dhëna të cilat na tregojnë disa gjëra:

- Me cilat shkathtësi zotërojnë në mënyrë të kënaqshme, zotërojnë keq apo aspak nuk zotërojnë në përdorimin e gjuhës nxënësit e klasavë të ulta të shkollës fillore;
- mënyra në të cilën nxënësit e kësaj moshe përvetësojnë gjuhën;
- përfaqësimi i përmbajtjeve të duhura në mësimin e gjuhës serbe.

Në tabelën vijuese janë dhënë rezultatet sipas kompetencave individuale të cilat i kanë realizuar nxënësit e klasës së IV të shkollës fillore:

Tabela 5.4.5. – Pasqyra e rezultateve sipas kompetencave individuale të cilat i kanë realizuar nxënësit e klasës së Ivnë shkollat në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Bujanoc dhe Preshevë – klasa IV				
Kompetencat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati i realizuar minimal	Rezultati i realizuar maksimal	Rezultati mesatar në pika
Njohuria gramatikore	203	0	43/50	5,67
Fjalori	203	0	15/15	6,52
Shkrimi	203	0	17/25	4,34
Kuptimi i tekstit të dëgjuar	203	0	5/5	2,85
Kuptimi i tekstit të shkruar	203	0	5/5	2,78

Vlerat më të mëdha i shohim në kompetencën gjuhësore e cila ka të bëjë me kuptimin, sikur të tekstit të dëgjuar ashtu edhe të atij të shkruar, ku është realizuar më shumë se 50%: nga 5 pikat maksimale vlera mesatare është 2,85, gjegjësisht 2,78. Edhe në njërën edhe në detyrën tjetër janë arritur rezultate maksimale. E gjithë kjo na tregon se nxënësit zotërojnë kryesisht me njohjen pasive të gjuhës, si rezultat i perceptimit të përmbajtjeve auditive apo të shkruara.

Rezultati i ardhshëm i realizuar ka të bëjë me njohjen e fjalorit – nga 15 pikat maksimale është realizuar vlera mesatare prej 6,52. Edhe në këtë detyrë është realizuar numri maksimal i pikave.

Mirëpo, duke pasur parasysh se kjo kompetencë u vlerësua në bazë të nominalizimit të vlerave të caktuara leksikore, shumë të frekuentuara në fondin leksikor themelor, janë pritur rezultate shumë më të mira.

Rezultatet e fituara me vlerësimin e kompetencës së shkrimit bashkojnë rezultatet e dy shkathtësive: shkrimin qirilik dhe shkruarjen e pavarur të tekstit. Nga 25 pikat maskimale është realizuar mesatarja prej 4,34, ku asnjë nxënës nuk ka realizuar më shumë se 17 pikë. Në rezultatin kaq të dobët ndikon para së gjithash arritja shumë e dobët e shkruarjes së përmbajtjes, kurse sukses më i mirë është arritur në shkruarjen e shkrimit qirilik. Pasi që shkrimi i tekstit të pavarur (përmbajtjes) konsiderohet si aftësi më e vështirë gjuhësore, e cila nënkupton zotërimin e pothuajse të gjitha aspekteve të gjuhës (fonologjike, morfologjike, leksikore, sintaksore dhe semantike), nuk habitë ky rezultat i dobët në dritën e (mos)njohjes së përgjithshme të gjuhës serbe.

Rezultati më i dobët është arritur me vlerësimin e kompetencës gramatikore – nga 50 pikat maksimale janë arritur mesatarisht 5,67 pika. Me këtë rezultat në mënyrë më të dukshme është e mundur të valorizohet mënyra e mësimit të gjuhës ne klasë. Derisa me të gjitha kompetencat tjera gjuhësore është e mundur pak-a-shumë të zotërohet jashtë shkollës, sikur në komunikim me folësit e gjuhës serbe ashtu edhe me dëgjimin e gjuhës në televizion, me përdorimin e duhur të konstrukteve gjuhësore, pa të folurit dialektik, mund të zotërohet vetëm në procesin mësimor. Si rezultat i qasjes jo mjaft të mirë në këtë problem, tek një numër i vogël i nxënësve të cilët janë përgjigjur në detyrat lidhur me njohurinë gramatikore, haset në shprehje gjuhësore jostandarde. Duhet cekur se është testuar njohja e domethënieve kryesore të rasave dhe tri kohët kryesore të foljeve me përdorimin e fjalëve të frekuencës së lartë. Në bazë të kësaj mund të konkludojmë se këtij problemi i kushtohet shumë vëmendje e vogël në shkollë ngase, në njërën anë, paraqet nivelin më të ndërlikuar të sistemit gjuhësor dhe nga arsimtarët kërkon shkallën e kënaqshme të kompetencës linguistike dhe metodike, kurse në anën tjetër për nxënësit është më i vështiri në procesin e mësimit, dhe nëse nuk e kanë mbështetjen e duhur nga ana e arsimtarëve dhe materiali didaktik, rezultatet padyshim mungojnë. Si shtesë mund të ceken edhe rezultatet e vërejtjes të shkaktuara

gjatë realizimit të mësimit, të cilët tregojnë se gjatë shpjegimit të njësive gramatikore arsimtarët përdorin jashtëzakonisht metodën demonstrative, kurse interakcioni mes arsimtarëve dhe nxënësve pothuajse plotësisht mungon. Rezultatet e njëjta tregojnë edhe për përdorimin shpeshherë të gabuar të formave gramatikore në të folurit e arsimtarit, por edhe gabime në qasjen didaktiko-metodike.

Analiza e rezultateve të testit për klasën e VIII në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Në klasën e tetë është realizuar rezultat më i mirë se sa në të katërtën, edhepse edhe rezultati i përgjithshëm mesatar i klasës së tetë është kryesisht larg nën 50%. Mirëpo, në krahasim me klasën e katërt, vërehet dallim më i madh i rezultateve dhe pabarazia më e madhe. Shkolla me rezultat mesatar më të mirë është „Naim Frashëri",, rezultati mesatar i diturisë së të cilit në klasën e tetë është 55,72%. Ai është rezultati i vetëm, në të dy klasët, i cili është më i madh se 50%. Rezultati mesatar më i dobët është realizuar në shkollën „Dituria" dhe ai është 15,92 pikë nga 100. Sa i përket rezultatit individual më të mirë, vetëm një nxënës ka realizuar 81 gjegjësisht 83 pikë nga 100 dhe këto janë rezultatet e vetme të cilat kalojnë 80 pikë për një test.

Tabela 5.4.6. – Pasqyra e testeve të nxënësve të klasës së tetë sipas shkollave në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Bujanoc dhe Preshevë – klasa VIII				
Shkollat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati minimal i realizuar	Rezultati maskimal i realizuar	Rezultati mesatar në pika
„Muharrem Kadriu“, Tërrnoc i Madh, komuna e Bujanocit	18	33	81	55,72
„Ali Bektashi“, Nasalcë, komuna e Bujanocit	15	22	71	40,40
„Sami Frashëri“, Llucan, komuna e Bujanocit	29	13	80	37,45
„Zenel Hajdini“, Raincë, komuna e Preshevës	17	7	68	36,00
„9 maj“, Leran, komuna e Preshevës	14	14	83	35,86
„Desanka Maksimović“, Bilac, komuna e Bujanocit	21	5	79	32,62
„Naim Frashëri“, Bujanoc	16	17	45	30,00
„Selami Hallaci“, Rahovicë, komuna e Preshevës	24	15	59	24,71
„Abdulla Krashnica“, Miratoc, komuna e Preshevës	16	11	36	23,06
„Dituria“, Corroticë, komuna e Preshevës	20	3	57	22,75
„Ibrahim Kelmendi“, Preshevë	6	3	34	18,33
„Migjeni“, Caravajkë, komuna e Preshevës	9	5	30	17,33
„Migjeni“, Muhoc, komuna e Preshevës	12	7	23	15,92

Rezultati i shkollës „Naim Frashëri“, siç është thënë më herët, i vetmi tejkalon 50%, me gjithsej shtatë teste (prej 18) me rezultat më të madh se 60%. Gjatë kontrollimit të këtyre testeve, ekzistonte përshtypja e fortë se nxënësit kanë përshkruar nga njëri tjetri ngase shumë përgjigje ishin identike, në mesin e të cilëve, që është edhe më e rëndësishme, ka shumë përgjigje jo të sakta. Biseda me nxënësit të cilët kanë arritur rezultat të mirë vërtetoi dyshimin mbi rezultatet joreale.

Në shkollën „Zenel Hajdini“ „kalueshmëria“ (rezultati mbi 60 pikë) është shumë e ulët, mirëpo ekzistojnë më shumë punime me rezultatin mes 50 dhe 60 pikave, gjë që flet për posedimin e njohurisë së caktuar, më të madhe se në shkollat tjera. Poashtu, kjo është njëra nga shkollat në të cilën njohja e shkrimit qirilik është në nivel shumë të lartë, që është gjithmonë pasojë e punës shkollore dhe rezultat i mësimit, dhe jo diçka që përvetësohet në mënyrë spontane.

Shkollat „Muharrem Kadriu“, „Abdulla Krashnica“, „Ali Bektashi“ dhe „Sami Frashëri“ kanë treguar lloj të ngjashëm të rezultatit: kështu, nga numri i madh testeve me rezultat shumë të dobët, janë dalluar disa nxënës të cilët kanë treguar njohuri të caktuar në test, dhe disa prej tyre më vonë kanë treguar edhe kompetencë solide gojore, mbi të cilën do të bëhet fjalë më vonë.

Shkolla fillore „9 maji“ në fshatin Leran, komuna e Preshevës, është e vetmja shkollë multietnike. Mirëpo, rezultatet e treguara në test tregojnë se me siguri nuk ka komunikim me fëmijët të cilët e kanë gjuhën serbe gjuhë amtare.

Sikur edhe në klasën e katërt, me nivelin e parë të analizës janë zbërthyer rezultatet e secilës detyrë vecmas, gjithsej për të gjitha shkollat, me qëllim të arritjes së një pasqyre më të qartë mbi atë se çfarë dijnë nxënësit më mirë dhe çfarë më dobët.

Tabela 5.4.7. – Pasqyra e rezultatit të testit të nxënësve të klasës së tetë në komuna e Bujanocit dhe Preshevës

Rezultatet e testit – Bujanoc dhe Preshevë – klasa e VIII				
Detyrat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultatet e realizuara minimale	Rezultatet e realizuara maksimale	Rezultati mesatar në pika
Detyra 1	217	0	10/10	6,27
Detyra 2	217	0	5/5	2,43
Detyra 3	217	0	10/10	2,03
Detyra 4	217	0	5/5	2,74
Detyra 5	217	0	9/10	2,04
Detyra 6	217	0	10/10	1,00
Detyra 7	217	0	10/10	7,51
Detyra 8	217	0	18/20	3,25
Detyra 9	217	0	10/10	1,35
Detyra 10	217	0	10/10	2,94
Rezultati i përgjithshëm	217	3	83/100	31,56

Në detyrën e parë – kuptimin e tekstit të dëgjuar – nga 10 pikat maksimale janë realizuar mesatarisht 6,27 pika. Sikur edhe në detyrën e këtij lloji në testin për klasën e katërt, gjatë vlerësimit janë marrë parasysh vetëm përgjigjet e dhëna në përputhje me udhëzimet për zgjidhjen e detyrën – e rrethuar vetëm njëra nga tri përgjigjet e dhëna. Është vërejtur aftësia e kënaqshme e nxënësve në zgjidhjen e detyrave të këtij lloji dhe nuk janë vërejtur gabimet që kanë dalë nga rrethimi i më shumë se një përgjigjes. Duke marrë parasysh strukturën e komplikuar të tekstit të dëgjuar për dallim nga teksti në testin për klasën e katërt, si dhe aftësitë e pritura më të zhvilluara perceptive të nxënësve të klasës së tetë, kjo detyrë është vlerësuar me numër më të madh të pikave se sa për nxënësit e klasëve më të ulëta – maksimalisht 10. Gjatë zgjidhjes së kësaj detyre nxënësit janë përballur me dy vështirësi: e para kishte të bënte me gjatësinë e përgjigjeve të ofruara (të cilat duhej lexuar dhe kuptuar në kohë relativisht të shkurtër), e dyta me dallime më të vogla semantike mes tyre.

Lloji i njëjt i detyrave (zgjedhja e shumëfisht) është i përfaqësuar edhe në detyrën tjetër – me njohjen e kategorisë së foljes. Vlera mesatare e pikave të realizuara **në detyrën e dytë** është 2,43 nga të mundurat 5.

Në detyrën e tretë – përdorimin e fjalive të varura – mesatarisht janë realizuar 2,03 pikë nga të mundurat 10. Në këtë detyrë nxënësve u është dhënë liria e caktuar në zgjidhje – është dashur që sipas zgjidhjes së tij, por pas lidhëzes adekuate, të shkruajnë fjali të varur. Në kërkesën e detyrës është përdorur shprehja terminologjike „fjalia e varur“ ngase sistemi i fjalive të varura, sipas programit dhe planit mësimor, është njësia gramatikore kryesore e cila përpunohet në klasën e tetë, prandaj ishte e pritshme që termi është i njohur për nxënësit e kësaj moshe. Mirëpo, në bazë të përgjigjeve të marra, janë vërtetuar dy gjëra: e para, nxënësit nuk e njohin këtë term dhe japin përgjigje në formë të sintagmës apo fjalë individuale; e dyta, nuk kuptojnë rëndësinë e lidhëzave. Vlerësimi i detyrës u bë me vlerësimin edhe të përdorimit të duhur të fjalisë së varur dhe strukturës së rregullt gramatikore të fjalisë, dhe në bazë të kësaj ishte e mundur të fitohen dy pika për fjali. Nëse në detyrë është përgjigjur me një fjali të varur të duhur, por me gabime gramatikore apo ortografike, përgjigja është vlerësuar me një pikë. Poashtu, nëse përgjigja në detyrë është dhënë me sintagmë apo konstruim parafjalor-rasor në rasën e duhur dhe pa gabime tjera, në c'mënyrë është fituar fjalia plotësisht e saktë e gjuhës serbe, edhe ajo përgjigje është vlerësuar me një pikë, ngase qëllimi i testimit ishte kontrollimi i njohurisë funksionale, komunikative dhe i përdorshëm i gjuhës.

Me detyrën e katërt janë kontrolluar dy kompetenca – njohuria gramatikore dhe ortografia. Edhepse janë kontrolluar kompetencat e ndryshme, kërkesa e detyrës ishte e njëjtë – rrethimi i përgjigjes së saktë. Rezultati mesatar është 2,03 pikë nga ato maksimale 10. Në këtë rezultat kanë ndikuar para së gjithash përgjigjet të cilat kanë të bëjnë me ortografinë, kurse është realizuar numri dukshëm më i vogël i pikave në pjesën me të cilën është vërtetuar kompetenca gramatikore.

Në detyrën e pestë – njohjen e leksikës – është dashur që në bazë të përshkrimit të dhënë të bëhet leksikalizimi i termit. Është paraparë njohja e fjalëve nga përdorimi i përditshëm me të cilat ka të bëjë përshkrimi i dhënë. Pavarësisht pritjes se kjo detyrë do të jetë më e lehtë për nxënësit, ngase bëhet fjalë për leksikën bazike dhe ngase janë të pranuara si të sakta shumë përgjigje, rezultatet e fituara kanë treguar për një fond leksik shumë të reduktuar, kështu që, edhe përkundër tolerimit të gabimeve në ortografi, në asnjë test nuk është vërejtur rezultati maksimal. Rezultati mesatar është 2,04 pikë nga maksimumi prej 10.

Në detyrën e gjashtë – konstruimi i fjalisë pyetëse në përgjigjen e dhënë me përdorimin e duhur të ndajfoljes apo konstruktit parafjalo-rasor – është treguar, sikur edhe në klasën e katërt, rezultati më i dobët në test, 1 nga të mundurat 10. Gjatë analizës së rezultatit kemi vërejtur ndikim të madh të formave dialektike jostandarde, por edhe gabime të shumta të cilat kanë rrjedhë nga njohja e pamjaftueshme e gjuhës, edhe atë para së gjithash në radhitjen e fjalëve në fjali dhe lakime.

Detyra e shtatë – përshkrimi i tekstit në shkrim qirilik – është detyra e zgjidhur më me sukses e gjithë testit në të gjitha komunat. Nga 10 maksimale, rezultati mesatar i realizuar është 7,51. Një numër shumë i vogël i nxënësve as nuk u përpoq që të zgjidhë këtë detyrë, kurse te shumica është vërejtur shkalla e lartë e njohjes së shkrimit qirilik. Në detyrë nuk është precizuar a kërkohet shkrimi qirilik i shtypur apo i shkrimit, kurse nxënësit kryesisht u përcaktuan për të shkruarën. Shkruarja e lehtë e shumicës së shkrimeve të fëmijëve dëshmon për njohjen e sigurt, shumëvjecare të shkrimit qirilik.

Detyra e tetë – shkruarja e përmbajtjes – është detyra më e vështirë e këtij testi. Me të është vlerësuar aftësia e nxënësve që në mënyrë të pavarur të shkruajnë tekstin korrekt gramatik dhe semantik për temën e dhënë. Tema (përshkrimi i shokut apo shoqes më të mirë) është zgjedhur që të jetë e afërt me nxënësit dhe që zgjedhja e leksikës të drejtohet në fjalët nga fondi leksikor bazik. Mirëpo, pavarësisht kësaj teme dhe nënpyetjeve ndihmëse të ofruara, rezultati i realizuar mesatar është 3,25 nga të mundurat 20. Numri maksimal i pikave në asnjë rast nuk është realizuar. Kjo pyetje ndoshta më ilustruese se të gjitha paraqet njhjen e dobët të gjuhës serbe në të gjitha nivelet gjuhësore.

Në detyrën e nëntë është kontrolluar njohja e sistemit të formave të foljeve kontekstin e dhënë të fjalisë. Format e kërkuara foljore janë paraparë me planin dhe programin mësimor për klasët e larta të shkollës fillore. Nga 10 pikat maksimale është realizuar rezultati mesatar prej 1,35 pikave, që është rezultati i dytë më i dobët i tërë testit dhe si i tillë tregon për nivelin shumë të ulët të njohjes së elementeve morfologjiko - sintaksore të gjuhës serbe.

Detyra e dhjetë ka valorizuar kuptimin e tekstit të shkruar. Është kërkuar nga nxënësit që të përgjigjen (në formë të fjalëve, sintagmës apo fjalisë) në pyetjet lidhur me tekstin. Teskti është shtypur në shkrim qirilik, por zgjedhja e shkrimit me të cilin do të shkruhet përgjigja ishte e lirë dhe nuk është marrë parasysh gjatë notimit. Janë pranuar të gjitha përgjigjet të cilat kanë treguar kuptimin pa marrë parasysh gabimet gramatikore dhe drejtshkrimore në përgjigje. Numri maksimal i pikave të cila i ka bartur kjo detyrë është 10, kurse mesatarisht janë realizuar 2,94 pika, që tregon për kuptimin e dobët të shprehjeve më të ndërlikuara – diskursit, edhepse pyetjet ishin sugjestive dhe udhëzonin drejt përgjigjes së kërkuar.

Pas analizës së rezultateve të detyrave individuale, detyrat janë grupuar sipas kompetencës të cilën e testojnë. Këto janë rezultatet e testit për klasën e VIII.

Tabela 5.4.8. – Pasqyra e rezultateve sipas kompetencave individuale të cilat i kanë realizuar nxënësit e klasës së VIII në shkollat në komunat e Bujanocit dhe Preshevës

Bujanoc dhe Preshevë – klasa VIII				
Kompetencat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati minimal i realizuar	Rezultati maksimal i realizuar	Rezultati mesatar në pika
Njohuria gramatikore	217	1	38/50	9,56
Fjalori	217	0	9/10	2,04
Shkrimi	217	0	26/30	10,76
Kuptimi i tekstit të dëgjuar	217	0	10/10	6,27
Kuptimi i tekstit të shkruar	217	0	10/10	2,94

Sikur edhe në klasën e katërt, kuptimi ka sjellë rezultatin më të mirë. Është i dukshëm një dallim i rëndësishëm mes rezultatit mesatar në kuptimin e tekstit të shkruar (2,94 nga 10) dhe në kuptimin e tekstit të dëgjuar (6,27 nga 10), që në masë të caktuar është e lidhur edhe me ndërlikueshmërinë e secilës detyrë, por gjithsesi, edhe me llojin e ndryshëm të njohurisë pasive me të cilën disponojnë nxënësit.

Në këtë test shkrimi është kontrolluar në dy detyra të ndara. Njëra ishte e lidhur me njohjen e shkrimit qirilik dhe aty rezultati është dukshëm më i mirë (7,51 nga 10) se sa në detyrën në të cilën kërkohej shkruarja e tekstit lidhur me temën e dhënë (3,25 nga 20). Në kontekstin e rezultateve të përgjithshme, kombinimi i këtyre dy rezultateve jep rezultat mesatar relativisht të mirë – 10,76 nga 30. Mirëpo, është e domosdoshme të theksohet se njohja e shkrimit aspak nuk do të thotë zotërim me kompetencën e shkrimit. Nxënësit e klasës së tetë zotërojnë mirë me kompetencën e shkrimit qirilik, që shpie deri te konkluzioni se shumë orë të gjuhës serbe u ishin dedikuar ushtrimit të shkrimit dhe/apo përshkrimit.

Rezultat i papritur i dobët (vetëm 2,04 nga 10) është vërejtur në njohjen e fjalorit, pasi që fjalët e kërkuara janë nga fondi leksikor i përditshëm (shtëpia, ushqimi, profesionet).

Pjesa më e rëndësishme e testit, e cila barte edhe numrin e përgjithshëm më të madh të pikave, ishte njohja e gramatikës, edhe atë jo njohuria gramatikore teorike, njohja e rregullave dhe përjashtimeve etj., por jashtëzakonisht aftësitë e përdorimit të gramatikës me qëllim të realizimit të komunikimit në gjuhën standarde serbe. Siç është thënë edhe më parë, roli i procesit mësimor në zotërimin e gramatikës është vendimtar. Rezultatet tregojnë se shkalla e zotërimit të gramatikës është jashtëzakonisht e ulët, madje

edhe kur është fjala për njësitë më të thjeshta gramatikore (për shembull, shprehja e kohës së tashme, të shkuar dhe të ardhme; tregimin e objektit direkt etj.). Gjithësej ishte e mundur të fitohen 50 pikë, por rezultati i realizuar maksimal është 38. Rezultati mesatar i njohjes së gramatikës në klasën e tetë është gjithsej 9,56.

Kompetenca e vlerësuar verbale

Pavarësisht rezultatit të përgjithshëm shumë të dobët, edhe në klasën e katërt edhe në klasën e tetë është dalluar një numër i caktuar i testeve me rezultat dukshëm më të mirë se mesatarja. Është fjala për gjithsej 33 nxënës, edhe atë 11 nxënës të klasës së katërt dhe 22 nxënës të klasë së tetë. Janë imponuar dy pyetje interesante lidhur me këto rezultate: e para, a posedojnë këta nxënës edhe kompetencë të duhur gojore, gjegjësisht a zotërojnë me gjuhën serbe në mënyrë aktive apo pasive; e dyta, ku dhe si e kanë mësuar këta nxënës gjuhën serbe, në cilat situata e kanë mundësinë që ta përdorin dhe të ushtrojnë.

Me nxënësit është biseduar një muaj pas testimit me shkrim, gjithashtu në hapësirat e shkollës dhe në praninë e arsimtarit, pedagogut apo drejtorit të shkollës.

Kompetencën gojore e cila është në pajtim me rezultatin e testit e kanë treguar 18 nxënës, gjashtë në klasën e katërt dhe 12 në klasën e tetë. Si burim kryesor të diturisë së tyre fëmijët kanë cekur shikimin e TV programeve në gjuhën serbe, kurse ajo që është shumë interesante, përgjigja më e shpeshtë ishte se shikojnë seriale turke me titra në gjuhën serbe dhe se në atë mënyrë, me ndihmën e prindërve apo ndonjë familjari tjetër, mësojnë gjuhën serbe. Numri më i madh i fëmijëve të cilët në këtë mënyrë i nënshtrohet gjuhës serbe ka edhe në shtëpi dikë që flet në gjuhën serbe dhe që mbështetë fëmijën në mësim (prindërit, gjyshet dhe gjyshërit). Në disa raste përgjigjet dalloheshin nga kjo tipike dhe me këtë rast do të ceken si raste plotësisht të izoluara, por ilustruese. Djaloshi nga Presheva e ka mësuar gjuhën serbe pasi që ka kaluar një kohë të gjatë për shërim në spitalin e Nishit; vajza nga Bilaci e ka mësuar duke folur me dadon e vëllaut të vogël, e cila e ka pasur gjuhën serbe gjuhë amtare; një djalosh nga Bujanoci ka theksuar se e ka mësuar gjuhën serbe duke u shoqëruar me bashkëlojtarët e tij në klubin futbollistik lokal; nxënësi nga Lluçani zotëronte mjaft mirë me gjuhën duke ndjekur emisionet shkencore në RTS, dhe pastaj njohurinë e gjuhës serbe ia ka bartur edhe shokut të tij më të mirë.

Aftësinë më të mirë të komunikimit gojor dhe bisedimin në gjuhën serbe, në të dy klasët, e kanë treguar nxënësit e shkollave „Sami Frashëri“ dhe „Muharrem Kadriu“.

Analiza e rezultateve të testit në komunën e Medvegjës

Duke pasur parasysh se Presheva dhe Bujanoci janë komuna kryesisht me popullsi shqiptare dhe se kontaktet dhe ndikimet ndërgjuhësore janë relativisht të dobëta,[89] rezultatet e testimit të fituara në komunën e Medvegjës, në të cilën është e përfaqësuar kryesisht popullsia serbe, jane ndarë nga rezultatet e fituara në dy komunat paraprake. Është supozuar se në këtë komunë duhet të jenë rezultatet më të mira të testimit si pasojë e nënshtrimit më të madh gjuhës serbe dhe në përgjithësi kontakteve ndëretnike.

Janë testuar gjithsej 13 nxënës në tri shkolla. Rezultati minimal prej 12 pikave dhe ai maksimal prej 81, si dhe vlera mesatare e realizuar prej 51,31 pikave mund të tregojnë për rezultate më të mira në krahasim me komunat e Preshevës dhe Bujanocit. Në bazë të vlerave të rezultatit mesatar mund të thuhet se nxënësit e testuar, në përgjithësi, posedojnë kompetencë gjuhësore themelore të paraparë për nivelin e nxënësve të klasës së IV dhe VIII. Edhepse nxënësit e klasës së IV në shikim të parë kanë realizuar rezultat më të mirë, ai sidoqoftë nuk është në aspektin statistikor më i madh se rezultatet e nxënësve të klasës së VIII.

Tabela 5.4.9. – Pasqyra përmbledhëse e testeve për komunën e Medvegjës

Medvegja – klasa IV dhe VIII				
Klasa	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati i realizuar minimal	Rezultati i realizuar maksimal	Rezultati mesatar në pika
Klasa e tetë	10	12	77	50,30
Klasa e katërt	3	29	81	54,67
Rezultati i përgjithshëm i testit	13	12	81	51,31

Sidoqoftë, rezultatet e fituara në këtë shembull të vogël nuk mund të jenë relevante për marrjen e konkluzioneve valide, por na shërbejnë si udhëzues për drejtimin të cilin duhet marrur në hulumtimet e mëtejshme.

89 Kjo ka të bëjë sidomos me Preshevën, ku është dominante popullsia shqiptare, kurse Bujanoci është komunë multietnike, të cilën e përbëjnë bashkësitë shqiptare, rome dhe serbe.

Analiza e rezultatit të testeve për klasën e IV në komunën e Medvegjës

SDuke pasur parasysh numrin relativisht të vogël të nxënësve të testuar, menduam se nuk është e nevojshme që të analizohen rezultatet sipas detyrave, por analiza e testit është bërë sipas rezultateve të kompetencave gjuhësore.

Tabela 5.4.10. – Pasqyra e rezultateve sipas kompetencave individuale të cilat i kanë realizuar nxënësit e klasës IV në shkollat në komunën e Medvegjës

Medvegja – Klasa IV				
Kompetencat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati minimal i realizuar	Rezultati maksimal i realizuar	Rezultati mesatar në pika
Njohuria gramatikore	3	26	41/50	33,00
Fjalori	3	5	14/15	10,67
Shkrimi	3	0	16/25	5,33
Kuptimi i tekstit të dëgjuar	3	4	5/5	4,33
Kuptimi i tekstit të shkruar	3	5	5/5	5,00

Duke marrë parasysh se një numër shumë i vogël i nxënësve e ka plotësuar testin në Medvegjë, nuk mund të formulojmë asnjë konkluzion relevant. Tre nxënës të testuar kanë treguar rezultatet më të mira në kuptimin e tekstit të shkruar, ku të tri nxënësit kanë numrin maksimal të pikave. Rezultati paksa më i dobët është në kuptimin e tekstit të dëgjuar. Pasojnë rezultatet e njohurisë gramatikore – 33 nga 50, dhe njohja e fjalorit – 10,67 nga 15. Rezultati më i dobët është shënuar në kompetencën e cila vlerëson shkrimin – 5,33 nga 25.

Analiza e rezultatit të testeve për klasën e VIII në komunën e Medvegjës

Rezultatet tek nxënësit e klasës së VIII janë më të njëjta dhe mesatarisht më të mira se sa në dy komunat paraprake. Kompetenca e vetme rezultati i së cilës është më i dobët se sa në Bujanoc dhe Preshevë është kuptimi i tekstit të dëgjuar. Sidoqoftë, për shkak të numrit shumë të vogël, nuk mund të marrim konkluzione të sigurta për asnjë kompetencë të testuar.

Tabela 5.4.11. – Pasqyra e rezultateve sipas kompetencave individuale të cilat i kanë realizuar nxënësit e klasës së VIII në shkollat në komunën e Medvegjës

Medvegja – klasa VIII				
Kompetencat	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati minimal i realizuar	Rezultati maksimal i realizuar	Rezultati mesatar në pika
Njohuria gramatikore	10	1	34/50	18,00
Fjalori	10	0	8/10	4,00
Shkrimi	10	0	25/30	16,60
Kuptimi i tekstit të dëgjuar	10	2	8/10	5,20
Kuptimi i tekstit të shkruar	10	0	10/10	6,40

Kuptimi i tekstit të shkruar dhe të dëgjuar janë përsëri anët më të fuqishme të kompetencës gjuhësore, pasi që rezultati mesatar i kuptimit të tekstit të dëgjuar është i vetmi i cili në aspektin statistikor nuk është dukshëm më i mirë se rezultatet në Bujanoc dhe Preshevë. Kjo është e papritur dukë marrë parasysh praninë dominuese të gjuhës serbe në mjediset siç është Medvegja.

Dallimi më i rëndësishëm në krahasim me Bujanocin dhe Preshevën pasqyrohet në kompetencën me të cilën kontrollohet shkruarja e përmbajtjes: vlerat mesatare në Medvegjë janë 7,90, që është rezultat dukshëm më i mirë në krahasim me vlerën mesatare të detyrës së njëjtë në Bujanoc dhe Preshevë (3,25). Rezultatet të cilat tregojnë njohjen e shkrimit qirilik janë të ngjashme me rezultatet në dy komunat tjera – në Medvegjë mesatarja e këtyre rezultateve është 8,70.

Edhe fjalori edhe njohuria gramatikore në Medvegjë janë më të mirë, rezultati i tyre i përgjithshëm mesatar është gati dyfish më i mirë se në Bujanoc dhe Preshevë. Natyrisht, as këtu nuk duhet harruar se numri i të testuarve në Medvegjë është i vogël dhe se të gjitha këto konkluzione duhet të shikohen me rezervë të caktuar.

Sidoqoftë, pavarësisht dallimit të dukshëm, duhet thënë se edhe rezultatet në Medvegjë në klasën e tetë janë shumë larg nga të kënaqshmet.

III.5.5. Konkluzioni

Duke shikuar rezultatet e përgjithshme nëpër komuna, mund të konkludohet se rezultatet më të mira janë arritur në komunën e Medvegjës, në të cilën anëtarët e bashkësisë shqiptare më së shumti i nënshtrohen ndikimit të gjuhës serbe. Vetëm në këtë komunë janë arritur vlerat të cilat tregojnë se nxënësit mund të zotërojnë me gjuhën në nivelin e përdorimit të saj funksional.

Rezultatet më të dobëta janë arritur në komunën e Preshevës – 23,55 nga 100, ku është njëherit edhe dallimi më i madh mes rezultateve të realizuara minimale dhe maksimale; paksa rezultat më i mirë është arritur në komunën e Bujanocit, por në asnjërën nga këto dy komuna nuk është arritur rezultati mesatar i cili do të tregonte njohjen e kënaqshme të gjuhës serbe.

Rezultat dukshëm më të dobët kanë realizuar nxënësit e klasës së IV në komunën e Preshevës, ku rezultati i realizuar maksimal mezi kalon vlerën minimale të duhur për vlerësimin mbi zotërimin e kënaqshëm të gjuhës tek nxënësit e kësaj moshe.

Tabela 5.5.1. – Pasqyra përmbledhëse e rezultateve të testeve për nxënësit e të gjitha klasëve nga tri komunat

GJITHSEJ				
Komuna	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati i realizuar minimal	Rezultati i realizuar maksimal	Rezultati mesatar në pika
Bujanoc	198	1	83	30,91
Preshevë	222	3	71	23,55
Medvegjë	13	12	81	51,31

Tabela 5.5.2. – Pasqyra e përmbledhjes së rezultateve të testeve për nxënësit e klasës së IV nga tri komunat

KLASA IV				
Komuna	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati i realizuar minimal	Rezultati i realizuar maksimal	Rezultati mesatar në pika
Bujanoc	91	1	75	25,49
Preshevë	112	3	57	19,48
Medvegjë	3	29	81	54,67

Tabela 5.5.3. – Pasqyra e përmbledhjes së rezultateve të testeve për nxënësit e klasës VIII nga tri komunat

KLASA VIII				
Komuna	Numri i përgjithshëm i testeve	Rezultati i realizuar minimal	Rezultati i realizuar maksimal	Rezultati mesatar në pika
Bujanoc	107	5	83	35,52
Preshevë	110	3	71	27,70
Medvegjë	10	12	77	50,30

Në bazë të rezultateve të fituara me testimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare tek nxënësit e klasës IV dhe VIII të shkollës fillore në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës – konkludojmë në vijim:

- Nxënësit në masë të madhe nuk posedojnë njohurinë funksionale të gjuhës serbe në atë masë që të mund të realizojnë komunikim në atë gjuhë, me shkrim apo me gojë, dhe as nuk janë në gjendje që të kuptojnë bashkëbiseduesin;
- Njohuria pasive e gjuhës pasqyrohet në njohjen relativisht të mirë të të dyja shkrimeve serbe dhe mundësisë së transkriptit të njënashëm (nga shkrimi latin në atë qirilik);
- Njohja e pamjaftueshme e fjalorit të gjuhës serbe pamundëson komunikimin dhe kumtimin e informacioneve pa marrë parasysh a janë në formë të shkruar apo në të folur;
- Komunikimi i suksesëshëm verbal është vërejtur vetëm tek një numër i vogël i nxënësve dhe kryesisht nuk është fituar në sistemin mësimor;
- Njohuria gramatikore është në nivel shumë të ulët dhe tek nxënësit e klasës së IV është pothuajse e panjohur;
- Mundësia e interpretimit të lirë të gjuhës (në mënyrë të shkruar) është e pamundësuar me mosnjohjen e përgjithshme të gjuhës;
- Është vërejtur lidhja mes strukturës demografike dhe rezultateve të testimit – sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e popullsisë në komunë të cilët e kanë gjuhën serbe gjuhë amtare, edhe rezultati i testimit është më i mirë.

IV. QËNDRIMET, MENDIMET DHE NEVOJAT E PALËVE TË INTERESUARA NË LIDHJE ME MËSIMIN E GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE

IV. QËNDRIMET, MENDIMET DHE NEVOJAT E PALËVE TË INTERESUARA NË LIDHJE ME MËSIMIN E GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE

Në këtë kapitull janë paraqitur qëndrimet, mendimet dhe nevojat e palëve të interesuara në lidhje me mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Duke pasur parasysh se vlerësimi i qëndrimeve rreth mësimit të gjuhës është shumë i rëndësishëm për çfarëdo përpjekje të avancimit të procesit mësimor, sidomos për vlerësimin e mundësisë së avancimit sistematik, ekipi hulumtues është munduar të përfshijë përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesuara – deputetin popullor nga komuniteti shqiptarë në Kuvendin e Republikës së Serbisë Shaip Kamberin, kryetarin e Komunës së Preshevës Ragmi Mustafën, kryetarin e Komunës së Bujanocit Nagip Arifin, kryetarin e Komunës së Medvegjës Sllobodan Drashkoviq, kryetarin e Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare[90] Galip Beqirin, këshilltarin arsimor nga Administrata shkollore në Leskoc Belul Nasufin, drejtorët dhe drejtoreshat e 16 shkollave fillore në tri komuna në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, nxënësit dhe nxënëset e këtyre shkollave dhe prindërit e tyre, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe mediat dhe përfaqësuesit e organeve shtetërore, administratës komunale, sektorit afarist dhe të punësuarit.

IV.1. QËNDRIMET E DEPUTETIT POPULLOR NGA KOMUNITETI SHQIPTAR, KRYETARIT TË KOMUNËS SË PRESHEVËS, BUJANOCIT DHE MEDVEGJËS DHE KRYETARIT TË KNPNSH

Natasha Boshkoviq

Deputeti popullor dhe kryetarët e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë si dhe kryetari i Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare (KNPNSH) – janë dakord në pikëpamje të vlerësimit të përgjithshëm të cilësisë së arsimit fillorë në ato komuna. Ata theksojnë se në përgjithësi janë të kënaqur me cilësinë e arsimimit fillorë dhe se situata aktuale është shumë më e mirë sesa ishte deri para disa viteve. Ekziston një pajtim se janë arritur mjaft rezultate në krahasim me periudhën e kaluar, para së gjithash kur flitet për përmirësimin e infrastrukturës. Problemet, megjithatë, janë ende të pranishme, posaçërisht kur bëhet fjalë për mungesën e kuadrit të kualifikuar arsimor dhe për mjetet moderne mësimore.

90

Sa i përket vështirësive në institucionet e shkollave fillore në tri komuna, janë identifikuar problemet në vijim: mungesa e kuadrit arsimor me kualifikime përkatëse profesionale, mungesa e teksteve shkollore për mësim në gjuhën shqipe, mungesa e pajisjeve teknike dhe mjeteve moderne mësimore në hapësirat shkollore, si dhe numri i pamjaftueshëm i seminareve dhe trajnimeve për përvetësimin e kuadrit ekzistues. Përmirësime gjithsesi ka: kështu, për shembull, në shumicën e rasteve në bashkëpunim me administratën lokale është zgjidhur çështja e transportit të nxënësve dhe personelit shkollor, dhe problemet e caktuara, posaçërisht kur bëhet fjalë për infrastrukturën, pjesërisht janë zgjidhur falë përpjekjeve të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare. Problemi i cili paraqitet në të tri komunat është zvogëlimi progresiv i numrit të nxënësve në shkolla dhe, në këtë aspekt, ekzistimi i numrit shumë të vogël të klasave dhe kushteve të këqija të punës, posaçërisht në shkollat në zonat rurale.

Vështirësi e rëndësishme me të cilën ballafaqohen shkollat fillore në të tri komunat është edhe mungesa e personelit të kualifikuar profesional. Shaip Kamberi, deputet popullor në Kuvendin e Republikës së Serbisë, në veçanti thekson se në arsim shpeshherë përfshihet kuadër mësimor jokompetent, dhe se njëkohësisht nuk ekzistojnë trajnime të mjaftueshme në dispozicion në nivel regjional dhe qendrorë, me të cilat, ndër të tjera, do të ndikohej në tejkalimin e këtij problemi. Duke vlerësuar se cilësia është e lidhur ngushtë me mungesën e teksteve mësimore në gjuhën shqipe, ai thotë se shpeshherë ndodhë që për këtë arsye mësimdhënia kryhet me përdorimin e materialeve joadekuate mësimore. Edhe pse përfaqësuesit e administratave lokale cilësinë e mësimdhënies e vlerësojnë si të kënaqshme, vërejtjet dhe problemet kryesore kanë të bëjnë me çështjen se në shumë raste arsimtarët nuk vijnë nga mjedisi lokal, gjegjësisht nga tri komunat e përmendura, dhe se për këtë arsye nuk janë të motivuar sa duhet dhe më pak i përkushtohen mësimit. Sipas kryetarit të Komunës së Bujanocit „arsimtarët duhet vlerësuar sipas suksesit të nxënësve të tyre“, dhe përveç kësaj duhet gjetur „mënyrën që të stimulohen arsimtarët të cilët arrijnë rezultate të mira“. Kryetari i KNPNSH vlerëson se „arsimtarët janë gjithnjë e më pak të angazhuar dhe motivuar për mësim“, si dhe që „shkollat nuk shënojnë suksese të mira sikurse në garat e mëhershme“. Kryetari i Komunës së Preshevës pohon se cilësia e mësimdhënies pëson „për shkak se në mësimdhënie përfshihet kuadër joadekuat arsimor“.

Problemet janë të pranishme edhe kur bëhet fjalë për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, kurse më të rëndësishmet kanë të bëjnë me mungesën e kuadrit profesional, gjë që ka të bëjë me mungesën e përgatitjes profesionale, por edhe me faktin se arsimtarët shpeshherë nuk flasin gjuhën amtare të nxënësve të tyre. Përveç kësaj, vërehet edhe interesim i dobët në mesin e arsimtarëve që të përtërijnë qasjen e punës me fëmijë. Në anën tjetër, kryetari i Komunës së Preshevës konsideron se „fëmijët që nga klasa e parë janë të ngarkuar me numër të madh të lëndëve“, gjë që në kombinim me kuadrin joadekuat rezulton me cilësi të dobët të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Sipas fjalëve të tij, edhe një vështirësi

ka të bëjë me çështjen se administratat lokale janë të ngarkuara me shpenzimet e larta të udhëtimit të arsimtarëve, të cilët kryesisht vijnë nga Vranja apo Vlladiçin Hani, ku edhe jetojnë, kurse mësimin e zhvillojnë në shkollat në territorin e Komunës së Preshevës. Për sa i përket cilësisë së mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare tjetër qëndrim ka Slobodan Drašković, kryetar i Komunës së Medvegjës, i cili konsideron se cilësia e mësimdhënies në shkollat fillore në territorin e kësaj komune është e kënaqshme, gjë që reflektohet në faktin se fëmijët e atjeshëm kanë nota të mira në atë lëndë.

Sipas dijenisë së tre kryetarëve të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe kryetarit të KNPNSH-së, prindërit konsiderojnë se është e nevojshme që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën serbe. Sipas pohimeve të deputetit popullor Shaip Kamberi, edhe pse bëhen përpjekje të mëdha në pikëpamje të tejkalimit të distancës etnike, prapëseprapë të rinjtë sot kryesisht nuk përcjellin programe televizive dhe përmbajtje tjera mediatike në gjuhën serbe, dhe përveç kësaj gati se fare nuk kanë kontakt me bashkëmoshatarët e tyre nga komunitetet tjera. Ai gjithashtu thotë se këtë gjithashtu e dinë edhe prindërit, të cilët janë të vetëdijshëm për faktin se e ardhmja e fëmijëve të tyre është në mjediset ku kanë lindur dhe se për këtë arsye është e rëndësishme që të flasin gjuhën serbe mjaft mirë. Prindërit konsiderojnë se është e rëndësishme që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën serbe për shkak të punësimit, edukimit dhe kryesisht për shkak të komunikimit, edhe pse, sipas fjalëve të kryetarit të Komunës së Bujanocit „një numër i vogël i përfaqësuesve të pakicës shqiptare janë të përfshirë në punën e organeve shtetërore dhe se ata kryesisht nuk kanë përvojë të përfshirjes në organe të administratës shtetërore“, gjë që i kontribuon ngritjes së vetëdijes mbi domosdoshmërinë e mësimit të gjuhës serbe.

Qëndrimet e deputetit popullor dhe përfaqësuesve të pushteteve lokale janë pozitive kur bëhet fjalë për nevojën e njohjes së mirë të gjuhës serbe, edhe atë jo vetëm të gjuhës serbe por edhe të gjuhëve huaja, në pajtim me thënien „njeriu vlen aq sa gjuhë dinë“. Njohja e gjuhës serbe është, sipas fjalëve të kryetarit të Komunës së Bujanocit „e nevojshme për realizimin e komunikimit në mjedis multietnik“, përderisa kryetari i Komunës së Preshevës nevojën e njohjes së gjuhës serbe e sheh në funksion të „punësimit, edukimit të mëtejshëm dhe mundësisë së punës në organet shtetërore“. Kryetari i KNPNSH konsideron se është shumë me rëndësi që fëmijët të dinë gjuhën serbe për arsye se ajo është „ gjuhë zyrtare e shtetit në të cilin jetojnë dhe për arsye se është i nevojshëm për komunikim dhe bashkëjetesë“ dhe shton se „është shumë me rëndësi që edhe serbët të mësojnë gjuhën shqipe“. Qëndrimi i kryetarit të KNPNSH-së është se kontributi më adekuat në procesin e integrimit do të ishte njohja e të dyja gjuhëve, gjegjësisht „zhvillimi i dygjuhësisë, e cila do të ishte e rëndësishme për arsimim dhe punësim“. Kryetari i Komunës së Bujanocit megjithatë konsideron se njohja e gjuhës serbe do t’i mundësonte të rinjve avancim dhe zhvillim profesional personal. Përveç kësaj, ai konsideron se njohja e të gjitha gjuhëve të huaja është shumë e dobishme, por që „për gjuhën serbe shteti duhet të përpiqet më shumë“. Të gjithë bashkëbiseduesit pajtohen se

njohja e gjuhës është e rëndësishme për arsimimin e mëtejshëm dhe për punësim, posaçërisht në institucionet shtetërore, si dhe për komunikimin e përditshëm dhe bashkëjetesë në mjedis të përzier etnik.

Deputeti popullor, kryetarët e tri komunave dhe kryetari i KMPNSH konsiderojnë se është i nevojshëm intervenimi në sistemin arsimor dhe theksojnë se do të kishin mbështetur iniciativën që nxënësit në shkollat fillore të ndjekin mësimin e avancuar dhe të përtërirë të gjuhës serbe, por theksojnë se është e rëndësishme që intervenimi i tillë duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i përhershëm. Sipas fjalëve të deputetit popullor Shaip Kamberi, ekziston nevoja për promovimin e materialeve alternative dhe materialeve plotësuese mësimore dhe për projektimin e avancimeve sistematike në kuadër të sistemit ekzistues arsimor me mbështetje dhe bashkëpunim të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik. Gjithsesi, ekziston edhe pajtimi i të gjithë bashkëbiseduesve lidhur me nevojën e modernizimit të përgjithshëm të mësimdhënies, gjë që përfshinë zbatimin e metodave moderne në mësim, si dhe materialet didaktike për mësimin e gjuhës, të tilla sikurse materialet digjitale, të cilat gjithnjë e më shumë po përdoren në gjithë botën.

Në të tri komunat ekziston vullneti i mirë dhe mbështetja për inicimin e iniciativës me qëllim që nxënësit e shkollave të ndryshme të fitojnë mundësinë që të shoqërohen dhe ndjekin dhe vizitojnë aktivitetet e përbashkëta. Për momentin ekzistojnë garat shkollore në njohuri dhe gara sportive, të cilat organizohen me mbështetje të komunave. Në Medvegjë, përveç kësaj, ekzistojnë edhe manifestime tjera, kurse punohet në drejtim të krijimit të kushteve që fëmijët të ballafaqohen dhe shoqërohen në kuadër të turneve sportive, takimeve të 1 Majit, kurse gjatë periudhës verore në manifestimet „Ditët e banjës“ dhe „Netët e gejzerit“. Në të tri komunat ekziston interesimi dhe mbështetja që për nxënësit të cilët nuk flasin gjuhë të njëjtë dhe vijnë nga shkollat e ndryshme – të organizohen aktivitete me të cilat do të nxitej edhe mësimi i gjuhës dhe shoqërimi. Disa nga aktivitetet e propozuara janë gara në njohuri, shëtitjet, ekskursionet dhe evenimentet dhe manifestimet tjera në fushën e kulturës, shkencës, sportit dhe rekreacionit.

Të gjithë bashkëbiseduesit vlerësuan se gjeneratat e vjetra shërbehen mirë dhe komunikojnë në gjuhën serbe, përderisa nuk është ashtu me gjeneratat më të reja, njohja e të cilëve në shumicën e rasteve është në nivel tejet të ulët. Kryetari i Komunës së Bujanocit arsyet i sheh në faktin se në kohën e shkollimit të gjeneratave më të vjetra „ka ekzistuar kuadër më i mirë arsimor“, si dhe në faktin se asokohe programi televiziv ishte pothuajse ekskluzivisht në gjuhën serbe. Deputeti popullor Shaip Kamberi, konsideron se është „domosdoshme që të arrihet një nivel më i lartë i integrimit shoqëror, posaçërisht në kontekst të integrimeve evropiane“. Ai shton se sot të rinjtë e fshatrave nga komuniteti shqipëtar në jug të Serbisë gjenden në situatë tejet të pafavorshme dhe se nuk kanë shumë kontakt me bashkëmoshatarët nga komuniteti serb dhe romë. Kryetari i Komunës së Preshevës konsideron se arsyeja qëndron në faktin se

„në atë kohë kishte më shumë serbë që jetonin në atë mjedis, dhe se komunikimi ishte më i pranishëm, kurse mësimi dhe njohja e gjuhës ishte e dyanshme“. Kryetari i KNPNSH shpreh mendimin se gjenerata më të vjetra njohin më mirë gjuhën serbe „sepse dikur, gjuha shqipe është mësuar në shkolla sikur lëndë, gjegjësisht, sikur lëndë e mjedisit shoqëror“, si dhe që „ideja e Jugosllavisë dhe shtetit të përbashkët ishte e fortë“. Gjeneratat më të reja sot kryesisht shikojnë televizionin satelitor, para së gjithash kanale të shumëta në gjuhën shqipe, shkojnë në shkollë në të cilën mësimi realizohet në gjuhë shqipe, dhe në shumë vende, posaçërisht në territorin e Komunës së Preshevës, jetojnë në mjedis ku gati se aspak nuk kanë mundësi që të jenë në kontakt me bashkëmoshatarët të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare. Përveç kësaj, njohja e dobët e gjuhës serbe paraqet njërën nga pasojat e konfliktit të vitit 1999–2001, si dhe situatës politike e cila është karakterizuar me tensione dhe e cila sipas fjalëve të kryetarit të Komunës së Bujanocit i ka kontribuar „distancimit, dallimeve dhe mungesës së besimit“. Kryetari i KNPNSH thekson edhe se „gjatë periudhës së caktuar është propaganduar që të mos mësohet gjuha serbe“, dhe më pas ky qëndrim është zëvendësuar me „mosinteresim“.

Sot, tema e mësimit të gjuhës serbe shikohet nga këndvështrimi i perspektivës e cila merr parasysh nevojën e njohur që njohja e gjuhës serbe të avancohet me qëllim të krijimit të komunikimit më të mirë dhe bashkëjetesës më të begatshme në mjedis multietnik, si dhe në kontekst të procesit të gjerë integrues, posaçërisht në fushën e arsimimit, punës dhe punësimit. Deputeti popullor, kryetarët e tri komunave dhe kryetari i KNPNSH konsiderojnë se ekzistojnë mundësitë për avancimin e njohjes së gjuhës serbe në sistemin ekzistues arsimor, duke filluar nga shkolla fillore. Propozimet e tyre për avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare janë të përqendruara rreth nevojës për trajnimin cilësor të kuadrit ekzistues arsimor dhe në shkollimin e kuadrit të ri arsimor, sikur për shkollat fillore ashtu edhe për të mesmet. Është vlerësuar se si prioritetet në atë proces duhet të përfshijnë trajnimin cilësor dhe të vazhdueshëm të kuadrit arsimor sikur në komunitetin shqipëtar ashtu edhe në atë serb, si dhe modernizimi i mësimit dhe mjeteve mësimore. Në këtë drejtim, kryetari i Komunës së Preshevës thekson se ekziston nevoja që një numër më i madh i universiteteve të themelojë katedra të duhura për arsimimin e kuadrit profesional për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, dhe se është e nevojshme që të gjithë arsimtarët të arrijnë njohuri teknike- informatike në mënyrë që të munden të përmbushin nevojat e trendeve moderne në arsim. Deputeti popullor Shaip Kamberi përfundon për zhvillimin e bashkëjetesës dhe dhënies së kontributit në procesin e integrimit shtetëror, si dhe për realizimin e të drejtave të pakicave, posaçërisht përmes pjesëmarrjes në institucione, është e domosdoshme që të punohet sistematikisht në avancimin e njohjes së gjuhës serbe në mesin e pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës nacionale shqiptare.

IV.2. MENDIMI I KËSHILLTARIT ARSIMOR NGA ADMINISTRATA SHKOLLORE NË LESKOC

Natasha Boshkoviq

Këshilltari arsimor nga administrata shkollore e Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik i cili është përgjegjës për mësimin në komunat e Rrethit të Pçinjës dhe Jabllanicës cilësinë e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe – e vlerëson si të kënaqshëm. Ai, në bazë të vlerësimit të jashtëm të shkollave të kryera në vitin shkollor 2012¬/13. dhe 2013/14., gjatë të cilit janë vizituar katër shkolla edhe atë: SHF „Abdulla Krashnica“ në Miratoc, SHF „Migjeni“ në Cerevajkë, SHF „Naim Frashëri“ në Bujanoc dhe SHF „Sijarinska Banja“ në banjën e Sijarinës, ka shprehur mendimin se „në orët e vizituara është realizuar numër më i madh i standardeve të cilësisë së punës nga fusha e mësimit dhe të edukimit, gjë që gjithsesi shkon në favor të faktit se mësimi i gjuhës serbe si gjuhë joamtare, po realizohet me cilësi. Në mësimdhënien klasore, arsimtarët të cilët kanë kaluar Metodikën e gjuhës serbe, kanë mësim më të mirë dhe më cilësorë dhe nxënësit njohin më mirë gjuhën serbe si gjuhë joamtare. Duhet theksuar se është vizituar një numër i vogël i shkollave dhe se vetëm në bazë të këtyre vizitave nuk mundet me siguri të madhe të pretendohet se mësimi nga kjo lëndë është në cilësi të plotë“.

Kur është fjala për kuadrin arsimorr dhe kualifikimet e përshkruara, këshilltari arsimor thekson se „është vërejtur se arsimtarët të cilët nuk janë profesional nuk japin rezultate të kënaqshme në mësimin e gjuhës dhe se nxënësit nuk zotojnë me gjuhën serbe si gjuhë joamtare“, dhe se „mund të konstatohet se është e rëndësishme që arsimtarët të aftësohen“ që të mund të thuhet se kuadri arsimorr i cili punon në shkolla është i kënaqshëm.

Në bazë të shënimeve nga vlerësimi i jashtëm dhe orëve të vizituara në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, këshilltari arsimor thotë se „arsimtarët gjatë punës kryesisht përdorin metoda tradicionale të punës, ndërsa sa i përket formave së punës, ato janë të llojllojshme, me ç’rast inkurajohet ndërveprimi midis nxënësve“.

Sipas mendimit të këshilltarit arsimor „duhet përmirësuar cilësia e teksteve mësimore, duhet përvetësuar kuadrin arsimor në mënyrë që në masë të madhe të jetë i kualifikuar. Përveç kësaj, duhet mundësuar arsimtarëve riaftësimin e vazhdueshëm profesional nga fusha e teknikës së mësimit dhe përdorimit

të mjeteve moderne të mësimdhënies. Posaçërisht duhet theksuar se mësimi i bashkëmoshatarëve nuk është shfrytëzuar në masë të mjaftueshme në punë“. Këshilltari arsimor shton se „trajnimet të cilat janë të dedikuara vetëm për arsimtarët të cilët japin gjuhë joamtare nuk janë realizuar“, duke theksuar se këtë vërejtje e thekson në bazë të intervistës me arsimtarët dhe këshilltarin për aftësim profesional.

Këshilltari arsimor konfirmon se në mësimdhënie përdoren tekstet e vjetra dhe të reja mësimore: „Ajo që duhet theksuar është se tek tekstet e reja mësimore ekziston një mospërputhje sepse në fund të tekstit në vend të fjalorit në gjuhën serbe/shqipe është dhënë fjalori në gjuhën serbe/hungareze. Gjatë bisedës arsimtarët kanë theksuar edhe një fakt shumë të rëndësishëm, i cili është se tekstet mësimore nuk janë gjithmonë në përputhje me moshën e nxënësve (tekste dhe vjersha shumë të gjata).“

IV.3. QËNDRIMET E DREJTORËVE DHE DREJTORESHAVE NË 16 SHKOLLAT FILLORE NË TË CILAT MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN SHQIPE

Ivana Stanojev

Gjatë studimit në terren i cili është realizuar në mars dhe prill të vitit 2014, studiuesit kanë biseduar edhe me drejtorë të shkollave fillore në të cilat mësimdhënia zhvillohet në gjuhën shqipe, në territorin e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Qëllimi i bisedës ishte që të konstatohet gjendja aktuale dhe të fitohen njohuri në lidhje me vështirësitë eventuale gjatë zhvillimit të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare (disponueshmëria dhe profesionalizmi i kuadrit, metodat të cilat përdoren në mësimdhënie, përmbledhja e burimeve të nevojshme dhe ekzistuese, mbështetja e institucioneve relevante dhe organizatave për trajnime profesionale). Biseda përfshinte gjithashtu edhe pyetjet mbi perspektivat e organizimit të mësimdhënies në tjetër mënyrë, në mënyrë ndërvepruese dhe gatishmërinë e administratës së shkollës që mësimdhënia të modernizohet me përdorimin e metodave moderne. Grumbullimi i të dhënave ka kaluar në një atmosferë të besimit dhe çiltërsisë së drejtorëve për bashkëpunim. Drejtorët kanë siguruar të gjitha të dhënat e nevojshme të cilat ishin relevante për studimin.

Pyetja e parë në pyetësor çon në qëndrimet e drejtorëve mbi kënaqshmërinë me mënyrën në të cilën në shkolla mësohet gjuha serbe si gjuhë joamtare. Edhe pse në shumicën e rasteve u përgjigjen se kryesisht janë të kënaqur, pyetjet të cilat pasuan më pas japin një pasqyrë më reale dhe sqarimin e problemit në zhvillimin e mësimit. Disa drejtorë konsiderojnë se fëmijët në klasat e ulëta janë të ngarkuar me njësitë mësimore, dhe se tekstet mësimore në klasat e larta nuk iu janë përshtatur në mënyrë kulturore fëmijëve

nga komuniteti shqiptarë dhe pozita gjeografike, dhe përgjigje e shpeshtë është se nuk ka kuadër cilësor. Drejtorët e shkollave vënë në dukje se kualifikimi profesional i kuadrit mësimor i cili jep gjuhë serbe si gjuhë joamtare në masë të madhe nuk është i kënaqshëm dhe se kuadri i trajnuar nuk është në dispozicion në të gjitha komunat. Në shumicën e shkollave drejtorët për zhvillim të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare kanë angazhuar arsimtar të cilët kanë nivel më të ulët të kualifikimit profesional nga ai i përshkruar. Shpeshherë ndodhë që këtë lëndë ta mbajnë arsimtarët e mësimit klasor (niveli i VI i kualifikimit profesional), më rrallë janë ata arsimtarët me shkallë të VII të cilët sipas profesionit janë pedagog, ekonomist, albanolog, dhe ngjashëm, dhe të cilët kanë kaluar provimin nga gjuha serbe. Si arsye më e shpeshtë për angazhimin e arsimtarëve me nivel më të ulët të kualifikimit profesional nga ai i përshkruar theksohet mungesa e kuadrit profesional, dhe shpeshherë theksohet se me rastin e shpalljes së konkursit përparësi kanë arsimtarët e mësimit klasor me shkallë të VI, të cilët janë tepricë teknologjike.[91] Drejtorët theksojnë se në konkurse shpeshherë nuk paraqiten kuadro me përgatitje të duhur profesionale, dhe si një nga arsyet, sipas fjalëve të tyre, mund të jetë distanca e shkollave apo transporti i keq-organizuar. Të gjithë drejtorët janë dakord se problemi më i madh është se nuk investohet në shkollimin e kuadrove për këtë lëndë.

Njohja e dobët e gjuhës gjithsesi mund të jetë pasojë e përdorimit të metodave të vjetërsuara të mësimdhënies. Sipas pohimeve të drejtorëve, kuadri ekzistues shumë rrallë përdor metoda të reja në zhvillimin e mësimdhënies. Ata theksojnë se arsimtarët shpeshherë përdorin metoda standarde (*ex cathedra*) në punë me nxënësit, duke i kombinuar nganjëherë me metodën e dialogut dhe monologut. Vetëm disa drejtorë janë përgjigjur se arsimtarët gjatë mësimdhënies përdorin ilustrime, punë në ekip dhe metodë demonstruese. Edhe pse shumica e shkollave kanë kabinete të informatikës, ato pothuajse nuk përdoren fare për organizimin e orëve në gjuhë serbe. Përveç kësaj, pothuajse të gjitha shkollat kanë qasje në internet, por ai më së shpeshti përdoret për punë administrative dhe shumë rrallë për përgatitjen e mësimit të gjuhës serbe. Gjithashtu, edhe pse gjysma e shkollave kanë mundësinë e dëgjimit të audio-inçizimeve, ata shumë rrallë përdoren gjatë orëve të gjuhës serbe. Drejtorët kanë propozuar të organizohet trajnim për përdorimin e kompjuterit dhe internetit për arsimtarët, në mënyrë që të inkurajohen që të përdorin metodat moderne dhe materialet ndërvepruese të cilat mund të gjenden në faqe të ndryshme të internetit.

Të gjithë drejtorët me të cilët është biseduar konsiderojnë se është e nevojshme të investohet në trajnimin e kuadrit arsimtar ekzistues i cili ligjëron gjuhën serbe si gjuhë joamtare. Në fakt, shumica e shkollave rrallë (deri një herë në vit) dërgojnë arsimtarët në trajnime të cilat i organizon Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik. Zakonisht bëhet fjalë për trajnimet në Vranjë dhe Leskoc, sepse shkollat nuk

91 Sipas dispozitave të Kontratës së posaçme kolektive për të punësuarit në shkollat fillore dhe të mesme dhe në konvikte, *Fl.zyrtare RS* nr. 12/2009.

kanë mjete të mbulojnë shpenzimet e ndjekjes së trajnimeve të cilat organizohen në Beograd apo Novi Sad. Përveç kësaj, meqenëse rrallë organizohen në afërsi të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, këto trajnime zgjasin shkurtë, për këtë arsye drejtorët vlerësojnë se ato nuk japin rezultate të rëndësishme.

Drejtorët konsiderojnë se trajnimet janë të domosdoshme dhe se aftësimi profesional duhet të modernizojë mënyrën e punës (qasje inovative, ndërvepruese të mësimdhënies) dhe t'i mundësojë arsimtarëve që të arrijnë aftësi të reja, njohuri të reja mbi metodikën e mësimdhënies dhe standardet mësimore. Shumica e bashkëbiseduesve propozon që qeverisja lokale dhe ministritë e linjës të ndajnë më shumë mjete në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrje në trajnimet për arsimtar nga komunat e varfra, apo që ato të realizohen më shpesh në nivel lokal. Meqenëse në shumicën e shkollave gjuhën serbe e ligjërojnë arsimtarët e mësimit klasor, është propozuar që të organizohen trajnime të posaçme të gjuhës serbe si gjuhë joamtare për këtë grup. Edhe pse ekziston nevoja që të investohet në kuadrin ekzistues, një numër i drejtorëve ka frikë se arsimtarët nuk do të jenë të interesuar për edukim të tillë, sepse nuk janë profesional apo janë përkohësisht në ato pozita. Prandaj, përveç organizimit të trajnimeve, kanë dhënë edhe propozime të tjera konkrete në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës serbe si gjuhë joamtare.

Disa drejtorë janë të njoftuar me mundësitë e prezantimit të asistentëve në mësimdhënie dhe konsiderojnë se kjo do të mund të jetë e dobishme për kuadrin ekzistues. Investimet në pajisjet audio-vizuale, përshtatshmëria e teksteve mësimore dhe publikimi i fjalorit serbisht-shqip për nxënësit, do të ishin zgjidhje të lehta të mundshme të cilat, sipas mendimit të bashkëbiseduesve, në masë të madhe do të përmirësonin mësimdhënien.

Përveç kësaj, drejtorët konsiderojnë se organizimi i aktiviteteve jashtëmësimore me shkollat tjera në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, do t'i kontribuonte mësimit më të mirë të gjuhës – puna në natyrë, vizitat e artizanateve nga komuniteti serb, shëtitjet dhe ekskurzionet me nxënësit e nacionalitetit serb, janë vetëm disa nga propozimet. Disa shkolla tashmë realizojnë bashkëpunim me shkollat tjera, por kjo është shpeshherë në nivel të garave vjetore dhe aktiviteteve sportive.

Pengesë kryesore për zbatimin e aktiviteteve të tilla, të cilat nuk janë në kompetencë të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, janë mjetet financiare dhe numri i vogël i nxënësve, gjegjësisht izolimi shkollor, për ç'arsye nuk mund të organizohe programe të shumëta. Të gjithë drejtorët do t'i përgjigjeshin me kënaqësi ftesës për bashkëpunim me shkollat tjera – si atyre nga Serbia qendrore ashtu edhe atyre nga rajoni. Është propozuar edhe organizimi i ekskurzioneve të përbashkëta me shkollat nga Bujanoci, Presheva dhe Medvegja në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhë serbe apo pjesëmarrja në përm-

bajtjet kulturore-sportive. Politika e viteve të nëntëdhjeta, disponueshmëria më e madhe e përmbajtjes së medieve në gjuhët tjera dhe cilësia më e dobët e mësimdhënies, sipas mendimit të bashkëbiseduesve, pjesërisht janë shkaktarë të njohjes së dobët të gjuhës. Si arsye kryesore të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës serbe në krahasim me gjeneratat e mëparshme gati të gjithë drejtorët potencojnë mungesën e ndërveprimit ndëretnik.

IV.4. QËNDRIMET E PRINDËRVE TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE FILLORE MBI MËSIMIN E GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE

Marija Stankoviq

Sipas përgjigjeve të prindërve, takimet e bordit shkollor thirren kryesisht një herë në muaj apo në dy muaj, dhe sipas nevojës edhe më shpesh. Temat mbi të cilat gjatë takimeve të bordit shkollor kryesisht bisedohet dhe çështjet të cilat më së shpeshti zgjidhen janë mësimi dhe disiplina e fëmijëve. Disa nga temat më të shpeshta janë, gjithashtu edhe puna e arsimtarëve – cilësia, metodat e punës, profesionalizmi dhe kualifikimi i kuadrit mësimor, si dhe problemet në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e mësimit, por edhe tekstet mësimore dhe mjetet mësimore (disponueshmëria e teksteve mësimore dhe diskutimi mbi cilësinë dhe përmbajtjen). Disa nga temat mbi të cilat bisedohet në takimet e bordit shkollor, sipas fjalëve të prindërve, janë edhe „depolitizimi i shkollave“, marrja e vendimeve të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e nxënësve (organizimi i ekskurzioneve, provimeve pranuese dhe garave), pastaj çështja që ka të bëjë me buxhetin shkollor dhe problemet aktuale të natyrës teknike (siguria e objektit shkollorë, sigurimi i nxënësve, kushtet e punës, transporti i nxënësve, etj.).

Të gjithë prindërit janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen se a merren me çështjen e cilësisë së zhvillimit të mësimit. Shumica e prindërve konsiderojnë se jo-profesionalizmi i kuadrit mësimor, me të mësuarit jo të përputhur, gjegjësisht njësitë mësimore primare të cilat kalohen shumë shpejtë, si dhe mungesa e fjalorëve të modernizuar shqip-serbisht janë disa nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e mësimit të gjuhës Serbe si gjuhë joamtare. Vetëm në një shkollë prindërit kanë theksuar se janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies.

Pa përjashtime, të gjithë prindërit të cilët janë anëtarë të bordeve shkollore konsiderojnë se është e rëndësishme që nxënësit në shkollë të mësojnë gjuhën serbe sepse besojnë se fëmijët të cilët jetojnë në Serbi, përveç se është e nevojshme të dijnë gjuhën zyrtare shtetërore, gjuhën serbe duhet të dijnë që të munden edhe në mjedis multietnik, sikurse në mjedisin e tyre, të komunikojnë pa vështirësi, socializohen

dhe të kuptohen me bashkëmoshatarët e tyre. Përveç kësaj, fëmijët duhet të mësojnë gjuhën serbe edhe për shkak të „perspektivës“, e cila sipas fjalëve të prindërve reflektohet në përdorimin e bursave të Republikës së Serbisë për shkollim, përcjellje dhe paraqitje në konkurse të ndryshme (për studime, punësim), por edhe për shkak të mundësisë së punësimit.

Në vendet në të cilat jetojnë, fëmijët kryesisht nuk kanë mundësinë të dëgjojnë apo mësojnë gjuhën serbe jashtë shkollës, nuk janë fare apo janë në masë shumë të vogël në kontakt me gjuhën serbe. Fëmijët nganjëherë shikojnë kanalet televizive në gjuhën serbe apo lexojnë gazeta, në qoftë se i kanë në dispozicion.

Të gjithë prindërit, pa përjashtim, me kënaqësi do të mbështetnin avancimin e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Në një shkollë prindërit kanë theksuar se „do të ishin të gatshëm të marrin pjesë në trajnime dhe punëtori “, kurse shumica do të ishin të gatshëm të bëjnë gjithçka çfarë është e nevojshme që nxënësve të i mundësohet dhe të motivohen për mësimin e gjuhës serbe. Vetëm një prind ishte skeptik në lidhje me prezantimin e metodave të reja në mësimdhënie, sepse, sikurse theksoi, beson se prezantimi i çfarëdo modeli të ri do të kishte kuptim vetëm nëse të njëjtit do të zbatoheshin edhe në mësimin e lëndëve tjera në shkollë. Prindërit konsiderojnë se komunikimi me folësit amtarë të gjuhës serbe do të ishte më se i dëshirueshëm, dhe se, përveç angazhimit të asistentëve dhe me përdorimin e audio dhe video materialeve në mësim, nxitja e shoqërimit të fëmijëve të përkatësive të ndryshme nacionale, organizimi i orëve të përbashkëta dhe aktiviteteve të përbashkëta sportive dhe të tjera – sigurisht do të jepnin rezultate të mira.

Prindërit kanë propozuar aplikimin e qasjeve më atraktive dhe inovative, posaçërisht në klasat më të reja. Ata theksuan: përdorimin e audio dhe video materialeve, fotografive dhe ilustrimeve, punëtoritë gjuhësore, orët shtesë dhe orët plotësuese, mësimin përmes lojës, kabinetin për mësimin e gjuhës serbe, kyçjen e asistentëve në mësimdhënie. Është propozuar edhe organizimi i kurseve të gjuhës për arsimtarët dhe seminare profesionale. Pastaj, prindërit kanë propozuar motivim shtesë të nxënësve duke organizuar shëtitje, ekskurzione, gara sportive, takime dhe aktivitete të ngjashme të përbashkëta me fëmijët e shkollave tjera në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën serbe. Më shumë se gjysma e prindërve të intervistuar beson se prezantimi i mësimdhënies ndërvepruese me pajisje të shtuar teknike do të ishte e dobishme, por se kjo do të kërkonte ndarje të shtuar të mjeteve. Në një shkollë prindërit kanë shprehur mendimin se nxënësit do t’i motivonte kontrollimi i testeve të diturisë, si dhe se fëmijët duhet stimuluar me nota më të ulëta („kanë nota të larta dhe nuk kanë motivim që të mësojnë“).

Prindërit janë vetëm pjesërisht të kënaqur apo janë të pakënaqur me njohjen e gjuhës serbe të fëmijëve të tyre. Ata përpiqen që t’i ndihmojnë atyre në përpunimin e detyrave të shtëpisë dhe në shpjegimin e

fjalëve të reja, por nuk komunikojnë me ata në gjuhën serbe. Nxënësit janë, sipas mendimit të prindërve, të kënaqur me mësimin, po jo edhe me njohuritë e tyre („në gjuhë serbe nuk munden as të lexojnë, as të shkruajnë, as të komunikojnë). Sipas fjalëve të prindërve, fëmijët nuk e dinë pse duhet të mësojnë gjuhën serbe, kur nuk kanë mundësi ta përdorinatë njohuri – „mungon komunikimi praktik". Disa nga nxënësit planifikojnë të studiojnë dhe punojnë jashtë Serbisë, sepse, sipas fjalëve të prindërve, mendojnë se „këtu nuk kanë kushte dhe mundësi", gjë që për mësimin e gjuhës serbe paraqet demotivim shtesë. Prindërit besojnë se është mirë që fëmijët sa më herët të fillojnë të mësojnë gjuhën serbe, edhe pse konsiderojnë se ata janë tepër të ngarkuar dhe se duhet të reduktojnë volumin e materialit, dhe se duhet përmirësuar cilësinë („më shumë punë në një mësim").

Në aspektin e rëndësisë së mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në të cilat mësimi zhvillohet në/edhe në gjuhë shqipe, qëndrimet e prindërve të nxënësve të cilët ndjekin ato shkolla janë të përshtatur dhe pozitiv. Sipas përgjigjeve të gjithë prindërve të intervistuar, kompetencat gjuhësore dhe njohja e gjuhëve janë vlerësuar sikur disa nga njohuritë më të rëndësishme dhe më të respektuara të cilat munden të miratohen në procesin e arsimimit.

IV.5. QËNDRIMET DHE MENDIMET E NXËNËSVE

Ivana Stanojev

Në Preshevë dhe Bujanoc, gjuha serbe jashtë shkollës më së shumti përdoret në institucionet shëndetësore, dhe në një përqindje të madhe nxënësit theksojnë se këtë gjuhë e mësojnë përmes televizionit. Gjuha serbe është e pranishme edhe në bisedime me prindërit apo familjen, posaçërisht në klasat më të reja, gjë që mund të jetë pasojë e moskuptimit të detyrave të shtëpisë, të cilat shpeshherë i zgjidhin me ndihmën e prindërve të tyre, që është konfirmuar edhe me analizimin e bisedës me prindërit. Dallime të rëndësishme janë vërejtur tek nxënësit e klasës së gjashtë, të cilët theksojnë se nuk përdorin gjuhën serbe jashtë shkollës (41.7% në krahasim me klasat tjera, ku është rreth 20%). Përqindje më e madhe e përgjigjeve të tilla janë marrë nga nxënësit e Preshevës, të cilët zakonisht janë më pak të ekspozuar ndaj gjuhës serbe në komunitet. Nxënësit e Medvegjës megjithatë, për dallim nga ata të Preshevës dhe Bujanocit, gjuhën serbe në masë të madhe e përdorin në shitore dhe në komunikim me fëmijët tjerë (shokët dhe shoqet), kurse të dhënat tregojnë se gjuha serbe në Medvegjë është më e pranishme në komunikim me fqinjët.

Nxënësit në Preshevë dhe Bujanoc programet televizive në përqindje më të madhe i përcjellin në gjuhë shqipe (rreth 50% të anketuarve), përderisa programet në gjuhën serbe i përcjellin në përqindje më të vogël, rreth 25%. Përcjellja e programeve në gjuhën serbe shtohet në klasat më të larta, si dhe përcjellja e programeve në gjuhën angleze dhe turke. Prej kanaleve televizive më të popullarizuara në gjuhënserbe në mesin e nxënësve është PRVA TV, kurse prej programeve në gjuhën shqipe më të pranishme janë kanalet në televizionin kabllor (filmat vizatimor dhe filmat në përgjithësi). Në Medvegjë situata është pak më ndryshe: atje në përqindje më të madhe përcillen kanalet në gjuhën serbe, përderisa programet në gjuhën shqipe përcillen në përqindje më të vogël.

Në pyetjen mbi kënaqësinë e vlerësimit nga gjuha serbe, rreth 91% enxënësve janë përgjigjur se janë të kënaqur, kurse pakënaqësia është theksuar më së shumti tek nxënësit e klasës së pestë (16.7%), gjë që mundet të jetë pasojë e ndryshimit të mësimit nga mësimi klasor në mësim lëndor. Kjo është në përputhje me rezultatet nga pyetësori me drejtorët në lidhje me pakënaqësinë e tyre të kuadrit të (pa)disponueshëm profesional. Edhe pse në përqindje më të madhe nxënësit e të gjitha klasave vlerësojnë se lexojnë, shkruajnë dhe komunikojnë shkëlqyeshëm në gjuhë serbe, vërehet se nxënësit e klasës së katërt dhe të pestë në përqindje më të vogël vlerësojnë se janë të kënaqur pjesërisht (komunikimi gojor është i mirë, përderisa komunikimi me shkrim duhet të përmirësohet), përderisa tek nxënësit e klasës së shtatë dhe të tetë ekziston një numër i madh i atyre të cilët konsiderojnë se kanë zotuar mirë shkrimin, por se duhet të përmirësojnë komunikimin gojor.

Në të tri komunat nxënësit e të gjitha klasave konsiderojnë se njohja e gjuhës serbe mundet të jetë e dobishme në të ardhmen (96,4% e të anketuarve). Përqindja më e ulët, madje ende shumë e madhe, është e pranishme tek nxënësit e klasës së katërt (91,5%), përderisa nxënësit e klasës së shtatë dhe të tetë tregojnë interesim më të madh për mësimin e gjuhës serbe, gjë që ndërlidhet drejtpërdrejtë me vazhdimin e shkollimit, për të cilin, sikurse konsiderojnë, gjuha serbe më së shumti i nevojitet për shkak të përdorimit formal të gjuhës (shkollimi, punësimi në institucionet publike apo në dyqane). Nxënësit e klasës së katërt dhe të gjashtë janë të mendimit se njohja e gjuhës serbe është e rëndësishme për shkak të komunikimit, përderisa në Medvegjë përqindje e konsiderueshme e nxënësve beson se gjuha serbe është e rëndësishme për shkak të përdorimit joformal të gjuhës (shoqërimi, takimet, marrëdhëniet me fqinjët). Pyetësorët gjithashtu kanë treguar se disa nxënës vërejnë rëndësinë e njohjes së gjuhës shtetërore në të cilën jetojnë (rreth 10% e të anketuarve), dhe 20% e nxënësve konsideron se njohja e gjuhës serbe është e dobishme në çdo mënyrë (për të ardhmen, marrëdhëniet, jetesën).

IV.6. QËNDRIMET E MEDIAVE LOKALE DHE SHOQËRISË CIVILE

Millica Rodiq

Me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave janë realizuar intervista gjatë muajit Maj të vitit 2014. Në studim morën pjesë përfaqësuesit e *Iniciativës qytetare* (Bujanoc), *Dituria* (Bilaç, komuna e Bujanocit), *International Human Center* (Preshevë), *Këshilli për drejtat e njeriut* (Preshevë); shtëpitë televizive *Radio-televizioni i Preshevës, Radio Televizioni i Bujanocit* dhe *Radio Televizioni Spektri* nga Bujanoci, internet portalet *Presheva.com* (Preshevë), *Titulli.com* dhe *Lugina lajm* nga Bujanoci.

Pothuajse të gjithë bashkëbiseduesit theksuan njohjen e dobët të gjuhës serbe në mesin e të rinjve të komunitetit shqiptar. Si ndryshim pozitiv theksuan motivimin e theksuar dhe interesimin e të rinjve për mësimin e gjuhës, duke theksuar se në ato përpjekje duhet të mbështeten. Opinioni i bashkëbiseduesve të internet portalit *Titulli.com* është diçka më ndryshe: ata theksojnë se të rinjtë nuk janë të motivuar që të mësojnë gjuhën serbe sepse nuk shohin perspektivë të jetës në vendin e tyre. Njohja e dobët e gjuhës është pasojë e mosekzistimit të komunikimit të drejtpërdrejtë midis të rinjve të komunitetit shqiptar dhe serb. Është shprehur edhe mendimi se ata të cilët e njohin gjuhën atë njohuri nuk e kanë arritur në shkollë, por në rrethana joformale, zakonisht duke marrë pjesë në aktivitetet e organizatave joqeveritare

Mosnjohjen e gjuhës serbe përfaqësuesit e mediave dhe organizatave të shoqërisë civile e shohin si pengesë të zhvillimit të gjeneratave të reja etnike të shqiptarëve dhe shqiptareve, duke theksuar se ata të cilët e njohin gjuhën kanë përparësi në krahasim me të tjerët. Mësimi i gjuhës është parë si i rëndësishëm për shkak të „faktit se të rinjtë jetojnë në një shtet në të cilin gjuha serbe është gjuhë zyrtare, dhe me të cilën ballafaqohen në secilin institucion“, por edhe për shkak të „pjesëmarrjes së shqiptarëve në institucionet shtetërore“.

Përfaqësuesit e organizatave prej të cilave janë bërë iniciativat e para për organizimin e orëve të gjuhës serbe, kuptuan domosdoshmërinë që përfaqësuesit dhe përfaqësueset e komunitetit shqiptar të mësojnë këtë gjuhë. Pritjet e tyre fillestare në lidhje me interesimin për ndjekjen e aktiviteteve të tilla ishin modeste, posaçërisht sepse janë ballafaquar me një numër shumë më të madh të kandidatëve sesa kishin paraparë. Internet portali *Titulli.com* prej vitit 2013 ka filluar të publikojë lajme edhe në gjuhë serbe, duke theksuar se qëllimi i tyre ishte që ky medium të bëhet edhe mjet i informimit „i cili do t'i mundësonte edhe komunitetit serb që të njoftohet me ngjarjet në mjedisin lokal“. Edhe pse kanë pritur dozë të caktuar të kritikës së një pjese të komunitetit lokal në lidhje me vendimin e tillë, patën mbështetjen e qytetarëve. Bashkëbiseduesi i internet portalit *Presheva.com*, njërit nga portalet më vizituara të gjuhës

shqipe në Serbi, theksoi nevojën që informacionet njëkohësisht të jenë të pranishme për të gjithë qytetarët dhe se lajmet të përkthehen në gjuhën serbe, por edhe faktin se nuk ekzistojnë kushte materiale të nevojshme për realizimin e kësaj ideje. [92]

Bashkëbiseduesit theksuan se mediat dhe organizatat e shoqërisë civile mund të japin kontribut të madh dhe të luajnë rol të rëndësishëm në zgjidhjen e çështjeve të mësimit të gjuhës serbe, duke theksuar se me aktivitetet e tyre në masë të madhe krijojnë hapësirë për komunikim dhe socializim të të rinjve me prejardhje të ndryshme etnike. Ata konsiderojnë se shoqatat e qytetarëve mund të kontribuojnë më shumë me propozimin e mënyrës së zgjidhjes sistematike të këtij problemi. Roli i mediave është që të paraqesin rëndësinë e mësimit të gjuhës serbe duke promovuar aktivitete të atyre të cilët tani e bëjnë këtë dhe duke punuar në „ngritjen e vetëdijes dhe ndryshimin e mendimeve negative ndaj gjuhës serbe dhe duke zgjuar ndjenjat për mësimin e të njëjtit". Mediat duhet të „tregojnë se gjuha serbe është nevojë e pashmangshme" dhe me organizimin e emisioneve dhe programeve në gjuhën serbe në të cilat do të merrnin pjesë të rinjtë nga komunitete të ndryshme etnike. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave konsiderojnë se „duhet të ekzistojë koordinim midis mediave, organizatave të shoqërisë civile dhe shkollave, në mënyrë që të punojnë së bashku në zgjidhjen e këtij problemi dhe në mënyrë që të zgjojnë interesimin e të rinjve për mësimin e gjuhës serbe".

IV.7. QËNDRIMET E PËRFAQËSUESVE TË ORGANEVE SHTETËRORE, ADMINISTRATËS KOMUNALE, SEKTORIT EKONOMIK DHE TË PUNËSUARVE

Millica Rodiq

Në mënyrë që të përcaktohet nevoja për njohjen e gjuhës serbe me qëllim të punësimit apo kryerjes së punës më mirë, ekipi hulumtues gjatë muajit Qershor të vitit 2014 ka realizuar biseda me përfaqësuesit e administratës shtetërore dhe komunale dhe përfaqësuesit e sektorit ekonomik. Në studim morën pjesë edhe përfaqësuesit e Administratës tatimore (Bujanoc), Entit nacional për punësim (Bujanoc), Stacionit policor (Bujanoc), Komunës së Bujanocit (kryeshefi i administratës komunale); [93] përfaqësuesit e shoqëri-

92 Përfaqësuesit e medieve theksojnë që për shkak të mosnjohjes së gjuhës serbe të gazetarëve të komunitetit shqiptarë shpeshherë duhet të angazhojnë persona tjerë për përkthim apo lloj tjetër të punës, gjë që i vështirëson punën dhe paraqet pengesë të shtuar financiare. Trajnimet të cilat organizohen për punëtorët e sektorit mediatik janë kryesisht në gjuhë serbe, dhe disa individë ballafaqohen me vështirësi gjatë ndjekjes dhe përcjelljes së trajnimeve të tilla. Për të gjitha këto arsye, gjatë intervistës është paraqitur edhe nevoja për gazetarët të organizohen trajnime shtesë me qëllim të përmirësimit të njohurive të gjuhës serbe..

93 Ftesa për intervistë i është dërguar edhe „Elektrodistribucionit", „Industrisë së duhanit në Bujanoc" dhe ndërmarrjes „Bi voda".

ve afariste *Agro Adria* (Bujanoc) dhe *Saba Belça* (Preshevë). Është bërë një fokus grup me të punësuarit e komunitetit shqiptar të cilët punojnë në Administratën tatimore dhe në administratën lokale (Bujanoc).

Bisedat me përfaqësuesit e organeve shtetërore, administratës komunale, afaristët dhe të punësuarit kanë treguar pa dyshim domosdoshmërinë e njohjes së gjuhës serbe. Përgjigjet e dhëna mund të përmblidhen në dy kategori. Kategorinë e parë e përbëjnë përgjigjet dhe arsyetimet mbi domosdoshmërinë e njohjes së gjuhës serbe, si të punësuarve ashtu edhe të atyre të cilët kërkojnë punë. Kjo, para së gjithash, ka të bëjë me komunikimin me qytetarët (klientët, palët, partnerët, etj.) të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare. Gjithashtu, bashkëbiseduesit theksojnë se rregullat të cilat duhet të dijnë të punësuarit janë të shkruara në gjuhën serbe. Njohjen e gjuhës e konsiderojnë posaçërisht të rëndësishme bashkëbiseduesit e Stacionit policor në Bujanoc, të cilët theksuan se natyra e punës kërkon intervenime dhe reagime të shpejta me rastin e zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohet ky organ. Kategoria tjetër e përgjigjeve ka të bëjë me faktin se është e domosdoshme të njihet gjuha serbe sepse është gjuhë zyrtare shtetërore dhe gjuhë e cila flitet në këto komuna.

Përfaqësuesit e administratës shtetërore në nivel lokal konsiderojnë se të punësuarit në organet shtetërore nga komuniteti shqiptar dhe ata të cilët konkurrojnë për punë në administratë shtetërore, ballafaqohen me vështirësi në punë, gjegjësisht me vështirësi me rastin e pranimit në punë, për shkak të njohjes së dobët apo të mosnjohjes së gjuhës serbe.[94] Edhe bashkëbiseduesit nga sektori afarist treguan për faktin se është e dëshirueshme që të punësuarit të njohin gjuhën serbe meqenëse pjesa më e madhe e punës kryhet në atë gjuhë. Edhe pse përfaqësuesit e sektorit afarist theksuan se ata personalisht njohin gjuhën serbe, ata paraqitën edhe faktin se punëtorët e caktuar nuk e njohin këtë gjuhë në masë të mjaftueshme, gjë që nganjëherë e vështirëson punën. Ata konsiderojnë se mosnjohja e gjuhës serbe ndikon negativisht në komunikim me parterët e punës, me furnizuesit, blerësit por edhe me institucionet me të cilat bashkëpunojnë, dhe theksojnë se mësimi i kësaj gjuhe është i domosdoshëm për komunikim dhe biznes të suksesshëm.

Të punësuarit në Administratë tatimore dhe administratë lokale me të cilët është realizuar fokus grupi, konsiderojnë se për shkak të kryerjes më të mirë të punës dhe për shkak të domosdoshmërisë së komunikimit të shpejtë dhe cilësor njohja e gjuhës serbe është jashtëzakonisht e rëndësishme për punë në administratë shtetërore. Ata shtuan se më lehtë kryejnë punën pikërisht për shkak të njohjes së gjuhës

94 Bashkëbiseduesit nga administrata tatimore dhe Enti nacional për punësim theksuan se këto organe nuk kanë vështirësi në punë dhe komunikim me palët, por që, sipas njohurive të tyre, ky problem është i pranishëm në institucionet tjera. Për shkak të njohjes s dobët të gjuhës serbe kryeshefi i Stacionit policorë në Bujanoc propozoi sistematizimin e vendeve të reja të punës, me të cilin është paraparë punësimi i dy përkthyesve, pikërisht me qëllim të kryerjes më efikase të punës së të punësuarve. Nga ana tjetër, administrata komunale në Bujanoc nuk kishte vështirësi në punë për shkak të faktit se në secilin shërbim në komunë janë punësuar persona nga të dy komunitetet.

serbe dhe theksojnë se pa të nuk do të kishin mundësi që të plotësojnë detyrat dhe përgjegjësitë e punës.

Se të rinjtë e komunitetit shqiptar të cilët nuk flasin apo të cilët flasin dobët gjuhën serbe ballafaqohen me vështirësi dhe pengesa me rastin e konkurrimit për punë, është treguar gjatë këtyre bisedave. Ata të cilët njohin gjuhën serbe mjaft mirë që të munden në mënyrë të pavarur të komunikojnë, kanë përparësi në krahasim me ata të cilët nuk munden të bëjnë këtë gjë, mendojnë të gjithë bashkëbiseduesit.

Për arritjen e efikasitetit në punë dhe për shkak të sigurimit të kryerjes më cilësore të punës së punëtorëve të rinj, bashkëbiseduesit propozuan që të rinjtë e komunitetit shqiptar të stimulohen që të mësojnë gjuhën serbe.[95] Përveç njohjes së mirë të gjuhës serbe të kandidatëve të cilët dëshirojnë të punësohen, disa bashkëbisedues paraqitën edhe nevojën e mësimit të gjuhës shqipe.[96]

95 Bashkëbiseduesi nga ndërmarrja Agro Adria tregoi praktikën e mirë të mësimit të gjuhës serbe në kuadër të projektit të cilin dy vite e organizoi Shërbimi i Trupit koordinues. Edhe të punësuarit të cilët morën pjesë në fokus grup treguan se është trend pozitiv organizimi i kurseve të gjuhës serbe, sepse i kontribuojnë avancimit personal dhe profesional të cilësisë së individëve të cilët dëshirojnë të punësohen apo të cilët kryejnë punë të caktuar.

96 Nevoja për njohjen e gjuhës shqipe është paraqitur nga ana e kryeshefit të administratës komunale në Bujanoc, duke theksuar se „është e domosdoshme njohja e gjuhës shqipe, si gjuhë e mjedisit". Përfaqësuesi i Shërbimit nacional për punësim theksoi se zyrtarët të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare, për shkak të mosnjohjes së gjuhës shqipe nuk janë në gjendje të komunikojnë me palët e komunitetit shqiptar.

V. REKOMANDIMET PËR AVANCIMIN E MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE NË SHKOLLAT FILLORE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

V. REKOMANDIMET PËR AVANCIMIN E MËSIMIT TË GJUHËS SERBE SI GJUHË JOAMTARE NË SHKOLLAT FILLORE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

Rekomandimet e mëposhtme rrjedhin nga analiza e përgjithshme e mësimit dhe mësimdhënies së gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Analiza përfshinte:

- verifikimin e njohjes ekzistuese të gjuhës serbe si gjuhë joamtare të nxënësve të klasës së IV dhe VIII;
- analizën e Planit dhe programit mësimor për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare;
- analizën e teksteve ekzistuese mësimore dhe doracakëve për arsimtarët të cilat janë miratuar nga Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik për mësimin e kësaj lënde;
- monitorimin dhe analizimin e orëve të gjuhës serbe si gjuhë joamtare nga aspekti i aftësisë metodike dhe profesionale të arsimtarët;
- analizën e kornizave shoqërore dhe mësimore në të cilat realizohet mësimi i gjuhës serbe si gjuhë joamtare (anketimi i nxënësve, prindërve, arsimtarëve, drejtorëve të shkollave, kryetarëve të komunave, kryetarit të Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare, deputetit popullor në Kuvendin e Republikës së Serbisë nga komuniteti shqiptar, këshilltarit arsimor nga Ministria e arsimit nga komuniteti shqiptar, përfaqësuesve të mediave, organizatave të shoqërisë civile, organeve shtetërore, administratës komunale dhe afaristëve nga komunat në të cilat është realizuar studimi);
- shqyrtimi i përvojave të iniciativave ekzistuese joinstitucionale për avancimin e njohjes së gjuhës serbe si gjuhë joamtare;
- bisedat me përfaqësuesit e Sekretariatit krahinor për arsimim, administratë dhe komunitete nacionale të KA të Vojvodinës, këshillat nacionale të pakicave nacionale në KA të Vojvodinës, Institutit pedagogjik të Vojvodinës, dhe Avokatit popullor krahinor të KA të Vojvodinës me qëllim të prezantimit të mundësive të mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare në KA të Vojvodinës.

Së pari do të përmblidhen rezultatet më të rëndësishme të studimit nga të cilat rrjedhin propozimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të cilat në periudhën e ardhme do të duhet të ndërmerren me qëllim të avancimit të mësimdhënies dhe mësimit të gjuhës serbe për nxënësit e komunitetit shqiptar.

Rezultatet kryesore të studimit

V.1. (Mos)njohja e gjuhës

Konstatimi kryesor i studimit është se mësimi i gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe njohjet e nxënësve në shkollat fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë nuk janë në nivel të kënaqshëm. Problemi kryesor i cili është vërejtur është se nxënësit nuk mund të realizojnë komunikim spontan në gjuhën serbe.

Këto pohime bazohen në analizën e rezultateve të testimit me të cilin janë fituar të dhënat mbi mosnjohjen sistematike të gjuhës serbe të nxënësve në të gjitha komunat e përmendura, si në klasën e katërt ashtu edhe në klasën e tetë. Në asnjë shkollë nuk është realizuar rezultat mesatarë në bazë të cilit do të mund të flitet mbi njohjen e gjuhës serbe të nxënësve të asaj shkolle. Nxënësit në masë të madhe nuk kanë njohuri funksionale të gjuhës serbe në atë masë në të cilën mund të realizojnë komunikim në atë gjuhë, qoftë në të shkruar apo në të folur, dhe as nuk janë në gjendje që të kuptojnë bashkëbiseduesin. Një numër i vogël i nxënësve i cili ka realizuar rezultate mbi mesataren në testim në fakt kryesisht posedon kompetencë gjuhësore të paraparë me plan dhe program mësimor për atë moshë, por, në bazë të të dhënave të marra duke intervistuar këta nxënës, është mësuar se kompetenca kryesisht edhe nuk është arritur në procesin mësimor. Gjatë studimit gjithashtu është vërejtur se nuk ekzistojnë aktivitetet jashtëmësimore të organizuara për nxënësit e këtyre shkollave në të cilat ata do të kishin mundësi që të realizojnë kontakt me bashkëmoshatarët të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare, që paraqet element të rëndësishëm të avancimit të kompetencës komunikuese.

V.2. Avancimi profesional dhe gjuhësor i arsimtarëve

Sipas të dhënave të grumbulluara nga 41 arsimtarë të cilët zhvillojnë mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, vërehet se asnjëri nuk është shkolluar, dhe nuk ka kaluar trajnimin, për mësimdhënie të gjuhës serbe si gjuhë joamtare, dhe gjithsej gjashtë prej tyre plotësojnë kushtet të cilat, sipas Rregullores mbi shkallën dhe llojin e arsimimit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollë fillore (në vazhdim: Rregullorja), janë të domosdoshme për zhvillimin e mësimdhënies së gjuhës serbe (si gjuhë amtare) në klasat në të cilat momentalisht zhvillojnë mësimdhënien. Situata e tillë në terren është pasojë e mungesës së kuadrit profesional, i cili për arsye të ndryshme është deficitar. Sipas pohimeve të drejtorëve të shkollave fillore shihet se në konkurset e publikuara nuk ekzistojnë paraqitje të arsimtarëve të kualifikuar për gjuhë serbe si gjuhë joamtare, gjë që paraqet

problem të madh për të gjitha shkollat në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Trajnimi i arsimtarëve për zhvillimin e kësaj lënde është parakusht kryesorëpër avancimin e mësimit dhe arritjen e suksesit më të mirë të nxënësve në zotimin e gjuhës serbe.

Për këtë arsye duhet organizuar seminare dhe punëtori në të cilat arsimtarët do të edukoheshin posaçërisht në metodikën e gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe do të shkëmbenin përvojat me arsimtarët të cilët këtë lëndë e zhvillojnë në ndonjë mjedis tjetër në Republikën e Serbisë. Duhet theksuar edhe rëndësinë e (vetë)avancimit të përhershëm të arsimtarëve, dhe për këtë të inkurajohen dhe mbështeten në mënyra të ndryshme. Madje, arsimtarët janë, sikurse ka treguar edhe biseda me ata, shumë të vetëdijshëm për të gjitha përparësitë e avancimit, por ajo deri më tani rrallë herë ishte në dispozicion.

Padyshim se arsimtarëve në zhvillimin e mësimit i nevojitet ndihma e asistentëve/bashkëpunëtorëve, para së gjithash e atyre të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare dhe të cilët janë të kualifikuar për dhënien e ndihmës së tillë, duke pasur posaçërisht parasysh se me Ligjin mbi bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit kjo gjë lejohet.

Rezultatet e studimit kanë treguar se, përveç avancimit profesional, duhet ndërmarrë hapa edhe me qëllim të përmirësimit të zotërimit të gjuhës standarde serbe edhe tek vetë arsimtarët.

V.3. Avancimi i mësimit

Mësimi i lëndës Gjuha serbe si gjuhë joamtare ka specifikat e saja, si përmbajtjesore ashtu edhe metodike, dhe assesi nuk mund të barazohet me mësimin e gjuhës amtare, qoftë të gjuhës serbe, qoftë të gjuhës së pakicës nacionale. Për shkak të aftësive të pamjaftueshme profesionale, arsimtarët shpeshherë i shmangen metodave të cilat nuk janë të bazuara në njohuritë moderne mbi adoptimin e gjuhës joamtare/gjuhës tjetër, gjë që rrallë rezulton me punën e cila është shënuar me anë tradicionale negative, ligjëruese, reproduktive, të mësimdhënies pseudo-aktive me karakteristika të theksuara të metodës gramatikore-përkthyese. Arsimtarët më së shpeshti mundohen të realizojnë detyrat e vendosura dhe të shtjellojnë përmbajtjet e parapara me program dhe shpeshherë ndodhen në mospërputhje midis mësimit të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj (të cilën, së paku intuitivisht, e dinë se duhet të merret parasysh). Përkundër kësaj, udhëzimet mbi mënyrën e realizimit të Programit (të cilat janë pjesë përbërëse e atij dokumenti zyrtarë) tregojnë jo-efikasitetin e veprimeve të tilla dhe sugjerojnë aktivitetin e nxënësve, rëndësinë e përdorimit praktik të gjuhës, zbatimin e formave të ndryshme të trajnimit dhe theksojnë nevojën që

mësimi të realizohet në përputhje me mundësitë dhe nevojat e nxënësve në mjedis të caktuar gjuhësor dhe kulturor. Programi, në fakt, përmban dy nivele të mësimdhënies së gjuhës serbe si gjuhë joamtare, të projektuara në bazë të njohjes së mëhershme të gjuhës nga ana e nxënësit, përmbajtjes së mjedisit etnik nga i cili vjen nxënësi dhe ngjashmërisë gjuhësore të dy gjuhëve. Niveli i cili parasheh përmbajtjen minimale gjuhësore me të cilën nxënësi duhet të zotojë, përputhet me numrin e orëve dhe moshën e nxënësve, ashtu që zbatimi i tyre mund t'imundësojë të gjithë nxënësve zotimin e kompetencave elementare gjuhësore. Obligim i arsimtarit është që me ndihmën e mjeteve të ofruara glota-didaktike, por edhe me materialin e vetë përgatitur, të gjej; mënyrën më efikase me të cilën përmbajtjet e parapara gjuhësore do t'ia ofrojnë nxënësve dhe do të mundësojë adoptimin e tyre.

Në program për këtë gjuhë propozohet që në mësimdhënie të shmanget përdorimi i gjuhës amtare, kryesisht për shkak të rritjes së efikasitetit të adoptimit të gjuhës serbe. Megjithatë, se ajo nuk është parakusht i vetëm për zotërimin e suksesshëm të gjuhës, tregojnë edhe rezultatet e testimit. Në fakt, të arriturat e nxënësve janë të dobëta njësoj pa marrë parasysh gjuhën amtare të arsimtarëve apo gjuhën e cila është përdorur në procesin mësimor. Duhet theksuar se më i rëndësishëm nga të gjithë është vetë „evoluimi" në orë, tranzicioni i arsimtarëve drejt nxënësve, të cilët duhet të fitojnë vend më të rëndësishëm, vend qendror në mësim. Ata do të duhej të jenë shumë më aktiv, të mos jenë të pyetur, por të pyesin, të mos riprodhojnë, por të prodhojnë. E gjithë kjo është e mundur të arrihet me prezantimin e metodave adekuate mësimore, ushtrimeve apo të ngjashme, të cilat deri më tani janë rrallë të pranishme në orë. Vetëm në këtë mënyrë nxënësit do të mundnin në të vërtetë të aftësohen që të jenë në gjendje të shprehen në gjuhën serbe, gjë që, fundja, do t'i hapte perspektiva të reja në të ardhmen. Që të ndodh kjo, duhet bërë lëvizje nga metodika e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare (për të cilën janë të shkolluar arsimtarët me kualifikim adekuat profesional) dhe të fillojnë të inkuadrojnë metodikat e caktuara, parimet e përzgjedhura të metodikës së mësimit të gjuhëve të huaja

V.4. Tekstet dhe mjetet tjera mësimore

Sistemi i arsimimit në Republikën e Serbisë në masë të madhe bazohet në tekstet mësimore. Ato janë mjete themelore të mësimdhënies dhe për shumicën e arsimtarëve paraqesin udhëzimet themelore në organizimin e procesit mësimor.

Përdoromi i teksteve mësimore për Gjuhën serbe si gjuhë joamtare, meqenëse të njëjtit janë të dedikuar për përfaqësuesit e pakicave të ndryshme nacionale dhe për të dy nivelet e mësimit (minimal dhe të

avancuar), nuk duhet të jetë mekanik, jo-kritik, por duhet të jetë seleksionues dhe i përshtatur ndaj mundësive të nxënësve. Meqenëse tekstet mësimore, sikurse tregoi analiza, janë shumë voluminoze dhe me material gramatikor dhe leksikor, shpeshherë sipas konceptit barazohen me gjuhën amtare të nxënësve (me gjuhën shqipe), dhe në disa raste edhe tejkalohet– është e domosdoshme që të seleksionohet materiali, sipas Programit, dhe të përcaktohet minimumi gjuhësor për secilën klasë, me të cilin do të sigurohej njohja funksionale e gjuhës. Disa tekste mësimore, kryesisht ato për klasat më të ulëta (librat e leximit për klasën e III dhe IV), kanë strukturë të tillë, por edhe ashtu, përmbajtja e caktuar minimale është shumë voluminoze. Posaçërisht duhet orientuar vëmendjen në materialin mësimor për klasën e I, kur (disa) nxënës për herë të parë ballafaqohen me gjuhën serbe. Kryesisht në këtë rast është vërejtur mospërputhje e madhe midis programit dhe tekstit mësimor, të ngarkuar me përmbajtje gjuhësore, të paraparë vetëm për prezantim auditiv. Meqenëse në shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe tek nxënësit e klasave më të larta nuk përdoren botimet e teksteve të fundit mësimore, është i domosdoshëm sigurimi i kompleteve të reja të teksteve mësimore, të tillë që do të jenë më të përdorshëm sikur me dukjen ashtu edhe me përmbajtjen e tyre. Kjo do të duhej të përcillet edhe me hartimin e materialit më të modernizuar mësimor si dhe me pajisjen e shkollave me mjete të ndryshme mësimore, të cilat në të vërtetë do të gjenin rrugën deri tek klasat.

Duke pasur parasysh vërejtjet e paraqitura, është e qartë se situatën e regjistruar duhet përmirësuar në të mirë.

Rekomandimet

Rekomandimet afatshkurtra (shtator 2014 – shtator 2015):

- Për të gjithë nxënësit dhe arsimtarët të sigurohet kompleti i ri ekzistues i publikimit të teksteve mësimore.
- Për të gjithë arsimtarët të sigurohen doracakë me kompletet e teksteve mësimore.
- Të sigurohet materiali shtesë mësimor – praktikumet, postaret, katalogët, lojërat, materialet digjitale etj. – me të cilat, posaçërisht në klasat më të ulëta, do të mundësohej adoptimi i përmbajtjeve minimale gjuhësore, leksikut dhe modeleve gjuhësore, në mënyrë kreative dhe të pranueshme. Si zgjidhje kaluese deri tek përpunimi i rregullt i kompleteve të reja të teksteve mësimore, kjo do të mundësonte që secili nxënës në orë të përvetësojë përmbajtjet e parapara funksionale të cilat mund t'i përdorë edhe jashtë klasës.
- Të organizohen seminare dhe trajnime për arsimtarët të cilët ligjërojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare në të gjitha shkollat fillore në të cilat mësimdhënia zhvillohet në gjuhën shqipe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në lidhje me metodikën e mësimdhënies dhe modernizimin e mënyrës së punës së kuadrit ekzistues arsimtar.
- Të organizohen takime me arsimtarët nga pjesët tjera të vendit të cilët gjithashtu ligjërojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare dhe me ata të shkëmbehen përvojat, të identifikohen modelet e suksesshme dhe të përshtaten sipas nevojave të mjedisit në të cilin punojnë, të analizohen mënyrat e zhvillimit të mësimdhënies, problemet me të cilat ballafaqohen, vërejtjet e tyre dhe të organizohet prezantimi profesional i një apo dy orëve.
- Në shkollat në të cilat është vërejtur kualifikimi joadekuat profesional dhe njohje më e dobët e gjuhës standarde serbe të arsimtarëve, të angazhohen bashkëpunëtorë të kualifikuar /asistentë të cilët do t'i ndihmonin në zhvillimin e mësimit.
- Në pikëpamje të mësimdhënies, të stimulohen arsimtarët dhe asistentët për ndryshim cilësorë të qasjes në mësimdhënie, prej ex cathedra ka mënyra ndërvepruese të punës; të stimulohet komunikimi edhe në mësim të gjuhës serbe për zbatimin e saj në jetën e përditshme.
- Në pikëpamje të mësimdhënies, të stimulohen arsimtarët që në mënyrë aktive të planifikojnë realizimin e secilës orë dhe të motivojnë nxënësit për mësimin e gjuhës serbe.

- Të prezantohen testimet tremujore (në fund të secilit tremujorësh) – në bazë të Planit dhe programit të paraparë mësimor të precizohen qartë të arriturat minimale të nxënësve në mësimin e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare; të zhvillohen modele të bazë të cilëve do të testohen nxënësit, në mënyrë që arsimtarët të dinë se në çfarë mënyre, në çfarë volumi dhe në çfarë intervali të ligjërojnë njësinë mësimore. Me testimin tremujorësh nxënësit dhe arsimtarët do të kishin pasqyra të rregullta në rezultatet e punës së tyre.

- Të iniciohet organizimi i garave nga Gjuha serbe si gjuhë joamtare në nivel shkollor, komunal dhe regjional në mënyrë që të arrihen kushtet që nxënësit e të tri komunave të marrin pjesë në garat republikane nga kjo lëndë.

- Të organizohen takime të përfaqësuesve të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, EAAE, EVCAE dhe të arsimtarëve të cilët ligjërojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare në shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

- Formimi i grupit punues (në kuadër të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik apo shërbimit të Trupit Koordinues) i cili do të përcillte rrjedhën e implementimit të rekomandimeve dhe i cili do të konceptonte hapat e mëtejshme dhe do të vlerësonte rezultatet e arritura.

Rekomandimet afatmesme (shtator 2015 – shtator 2017):

- Të shkruhen udhëzuesit për arsimtarët e secilit nivel dhe të jenë në dispozicion për arsimtarët (botuesit duhet t'i trajtojnë si pjesë e obligueshme e teksteve mësimore); në udhëzues të paraqitet dallimi në metodikën e mësimit të gjuhës joamtare dhe amtare.

- Të shkruhet fjalori (sikur shtesë e librave të leximit ekzistues) për nxënësit e të gjitha klasave të shkollave fillore i cili do të bëjë të mundur mësimin më efikas të gjuhës serbe.

- Të sigurohet trajnimi i vazhdueshëm i arsimtarëve të mësimit të Gjuhës serbe si gjuhë joamtare në përputhje me Rregulloren mbi shkallën dhe llojin e arsimimit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollë fillore dhe të përcillet zbatimi i metodave moderne të punës në klasë

- Të krijohet lidhja midis shkollave në nivel lokal dhe pjesëve tjera të vendit: organizimi i vizitave të nxënësve të dy shkollave të cilat i përkasin komuniteteve të ndryshme nacionale (në kuadër të të cilëve do të organizoheshin aktivitete rekreative, shkencore, kulturore dhe sportive) do të rezul-

tonte me realizimin e komunikimit dhe njohjen me ngjashmëritë kulturore dhe me veçantitë midis pjesëmarrësve.

- Në saje të mundësive teknike të shkollave dhe arsimtarëve, të organizohet lloji i „rrjetit“ në internet i cili do të ndërlidhte arsimtarët e gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe do t'i jepte mundësinë që të shkëmbejnë përvoja të ndryshme të mira: përgatitjet për orë, trajnimet, testet (përzgjedhja, adoptimi, mënyra e përpunimi) etj. Posaçërisht do të ishte i dobishëm shkëmbimi i përvojave të arsimtarëve të cilët punojnë në mjediset homologe si dhe atyre të cilët i ligjërojnë gjuhën serbe nxënësve të cilëve gjuha amtare i dallon konsiderueshëm nga gjuha serbe.

- Të organizohen një varg punëtorish – në saje të mundësive teknike të sigurohet që nxënësit e komunitetit shqiptar të fitojnë një „shok/shoqe“ nga komuniteti serb (duke mos u kufizuar në territorin e Serbisë jugore) me të cilin përmes rrjeteve sociale do të komunikonte në gjuhën serbe, me pasqyrë dhe kontroll të caktuar të arsimtarëve dhe prindërve.

- Të përcaktohen standardet dhe pastaj rezultatet për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare.

- Të integrohet testimi i obligueshëm nacional në mënyrë që të përcaktohet shkalla e të arriturave të nxënësve.

- Të përcaktohet nevoja për përshtatjen e programit mësimor për lëndët Gjuha shqipe (si gjuhë amtare) dhe Gjuha serbe si gjuhë joamtare.

Rekomandimet afatgjata:

- Të sigurohen kushte për shkollimin e kuadrit të ri profesional sipas standardeve moderne të metodikës së mësimit të gjuhës joamtare. Të mendohen masat stimuluese për studimin e gjuhës serbe për të rinjtë nga këto tri komuna, posaçërisht nga komuniteti shqiptar.

- Të sigurohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe për përfaqësuesit dhe përfaqësueset e popullsisë shumicë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, në pajtim me standardet ndërkombëtare të mësimit dygjuhësorë.

- Me rastin e hartimit të rregullt të teksteve të reja mësimore, të analizohen qëndrimet dhe mendimet e arsimtarëve të cilët ligjërojnë gjuhën serbe si gjuhë joamtare në shkollat fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë në lidhje me materialin ekzistues mësimor, dhe të modernizohen tekstet:

të jepen tekste shtesë sipas propozimeve të arsimtarëve, nga fusha e përditshmërisë, mbrojtjes së mjedisit jetësor, argëtimit, artit dhe kryesisht, përmbajtjes e cila do t'i ndihmojë fëmijëve që të tejkalojnë komunikimin në jetën e përditshme. Të baraspeshohet disponueshmëria e përmbajtjeve kulturore për të gjitha komunitetet pakicë.

- Në përputhje me rezultatet e studimit, dhe pas përcaktimit të standardeve dhe rezultateve, të analizohet nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e planit dhe programit mësimor për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare dhe për tekstet mësimore për këtë lëndë

Shtojca 1 – Përvojat e projekteve të cilët kanë për qëllim arritjen dhe avancimin e njohjes së gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë dhe Bujanoc

Shtojca 1 – Përvojat e projekteve të cilat kanë për qëllim arritjen dhe avancimin e njohjes së gjuhës serbe si gjuhë joamtare në komunat Preshevë dhe Bujanoc

Millica Rodiq

Projekti „Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë e komunitetit shqiptar nga komunat Bujanoc dhe Preshevë“ – Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë se Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Me përkrahje të vazhdueshme të ambasadës së Britanisë së Madhe, Shërbimi i Trupit Koordinues ka organizuar dy herë pa pagesë shkollën e gjuhës serbe në Bujanoc dhe Preshevë.[97] Objektivi afatgjatë i projektit „Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë e komunitetit shqiptar nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës“ (në vazhdim: *Shkolla e gjuhës serbe*) është përmirësimi i njohjes së gjuhës zyrtare të Republikës së Serbisë, me të cilën përmirësohet integrimi.

Numri i kandidatëve të paraqitur dy herë ka tejkaluar pritjet. Mësimi i gjuhës serbe njëkohësisht është zhvilluar në Bujanoc dhe Preshevë për 310 pjesëmarrës gjatë vitit 2012/13, gjegjësisht për 250 pjesëmarrës në vitin 2013/14.

Në të dy rastet, Shërbimi i Trupit Koordinues ka publikuar prokurimin publik dhe janë përzgjedhur shkollat të cilat posedojnë licencë për organizimin e orëve të gjuhës serbe. Personat të cilët kanë zhvilluar mësim sipas profesionit janë profesoresha të gjuhës dhe letërsisë serbe dhe kanë përvojë pune në shkolla. Nën organizimin dhe realizimin e orëve i kanë ndihmuar asistentët nga komuniteti lokal të cilët gjuhën shqipe e kanë gjuhë amtare, dhe disponojnë me nivel të lartë të njohjes së gjuhës serbe. Profesoreshat e gjuhës serbe ishin të angazhuara për zhvillimin e mësimit, përderisa asistentët/asistentet, të cilët qëndrojnë në klasë gjatë mbajtjes së orëve, janë aktiv sipas thirrjes së profesoreshës. Orët janë organizuar dy herë në javë në kohëzgjatje prej katër orëve shkollore. Kohëzgjatja e përgjithshme e Shkollës është shtatë muaj, gjithsej 112 orë për çdo cikël. Për mësimdhënie janë përdorur tekstet mësimore „Fjalë për fjalë“ (për nivelet fillestare) dhe „Më shumë se fjalët“ (për nivelet mesatare) të „Institutit për gjuhë të huaja“ nga Beogradi.

97 Cikli i parë i *Shkollës së gjuhës serbe* është organizuar nga nëntori i vitit 2012. deri në maj të vitit 2013, kurse i dyti përfshinte periudhën nga nëntori i vitit 2013. deri në maj të vitit 2014.

Gjatë vitit të parë të realizimit të projektit Shërbimi i Trupit Koordinues ka përcaktuar grupin e synuar, i cili përbëhej nga të rinjtë e moshës prej 15 deri në 30 vjet. Baza fillestare për përcaktim ishte supozim i argumentuar se bëhet fjalë për grupin e vjetërsisë i cili ka nevojë për gjuhën serbe për shkak të vazhdimit më të lehtë të shkollimit, punësimit, por edhe të komunikimit të përditshëm. Duke pasur parasysh faktin se për orët e gjuhës janë paraqitur edhe ata të cilët nuk bënin pjesë në grupin e përcaktuar të vjetërsisë, gjatë vitit të dytë të realizimit të projektit të gjithë të interesuarit për arritjen dhe/apo avancimin e njohjes së gjuhës kanë mundur të ndjekin orët.

Shumica e pjesëmarrësve të *Shkollës së gjuhës serbe* janë të shkollës së mesme, të moshës 15–20 vjet,[98] nga mjediset rurale. Një numër të konsiderueshëm e përbëjnë studentët e degës së Fakultetit ekonomik në Bujanoc, por edhe studentët e profileve dhe fakulteteve tjera.[99] Pjesëmarrësit e *Shkollës së gjuhës serbe* me gjuhën serbe më së shpeshti janë në kontakt përmes mediave, gjë që paraqet ekzistimin e njohjes pasive të gjuhës e cila reflektohet në njohjen (pjesërisht) dhe pamundësinë e komunikimit verbal. Të rrallë janë pjesëmarrësit të cilët kanë komunikim aktiv, të dyanshëm në gjuhën serbe, por edhe ata të cilët e kanë kryesisht e përdorin gjuhën për kryerjen e punëve të thjeshta të përditshme. Përgjigja më e shpeshtë të cilën pjesëmarrësit e konkursit e kanë dhënë në pyetjen për çfarë arsye dëshirojnë të mësojnë gjuhën serbe është dëshira për komunikim me bashkëmoshatarët e tyre nga komuniteti tjetër, përderisa një numër i madh theksoi edhe aspektin e përfitimit nga njohja e kësaj gjuhe. Një numër i konsiderueshëm ka theksuar dëshirën që të studiojë gjuhën serbe.

Gjatë vitit të dytë të realizimit të projektit, me propozim të arsimtarëve të shkollës fillore në Bilaç (komuna e Bujanocit), në kuadër të projektit është organizuar një fond prej 58 orëve të gjuhës serbe për një grup prej 80 nxënësve nga klasa e pestë deri në klasën e tetë.

Pas testimit fillestar, me të cilin secilin vit është përcaktuar njohja fillestare e pjesëmarrësve, janë formuar grupe dhe është hartuar orari i mësimit. Për dy herë është konstatuar se një numër i madh i kandidatëve ka nivel shumë të ulët të njohjes së gjuhës serbe apo nuk ka fare.

Me qëllim të grumbullimit më sistematik të të dhënave mbi përvojat e arritura gjatë realizimit të projektit në Bujanoc dhe Preshevë janë kryer intervistat anketuese me: tri profesoresha të cila në të dy ciklet e

98 Në ciklin e parë, prej 250 pjesëmarrsëve të cilët morrën diploma, 151 ishin të gjinisë femërore kurse 99 ishin të gjinisë mashkullore. Në ciklin e dytë 180 pjesëmarrës morën diploma, 129 ishin të gjinisë femërore.

99 Të dhënat e marra nga formularët të cilat pjesëmarrësit i kanë plotësuar në orën e parë të gjuhës serbe.

projektit ishin të angazhuara në projekt;[100] dy, nga gjithsej katër asistentët;[101] fokus grupet me 20 pjesëmarrës. Gjatë grumbullimit të të dhënave për nevoja të hartimit të Studimit, është monitoruar mësimi i gjuhës serbe në Bujanoc.

Për punë në shoqërinë post-konfliktuoze dhe në mjediset me etnitet heterogjen, është i rëndësishëm posedimi i shkathtësisë së njohjes së shpejtë dhe mësimit mbi kulturën e komunitetit etnik me të cilin punohet dhe mbi specifikat e saj, dëshira në të mësuarit kulturor dhe përshtatjes në rrethanat shoqërore dhe veçantitë kulturore. Për këtë arsye përzgjedhja e personelit mësimdhënës për punë në projekt ishte punë e cila është bërë me kujdes të posaçëm. Tri profesoresha treguan se, përveç kualifikimeve formale, posedojnë edhe aftësinë e përshtatshmërisë së shpejtë dhe kuptimit të specifikave të mjedisit, me anë të së cilës shumë lehtë kanë krijuar marrëdhënie të mira me kolegët, asistentë dhe pjesëmarrësit.

Në vend të ligjërimit *ex cathedra* është insistuar në qasjen dinamike, inovative dhe ndërvepruese. Secila profesoreshë ka zhvilluar metodat e veta të punës, kurse efektet e punës dhe rezultatet e arritura janë përcjellur në nivel javor. Para zhvillimit të mësimdhënies profesoreshat me ekipin e projektit kanë bërë planin e punës me përshkrimin e metodologjisë dhe qëllimeve. Profesoreshat dhe asistentët kanë theksuar se qasja më e lirë dhe më joformale në mësimdhënie, si dhe fleksibiliteti në përzgjedhjen e përmbajtjes interesante të programit mësimor, janë të rëndësisë thelbësore për suksesin dhe rezultatet e mira në projekt. Pas përfundimit të orëve, profesoreshat për çdo javë kanë bërë analizimin e rezultateve të arritura.

Të tri profesoreshat gjatë orëve kanë përdorur metodën didaktike, duke konsideruar se kjo është mënyra më e mirë që pjesëmarrësit të inkurajohen që të flasin në gjuhën serbe. Janë përdorur edhe metoda tjera, edhe atë metoda e lojës (më së shpeshti asociacionet dhe lojërat e qëllimit, luajtja e roleve), metoda monologe dhe tekstuale.[102] Përveç tyre, janë përdorur edhe forma më të vogla konvencionale të shprehjes: krijimi i skeçeve dhe shkrimi i artikujve për revistën shkollore (puna e punëtorisë), por edhe përdorimi

100 Duke pasur parasysh se numri më i madh i kandidatëve për mësimin e gjuhës serbe ishte në komunën e Bujanocit, një profesoreshë ka ligjëruar në Preshevë, kurse dy në Bujanoc.

101 Dy asistentë janë angazhuar në mësimdhënien e gjuhës serbe në Bujanoc, kurse nga një asistent në Preshevë dhe Bilaç. Metoda e përzgjedhjes së kandidatëve për intervista është udhëhequr me logjikën se asistentët, të cilët sipas profesionit janë arsimtar dhe profesorë dhe punojnë me nxënës të moshave të ndryshme, gjatë punës në projekt kanë mundësinë të njoftohen me qasjet e reja dhe të ndryshme të punës dhe mësimdhënies. Dy asistentë të cilët janë arsimtar në shkollën fillore, gjegjësisht të mesme janë përzgjedhur që me ata të bëhet intervista.

102 Metoda e dialogut apo metoda e bisedës është metodë komplekse e punës me nxënës meqenëse ekziston një tërësi e mënyrave në të cilat ajo mundet të realizohet gjatë punës me nxënës. Kjo mënyrë e punës reflektohet në ndërveprimin dhe dialogun në relacionin arsimtar – nxënës. Metoda e lojës është mënyrë e realizimit të përmbajtjes mësimore në mënyrë që njëkohësisht nënkupton lojën dhe mësimin, gjegjësisht paraqet procesin e mësimit përmes lojës. Metodat monologe dhe tekstuale, sipas kriterit komunikues- informativ, paraqesin mënyrën e realizimit të mësimdhënies në të cilën dominon arsimtari. Metoda monologe dhe ligjëruese është metodë e paraqitjes gojore, mënyra më e vjetër dhe më e shpeshtë e punës e zbatuar në klasë. Metoda tekstuale apo metoda e punës me tekst nënkupton punën në kuadër të klasës kur nxënësit punojnë me tekstin e përgatitur paraprakisht (nga teksti mësimor, nga listat punuese etj.).

i *hartave të trurit* në mënyrë që pjesëmarrësit më lehtë të mësojnë përmbajtjet më të vështira, para së gjithash nga fusha e gramatikës. Metodat të cilat profesoreshat i kanë theksuar se japin rezultatet më të mira në mësimin e gjuhës janë mësimi përmes lojës, metoda e asociacionit, kuizet, puna me grupe, metoda e dialogut. Përzgjedhja e metodave varej nga njësia gjuhësore e cila është planifikuar për mësim, nga mosha e pjesëmarrësve dhe nga niveli i njohurisë.

Asistentët dhe profesoreshat konsiderojnë se qasja e cila zbatohet në kuadër të projektit dallon mjaftë nga ajo nëpër shkolla. Nga njëra anë, me rastin e numrit më të vogël të pjesëmarrësve në grupe[103] është vërejtur se zhvillimi i mësimit është më i thjeshtë sepse arsimtarët mund të merren me secilin pjesëmarrës dhe të konstatojnë njohuritë e arritura dhe vështirësitë të cilat pjesëmarrësi/ja i ka me rastin e përvetësimit të njësisë mësimore. Duhet pasur parasysh edhe faktin se pjesëmarrësit e *Shkollës së gjuhës serbe* kanë treguar motivim shumë të madh që të mësojnë gjuhën. Metodika e mësimit e cila karakterizohet me qasje interaktive dhe materiali të cilin pjesëmarrësit e konsiderojnë cilësor, konsiderohen sikur motivim shtesë për mësimin e gjuhës. Qasja e përdorur në këtë projekt rezulton me njohje të mirë të gjuhës sepse insistohet në dialog, mësim përmes lojës dhe asociacione, literatura i është përshtatur nivelit të njohurive të nxënësve, dhe janë të shpeshta ushtrimet me shkrim dhe me gojë. Kjo është konstatuar edhe me testet përfundimtare rezultatet e të cilëve tregojnë përmirësim të konsiderueshëm në arritjen e njohurive. Mbi 90% e pjesëmarrësve kanë kaluar testin përfundimtar.

Në bazë të përvojës në punë me nxënësit nga Bilaçi[104] profesoreshat e gjuhës serbe vënë re se nxënësit e klasës së pestë dhe të gjashtë shumë më shpejtë mësojnë dhe përvetësojnë njohuri gramatikore, para së gjithash përmbajtje të cilat paralelisht mësohen në gjuhën shqipe (llojet e fjalëve dhe rasat). Metodat e mësimit dallojnë nga ato të cilat zbatohen në Shkollën e gjuhës serbe, kurse më së tepërmi zbatohet metoda e lojës dhe asociacioneve, duke marrë parasysh se më së tepërmi i përshtatet moshës së nxënësve.

Para ndjekjes së orëve, disa pjesëmarrës të *Shkollës së gjuhës serbe* kishin njohuri pasive të gjuhës. Njohja e tillë e gjuhës reflektohet me kuptimin e plotë, apo më së shpeshti, në kuptimin e pjesërishëm të përm-

103 Secila profesoreshë ka punuar me katër grupe të pjesëmarrësve, me ç'rast numri i pjesëmarrësve në grup nuk ishte më i madh se 20.

104 Në periudhën prej janarit të vitit 2014. janë organizuar 58 orë mësimore për nxënësit e klasave të larta (prej klasës së pestë deri në të tetën) të shkollës fillore „Desanka Maksimović" në fshatin Bilaç (komuna e Bujanocit). Ideja për organizimin e orëve rrodhi nga profesorët e shkollës fillore. Qysh në fillim, sikurse edhe në projektin Shkolla e gjuhës serbe, nxënësit kalonin testin, me të cilin përcaktohen grupi i baraspeshuar në njohjen e gjuhës, gjegjësisht që pothuajse asnjë nxënës nuk ka njohuri të gjuhës. Me qëllim të punës më të lehtë me 80 nxënës, janë formuar dy grupe: njërën e përbënin nxënësit e klasës së pestë dhe të gjashtë, kurse tjetrën e përbënin nxënësit e klasës së shtatë dhe të tetë. Mësimi zhvillohej të hënave dhe të premteve, kurse dy profesoresha e angazhuara në projektin *Shkolla e gjuhës serbe* i mbanin mësim të shtuar nxënësve në Bilaç, me asistencë të mësueses nga komuniteti shqiptarë e cila punon me nxënësit e klasave të ulëta në komunën e Bujanocit.

bajtjeve të thjeshta gjuhësore. Rezultatet[105] e arritura pas shtatë muajve reflektohen me përdorimin më të shpeshtë dhe të pavarur të gjuhës serbe. Profesoreshat theksuan se pjesëmarrësit janë më të lirë në komunikim dhe se fjalët i kanë gramatikisht më mirë. Në bazë të testeve të cilat janë organizuar periodikisht me qëllim të përcaktimit të njohjes së arritur, kontrollimet e detyrave të shtëpisë (të cilat janë dhënë në nivel javor), të ushtrimeve në të folur gjatë orës dhe ushtrimeve dhe detyrave në të shkruar gjatë orës, profesoreshat kanë përcaktuar se pjesëmarrësit kanë arritur njohje fillestare të gjuhës serbe, kurse tek disa pjesëmarrës njohuritë janë avancuar. Përvetësimi i njohjes themelore të fushës së gramatikës dhe letërsisë solli deri tek vetëbesimi më i madh i pjesëmarrësve, të cilët falë kësaj, sipas mendimit të asistentëve, më shumë angazhoheshin edhe në orët e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare në mësimdhënien e rregullt.

Profesoreshat dhe asistentët theksuan se është e rëndësishme të krijohet marrëdhënie e mirë me nxënësit dhe se është e nevojshme që të zvogëlohen formalitetet në qasje, në mënyrë që të stimulohet motivimi i nxënësve për mësimin e gjuhës serbe. Motivimi i nxënësve do të duhej të stimulohet edhe jashtë shkollës, kurse është e rëndësishme që të kyçen edhe prindërit në mënyrë që nxënësit të kenë pasqyrim më të plotë në rëndësinë e mësimit të gjuhës serbe, konsiderojnë asistentët. Stimulimi i nxënësve që në mënyrë të pavarur të vijnë deri tek konkluzionet, në suaza të njohjeve leksikore dhe gramatikore, është edhe një aspekt të cilin profesoreshat dhe asistentët e kanë theksuar gjatë bisedës.

Rezultatet më të rëndësishme të këtij projekti reflektohen në rritjen e numrit të të rinjve nga komuniteti shqiptar të cilët kanë avancuar njohjen e gjuhës serbe[106] si dhe në rritjen e dëshirës dhe motivimit për mësimin e gjuhës. Ky projekt tregoi ekzistimin e dimensionit tjetër të mësimit dhe arritjes së njohurive dhe aftësive: asistentët kishin rastin që të shohin, mësojnë por edhe të projektojnë metoda personale të punës të cilat zbatohen në shkolla gjatë punës me nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme.

105 Monitorimi i përmirësimit dhe matja e rezultateve ishte shumështresore. Përveç testeve (në fillim, në mes dhe në fund të realizimit të projektit), pjesëmarrësit një herë në javë bënin detyrat e shtëpisë, kurse gjatë orëve bënin ushtrime në të folur dhe në të shkruar dhe është stimuluar komunikimi. Orët janë paramenduar ashtu që rezultatet dhe përmirësimet të munden të jenë të dukshëm në nivel javorë, duke përfshirë segmente dhe aspekte të gjuhës, adoptimi i të cilave është më i ngadalshëm në masë të konsiderueshme. Ekipi i projektit ka projektuar dy lloje të pyetësorëve. Lloji i parë shërbente për grumbullimin e të dhënave me motivimin për mësimin e gjuhës serbe, dobinë në përdorimin e njohurive të arritura dhe perceptimin e lartësisë së cilësisë së përmbajtjes së adoptuar. Këta pyetësorë janë dhënë në fillim dhe në fund të periudhës së projektit. Llojin e dytë i pyetësorëve pjesëmarrësit e kanë mbushur një herë në javë, dhe në lidhje me orët e organizuara: sa shpeshë i ndjekin, çfarë është mendimi i tyre mbi cilësinë e mësimit të cilin e ndjekin, etj.

106 Disa prej tyre njohuritë e tyre i kanë shfrytëzuar për përfitimin e bursës për studime në Novi Sad, apo për pjesëmarrje në Programin e praktikantëve, në kuadër të cilit gjatë qëndrimit gjashtëmujorë në institucionet shtetërore në Beograd kanë arritur përvojë të re të punës.

Me pjesëmarrësit e *Shkollës së gjuhës serbe* të cilët kanë ndjekur orët gjatë dy cikleve të projektit[107] janë organizuar fokus grupe. Qëllimi i këtij veprimi ishte grumbullimi i të dhënave në lidhje me motivet e mësimit të gjuhës, mënyrat dhe situatat në të cilat përdoren njohuritë e arritura. Arsyet të cilat i kanë theksuar se i kanë stimuluar që të mësojnë gjuhën serbe janë: arsimimi,[108] punësimi dhe funksionimi më i madh në punë të cilën e punojnë aktualisht dhe, në përgjithësi, për komunikim.[109] Është vërejtur edhe qëndrim pozitiv dhe dëshira për mësimin e gjuhës zyrtare.[110] Punësimi, vazhdimi i arsimimit dhe nevoja e kryerjes së punëve të përditshme janë tri përgjigje më të shpeshta në pyetjen se në çfarë mënyre planifikojnë të përdorin njohjen e arritur të gjuhës serbe.

Pjesëmarrësit në fokus grupe theksuan se pas orëve në jetën e përditshme nuk kanë vështirësi të komunikojnë në gjuhën serbe, kurse disa prej tyre theksuan se munden të lexojnë libra në gjuhën serbe dhe të përgatisin provimet, të ndjejnë se kanë më shumë vetëbesim dhe se më lehtë gjenden në kryerjen e obligimeve të përditshme. Duke pasur parasysh faktin se gjatë fokus grupeve pjesëmarrësit theksonin se njohja e gjuhës serbe ka ndikuar edhe në ngritjen e vetëbesimit të tyre, ata shtuan se ndjehen më lirë dhe më sigurt sepse munden të përdorin gjuhën. Megjithatë, pjesëmarrësit e fokus grupeve tregonin faktin se është e domosdoshme që të avancojnë njohuritë e tyre nga fusha e gramatikës dhe rregullave gramatikore.

Përveç në fakultet, me kolegët e punës dhe me shokët, pjesëmarrësit e fokus grupeve deklaruan se aktualisht përdorin gjuhën serbe në punë, në shkollë, se nganjëherë edhe në shtëpi flasin me prindërit dhe se përcjellin emisione televizive në gjuhën serbe.[111]

Në bazë të përvojave, profesoreshat dhe asistentët theksuan se për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare është me rëndësi të:

---

107 Janë mbajtur dy fokus grupe, nga një në secilën komunë. Në secilin fokus grup morën pjesë nga 10 pjesëmarrës të Shkollës së gjuhës serbe. Profesoreshat e gjuhës serbe kanë përzgjedhur personat për pjesëmarrje në fokus grupe.

108 Pjesëmarrësit të cilët kanë përfunduar studimet themelore theksuan nevojën e mësimit dhe/apo avancimit të gjuhës me qëllim të gjetjes më të lehtë të punës apo me qëllim të vazhdimit të arsimimit. Studentët e degës së Fakultetit ekonomik në Bujanoc kanë nevojë të mësojnë gjuhën serbe në mënyrë që sa më lehtë të ndjekin ligjëratat apo që të kalojnë provimet. Pjesëmarrësit më të rinj të Shkollës së gjuhës serbe, të cilët janë aktualisht nxënës të shkollave të mesme, theksuan se njohja e gjuhës i nevojitet për regjistrim në fakultete, përfitim të bursave për të studiuar në Novi Sad, por edhe për leximin e librave në gjuhën serbe.

109 Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e fokus grupeve theksuan se një nga arsyet themelore të ndjekjes së orëve të gjuhës serbe është komunikimi në gjuhë serbe në nivel ditorë (me ata të cilët punojnë në institucionet shtetërore apo me qytetarët të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare).

110 Këtu përgjigja më e shpeshtë është: „Jetojnë në Serbi dhe duhet të dimë gjuhën serbe.“ Disa individë thanë se njohja e gjuhës serbe i ofron mundësi që të shoqërohem ne serbët dhe romët.

111 „Magazin”, „Žene” dhe „Slagalica” janë emisione të cilat pjesëmarrësit e fokus grupeve theksuan se përcjellin. Disa prej tyre theksuan se përcjellin tenis dhe se sportistët e preferuar të tyre janë Novak Đoković dhe Ana Ivanović.

- që të zbatohen metodat dinamike në mësimin e gjuhës (të evitohet metoda monologe), posaçërisht të kushtohet vëmendje në mënyrën e të mësuarit të rregullave dhe përmbajtjeve gramatikore (të përdoret metoda e lojës);
- që të zvogëlohet formaliteti në qasjen e mësimdhënies së Gjuhës serbe si gjuhë joamtare;
- që të stimulohen nxënësit që në mënyrë të pavarur të vijnë në përfundim, në suaza të njohurive leksikore dhe gramatikore;
- profesionalizmi, kuadro e kualifikuar;
- njohja e gjuhës amtare të nxënësve;
- të iniciohet puna me prindërit në planin e motivimit të nxënësve që të mësojnë gjuhën serbe.

Projekti „Avancimi i aftësive gjuhësore të popullsisë minoritare në jug të Serbisë "[112] *– Misioni i OSBE-së në Serbi*

Nga shtatori i vitit 2013 Misioni i OSBE-së në Serbi (në vazhdim të tekstit OSBE), me mbështetjen financiare të ambasadës së Gjermanisë dhe Zvicrës, realizon projektin „Avancimi i aftësive gjuhësore të popullsisë minoritare në jug të Serbisë" në Shkollën e mesme „Sezai Surroi" në Bujanoc. Qëllimi i kësaj iniciative është avancimi i mundësisë dhe kornizave të integrimit të përfaqësuesve të pakicës nacionale shqiptare dhe rome përmes përmirësimit të mësimdhënies së Gjuhës serbe si gjuhë joamtare.

Projekti ka dy dimensione, prej të cilave e para nënkupton punën me nxënësit e shkollës së mesme, kurse e dyta fokusohet në përgatitjen e pjesëmarrësve të komunitetit shqiptar dhe serb për studimin e gjuhës serbe në Universitetin e Nishit. Në këtë prezantim të rezultateve të projektit i cili është realizuar nga OSBE, do të prezantohet komponenta e punës me nxënësit e shkollës së mesme. Bartësit e këtij aktiviteti janë studentë të sapodiplomuar të gjuhës dhe letërsisë serbe, të cilëve ju ofrohet mundësia që të arrijnë përvojën e parë të punës përmes pjesëmarrjes në mësimdhënie në mjedis shumetnik.

112 *Improving Language Skills of the Minority Population in South Serbia.*

Pas procedurës intensive të përzgjedhjes,[113] janë përzgjedhur pesë asistentë për mësimdhënie. Anëtarja e gjashtë e ekipit ka përfunduar studimet në Katedrën për gjuhë dhe letërsi shqipe në Beograd dhe asistentëve tjerë i ka mbajtur orë të gjuhës shqipe.[114]

Për nevoja të hartimit të Studimit, ekipi studiues ka zhvilluar intervista anketuese me: drejtorin e Shkollës së mesme „Sezai Surroi"; dhe dy arsimtar të cilët ligjërojnë gjuhë serbe si gjuhë joamtare në shkollën „Sezai Surroi" dhe marrin pjesë në projekt si mentorë të asistentëve të përzgjedhur; gjashtë asistentë; ekipin e projektit (tre përfaqësues) dhe shefin e zyrës lokale të OSBE-së në Bujanoc.

Anëtarët e ekipit studiues kanë monitoruar mësimin i cili është zhvilluar në shkollën e mesme edhe atë nga një orë të gjuhës serbe në departamentin e gjimnazit dhe departamentin e profilit profesional.

Anëtarët e ekipit të projektit theksuan se OSBE ka përzgjedhur shkollën e mesme në Bujanoc sepse bëhet fjalë për një komunë multietnike. Përveç kësaj, OSBE ka zyrën lokale në Bujanoc, gjë që bënë më të thjeshtë anën organizative të projektit, kurse me disa nga profesorët e kësaj shkolle është arritur bashkëpunimi në periudhën e mëhershme.[115] Është përzgjedhur puna me nxënësit e vitit të tretë të shkollës së mesme të të gjitha departamenteve dhe profileve.[116] Shkolla e mesme është përzgjedhur për shkak të moshës së nxënësve, kurse përfaqësuesit e OSBE-së kanë theksuar se projekti është orientuar në moshën për të cilën supozohet se e përbëjnë personat të cilët janë mjaftë të pjekurë që të mendojnë mbi ardhmërinë e tyre dhe të mendojnë se në cilat fakultete do të regjistrohen.

Sipas fjalëve të përfaqësuesve të OSBE-së, ideja fillestare për punë në avancimin e njohjes së gjuhës serbe dhe cilësisë së mësimdhënies në shkollën e mesme bazohet në përvojat e ndryshme: studentët e degës së Fakultetit ekonomik në Bujanoc për shkak të njohjes së dobët të gjuhës serbe kanë vështirësi gjatë studimeve, kurse kandidatët e përzgjedhur të Qendrës për trajnim themelor policor (Sremska Kamenicë) në masë të madhe nuk kanë kaluar testin e njohjes së gjuhës serbe, për ç'arsye nuk kanë mundur të kalojnë trajnimin e domosdoshëm dhe të arrijnë kushtin të punojnë në polici. Duke pasur parasysh se ekziston

113 Nga të gjithë kandidatët e paraqitur, janë përzgjedhur 15 prej tyre, të cilët kanë ndjekur trajnimin shtatëditorë mbi metodat e reja dhe praktikat më të mira të mësimit të gjuhës, pastaj mbi punën në mjediset shumëkulturore, zhvillimin e gjuhës në mjedise të tilla, adoptimin e „gjuhës tjetër" dhe dygjuhësisë, strategjitë dhe mjedisin të cilat stimulojnë adoptimin e „gjuhës tjetër" në klasë, njohjen themelore të gjuhës shqipte, barazisë gjinore. Asistentët e përzgjedhur janë nga jugu i Serbisë (Leskoc, Nish, Pirot) dhe nga Beogradi.

114 Është vërejtur rëndësia e mësimit të gjuhës amtare të nxënësve në mënyrë që adoptimi i gjuhës serbe të jetë më i lehtë.

115 Gjatë bisedës është theksuar se ishte e rëndësishme që të gjenden arsimtar të cilët nuk do të rezistojnë ndaj mënyrave të reja të punës, të cilët janë të hapur për qasje të reja dhe të ndryshme dhe të cilët janë të kualifikuar që të ligjërojnë këtë lëndë.

116 Grupi i synuar përbëhej nga 240 nxënës prej 13 departamenteve klasës së tretë të Shkollës së mesme „Sezai Surroi". OSBE është përqendruar në punën me nxënësit e klasës së tretë duke marrë parasysh edhe faktin se për nxënësit e klasës përfundimtare viti shkollorë zgjatë më pak për shkak të nënshtrimit në provime pranuese për fakultete.

korniza ligjore e cila përcakton mësimin e gjuhës serbe në kuadër të arsimit, OSBE projektin e ka realizuar brenda institucionit arsimor.

Drejtori i shkollës ka pranuar ftesën e OSBE-së për bashkëpunim dhe ka mundësuar që projekti të zbatohet në shkollë. Ai ka theksuar se nuk ekziston kuadër i mjaftueshëm profesional për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare, se nuk ka trajnime të mjaftueshme profesionale, të cilat do të duhej të organizohen në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik. Për rëndësinë e trajnimeve për arsimtar dhe nevojën e aftësimit profesional e theksuan edhe profesorët dhe asistentët dhe përfaqësuesit e ekipit të projektit. Përveç kësaj, drejtori theksoi se nxënësit kanë edhe përkrahjen dhe mirëkuptimin e prindërve të tyre.[117]

Mësimdhënien e zhvilluan asistentët, me mbështetjen e dy profesorëve të rregullt të cilët kanë rolin e mentorit. Ekipi i projektit të OSBE-së konsideron se asistentët kanë edhe rolin e edukatorëve të kuadrit arsimor, të cilët profesorëve munden t'i bartin njohuritë të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e mësimit në mënyrë që të dallojë nga zhvillimi i zakonshëm.

Rolin e tyre asistentët e definuan në këto mënyra: ndihmë kuadrit arsimor ekzistues që të njoftohen me metodat e reja të punës; avancimi i metodologjisë; ndihmë nxënësve që të ndryshojnë raportin ndaj mësimit të gjuhës serbe; ndihmë nxënësve në përputhje me nivelin e treguar të njohurive; përshtatja e planit dhe programit mësimor sipas njohurive të nxënësve; aftësimi i nxënësve për komunikim elementar; ndihmë nxënësve të cilët e dinë më mirë gjuhën, kurse kanë paraqitur interesimin të studiojnë gjuhën serbe; zhvillim të mësimdhënies të rregullt me monitorim të mentorëve; organizimin e aktiviteteve jashtëmësimore, përpunimi i përgatitjeve, planit të punës, testeve dhe raporteve.

Problemi me të cilin ballafaqohen profesorët gjatë punës me nxënës në shkollën e mesme është njohja e pamjaftueshme e gjuhës serbe në shkollën fillore, me ç'rast vështirësohet puna sipas programit të përcaktuar. Për këtë arsye, një nga obligimet e asistentëve ishte projektimi i përmbajtjes së secilës orë, dhe në përputhje me nevojat e vërejtura dhe me nivelin e njohurive tek nxënësit. Mënyrën e tillë të punës profesorët dhe asistentët e konsiderojnë si efektive.

Asistentët kanë theksuar se vështirësia kryesore me të cilën janë ballafaquar gjatë punës me nxënës është mospërshtatja e planit dhe programit me nxënësit e këtij mjedisi. Problemi i njëjtë është vërejtur edhe nga ana e profesorëve. Kjo mospërshtatje, sipas tyre, reflektohet në mbi-përfaqësimin e përpunimit të

117 Profesorët të cilët janë intervistuar gjithashtu kanë vërejtur rëndësinë e prindërve dhe kanë propozuar që prindërit të jenë të kyçur në aktivitetet metë cilat nxënët do të motivohen që të mësojnë gjuhën serbe.

veprave letrare dhe në orientimin e pamjaftueshëm në përdorimin praktik të gjuhës. Plani mësimor parasheh që gjuha serbe të mësohet dy herë në javë, përderisa fondi i orëve për gjuhë angleze është dy herë më i madh. Për shkak të nivelit të pa baraspeshuar të njohjes së gjuhës serbe në kuadër të secilës klasë,[118] me qëllim të mësimit të gjuhës serbe asistentët kanë përgatitur në mënyrë të pavarur secilën orë, duke u kujdesur për njohuritë e nxënësve dhe nevojën për zbatimin praktik të gjuhës.

Drejtori i shkollës, asistentët dhe profesorët vënë në dukje se qasja në mësimin e gjuhës serbe e cila zbatohet në kuadër të projektit, dallon nga e zakonshmja. Dallimi përbëhet nga fakti se në kuadër të projektit asistentët përgatisin planin e punës pavarësisht nga plani dhe programi, theksi është në gramatikë, studim dhe drejtshkrim, mënyra e të mësuarit është ndërvepruese dhe insistohet në komunikim, zhvillohet liria në komunikim të nxënësve dhe arsimtarëve, përpunohen tema të cilat janë për nxënësit. Prioritet iu është dhënë ndërveprimit me nxënësit, lojërat e rastit dhe gjuhësore, metodës bilinguale dhe qasjes multimediale. Metoda e dialogut, ndërveprimi me nxënësit përmes lojës së roleve dhe punës në grupe,organizimi i kuizeve për ndihmesa audio-vizuale i kanë kontribuar njohurive më të mira dhe rritjes së motivimit të tyre për mësimin e gjuhës.

Njohja e gjuhës amtare të nxënësve është treguar shumë e rëndësishme në procesin e mësimit të gjuhës. Me mësimin e gjuhës së komunitetit pakicë zvogëlohet distanca potenciale midis nxënësve dhe arsimtarëve, në këtë rast asistentëve. Kur asistentët gabojnë me rastin e përdorimit të kohëpaskohshëm të gjuhës shqipe në mësimdhënie, nxënësit vërejnë se gabimet janë gjë e zakonshme e cila nuk duhet të veprojë në mënyrë dekurajuese në përdorimin e gjuhës joamtare. Njohja e gjuhës shqipe është e rëndësishme edhe për mësimin e gjuhës serbe sepse përdoret me rastin e shpjegimit të njësisë mësimore dhe bëhet paralelja e rregullave gramatikore dhe të tjera në gjuhën serbe dhe shqipe. Përdorimi i metodave të theksuara jep rezultate shumë më të mira dhe më të dukshme sepse, sipas mendimit të profesorëve, asistentëve dhe drejtorit të shkollës, bëhet fjalë për mënyrën novatore të punës me nxënës.

Kushtet teknike për organizimin e mësimdhënies posaçërisht janë përmirësuar me marrjen e kabinetit për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, i cili është donacion në kuadër të projektit. Mësimi kabinetor në klasë të pajisur posaçërisht me mjete teknike i kontribuon përmirësimit të punës me nxënës, gjë që rezulton me njohjen e tyre më të mirë. Një nga propozimet e drejtorit të shkollës është se këto përfitime dhe mundësi të organizmit të mësimit në kabinet të përdoren më shpesh.[119]

118 Disa asistentë theksuan vështirësinë shtesë edhe në vështirësinë shtesë në punë me pjesëmarrësit të cilët kanë pasur njohje të cakuar të gjuhës serbe, të shkaktuar me ndikimin e dialektit lokal i cili është manifestuar edhe me gjuhën e shkruar edhe në të folur.

119 Drejtori theksoi se është e nevojshme të organizohet trajnimi i arsimtarëve me qëllim të arritjes së njohurive edhe aftësive për përdorimin e kabinetit për gjuhë serbe. Përkatësisht kjo është arsyeja që arsimtarët vetëm pjesërisht përdorin këtë përparësi në mësimdhënie. Në momentin kur është bërë intervista, kabineti nuk kishte qasje në internet, gjë që drejtori e ka theksuar sikur pengesë me organizimin më cilësorë në organizimin e mësimdhënies.

Zhvillimi i mësimit me ndihmën e asistentëve është risi e cila ia lehtëson punën profesorëve, kurse nxënësve ia bënë më interesante këtë çështje. Profesorët konsiderojnë se për shkak të organizimit më të mirë në orë duhet të reduktohet numri i asistentëve në klasë nga tre në një apo dy asistentë. Njësoj mendojnë edhe disa përfaqësues të OSBE-së.

Puna me personat jerënë klasë, sipas mendimit të asistentëve, në masë të madhe lehtëson zhvillimin e mësimdhënies dhe jep rezultate pozitive, të cilat reflektohen në projektimin e qasjeve tjera për nxënësit e niveleve të ndryshme të njohjes së gjuhës serbe, rritet motivimi dhe aktiviteti i nxënësve dhe ndihmon në „tejkalimin e barrierës gjuhësore“[120] njëkohësisht, nxënësit reagojnë pozitivisht në praninë e tyre në klasë, kurse pas ciklit të parë të projektit (shtator – dhjetor2013.) rezultatet e punës së përbashkët ishin të dukshme, posaçërisht kur bëhet fjalë për motivimin e nxënësve që të mësojnë gjuhën serbe.

Drejtori i shkollës konsideron se organizimi i mësimdhënies me asistentë është më i suksesshëm sepse mund të vërehet interesimi i shtuar i nxënësve të cilët mësojnë serbisht, avancimi i tyre në njohjen e gjuhës, motivimi që të marrin pjesë në klasë dhe aktivitetet jashtëmësimore. Propozimi për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është prezantimi i asistentëve për të gjithë arsimtarët të cilët në këtë masë ligjërojnë Gjuhën serbe si gjuhë jo-amtare dhe në të gjitha klasat.

Në bazë të përvojave të përfaqësuesve të OSBE-së për sigurimin e rezultateve të përhershme të iniciativave të ngjashme është e rëndësishme:

- përfshirja e institucioneve shtetërore të cilat do të njohin rezultatet e këtij projekti sikur shembull i praktikës së mirë (si partnerë kryesorë janë të njohur: Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, Shërbimi i Trupit Koordinues, Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit);
- përfshirja e aktorëve lokal (vetëqeverisja lokale, liderët, Këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare, drejtorët, arsimtarët, këshilli i prindërve, nxënësit);
- përfshirja e faktorëve ndërkombëtar dhe sigurimi i mbështetjes financiare;
- bashkëpunimi me Universitetin e Nishit;
- përkufizimi i planit shumëvjeçar për avancimin e mësimit të gjuhës;

120 „Tejkalimi i barrierës gjuhësore“ është theksuar si shembull i mësimit të ndërsjellët të mësimit, gjegjësisht si shembull i praktikës së mirë të mësimit të gjuhës shqipe.

- sistematizimi i vendeve të punës në mënyrë që asistentët në mësimdhënie të jenë konstant dhe praktika[121] dhe pranimi i kuadrit të ri arsimorr;
- nxjerrja e strategjisë me të cilën vetëm studentët e sapodiplomuar do të kenë praktikën e punës me nxënës në klasë, sikurse në rastin kur është ofruar në kuadër të projektit të OSBE-së;
- puna e vazhdueshme në trajnimin dhe profesionalizimin e arsimtarëve;
- mësimi i gjuhës shqipe në mesin e profesorëve dhe arsimtarëve të cilët gjuhën shqipe nuk e kanë gjuhë amtare, dhe të cilët i mësojnë nxënësit e komunitetit shqiptar;
- aplikimi i metodave të reja të reja të mësimit dhe ligjërimit

Përveç kësaj, përfaqësuesit e OSBE-së vunë në dukje se duhet avancuar dhe plotësuar tekstet ekzistuese mësimore me përmbajtje të cilat do të përpunohen në bashkëpunim me KNPNSH, si dhe se duhet punuar në përshtatjen e planit dhe programit mësimor për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare.

Përfaqësuesit e OSBE-së theksuan se me iniciativën e këtij lloji dëshirohet të paraqiten zgjidhje tjera kur bëhet fjalë mbi realizimin e mësimdhënies dhe se ndryshimet në brendi të sistemit janë të mundura.[122]

121 Rekomandimi që në vend të tre asistentëve në mësimdhënie të marrin pjesë vetëm dy asistentë.

122 Me „ndryshime“ përfaqësuesit e OSBE-së, sikurse theksuan, mbështesin ndryshimet e programit dhe përfshirjen e asistentëve në sistemin e arsimimit.

Shtojca 2 – Vështrim tabelar i nxënësve sipas shkollave në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes

Shtojca 2 – Vështrim tabelar i nxënësve sipas shkollave në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes

Përgatitur nga Millica Rodiq

Të dhënat për Bujanovc dhe për Preshëve janë marrë nga drejtorët e shkollave, ndërsa për Medvegjë nga administrata komunale. Këto të dhëna janë shfrytëzuar në planifikimin e punës në terren për mbledhjen e të dhënave në shkolla. Të dhënat janë për vitin shkollor 2013/2014 dhe paraqesin numrin e nxënësve në shkolla të cilat nxënësit nga komuniteti shqiptar i vijojnë.

Shkollat në komunën e Bujanovcit:

ShF 'Ali Bektashi' Nesalce (komuna Bujanovc)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	21	12	9
II	36	20	16
III	35	14	21
IV	41	23	18
I–IV	**133**	**69**	**64**
V	53	31	22
VI	37	20	17
VII	50	29	21
VIII	45	20	25
V–VIII	**185**	**100**	**85**
GJITHSEJTË	**318**	**169**	**149**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 4.			

ShF 'Desanka Maksimović' Bilaqë (komuna Bujanovc) [121]			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	36	17	19
II	26	12	14
III	44	20	24
IV	49	24	25
I–IV	**155**	**73**	**82**
V	44	21	23
VI	51	27	24
VII	64	30	34
VIII	50	27	23
V–VIII	**209**	**105**	**104**
GJITHSEJTË	**364**	**178**	**186**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 3.			

ShF 'Migjeni' Muhovc (komuna Bujanovc)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	9	4	5
II	16	9	7
III	17	7	10
IV	15	11	4
I–IV	**57**	**31**	**26**
V	12	2	10
VI	16	13	3
VII	20	9	11

VIII	20	9	11
V–VIII	**68**	**33**	**35**
GJITHSEJTË	**125**	**64**	**61**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 3.			

ShF 'Muharem Kadriu' Trnovci i Madh (komuna Bujanovc)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	62	34	28
II	80	41	39
III	85	48	37
IV	98	50	48
I–IV	**325**	**173**	**152**
V	121	64	57
VI	110	52	58
VII	113	65	48
VIII	108	55	53
V–VIII	**452**	**236**	**216**
GJITHSEJTË	**777**	**409**	**368**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 7.			

ShF 'Naim Frasheri' Bujanovc			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	34	21	13
II	42	21	21
III	38	17	21
IV	37	20	17

I–IV	**151**	**79**	**72**
V	48	25	23
VI	65	32	33
VII	43	23	20
VIII	60	30	30
V–VIII	**216**	**110**	**106**
GJITHSEJTË	**367**	**219**	**178**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 5.			

ShF ’Sami Frasheri’ Luçan (komuna Bujanovc)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	35	17	18
II	36	23	13
III	34	15	19
IV	31	17	14
I–IV	**136**	**72**	**64**
V	34	17	17
VI	54	28	26
VII	62	32	30
VIII	50	17	33
V–VIII	**200**	**94**	**106**
GJITHSEJTË	**336**	**166**	**170**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 6.			

Shkollat në komunën e Preshevës:

ShF '9 Maj' Relan (komuna Preshevë)						
Mësimi në gjuhën serbe				Mësimi në gjuhën shqipe		
KLASA	**NR. I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**	**KLASA**	**NR. I NXËNËSVE**	**DJEM**
I	11	8	3	40	21	19
II	12	7	5	36	20	16
III	5	2	3	44	19	25
IV	9	5	4	49	28	21
I–IV	**37**	**22**	**15**	**169**	**88**	**81**
V	10	7	3	67	36	31
VI	4	3	1	46	24	22
VII	5	2	3	47	30	17
VIII	2	1	1	48	25	23
V–VIII	**21**	**13**	**8**	**208**	**115**	**93**
GJITHSEJTË	**58**	**35**	**23**	**377**	**203**	**174**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 4.						

ShF 'Abdulla Krashnica' Miratovci (komuna Preshevë)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	18	8	10
II	25	13	12
III	31	23	8
IV	31	16	15
I–IV	**105**	**60**	**45**
V	37	19	18

VI	52	25	27
VII	46	28	18
VIII	36	17	19
V–VIII	**171**	**89**	**82**
GJITHSEJTË	**276**	**149**	**127**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 4.			

ShF 'Dituria' Crnotince (komuna Preshevë)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	25	15	10
II	34	19	15
III	45	18	27
IV	38	22	16
I–IV	**142**	**74**	**68**
V	41	23	18
VI	48	24	24
VII	45	23	22
VIII	50	25	25
V–VIII	**184**	**95**	**89**
GJITHSEJTË	**326**	**169**	**157**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 4.			

ShF 'Ibrahim Kelmendi' Preshevë			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	160	88	72
II	183	106	77

III	198	97	101
IV	187	85	102
I–IV	**728**	**376**	**352**
V	264	124	140
VI	270	143	127
VII	251	132	119
VIII	231	110	121
V–VIII	**1016**	**509**	**507**
GJITHSEJTË	**1744**	**885**	**859**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 12.			

ShF ‘Selami Halaqi’ Oraovicë (komuna Preshevë)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	34	17	17
II	50	30	20
III	55	30	25
IV	46	19	27
I–IV	**185**	**96**	**89**
V	63	35	28
VI	67	30	37
VII	68	28	40
VIII	45	23	22
V–VIII	**243**	**116**	**127**
GJITHSEJTË	**428**	**212**	**216**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 4.			

ShF 'Zenelj Hajdini' Rainc (komuna Preshevë)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	15	8	7
II	32	19	13
III	20	11	9
IV	30	16	14
I–IV	**97**	**54**	**43**
V	33	23	10
VI	21	14	7
VII	34	19	15
VIII	30	18	12
V–VIII	**118**	**74**	**44**
GJITHSEJTË	**215**	**128**	**87**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 4.			

ShF 'Migjeni' Cerevajka (komuna Preshevë)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	7	3	4
II	5	3	2
III	5	2	3
IV	10	4	6
I–IV	**27**	**12**	**15**
V	7	3	4
VI	5	2	3
VII	8	4	4
VIII	6	5	1
V–VIII	**26**	**14**	**12**
GJITHSEJTË	**53**	**26**	**27**

Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 2.

Shkollat në komunën e Medvegjës:

ShF 'Zenel Hajdini' Tupal (komuna Medvegjë)			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I–IV	5	3	2
V–VIII	16	7	9
GJITHSEJTË	**21**	**10**	**11**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 2.			

ShF 'Jabllanica e Epërme' Medvegjë[122]			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
II	2	1	1
IV	3	1	2
GJITHSEJTË	**5**	**2**	**3**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 1.			

ShF 'Banja e Sijarinit', Banja e Sijarinit (komuna Medvegjë)[123]			
KLASA	**NUMRI I NXËNËSVE**	**DJEM**	**VAJZA**
I	5	3	2
II	3	2	1
III	3	2	1
IV	4	4	/
I–IV	**15**	**11**	**4**

V	2	/	2
VI	4	2	2
VII	5	3	2
VIII	3	2	1
V–VIII	**14**	**7**	**7**
GJITHSEJTË	**29**	**18**	**11**
Numri i arsimtarëve që japin gjuhën serbe si gjuhë joamtare është 2.			

Shtojca 3 – Pyetësorët e shfrytëzuar përgjatë hulumtimit në terren në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes

Shtojca 3 – Pyetësorët e shfrytëzuar përgjatë hulumtimit në terren në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes

Në këtë shtojcë janë paraqitur gjithsejtë 16 pyetësorë dhe një udhërrëfyes të përpiluar për nevojat e hulumtimit në terren. Të dhënat tjera mbi hulumtimin në terren dhe për çdo pyetësor dhe udhërrëfyes të përdorur shpalosën në pjesën III.1 Korniza Metodologjike e Hulumtimit.

1.

Shënim: Pyetësori është përpiluar për nevojat e zhvillimit të bisedës me pjesëtarin e kuvendit, me kryetarët e tre komunave dhe me kryetarin e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare.

1. *Si e vlerësoni cilësinë e arsimit fillor në Bujanovc/Preshevë/Medvegjë?*
2. *Cilat janë vështirësitë e sistemit arsimor me të cilat përballet komuna e Bujanovcit/Preshevës/Medvegjës?*
3. *A jeni në dijeni me çështjen e cilësisë së mësimdhënies?*
4. *A jeni në dijeni se çfarë është cilësia e mësimdhënies së gjuhës serbe si gjuhë jo amtare?*
5. *Njohuritë nga cilat lëndë/fusha janë më të çmueshmet – cilat lëndë është më e rëndësishme t'i dinë fëmijët?*
6. *A keni njohuri mbi atë se a besojnë shumica e prindërve, fëmijët e cilëve vijojnë shkollën fillore në këtë komunë, se është e domosdoshme që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhen serbe?*
7. *A e konsideroni ju të rëndësishme që fëmijët të dinë gjuhën serbe?*
8. *Pse mendoni kështu?*
9. *A jeni të mendimit se njohja e gjuhës do t'ju mundësonte përparim të rinjve (përparim personal, profesional, etj). Arsyetoni përgjigjën tuaj.*

10. A do të mbështetnit mundësinë që fëmijët të mësojnë gjuhën serbe edhe më mirë?

11. A do të mbështetnit iniciativën që filloristët të vijojnë mësimin e gjuhës serbe të organizuar në mënyrë tjetër (p.sh. përmes angazhimit të asistentëve, përmes përdorimit të metodave tjera, përmes lojërave, etj)?

12. A kanë pasur mundësi fëmijët e shkollave të ndryshme të kenë aktivitete të përbashkëta përmes së cilave shoqërohen?

13. A do të mbështetnit iniciativën që për nxënësit e shkollave të ndryshme të cilët nuk flasin gjuhën e njëjtë të organizohen aktivitete, përmes së cilave do të nxitej të mësuarit e gjuhës dhe shoqërimi?

2.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me drejtorët e shkollave fillore në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, ku mësimi zhvillohet në gjuhë shqipe.

I. Konteksti

1. Sa është numri i nxënësve në shkollë të cilët gjuhën serbe nuk e kanë gjuhë amtare?

II. Perspektivat

1. A jeni të kënaqur me mënyrën se si jepet serbishtja si gjuhë joamtare në këtë shkollë?

2. A e dini se a e konsiderojnë shumica e prindërve të fëmijëve të kësaj shkolle të rëndësishme që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën serbe?

III. Mësimdhënia

1. Mësimdhënësit në shkollën tuaj që japin gjuhën serbe, a japin edhe lëndë tjera?

2. Nëse mësimdhënësit janë të angazhuar edhe në lëndë tjera, cekni se në cilat lëndë.

3. Mësimdhënësi i kësaj shkolle i cili jep gjuhën serbe, a ligjëron edhe në ndonjë shkollë tjetër?

4. Nëse mësimdhënësi është i angazhuar edhe në shkolla tjera, atëherë sa shpesh punon në shkollën në të cilën jeni ju drejtor (në jave)?

5. Cili është niveli i kualifikimeve i cili i nevojitet kandidatëve që të angazhohen në këtë shkollë si mësimdhënës të serbishtes si gjuhë joamtare?

6. A është përgatitja profesionale e kuadrit mësimdhënës në këtë shkollë e kënaqshme për këtë lëndë?

7. A jeni të kënaqur me disponibilitetin e kuadrit mësimdhënës i cili është i trajnuar/ka përgatitjen e duhur profesionale për këtë lëndë?

8. A keni angazhuar për lëndën e gjuhës serbe mësimdhënës të cilët kanë nivel më të ulët të përgatitjes profesionale se ai i paraparë? Nëse po, pse?

9. Cilët tekste mësimore shfrytëzohen nga mësimdhënësit për mbajtjen e kësaj lëndë?

10. A shfrytëzojnë mësimdhënësit e kësaj shkolle që japin lëndën e gjuhës serbe metoda të reja të punës me fëmijë?

11. Cilat metoda i shfrytëzojnë ata kryesisht?

12. A mendoni se materiali digjital apo ndonjë material tjetër do të ishte i dobishëm për të mësuar gjuhën serbe?

13. A mendoni se disa qasje të reja dhe trajnime shtesë do të jepnin rezultate edhe më të mira tek nxënësit kur është fjala për mësimin e gjuhës serbe? A keni ndonjë propozim për qasje të reja?

14. A do të ishit të gatshëm që më mësimdhënësit në këtë shkollë të provoni ide të reja në punën ekzistuese me nxënësit kur është fjala për këtë lëndë?

15. A keni propozime konkrete për përmirësimin e cilësisë së dhënies së serbishtes si gjuhë joamtare?

16. A ka (dhe cilat janë ato) pengesa për realizimin e këtyre propozimeve? Nëse mendoni se ka, atëherë ju lutëm saktësoni se për çfarë saktësisht mendoni?

IV. Resurset

1. A ka shkolla kabinet për mbajtjen e mësimit të serbishtes si gjuhë joamtare?

2. Sa janë të pajisura teknikisht hapësirat shkollore ku zhvillohet mësimi i kësaj lënde?

3. A keni mundësi të dëgjoni audio incizimet?

4. Nëse përgjigja e juaj është po, shkruani se a e shfrytëzojnë mësimdhënësit këtë mundësi për organizimin e orëve mësimore të gjuhës serbe?

5. A keni kompjuter dhe projektor?

6. Nëse përgjigja e juaj është po, shkruani se a e shfrytëzojnë mësimdhënësit këtë mundësi për organizimin e orëve mësimore të gjuhës serbe?

7. A keni qasje në internet?

8. Nëse përgjigja e juaj është po, shkruani se a e shfrytëzojnë mësimdhënësit këtë mundësi për organizimin e orëve mësimore të gjuhës serbe?

V. Mbështetja

1. A mendoni se është e domosdoshme të investohet në trajnimin e kuadrit ekzistues të mësimdhënësve i cili është i ngarkuar për gjuhën serbe?

2. Cili do të ishte propozimi i juaj përkitazi trajnimeve të cilat këta mësimdhënës duhet t'i vijojnë?

3. A i vijojnë mësimdhënësit e kësaj shkolle trajnimet që mbahen nga Ministria e Arsimit?

4. Nëse po, sa shpesh dhe ku?

5. A japin rezultate këto trajnime dhe çfarë rezultate?

6. Nëse nuk japin rezultatet e dëshiruara, cekni se cili është mendimi juaj se pse është ashtu?

VI. Aktivitetet

1. *A organizoni për nxënësit e juaj aktivitete të përbashkëta me nxënësit e shkollave tjera përmes së cilave ata shoqërohen?*

2. *A do të mbështetnit idenë që për nxënësit e shkollave të ndryshme, të cilët nuk flasin gjuhën e njëjtë, të organizohen aktivitete me të cilat do të nxitej mësimi i gjuhës dhe shoqërimi?*

3. *A pajtoheni se gjeneratat e vjetra njohin gjuhën serbe më mirë se sa gjeneratat e reja? Nëse po, pse mendoni se është kështu?*

3.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me mësimdhënësit të cilët japin serbishten si gjuhë joamtare në shkollat fillore të komunave të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe.

I. Të dhënat e arsimtarit

1. *Vendi ku jepni serbishten si gjuhë joamtare:*

2. *Shkollat ku jepni serbishten si gjuhë joamtare:*

3. *Klasat ku jepni serbishten si gjuhë joamtare:*

4. *Përgatitja profesionale / shkolla më e lartë e kryer (shënoni emrin e plotë dhe vendin e institucionit arsimor):*

    1. Shkolla fillore _____

    2. Shkolla e mesme: _____

    3. Shkolla e lartë: _____

    4. Fakultet, studime themelore: _____

5. Fakultet, studime magjistrature, masteri apo të specializuara:_____

6. Fakultet, studime doktorature: _____

5. Sa gjatë e jepni lëndën e serbishtes si gjuhë joamtare:

6. Gjuha amtare e arsimtarit:

1. Shqip;

2. Serbisht;

3. Tjetër, cekni_____ .

II. Të dhënat për mbajtjen e orëve mësimore

7. Kur përgjatë orës mësimore e shfrytëzoni gjuhën e nxënësve tuaj?

1. Nuk e njoh gjuhën amtare të nxënësve të mi;

2. Gjatë gjithë kohës;

3. Kur shpjegoj material të ri;

4. Evitoj shfrytëzimin e gjuhës amtare;

5. Diçka tjetër, cekni _____ .

8. Sa kohë ndani mesatarisht gjatë një ore mësimore për shpjegim e sa për ushtrim të materialit të ri nga gjuha/gramatika?

1. Shpjegim deri në 15 minuta, e tjerat ushtrim;

2. Pothuajse njëjtë;

3. Shpjegim pjesën më të madhe të orës ndërsa ushtrim në fund;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

9. Për sa kohë të orës suaj mësimore bëhet shprehja verbale e nxënësve e sa ajo me shkrim?

1. Barabartë;

2. Më shumë kohë bëhet me shkrim (përfshirë edhe kryerjen e detyrave nga gjuha / gramatika);

3. Më shumë kohë me gojë (dialog, monolog, ushtrime gramatikore me gojë);

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

10. Përshkruani se si i përpunoni më së shpeshti mësimet e reja të gjuhës:

1. Kryesisht e përcjell materialin, renditjen dhe vëllimin e cekur në tekstin mësimor;

2. Sjell material shtesë (tekste, ilustrime, përmbajtje muzikore, filma, lojëra...);

3. Kombinoj përmbajtjen e tekstit mësimor me materiale shtesë;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

11. A ju shpjegoni fjalët e reja të panjohura nxënësve?

1. Po

2. Jo

12. Nëse në pyetjen paraprake jeni përgjigjur me po, atëherë cekni se në çfarë mënyrë ju shpjegoni fjalët e reja të panjohura nxënësve?

1. I përkthej në gjuhën amtare;

2. Përdori ilustrime (ilustrime të përgatitura apo vizatoj në tabelë);

3. Përdori metodën e përshkrimit dhe asociacionit që të sjell nxënësit tek kuptimi i fjalës së re;

4. Diçka tjetër, shpjego _____ .

13. Nëse në pyetjen me numër 11 jeni përgjigjur me jo, atëherë shpjegoni se pse nxënësve nuk ju shpjegoni fjalët e reja të panjohura:

1. Nxënësit shfrytëzojnë fjalor;

2. Këtë ua jap detyrë shtëpie;

3. Nxënësit përkthejnë fjalët me njëri-tjetrin;

4. Diçka tjetër, shpjego _____ .

14. A bëni ushtrime të simulimit të situatave reale të jetës në orët e juaja mësimore?

1. Në orë mësimore nuk bëjmë simulime të situatave reale të jetës për arsye se _____ ;

2. Shumë rrallë, disa herë në vit;

3. Më pak se një herë në muaj;

4. Një apo dy herë në muaj;

5. Një herë në javë;

6. Pothuajse se në çdo orë.

15. Nëse me nxënësit bëni simulime të situatave reale të jetës, atëherë cekni disa situata të cilat i merrni shembull më së shpeshti (cilat situata jetësore më së shpeshti i përpunoni në këtë mënyrë):

16. Cilat mjete mësimore i përdorni për mbajtjen e mësimit (duhet të jepni vetëm një arsye)?

1. Kryesisht përdori tekste mësimore (cekni tekstet);
2. Kryesisht përdori video-materiale (cekni cilat video-materiale i shfrytëzoni);
3. Kryesisht përdori audio-materiale (cekni audio-materialet);
4. Kryesisht përdori mjete tjera vizuale/foto, fotografi, libra, etj (cekni mjetet);
5. Përpiloj material vetanak (duke shfrytëzuar cilat burime);
6. Qasje e kombinuar – shfrytëzimi i shumë mjeteve (cekni cilat mjete më së shpeshti i kombinon).

III. Tekstet mësimore, plani dhe programi

17. A i shfrytëzoni tekstet mësimore të 'Entit për Tekste Mësimore'?

1. Po
2. Jo (shpjegoni pse) _____ .

18. Nëse i shfrytëzoni tekstet mësimore të 'Entit për Tekste Mësimore', cili është mendimi i juaj për librat e fëmijëve me figura nga aspekti i dobishmërisë së tyre:

1. Librat e fëmijëve me figura janë shumë të dobishme dhe më ndihmojnë në mbajtjen e mësimit për çdo orë mësimore;
2. Librat e fëmijëve me figura janë pjesërisht të dobishme;
3. Librat e fëmijëve me figura nuk janë të dobishme dhe nuk më ndihmojnë në planifikimin dhe mbajtjen e mësimit;
4. Diçka tjetër, cekni _____ .

19. Cili është mendimi i juaj për këto libra fëmijësh me figura nga aspekti i strukturës së tyre:

1. Librat e fëmijëve me figura kanë një strukturë mirë të menduar dhe mënyrë të mirë të shpalosjes së përmbajtjes (me mësime dhe detyra nga më të lehtat deri të më komplekse, etj);
2. Librat e fëmijëve me figura kanë një strukturë pjesërisht mirë të menduar dhe mënyrë të mirë të shpalosjes së përmbajtjes;
3. Librat e fëmijëve me figura nuk kanë strukturë mirë të menduar dhe përmbajtja nuk është e shpalosur mirë;
4. Diçka tjetër, cekni _____ .

20. Cili është mendimi i juaj për këto libra fëmijësh me figura nga aspekti i përshtatshmërisë së tyre nxënësve të moshës së caktuar:

1. Librat e fëmijëve me figura janë për nga përmbajtja dhe struktura plotësisht të përshtatura nxënësve;
2. Librat e fëmijëve me figura janë për nga përmbajtja dhe struktura pjesërisht të përshtatura nxënësve;
3. Librat e fëmijëve me figura nuk janë të përshtatura nxënësve as për nga përmbajtja as për nga struktura;
4. Diçka tjetër, cekni _____ .

21. Cili është mendimi i juaj për porositë (mësimet) e nxjerra nga gjuha/gramatika nga aspekti i dobishmërisë së tyre:

1. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika janë shumë të dobishme dhe më ndihmojnë në mbajtjen e mësimit në çdo orë;
2. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika janë pjesërisht të dobishme;
3. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika nuk janë të dobishme dhe nuk më ndihmojnë në mbajtjen e mësimit;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

22. Cili është mendimi i juaj për porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika nga aspekti i strukturës së tyre:

1. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika kanë strukturë dhe mënyrë të shpalosjes së përmbajtjes mirë të menduar (mësime dhe detyra të lehta deri te ato komplekse, etj);

2. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika kanë strukturë dhe mënyrë të shpalosjes së përmbajtjes pjesërisht mirë të menduar;

3. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika nuk kanë strukturë mirë të menduar dhe përmbajtja nuk është mirë e shpalosur;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

23. Cili është mendimi i juaj për porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika nga aspekti i përshtatshmërisë së tyre nxënësve:

1. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika janë të përshtatura nxënësve nga aspekti i përmbajtjes dhe strukturës;

2. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika janë pjesërisht të përshtatura nxënësve nga aspekti i përmbajtjes dhe strukturës;

3. Porositë e nxjerra nga gjuha/gramatika nuk janë të përshtatura nxënësve as për nga përmbajtja as për nga struktura;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

24. Cili është mendimi i juaj për fletorët e punës nga aspekti i dobishmërisë së tyre:

1. Fletorët e punës janë shumë të dobishme dhe më ndihmojnë në sajimin e detyrave për fëmijët;

2. Fletorët e punës janë pjesërisht të dobishme;

3. Fletorët e punës nuk janë të dobishme dhe nuk më ndihmojnë në mbajtjen e mësimit;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

25. Cili është mendimi i juaj për fletorët e punës nga aspekti i strukturës së tyre:

1. Fletorët e punës kanë strukturë mirë të menduar (nga detyra të lehta deri te ato komplekse, etj);

2. Fletorët e punës kanë strukturë pjesërisht mirë të menduar;

3. Fletorët e punës nuk kanë strukturë mirë të menduar dhe përmbajtja nuk është mirë e shpalosur;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

26. Cili është mendimi i juaj për fletorët e punës nga aspekti i përshtatshmërisë së tyre nxënësve:

1. Fletorët e punës janë plotësisht të përshtatura nxënësve për nga përmbajtja dhe struktura e tyre;

2. Fletorët e punës janë pjesërisht të përshtatura nxënësve për nga përmbajtja dhe struktura e tyre;

3. Fletorët e punës nuk janë të përshtatura nxënësve as për përmbajtja as për nga struktura;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

27. A ekzistojnë tekste në këto libra fëmijësh me figura të cilat sipas mendimit tuaj janë të tepërta ose të panevojshme?

28. A mendoni se materiali në tekstet mësimore është tepër voluminoz?

1. Po (shpjego) _____

2. Jo.

29. Cilat mësime dhe përmbajte keni vërejtur se nxënësve ju pëlqejnë më shumë / nxënësit përvetësojnë njohuri më shpejtë nga to?

30. Cilat mësime dhe përmbajte keni vërejtur se nxënësit e kanë më vështirë t'i përvetësojnë / nuk janë të kuptueshme?

31. A ka sipas mendimit tuaj, material në plan-programin për serbishten si gjuhë joamtare, i cili nuk është i përshtatshëm për nxënësit e moshës së caktuar?

1. Po (cekni se cilat janë ato materiale)

2. Jo, konsideroj se plan-programi ekzistues është shumë i përshtatshëm.

32. A mendoni se plan-programi duhet të plotësohet apo ndryshohet?

1. Po (cekni me çfarë materiali)

2. Jo.

IV. Vlerësimi dhe vetë-vlerësimi i mësimdhënësve

33. Në çfarë mënyre e matni nivelin e arritur të njohurive nga nxënësit (mund të jepen disa përgjigje)?

1. Përmes testeve;

2. Përmes kontrollimit të detyrave të shtëpisë;

3. Ushtrimeve me gojë në orë;

4. Ushtrimeve me shkrim dhe detyra në orë;

5. Diçka tjetër, cekni _____ ;

6. Nuk kontrolloj njohurinë e nxënësve të mi.

34. Sipas vlerësimit tuaj, a e njohin mirë nxënësit tuaj gjuhën serbe?

1. Kam vërejtur se shkruajnë, lexojnë dhe komunikojnë në mënyrë të shkëlqyeshme në gjuhën serbe;

2. Janë të mirë në komunikimin verbal, mirëpo nevojitet përmirësim në shkrim dhe në lexim;

3. Tregojnë njohuri të mirë në lexim dhe në shkrim në gjuhën serbe, mirëpo nevojitet përmirësimi i shkathtësive të tyre verbale;

4. Nevojiten përmirësime në komunikimin me shkrim dhe verbal.

35. *Cilat veprime (procedura) tuaja përgjatë orës mësimore (metoda, teknika e punës, llojet e detyrave dhe ushtrimeve, etj) motivojnë nxënësit për të mësuar gjuhën serbe?*

36. *Cilat veprime (procedura) përgjatë orës i konsideroni se më dobët ndikojnë në arritjen e rezultateve të dëshiruara?*

37. *A i korrigjoni, në bazë të notave dhe njohurisë së nxënësve tuaj, metodat për mësimin e gjuhës serbe (në mënyrë që ata të arrijnë rezultate sa më të mira):*

    1. Po, pas çdo ore e shoh se cila qasje iu konvenon më së shumti në punën e tyre dhe cila qasje sjell rezultate më të mira, dhe tentoj ta aplikojë atë qasje sa më shpesh;

    2. Kohë pas kohe;

    3. Definoj metodën time e cila më së shumti më konvenon mua pavarësisht efektit/rezultatit.

38. *A do të ishit të gatshëm të aplikoni metoda dhe mënyra të reja të punës në mbajtjen e serbishtes si gjuhë joamtare? Arsyetoni përgjigjën tuaj:*

    1. Po _____

    2. Jo _____

39. *A mund të na tregoni propozimet tuaja, nëse keni, për rritjen e suksesit në përvetësimin e gjuhës serbe nga nxënësit.*

V. Mbështetja

40. A merrni mbështetje shtesë nga Ministria e Arsimit për mbajtjen e orëve mësimore të gjuhës serbe?

1. Trajnim për mësimdhënësit PO JO

   Ku _____

   Sa shpesh _____

2. Pajisje shtesë për klasat mësimore PO JO

   (Shpjegoni cilat pajisje) _____

3. Material shtesë mësimor PO JO

   (shpjego çfarë materiali) _____

4. Diçka tjetër PO JO

   (shpjego) _____

NË PYETJET E RADHËS PËRGJIGJËN VETËM MËSIMDHËNËSIT TË CILËT KANË CEKUR SE PRANOJNË MBËSHTETJE SHTESË NGA MINISTRIA E ARSIMIT

41. Me notat nga 1 në 5 (ku 1 d.m.th. shumë dobët ndërsa 5 shkëlqyeshëm) vlerësoni rëndësinë dhe ndikimin e mbështetjes shtesë të cilën e pranoni nga Ministria e Arsimit:

1. Trajnim për mësimdhënës:	1	2	3	4	5
2. Pajisje shtesë për klasat mësimore:	1	2	3	4	5
3. Material shtesë mësimor:	1	2	3	4	5
4. Diçka tjetër (shpjego):	1	2	3	4	5

42. A pranoni mbështetje për mbajtjen e orëve mësimore nga akterët tjerë (p.sh. nga donatorët, administrata komunale apo nga ndonjë tjetër)?

1. Nuk pranojmë asnjë mbështetje shtesë

2. Trajnim për mësimdhënës PO JO

   Ku _____

   Sa shpesh _____

3. Pajisje shtesë për klasat mësimore PO JO

   (Shpjego çfarë pajisje, nga kush) _____

4. Material shtesë mësimor PO JO

   (shpjego çfarë materiali) _____

5. Mbështetje shtesë financiare (p.sh. rrogë shtesë, etj) PO JO

   (shpjego)_____

6. Diçka tjetër PO JO

   (shpjego) _____

NË PYETJET E RADHËS PËRGJIGJËN VETËM MËSIMDHËNËSIT TË CILËT KANË CEKUR SE PRANOJNË MBËSHTETJE SHTESË NGA AKTERËT TJERË

43. Me notat nga 1 në 5 vlerësoni rëndësinë dhe shkallën e ndikimit të mbështetjes të cilën e pranoni nga akterët tjerë

1. Trajnim për mësimdhënës:	*1*	*2*	*3*	*4*	*5*
2. Pajisje shtesë për klasat mësimore:	*1*	*2*	*3*	*4*	*5*

3. Material shtesë mësimor:	*1*	*2*	*3*	*4*	*5*
4. Mbështetje shtesë financiare:	*1*	*2*	*3*	*4*	*5*
5. Diçka tjetër (shpjego):	*1*	*2*	*3*	*4*	*5*

44. A shfrytëzoni doracakë për mësimdhënës në planifikimin e orëve mësimore?

45. Gjeneratat e vjetra e njohin mirë gjuhën serbe, për dallim nga gjeneratat e reja. A pajtoheni më këtë dhe pse mendoni se është kështu?

4.

Shënim: Pyetësorin e kanë plotësuar filloristët e klasës IV, V, VI, VII dhe VIII të shkollave fillore të komunës së Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës ku mësimi zhvillohet në gjuhës shqipe.

1. Emri i shkollës:

2. Vendi:

3. Gjinia (rrumbullakëso)

1. Mashkull 2. Femër

4. Në cilën klasë je?

5. Çka të pëlqen më së shumti në orët e gjuhës serbe (mund të rrumbullakësosh disa përgjigje)?

1. Mënyra në të cilën arsimtari punon me ne;
2. Tekstet mësimore të cilat i kemi;
3. Materiali shtesë (video, audio, fotot, etj);
4. Diçka tjetër _____ .

6. Çka të pëlqen më së paku në orët e gjuhës serbe (mund të rrumbullakësosh disa përgjigje)?

1. Mënyra në të cilën arsimtari punon me ne;
2. Tekstet mësimore të cilat i kemi;
3. Materiali shtesë (video, audio, fotot, etj);
4. Diçka tjetër _____ .

7. Sa minuta zgjatë një orë e gjuhës serbe?

8. A mendon se gjatësia e orës së gjuhës serbe është e duhur (rrumbullakëso një përgjigje):

1. Gjatësia e orës është në rregull;
2. Ora është shumë e gjatë;
3. Ora është shumë e shkurtër;

9. Çka bëni në orët e gjuhës serbe, si duken ato? (mund të rrumbullakësosh disa përgjigje)

1. Arsimtari kryesisht flet e ne përgjigjemi kur na bën pyetje;
2. Këndojmë këngë, recitojmë;
3. Shikojmë filma dhe video-materiale tjera interesante të cilat na ndihmojnë të mësojmë gjuhën;
4. Vizatojmë, ngjyrosim, bëjmë kolazhe, stripa, foto, etj;
5. Në serbisht komunikojmë mjaftueshëm, sajojmë situata konkrete dhe aktrojmë role të ndryshme;
6. Shkruajmë këngë, hartime dhe artikuj për shkollën tonë dhe rrethinën;
7. Diçka tjetër, ceke _____ .

10. Çfarë kishe dëshiruar të bëni në orët e gjuhës serbe? (mund të rrumbullakësosh disa përgjigje)

1. Këndojmë këngë, recitojmë;

2. Shikojmë filma dhe video-materiale tjera interesante të cilat na ndihmojnë të mësojmë gjuhën;

3. Vizatojmë, ngjyrosim, bëjmë kolazhe, stripa, foto, etj;

4. Në serbisht komunikojmë mjaftueshëm, sajojmë situata konkrete dhe aktrojmë role të ndryshme;

5. Shkruajmë këngë, hartime dhe artikuj për shkollën tonë dhe rrethinën;

6. Diçka tjetër, ceke _____ .

11. A ju jep arsimtari detyra të shtëpisë?

1. PO 2. JO

12. Çfarë lloji të detyrave të shtëpisë bëni më së shpeshti?

1. Detyra për mësimin e fundit të shpjeguar, nga lista e punës dhe nga libri me figura;

2. Bëjmë vetë hartime në tema të ndryshme;

3. Diçka tjetër _____ .

13. A e ushtroni në shtëpi atë që e keni mësuar në orët e gjuhës serbe?

1. PO 2. JO

14. Cila pjesë e gjuhës serbe është më interesantja për ty?

1. Gramatika;

2. Leximi (ushtrimi i leximit në orë);

3. Shkrimi i hartimit;

4. Komunikimi me gojë;

5. Letërsia;

6. Diçka tjetër _____ .

15. Cili pjesë e gjuhës serbe është më e vështira për ty?

1. Gramatika;

2. Leximi (Ushtrimi i leximit në orë);

3. Shkrimi;

4. Komunikimi me gojë;

5. Letërsia;

6. Diçka tjetër _____

16. Si quhet teksti mësimor të cilin e përdor për serbishten si gjuhë joamtare?

17. Çka të pëlqen më së shumti në tekstet të cilat i përdor për këtë lëndë)?(rrumbullakëso një përgjigje)

1. Tekstet;

2. Detyrat;

3. Ilustrimet;

4. Diçka tjetër, ceke _____ .

18. Çka të pëlqen më së paku në tekstet të cilat i përdor për këtë lëndë)?(rrumbullakëso një përgjigje)

1. Tekstet;

2. Detyrat;

3. Ilustrimet;

4. Diçka tjetër, ceke _____

19. A e përdor gjuhën serbe jashtë shkollës (rrumbullakëso disa përgjigje, sipas nevojës)

1. Jo, gjuhën serbe nuk e përdori jashtë shkollës;

2. Po, në dyqan;

3. Po, te mjeku;

4. Po, në rrugë më fëmijë, me shokë dhe shoqe, etj;

5. Po, përmes TV-së (shikoj filma vizatimor, filma, seriale);

6. Po, dëgjoj muzikë;

7. Po, përmes internetit;

8. Po, ndonjëherë në shtëpi flas serbisht me _____;

9. Po, me fqinjët;

10. Po, vijoj/kam vijuar kurse shtesë të gjuhës serbe _____.

20. Kur shikon televizor në shtëpi, në cilën gjuhë është emisioni apo programi yt i preferuar?

21. A je i/e kënaqur me notën tënde në këtë lëndë?

1. PO 2. JO

22. A je i/e kënaqur me njohurinë tënde të gjuhës serbe?

1. Plotësisht jam i/e kënaqur me njohurinë time ngase lexoj, shkruaj dhe komunikoj verbalisht shkëlqyeshëm në gjuhën serbe;

2. Pjesërisht jam i/e kënaqur me njohurinë time të gjuhës serbe sepse komunikimi verbal më shkon mirë por kam nevojë të përmirësohem në të shkruar;

3. Pjesërisht jam i/e kënaqur me njohurinë time të gjuhës serbe sepse shkrimi me shkon mirë por kam nevojë të përmirësohem në komunikim verbal;

4. Fare nuk jam i/e kënaqur me njohurinë time të gjuhës serbe.

23. A mendon se njohja e gjuhës serbe mund të jetë e dobishme në të ardhmen?

1. PO 2. JO

24. Në çfarë mënyrë mund të jetë njohja e gjuhës serbe e dobishme për ty në të ardhmen?

5.

Shënim: Pyetësori është përdorur për nevojat e intervistimit të Këshilltarit për Arsim në administratën shkollore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik në Leskovc të ngarkuar për shkollat e qarkut të Jabllanicës dhe Pçinit.

1. A jeni të kënaqur me mënyrën e mësimdhënies së serbishtes si gjuhë joamtare në shkolla në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhen shqipe (dhe cilësinë e mësimdhënies të kësaj lënde)?

2. A jeni të kënaqur me disponibilitetin e kuadrit mësimdhënës të trajnuar/i cili ka përgatitjen e duhur profesionale për të dhënë lëndën e serbishtes si gjuhë joamtare në shkolla?

3. Cilat tekste mësimore i shfrytëzojnë mësimdhënësit në dhënien e kësaj lëndë?

4. *A shfrytëzojnë mësimdhënësit, të cilët japin serbishten si gjuhë joamtare në shkollat e Bujanovcit, Preshevës dhe Medvegjës, metoda të reja në punën me fëmijë?*

5. *Cilat metoda i shfrytëzojnë ata kryesisht?*

6. *A mendoni se ndonjë qasje e re dhe trajnime shtesë do të prodhonin rezultate edhe më të mira tek nxënësit kur është fjala për të mësuarit e gjuhës serbe? A keni ndonjë propozim për qasje të reja?*

7. *A keni propozime konkrete për përmirësimin e cilësisë së mbajtjes së mësimit të lëndës së serbishtes si gjuhë joamtare?*

8. *A ka (dhe cilat janë ato) pengesa për realizimin e atyre propozimeve? Nëse mendoni se ka, atëherë ju lutem saktësoni se në çfarë saktësisht mendoni.*

9. *A mendoni se është e domosdoshme të investohet në trajnimin e kuadrit ekzistues mësimdhënës të ngarkuar për gjuhën serbe?*

10. *Cili do të ishte propozimi juaj mbi trajnimet të cilat këta mësimdhënës duhet t'i vijojnë?*

11. *Sa shpesh organizohen trajnime për mësimdhënësit që japin serbishten si gjuhë joamtare, të akredituara nga Ministria e Arsimit?*

12. *Sa shpesh dhe ku organizohen këto trajnime?*

13. *A mendoni se është e rëndësishme që fëmijët të dinë gjuhën serbe?*

14. *Pse mendoni kështu?*

6.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me prindërit, fëmijët e të cilëve vijojnë shkollat fillore në gjuhën shqipe në komunat e Bujanovcit, Preshevës dhe Medvegjës.

Shkolla: _____

1. Sa shpesh thirren takime të bordit të prindërve?

2. Për cilat tema kryesisht bisedoni dhe cilat janë çështjet më të shpeshta të cilat i zgjidhni?

3. A merreni edhe me çështjen e cilësisë së mësimdhënies?

4. Cilat lëndë mendoni se janë më të rëndësishme që fëmijët t'i dinë – cilat njohuri çmohen më së shumti?

5. A e dini se a besojnë shumica e prindërve të fëmijëve në këtë shkollë se është e domosdoshme që të mësojnë gjuhën serbe?

6. A e konsideron bordi i prindërve, dhe ju personalisht, se është e rëndësishme për fëmijët të mësojnë gjuhën serbe?

7. Pse mendoni ashtu?

8. A do të mbështetnit mundësinë që fëmijët në këtë shkollë të mësojnë gjuhën serbe edhe më mirë?

9. A do të mbështetnit iniciativën që nxënësit në këtë shkollë të vijojnë lëndën e gjuhës serbe nëse do të organizohej në ndonjë mënyrë tjetër ndryshe nga ajo e gjertanishmja (p.sh. përmes angazhimit të asistentëve, përdorimit të metodave tjera, përmes lojës, etj)?

10. A kanë fëmijët mundësi të dëgjojnë apo mësojnë gjuhën serbe në këtë vend jashtë shkollës?

11. Nëse po, në çfarë mase?

12. A keni propozime për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës serbe?

7.

Shënim: Udhërrëfyesi është shfrytëzuar përgjatë vëzhgimit të mbajtjes së serbishtes si gjuhë joamtare në shkollat fillore në komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe.

Shkolla: _____

Klasa: _____

Kohëzgjatja e orës mësimore: _____

I. Përfaqësimi i gjuhës joamtare dhe amtare në orën mësimore

1. Në çfarë masë është prezente gjuha amtare në një orë mësimore?

2. Kur është prezente gjuha amtare e nxënësve në orë?

3. Sa komunikohet në gjuhën amtare, e sa në atë joamtare?

4. A e përkthen arsimtari tekstin?

5. Nëse arsimtari nuk e përkthen tekstin, atëherë kush e përkthen?

6. Si i shpjegon fjalët e reja?

7. Në çfarë gjuhe arsimtari shpjegon materialin?

8. A parashtrojnë nxënësit pyetje? Në çfarë gjuhe?

9. A shfrytëzon arsimtari tekst mësimor (dhe cilin) dhe cilat mjete tjera shfrytëzon për mbajtjen e mësimit?

10. Cila është gjuha amtare e arsimtarit?

11. A bën arsimtari shqiptimin e saktë të gjuhës serbe se a flet sipas rregullave gramatikore?

12. A ka arsimtari asistent i cili e ndihmon në mbajtjen e mësimit?

II. Aktivitetet e nxënësve

1. Kush flet më shumë përgjatë orës, arsimtari apo nxënësit?

2. *A janë të gjithë nxënësit të përfshirë? Nëse jo, a tenton arsimtari t'i përfshijë edhe nxënësit të cilët janë më pak aktiv?*

3. *A janë djemtë dhe vajzat barabartë aktiv përgjatë orës, apo njëra nga këto grupe është dukshëm më e qetë/heshtur/aktive?*

4. *A tenton arsimtari t'i përfshijë barabartë si djemtë ashtu dhe vajzat?*

5. *Sa përqind e orës i përkushtohet shprehjes me gojë e saj asaj me shkrim?*

6. *A është drejtimi i komunikimit çdo herë nga arsimtari tek nxënësi, me fjalë tjera, a është arsimtari ai që çdo herë inicion komunikimin apo këtë e bëjnë edhe nxënësit?*

7. *A ka ndërveprim përgjatë orës në mes të nxënësve në gjuhën joamtare, p.sh. a i bëjnë pyetje njëri tjetrit, a e njoftojnë njëri tjetrin me diçka, a japin detyra?*

8. *Krahas punës frontale (ku arsimtari i drejtohet të gjithë nxënësve), a ka edhe punë individuale dhe grupore?*

III. Llojet e detyrave dhe ushtrimeve

1. *A i shfrytëzon arsimtari detyrat dhe ushtrimet nga teksti mësimore?*

2. *A shfrytëzon arsimtari edhe mjete tjera në mbajtjen e orës mësimore dhe cilat?*

3. *A e kontrollon arsimtari njohurinë teorike (njohjen e rregullave, definicioneve) dhe në çfarë mënyre?*

4. *A ka përgjatë orës ushtrime të të folurit, të llojit të dialogut dhe monologut të nxënësve, luajtja e roleve, etj?*

5. *Sa është përgjatë orës prezente përdorimi praktik i gjuhës joamtare?*

IV. Nxënësit (me përfundim të orës)

1. *Sa nxënës janë prezent në orë?*

2. Sa nxënës janë të regjistruar në klasë/ditar?

3. A i vijojnë nxënësit rregullisht orët mësimore të gjuhës serbe?

8.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me përfaqësuesit e mediave dhe të organizatave të shoqërisë civile nga komuna e Bujanovcit dhe Preshevës.

1. Si e vlerësoni situatën në radhët e të rinjve kur është fjala për njohjen e gjuhës serbe?

2. Cili është qëndrimi i juaj për këtë? A mendoni se të rinjtë ndeshën me pengesa për shkak të mosnjohjes së gjuhës serbe apo me përparësi për shkak të njohjes së saj?

3. Si e shihni rolin e shoqërisë civile dhe mediave në zgjidhjen e kësaj çështjeje?

4. A keni hasur në vështirësi në komunikimin me përfitues, bashkëpunëtorë dhe kolegë, gjuha amtare e të cilëve është serbe (sa ndikon mosnjohja e gjuhës serbe në punën e organizatës suaj)?

5. Si ju ka lindur ideja të organizoni mësim të gjuhës serbe për pjesëtarët e komunitetit shqiptar?

6. Cilat ishin parashikimet dhe pritjet e juaja para realizimit të projektit?

7. A jeni të kënaqur me rezultatet e arritura pas përfundimit të projektit?

8. Si e ka pranuar komuniteti shqiptar iniciativën tuaj për organizimin e kursit të gjuhës serbe? A keni pasur vështirësi përgjatë realizimit të projektit?

9.

Shënim: Pyetësori është përpiluar për nevojat e bisedës me përfaqësuesit e administratës shtetërore dhe komunale, si dhe me të punësuarit në organet shtetërore dhe komunale në komunën e Preshëves dhe Bujanovcit.

1. *A mendoni se personat të cilët kërkojnë punë apo të cilët janë të punësuar në administratën shtetërore, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuha serbe, duhet të dinë gjuhën serbe?*

2. *Sa është njohja e gjuhës serbe e rëndësishme për punë në administratën shtetërore (nëse është e mundshme cekni ndonjë situatë konkrete si shembull)?*

3. *Sa ju lehtësohet kryerja e punës të punësuarve që njohin gjuhën serbe?*

4. *A ballafaqohen përfaqësuesit e organeve shtetërore në këto komuna me vështirësi për shkak të njohjes së dobët të serbishtes nga kandidatët të cilët aplikojnë për vende pune apo me personat e punësuar?*

5. *A mendoni se para se gjithash të rinjtë punëkërkues ballafaqohen me pengesa për arsye të mosnjohjes së serbishtes apo me përparësi për shkak të njohjes së saj?*

6. *A keni hasur në vështirësi në komunikimin me qytetarë apo kolegë të cilëve gjuha serbe është amtare?*

7. *A e dini e a mos vallë të punësuarit kanë hasur në vështirësi në komunikimin me përfitues, bashkëpunëtorë, qytetarë dhe kolegë të cilët gjuhën serbe e kanë gjuhë amtare?*

8. *A keni propozime për zgjidhjen e problemit të mosnjohjes së gjuhës serbe nga të punësuarit apo nga punëkërkuesit në sektorin privat?*

10.

Shënim: Pyetësori është përpiluar për nevojat e bisedës me përfaqësuesit e sektorit ekonomik në komunat e Preshevës dhe Bujanovcit.

1. *A mendoni se personat të cilët kërkojnë punë në sektorin privat duhet të njohin gjuhën serbe?*

2. *A parapëlqeni që personi i cili punon në firmën tuaj të njeh edhe gjuhën serbe?*

3. *Pse mendoni se njohja e gjuhës serbe është e nevojshme për punë në firmën tuaj?*

4. *A mendoni se të rinjtë të cilët kërkojnë punë hasin në vështirësi për shkak të mosnjohjes së gjuhës serbe apo në përparësi për shkak të njohjes së saj?*

5. A keni hasur në vështirësi në komunikimin me përfitues, bashkëpunëtorë, partnerë dhe kolegë, gjuha amtare e të cilëve është gjuha serbe?

6. A kanë hasur punonjësit tuaj në vështirësi në komunikimin me përfitues, bashkëpunëtore, partnerë dhe kolegë, gjuha amtare e të cilëve është gjuha serbe?

7. Nëse konsideroni se ju dhe punonjësit tuaj nuk e flitni mirë gjuhën serbe, a mendoni se kjo ndikon, dhe në çfarë mënyrë, në punën dhe afarizimin e firmës suaj?

8. A keni propozime për zgjidhjen e problemit të mosnjohjes së gjuhës serbe nga të punësuarit apo nga punëkërkuesit në sektorin privat?

11.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me profesoreshat e serbishtes në projektin 'Shkolla e gjuhës serbe' të Shërbimit të Trupit Koordinues.

1. Sa gjatë e jepni gjuhën serbe (në vite dhe në muaj): _____

2. A keni pasur mundësi që para pjesëmarrjes në projektin e Shërbimit të Trupit Koordinues të jepni gjuhën serbe si gjuhë joamtare?

1. PO 2. JO

3. Cili është niveli i njohurisë së serbishtes nga vijuesit?

1. Kam vërejtur se shkruajnë, lexojnë dhe komunikojnë në mënyrë të shkëlqyeshme në gjuhën serbe;
2. Janë të mirë në komunikimin verbal, mirëpo nevojitet përmirësim në shkrim dhe në lexim;
3. Tregojnë njohuri të mirë në lexim dhe në shkrim në gjuhën serbe, mirëpo nevojitet përmirësimi i shkathtësive të tyre verbale;
4. Nevojiten përmirësime në komunikimin me shkrim dhe verbal;
5. Diçka tjetër, shpjego _____ .

4.Në cilën mënyrë e matni njohurinë e arritur tek vijuesit (mund të jepen disa përgjigje)?

1. Përmes testeve;

2. Përmes kontrollimit të detyrave të shtëpisë;

3. Përmes ushtrimeve gojore në orë;

4. Përmes ushtrimeve dhe detyrave në orë;

5. Diçka tjetër, cekni _____

6. Nuk e kontrollojë njohurinë e tyre.

5. Cilat metoda i përdorni më së shpeshti në orët e gjuhës serbe në kuadër të projektit?

6. Sipas mendimit tuaj, a jep ndonjëra nga metodat rezultate të mira (në çka vijuesit reagojnë më së miri)? Cila?

7. A ndryshon sipas mendimit tuaj metoda e punës të cilën e aplikoni në kuadër të projektit të Shërbimit të Trupit Koordinues nga metoda e rëndomtë e mbajtjes së mësimit?

1. PO 2. JO

8. Nëse përgjigja është po, përshkruani se në çka dallojnë këto dy qasje:

9. Cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat ballafaqoheni përgjatë mbajtjes së mësimit në kuadër të projektit?

10. A vëreni rezultate pas ciklit të parë të projektit?

1. Po, i vërej. Cilat? _____

2. Nuk i vërej.

11. Cilat janë përvojat më të rëndësishme nga ky projekt të cilat kanë kontribuar që nxënësit të përvetësojnë më lehtë njohuri të gjuhës?

12. Cilat janë rekomandimet e juaja për përmirësimin e mësimit të gjuhës serbe nëpër shkolla?

PYETJE SHTESË PËR PROFESORESHAT TË CILAT JAPIN MËSIM NXËNËSVE TË SHKOLLËS FILLORE NË BILAQ NË PJESËN E DYTË TË PROJEKTIT TË SHËRBIMIT TË TRUPIT KOORDINUES

13. A ekziston ndonjë dallim në punë me grupin e përbërë nga nxënësit e klasës V dhe VI, gjegjësisht VII dhe VIII, dhe nëse ka ndonjë dallim, përshkruani se cili është ai dallim:

14. Cilat metoda më së shpeshti i aplikoni në punën me nxënësit e Bilaqit?

15. A është e dobishme ndihma e asistentit lokal në punën me nxënës nge Bilaqi dhe çfarë rezultatesh jep sipas mendimit tuaj kjo qasje?

16. Sipas mendimit tuaj, sa orë në javën nevojiten që nxënësit të përvetësojnë materialin e paraparë me plan-program?

17. Në bazë të përvojës me punë me nxënësit nga Bilaqi, cilat janë përshtypjet dhe rekomandimet e juaja për mësimin e gjuhës serbe në orë të rregullta mësimore?

12.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me asistentët në projektin 'Shkolla e gjuhës serbe' të Shërbimit të Trupit Koordinues.

1. Përshkruani rolin e juaj në projekt:

2. A dallon sipas mendimit tuaj qasja të cilën e aplikoni në kuadër të projektit nga qasja e rëndomtë e mënyrës së mësimit të gjuhës serbe në shkolla dhe nëse përgjigja është po, atëherë përshkruani dallimin?

3. Nëse i krahasoni këto dy qasje, atëherë cila qasje sipas mendimit tuaj jep rezultate më të mira?

1. Asnjëra qasje;

2. Qasja e zakonshme;

3. Qasja e re të cilën e aplikoj në kuadër të projektit që e zbaton ShTK;

4. Të dy qasjet.

5. Pse mendoni se është ashtu?

6. Çfarë rezultatesh sipas mendimit tuaj jep mënyra e punës së Shkollës së gjuhës serbe?

7. Cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat ballafaqoheni në mësimdhënien e gjuhës serbe në kuadër të projektit? ?

8. A vëreni rezultatet pas ciklit të parë të projektit?

1. Po, i vërej. Cilat? _____

2. Nuk i vërej.

9. A e keni ndryshuar mënyrën e punës me nxënësit në shkollën e juaj pas pjesëmarrës në projekt? Nëse përgjigja është po, përshkruani këtë ndryshim.

10. Cilat janë metodat e reja të cilat i keni adoptuar përgjatë punës në projekt dhe të cilat kanë kontribuar që të mbani mësimin në mënyrë tjetër /ose që nxënësit të përvetësojnë më lehtë njohuri të gjuhës?

11. Cilat janë rekomandimet tuaja për përmirësimin e mësimdhënies së gjuhës serbe në shkollat fillore?

13.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me vijuesit e "Shkollës së gjuhës serbe" të Shërbimit të Trupit Koordinues.

1. Pse ke vendosur të vijosh 'Shkollën e gjuhës serbe'?

2. Sipas mendimit tënd, a është njohuria juaj e gjuhës serbe më e mirë se para fillimit të kursit?

3. A ke ndonjë vështirësi, pas shkollës së gjuhës serbe, të komunikosh në gjuhën serbe në jetën e përditshme?

4. Nëse përgjigja e juaj në pyetjen paraprake ishte po, atëherë të lutem specifiko se në cilat situata ke vështirësi të shkaktuara nga mungesa e njohjes së gjuhës serbe?

5. A mendoni se është e nevojshme të rrisësh njohjen tënde të gjuhës serbe?

6. A ndjehesh më sigurt dhe me vetëbesim më të madh tash pasi ke mësuar gjuhën serbe?

7. A ndjehesh më i/e lirë që të flasësh në gjuhën serbe pas vijimit të kursit?

8. Në çfarë mënyre tani momentalisht komunikon në gjuhën serbe?

9. A mendon se njohja e gjuhës serbe mund të të ndihmojë në të ardhmen?

10. Në çfarë mënyre planifikon të shfrytëzosh njohjen e gjuhës serbe të cilën e ke fituar gjatë kursit?

14.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me përfaqësuesit e OSBE-së të ngarkuar me realizimin e projektit të cilin misioni e ka zbatuar në shkollën e mesme 'Sezai Surroi' në Bujanovc.

1. Cila është ideja pikënisje dhe cilat ishin supozimet themelore në realizimin e projektit të cilin misioni i OSBE-së e zbaton në shkollën e mesme 'Sezai Surroi' në Bujanovc?

2. Cili ishte qëllimi i realizimit të projektit të cilin misioni i OSBE-së e zbaton në shkollën e mesme 'Sezai Surroi' në Bujanovc?

3. Në bazë të të cilave të dhënave është përcaktuar procedura e realizimit të projektit (përzgjedhja e shkollës, e klasave, etj)?

4. A ballafaqoheni me vështirësi në realizimin e projektit? Nëse përgjigja është po, atëherë cilat janë sfidat kryesore?

5. A vëreni rezultate pas ciklit të parë të projektit?

1. Po, i vërej. Cilat? _____

2. Nuk i vërej.

6. Çka është, sipas mendimit tuaj, kyçe për të siguruar rezultate afatgjate të iniciativa të tilla?

7. Sipas mendimit tuaj, cilët janë partnerët kyç për sigurimin e cilësisë së të mësuarit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare dhe për qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura?

8. Në bazë të mësimeve të nxjerra deri në tani nga projekti të cilin e implementon misioni i OSBE-së në Serbi, në shkollën e mesme 'Sezai Surroi' në Bujanovc, cilat janë rekomandimet e juaja për përmirësimin e mësimit të gjuhës serbe në shkolla?

15.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me drejtorin e shkollës së mesme 'Sezai Surroi' në Bujanovc, në të cilën misioni i OSBE-së në Serbi ka realizuar projektin.

I. Konteksti

1. Cili është motivi kryesor prapa pjesëmarrjes në projektin e misionit të OSBE-së dhe punës në mësimdhënien e serbishtes si gjuhë joamtare?

2. A mendoni se shumica e prindërve të fëmijëve të shkollës suaj e konsideron të nevojshme që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën serbe?

II. Mbështetja

1. A jeni të kënaqur me mënyrën se si jepet serbishtja si gjuhë joamtare në shkollën 'Sezai Suroi'?

2. A jeni të kënaqur me përgatitjen profesionale të kuadrit mësimdhënës të shkollës 'Sezai Surroi' për këtë lëndë?

3. A mendoni se nevojiten investime shtesë në kuadrin mësimdhënës (trajnime e të ngjashme?

4. A jeni të kënaqur me disponibilitetin e kuadrit mësimdhënës i cili është i trajnuar/ka përgatitjen e duhur profesionale për këtë lëndë?

5. *A mendoni se është e domosdoshme të investohet në trajnimin e kuadrit ekzistues mësimdhënës të ngarkuar për gjuhën serbe?*

6. *Cili do të ishte propozimi i juaj në lidhje me trajnimet të cilat këta mësimdhënës duhet t'i vijojnë?*

7. *A vijojnë mësimdhënësit e shkollës suaj trajnimet e Ministrisë së Arsimit? Nëse po, sa shpesh dhe ku?*

III. Mësimdhënia

1. *Cilat tekste shkollore i shfrytëzojnë mësimdhënësit në mbajtjen e mësimit për këtë lëndë?*

2. *A shfrytëzojnë mësimdhënësit e shkollës 'Sezai Surroi', të cilët japin gjuhën serbe, metoda të reja në punën me fëmijë? Cilat?*

3. *Çfarë është mendimi i juaj për punë në klasa me fëmijë përmes ndihmës së personave tjerë/asistentëve?*

4. *Çfarë rezultate sipas mendimit tuaj jep kjo qasje?*

5. *Si reagojnë nxënësit ndaj personave/asistentëve të ri në klasë?*

6. *Jepni propozime konkrete në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies së serbishtes si gjuhë joamtare?*

7. *A ka (dhe cilat janë ato) pengesa për realizimin e këtyre propozimeve? Nëse mendoni se ka, ju lutem specifikoni ato.*

8. *Cilat janë përvojat më të rëndësishme të këtij projekti të cilat kanë kontribuar në atë që fëmijët më lehtë të përvetësojnë njohuri të gjuhës?*

IV. Resurset

1. *A ka shkolla kabinet për mbajtjen e kësaj lëndë?*

2. *A keni mundësi të dëgjimit të audio-incizimeve?*

3. Nëse përgjigja e juaj është po, atëherë a e shfrytëzojnë mësimdhënësit këtë mundësi për organizmin e mbajtjes së lëndës së gjuhës serbe?

4. A keni kompjuter dhe projektor?

5. Nëse përgjigja e juaj është po, atëherë a e shfrytëzojnë mësimdhënësit këtë mundësi për organizmin e mbajtjes së lëndës së gjuhës serbe?

6. A keni qasje në internet?

7. Nëse përgjigja e juaj është po, atëherë a e shfrytëzojnë mësimdhënësit këtë mundësi për organizmin e mbajtjes së lëndës së gjuhës serbe?

16.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me profesorët e serbishtes si gjuhë joamtare në shkollën e mesme 'Sezai Surroi' në Bujanovc, të cilët kanë marrë pjesë edhe në projektin e realizuar nga misioni i OSBE-së në Serbi.

1. Cekni klasat në të cilat jepni lëndën e serbishtes si gjuhë joamtare:

2. Sa gjatë e jepni serbishten si gjuhë joamtare:

3. Cila është gjuha juaj amtare:

4. Në çfarë mënyre e matni njohurinë e arritur tek nxënësit? (mund të jepen disa përgjigje)

1. Nuk e kontrolloj njohurinë e nxënësve të mi;
2. Përmes testeve;
3. Përmes kontrollimit të detyrave të shtëpisë;
4. Përmes ushtrimeve gojore në orë;

5. Përmes ushtrimeve dhe detyrave në orë;

6. Mënyrë tjetër, cekni _____ .

5. Cili është, sipas mendimit tuaj, niveli i njohurisë së nxënësve tuaj të cilët sapo ka përfunduar shkollën fillore dhe e kanë regjistruar shkollën e mesme?

1. Kam vërejtur se shkruajnë, lexojnë dhe komunikojnë në mënyrë të shkëlqyeshme në gjuhën serbe;

2. Janë të mirë në komunikimin verbal, mirëpo nevojitet përmirësim në shkrim dhe në lexim;

3. Tregojnë njohuri të mirë në lexim dhe në shkrim në gjuhën serbe, mirëpo nevojitet përmirësimi i shkathtësive të tyre verbale;

4. Nevojiten përmirësime në komunikimin me shkrim dhe verbal.

5. Diçka tjetër, shpjego _____ .

6. Cilat metoda i shfrytëzoni më së shpeshti në orët mësimore të serbishtes si gjuhë joamtare?

7. A dallon metoda e punës, e cila zbatohet në kuadër të projektit që zbaton misioni i OSBE-së, me metodën e punës të cilët e zbatoni rëndom në orët mësimore?

1. Po, dallon;

2. Jo, nuk dallon.

8. Nëse përgjigja është po, atëherë përshkruani se si dallojnë këto dy qasje:

9. Nëse i krahasoni këto dy qasja, atëherë sipas mendimit tuaj, cila qasje jep rezultate më të mira?

1. Qasja e rëndomtë të cilën e aplikoj rregullisht;

2. Qasja e re të cilën e aplikoj në kuadër të projektit të cilin e zbaton misioni i OSBE-së;

3. Të dy qasjet ofrojnë rezultate të mira;

4. Asnjëra qasje.

10. Pse mendoni se është ashtu?

11. Cili është mendimi juaj për punën me fëmijë nëpër klasa me ndihmën e personave tjerë/asistentëve?

1. Lehtëson mbajtjen e mësimit;

2. Vështirëson mbajtjen e mësimit;

3. Diçka tjetër, cekni _____.

12. Çfarë rezultate sipas mendimit tuaj jep kjo qasje?

1. Nuk jep rezultate/nuk i vërej rezultatet;

2. Jep rezultate pozitive, shpjego _____;

3. Jep rezultate negative, shpjego _____;

4. Diçka tjetër, cekni _____.

13. Në çfarë mënyrë reagojnë nxënësit në klasë ndaj personave/asistentëve të ri?

1. Nxënësit nuk reagojnë ndaj asistentëve;

2. Pozitivisht, shpjego _____;

3. Negativisht, shpjego _____;

4. Diçka tjetër, cekni _____ .

14. Cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat ballafaqoheni në dhënien e serbishtes si gjuhë joamtare?

15. A vëreni rezultate pas ciklit të parë të projektit?

1. Po, i vërej (cekni rezultatet)_____

2. Nuk i vërej.

16. Në çfarë mënyrë i matni dhe kuantifikoni rezultatet e arritura nga projekti?

17. A e keni ndryshuar mënyrën e punës me fëmijë pas ciklit të parë të projektit? Nëse po, përshkruani ndryshimin.

18. A ka ndihmuar/kontribuar projekti që të jepni gjuhën serbe në mënyrë tjetër dhe që fëmijët më lehtë të përvetësojnë njohuri të gjuhës?

1. PO 2. JO

19. Nëse ka ndihmuar, shpjegoni se në çfarë mënyrë. Nëse konsideroni se nuk ka ndihmuar, shpjegoni pse është ashtu:

20. Cilat janë rekomandimet e juaja për përmirësimin e mësimdhënies së gjuhës serbe në shkolla?

21. Gjeneratat e vjetra e njohin mirë gjuhën serbe, mirëpo gjeneratat e reja jo. A pajtoheni më ketë dhe pse mendoni se është ashtu?

17.

Shënim: Pyetësori është shfrytëzuar për bisedë me asistentët e angazhuar për mbajtjen e mësimit të serbishtes si gjuhë joamtare në shkollën e mesme 'Sezai Surroi' në Bujanovc përgjatë projektit të zbatuar nga misioni i OSBE-së në Serbi.

1. Cekni klasat në të cilat ndihmoni në mësimdhënien e serbishtes si gjuhë joamtare:

2. Sa gjatë e jepni lëndën e serbishtes si gjuhë joamtare (në vite dhe muaj):

3. A keni dhënë mësim të gjuhës serbe nxënësve të komunitetit pakicë para se të merrni pjesë në projekt?

1. PO 2. JO

4. Cili është, sipas mendimit tuaj, niveli i njohurisë në nxënësve me të cilët punoni?

1. Kam vërejtur se shkruajnë, lexojnë dhe komunikojnë në mënyrë të shkëlqyeshme në gjuhën serbe;

2. Janë të mirë në komunikimin verbal, mirëpo nevojitet përmirësim në shkrim dhe në lexim;

3. Tregojnë njohuri të mirë në lexim dhe në shkrim në gjuhën serbe, mirëpo nevojitet përmirësimi i shkathtësive të tyre verbale;

4. Nevojiten përmirësime në komunikimin me shkrim dhe verbal;

5. Diçka tjetër, shpjego _____.

5. Përshkruani rolin e juaj në projekt/në çfarë mënyrë merrni pjesë në mbajtjen e orëve mësimore të serbishtes si gjuhë joamtare:

6. Cilat metoda të punës shfrytëzoni më së shpeshti në punën me fëmijë?

7. Cili është mendimi juaj për punën me fëmijë nëpër klasa me ndihmën e personave tjerë/asistentëve?

1. Lehtëson mbajtjen e mësimit;

2. Vështirëson mbajtjen e mësimit;

3. Diçka tjetër, cekni_____ .

8. Çfarë rezultate sipas mendimit tuaj jep kjo qasje?

1. Nuk jep rezultate/nuk i vërej rezultatet;

2. Jep rezultate pozitive, shpjego _____;

3. Jep rezultate negative, shpjego _____;

4.Diçka tjetër, cekni _____.

9. Në çfarë mënyre reagojnë nxënësit nëpër klasa ndaj personave/asistentëve të ri?

1. Nxënësit nuk reagojnë ndaj asistentëve;

2. Pozitivisht, shpjego _____;

3. Negativisht, shpjego _____;

4. Diçka tjetër, cekni _____.

10. Cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat ballafaqoheni në mbajtjen e serbishtes si gjuhë joamtare?

11. A vëreni rezultate pas ciklit të parë të projektit?

1. Po, i vërej. Cilat? _____

2. Nuk i vërej

12. Në çfarë mënyre i matni apo kuantifikoni rezultatet e arritura tek nxënësit?

13. Cilat janë përvojat më të rëndësishme të projektit të cilat kanë kontribuuar që nxënësit më lehtë të përvetësojnë njohuri të gjuhës?

RRETH AUTORËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE

RRETH AUTORËVE DHE AUTOREVE

Millan Ajxanoviq është docent në Fakultetin filozofik (Dega për gjuhë dhe linguistikë serbe) të Universitetit në Novi Sad. Në fakultetin amë magjistroi në vitin 2007, kurse pastaj, në vitin 2012 mbrojti disertacionin e doktoraturës, me ç'rast fitoi titullin e doktorit të shkencave filologjike. Fushëveprimi primar i interesimit të tij është morfologjia dhe derivatologjia e gjuhës serbe, përderisa merret me çështje të ndryshme nga fusha e gjuhës serbe si gjuhë e huaj, nga fusha e sintaksës, metrikës etj. Është autor i rreth 30 punimeve shkencore dhe profesionale nga fushat e përmendura. Përveç kësaj, që nga themelimi i Qendrës për gjuhë serbe si gjuhë e huaj në Fakultetin filozofik në N. Sad (2002), është angazhuar në të në cilësi të lektorit, si dhe në Shkollën verore të gjuhës, kulturës dhe historisë serbe. Është bashkautor i fletores punuese të dedikuar për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë të huaj në nivelin A1. Në vitin 2011, në cilësi të lektorit të gjuhës serbe, ishte angazhuar në shkollën verore të gjuhës serbe në Universitetin shtetëror në Osakë. Gjithashtu, në vitin 2014 morri pjesë, si përfaqësues i Universitetit të N. Sadit, në takimin e rregullt vjetorë FLTEX (Campus Europae), i cili është mbajtur në Luksemburg.

Natasha Boshkoviq ka diplomuar në Universitetin Notingem Trent pranë Shkollës evropiane të ekonomisë (Nottingham Trent University / European School of Economics) në Romë, në katedrën për studime politike ndërkombëtare. Magjistraturën e kreu në programin Demokracia dhe të drejtat e njeriut në Evropën juglindore (MA in Democracy and Human Rights in South East Europe) të Universitetit në Bolonjë dhe të Universitetit në Sarajevë. Ka punuar si konsulente dhe udhëheqëse në projektet në fushën e të drejtave të njeriut dhe pakicave, dhe bashkëpunëtore në hartimin e dokumenteve dhe analizave strategjike, në institucionet shtetërore dhe akademike, në organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare në Serbi, Itali dhe Bosnjë e Hercegovinë. Është autore e disa punimeve të publikuara në fushën e shkencave politike dhe të të drejtave të njeriut. Merret edhe me përkthimin e literaturës në fushën e shkencave shoqërore.

Vesna Krajishnik ka diplomuar në vitin 1987. dhe ka përfunduar magjistraturën në vitin 1989. në Fakultetin Filologjik në Beograd, në Katedrën për gjuhë serbe. Ka doktoruar në të njëjtin fakultet në vitin 2005 në temën *Minimumi leksikor i gjuhës serbe si gjuhë e huaj*. Lënda me të cilën merret është Gjuha moderne serbe, kurse fushëveprimi më i ngushtë shkencor është Metodika e gjuhës serbe si gjuhë e huaj. Prej vitit 1991 është punësuar në Fakultetin filologjik në Beograd, në qendrën për gjuhë serbe si gjuhë të huaj. Gjatë përvojës së punës shumëvjeçare është marrë me organizimin e mësimdhënies dhe aktivitetet testuese për studentët e huaj në fakultetin amë, me organizimin e mësimdhënies së gjuhës serbe për studentët e huaj në Fakultetin e medicinës në Beograd, me pjesëmarrje në konferenca të shumëta shkencore dhe projekte që kanë të bëjnë me teorinë, metodikën dhe implementimin në mësimdhënien

e gjuhës serbe (si gjuhë e huaj), organizmin e takimeve shkencore, ligjërata në bazë të ftesave (Universiteti Humbolt në Berlin, Fakulteti filozofik në Lubjanë), me organizimin e provimeve në Institutin për studime ballkanike në Selanik. Është autore e monografisë *Karakteristikat kuantitative dhe spektrale të sonatave*, dy doracakëve të gjuhës serbe si gjuhë e huaj dhe punimeve të shumta shkencore të publikuara në revistat dhe librat shkencore vendore dhe të huaja.

Dunja Polleti ka përfunduar studimet themelore të sociologjisë në Fakultetin filozofik në Beograd, kurse momentalisht është në studimet e doktoraturës në departamentin e njëjtë. Në kuadër të doktoraturës së saj përpunon temën e migrimeve të punës në Serbi. Përveç migrimeve dhe lëvizjeve në përgjithësi, ajo është e interesuar dhe për sociologjinë ekonomike, çështjen e ideologjive politike dhe rrjetet sociale, kurse merret me studime kuantitative. Si bursiste e Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik është inkuadruar në projektet të cilat i zhvillon Instituti për studime sociologjike të Fakultetit filozofik në Beograd. Mori pjesë në disa konferenca vendore dhe ndërkombëtare dhe publikoi punime në revista dhe libra profesionale.

Millica Rodiq ka diplomuar në katedrën për sociologji në Fakultetin filozofik të Universitetit të Beogradit. Prej vitit 2010 është këshilltare e drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues e angazhuar për punë në fushëveprimin e avancimit të cilësisë së arsimimit, sigurimit të teksteve mësimore për nxënësit e komunitetit shqiptar dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Ishte e angazhuar në sektorin civil si koordinatore e programit me qëllim të krijimit të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të mira ndëretnike në territorin e ish Jugosllavisë. Si studente dhe kryetare e klubit të studentëve dhe studenteve të sociologjisë „Stalkeri“, ishte njëra nga themelueset e asociacionit i cili grumbullonte studentët e sociologjisë nga Evropa juglindore. Morri pjesë në studimet e shumta si studiuese, bashkëpunëtore dhe analiste. Ishte e angazhuar si konsulente dhe bashkëpunëtore në hartimin e publikimit të Bordit të Helsinkit për të drejtat e njeriut (analiza e teksteve mësimore të historisë), studiuese në projekt dhe pastaj edhe si bashkëpunëtore në hartimin e artikullit në revistën Sociologjia (analiza e sektorit civil në komunën e Topollës).

Rahim Salihi ka diplomuar në vitin 2011 në Fakultetin e shkencave politike dhe administrimit publik në Tetovë, në drejtimin e politikologjisë. Ishte bashkëpunëtor dhe studiues gjatë hartimit të *Studimit të fizibilitetit mbi mundësitë e zhvillimit të arsimimit të lartë në jug të Serbisë*. Në periudhën prej vitit 2009 deri në vitin 2011 ishte koordinator i projektit në organizatën "*Ti dhe unë jemi ne*", e cila grumbullonte të rinjtë e tri komuniteteve nga komunat Bujanoc dhe Preshevë, me qëllim të njoftimit të tyre, shoqërimit të tyre dhe thyerjes së stereotipeve dhe barrierave etnike. Që nga shtatori i vitit 2011 punon si këshilltar i drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues në zyrën në Beograd.

Marija Stankoviq është kandidat për doktoraturë në Fakultetin filologjik të Universitetit në Beograd, në të cilin ka diplomuar (grupi studiues i Linguistikës së përgjithshme) në vitin 2011, kurse pastaj, në vitin 2013 mbaroi studimet postdiplomike (grupi studiues i Linguistikës së përgjithshme – punimi me temë: *Gabimet leksikore në punimet e shkruara të fëmijëve në klasën e V dhe VII të shkollës fillore*). Flet gjuhën serbe, angleze, spanjolle, ruse dhe bullgare. Merret me punime të pavarura studiuese nga fusha e sociolinguistikës, psikolinguistikës dhe disiplinave tjera të ngjashme, merret me shkrime, përkthim dhe përpunimin elektronik të teksteve.

Ivana Stanojev është studiuese dhe aktiviste me përvojë në fushën e themelimit të komuniteteve, punën me të rinj, të drejta të pakicave në territoret e pasluftës dhe në monitorimin e zgjedhjeve. Ka punuar në organizatat vendore dhe të huaja ndërkombëtare të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe: Forumi për marrëdhënie etnike, Projekti i marrëdhënieve etnike (SHBA), këshilli për menaxhim përfshirës (SHBA), Qendrën për rezistencë jo të dhunshme. Ishte bashkëpunëtore në projektet e Shërbimit të Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë. Bujanoc dhe Medvegjë. Sikur studiuese mori pjesë në hartimin e tri studimeve të cilat kanë të bëjnë me territorin e Serbisë jugore: *Studimi i fizibilitetit mbi mundësitë e zhvillimit të arsimimit të lartë në komunat Bujanoc dhe Preshevë*, Serbi jugore, *në fokus: ndryshimi i mendimit mbi pakicat etnike në mediat në Serbi* dhe *Konflikti dhe pasojat e tij në jug të Serbisë*. Mori pjesë në misionet monitoruese zgjedhore OSBE/ODIHR si monitoruese dhe analiste në Ukrainë, Bullgari, Turkmenistan dhe Serbi.

Nikica Strizhak ka diplomuar në Katedrën për gjuhë serbe në Fakultetin filologjik të Universitetit në Beograd. Punimin për studimet postdiplomike *Testi si mënyrë e matjes së njohjes së gjuhës serbe si gjuhë e huaj në moshën e nivelit të shkollës fillore* e ka mbrojtur në vitin 2011. Ky është punimi i parë i studimeve postdiplomike nga fusha e gjuhës serbe si gjuhë e huaj e mbrojtur në Fakultetin filologjik në Beograd. Punon si lektorë në Qendrën për gjuhë serbe si gjuhë e huaj, duke marrë pjesë në të gjitha aktivitetet mësimore, studiuese dhe shkencore të Qendrës. Momentalisht është student i vitit të tretë të studimeve të doktoraturës në Fakultetin filologjik, në kuadër të së cilave më së shumti merret me metodikën e mësimit të gjuhës serbe si gjuhë e huaj.

Dushanka Zvekiq-Dushanoviq është profesoreshë e çrregullt në Fakultetin filozofik (Dega për gjuhë serbe dhe linguistikë) të Universitetit në Novi Sad. Ka doktoruar në vitin 2007. në Fakultetin filozofik të Universitetit në Novi Sad, në fushën e shkencës Filologjike – gjuha serbe dhe linguistika. Merret me gjuhën moderne serbe, me gjuhën moderne hungareze, me linguistikë kontaktuese dhe linguistike gjegjësisht metodikën e mësimdhënies së gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Është autor i rreth 50 punimeve shkencore dhe profesionale nga këto fusha. Prej vitit 2013, është koordinatore e Qendrës për gjuhë serbe si

gjuhë e huaj (pranë Degës për gjuhë serbe dhe linguistikë të Fakultetit filozofik në Novi Sad). Përveç kësaj, është bashkë-autore në kompletet e teksteve mësimore për lëndën Gjuha serbe si gjuhë joamtare në shkollën fillore dhe të mesme dhe udhëzuesit për arsimtar (botuar nga Enti për tekste mësimore, Beograd). Është koordinatore dhe implementuese e *Programit për nënshtrimin e provimeve shtesë për realizimin e mësimdhënies së gjuhës serbe si gjuhë joamtare të Qendrës për avancimin* e arsimtarëve të Fakultetit filologjik në Novi Sad (prej vitit 2013) si dhe seminareve për arsimtar në kuadër të Programit të aftësimit profesional të të punësuarve në arsim, me titull *Avancimi i mësimdhënies së gjuhës serbe si gjuhë joamtare në shkollën fillore* (2009–2011). Është anëtare e komisionit për hartimin e planeve dhe programeve për lëndën e Gjuhës serbe si gjuhë joamtare (Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit, Beograd, 2010–2012). Është autore e testeve dhe ligjëruese në seminaret për arsimtar në garat regjionale dhe republikane të nxënësve të klasës së 7. dhe 8. të shkollës fillore nga Gjuha serbe si gjuhë joamtare (2007–2013). Është anëtare e komisionit për nënshtrimin e provimit profesional për licenca të arsimtarëve, edukatoreve dhe të bashkëpunëtorëve profesional (prej vitit 2012.).

RRETH BASHKËPUNËTORËVE DHE BASHKËPUNËTOREVE

Nehat Aliu ka diplomuar në Akademinë pedagogjike në Prizren, dega e gjuhës serbo- kroate dhe letërsisë jugosllave. Pas përfundimit të studimeve ka punuar si arsimtar në Shkollën fillore „Muharrem Kadriu" në Tërnoc të madh dhe „Zenel Hajdini" në fshatin Raincë në komunën e Preshevës. Që nga viti 2002. dhe në gjashtë vitet e ardhme, vazhdon që të merret me arsimim në vetëqeverisje lokale si dhe kryeshef për veprimtari shoqërore, në kuadër të cilës bënë pjesë edhe çështja e edukimit. Ka qenë drejtor i Shtëpisë së kulturës „Vuk Karadžić" në Bujanoc, kurse nga 2012. punon si profesor i gjuhës serbe si gjuhë joamtare në Shkollën e mesme „Sezai Surroi" në Bujanoc. Në periudhën prej shtatorit të vitit 2013 deri në qershor të vitit 2014 ishte mentor i asistentëve në kuadër të projektit qëllimi i të cilit ishte përmirësimi i mësimdhënies së Gjuhës serbe si gjuhë joamtare. Që nga formimi i Këshillit nacional të pakicave nacionale shqiptare (KNPNSH) në vitin 2010, është anëtar aktiv i Bordit për arsimim, në kuadër të cilit shqyrton dhe propozon masa për avancimin e cilësisë së arsimimit të këtij komuniteti. Si përfaqësues i KNPNSH është pjesëmarrës i trupit punues të formuar për nevoja të hartimit të kësaj Strategjie.

Fadil Azizi ka diplomuar në Fakultetin ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Prej vitit 1987 punon në komunën e Preshevës si bashkëpunëtor profesional për planifikim dhe analizë. Gjashtë vite më vonë është emëruar si kryeshef i financave në komunën e Preshevës, pas të cilës ishte drejtor i Fondit për çështje komunale dhe kryeshef i shërbimit të inspektimit. Momentalisht gjendet në pozitën e kryeshefit për veprimtari shoqërore.

Raife Ibishi është studente e vitit të tretë në degën e Fakultetit ekonomik të Suboticës në Bujanoc në departamentin e marketingut. Nga viti 2012. deri në vitin 2013. Ishte anëtare e parlamentit të studentëve, në kuadër të së cilit merrej me çështjet jetike për studentët e degës në Bujanoc. Flet gjuhën shqipe dhe serbe.

Femi Isufi ka diplomuar në Katedrën për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin filologjik të Universitetit në Prishtinë. Me çështjen e arsimimit merret prej përfundimit të studimeve, fillimisht si arsimtar, dhe pastaj edhe si drejtor i Shkollës fillore „Sami Frashëri" në fshatin Lluçan të komunës së Bujanocit.

BIBLIOGRAFIA

- Bugarski, Ranko (1986a). *Jezik u društvu.* Beograd: Čigoja štampa.

- Bugarski, Ranko (1986b). *Lingvistika u primeni.* Beograd: Čigoja štampa.

- Bugarski, Ranko (1997). *Jezici.* Beograd: Čigoja štampa

- Burzan, Mirjana (1979). *Metodički priručnik za nastavu srpskohrvatskog kao jezika društvene sredine od III do VIII razreda osnovnog vaspitanja i obrazovanja.* Novi Sad: Enti pedagogjik i Vojvodinës.

- Burzan, Mirjana (1984). *Interferencija u predikatu srpskohrvatske rečenice u jeziku učenika mađarske narodnosti.* Novi Sad: Fakulteti filologjik, Instituti për gjuhë jugosllave.

- *Commom European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment, Council of Europe.* Cambridge, Cambridge University Press, 2001.

- Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e përfaqësuesve nacional dhe etnik, fetar dhe përfaqësuesve të pakicave gjuhësore, neni 4.

- Dokumenti nga Kopenhaga (1990)

- Konventa evropiane mbi kulturën (1954)

- Karta evropiane mbi gjuhët regjionale dhe gjuhët e pakicave (1992)

- *From Linguistic Diversity to Plurilingual Education: Guide for the Development of Language Education Policies in Europe,* Executive Version 2007. Language Policy Division, Council of Europe

- Morrow, Keith (2004). “Insights from the Common European Framework”, Oxford UniversityPress.

- Kočiš, Nikola; Andrej Čipkar, Jovan Jerković, Elemer Brunet (1966). *Srpskohrvatski u školama narodnosti, Priručnik za učitelje i nastavnike 1.* Novi Sad: Enti krahinor për botimin e teksteve mësimore.

- Kolka, A. (1983). Društveno planiranje stranih jezika, u *Strani jezici,* god. XII, br. 1–2, Zagreb.

- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve (1989)

- Konventa e UNESCO kundër diskriminimit në fushën e arsimimit (1960)

- Krajišnik, Vesna (2007a). *„Potrebna“ leksika u rječniku praga znanja srpskog kao stranog jezika,* Përmbledhje e punimeve *Srpski kao strani jezik u teoriji i praksi,* Beograd, 195–201.

- Krajišnik, Vesna (2007b). *Značaj semantičke pokrivenosti u izboru leksičkog minimuma srpskog kao stranog jezika,* Përmbledhje e punimeve *Savremene tendencije u nastavi jezika i književnosti,* Beograd, 325–332.

- Krajišnik, Vesna (2008). *Multidisciplinarnost u izboru nastavnih sredstava u nastavi srpskog kao stranog jezika,* Përmbledhje e punimeve *Multidisciplinarnost u nastavi jezika i književnosti,* Nikšić, 27–33.

- Lukić, Vera (1983). *Dečji frekvencijski rečnik,* Beograd: Prosveta.

- Udhëzimet e Lubjanës për integrimin e shoqërive të ndryshme (2012), Zyra e komisionarit të lartë për pakica nacionale, Hagë.

- Strategjia nacionale e Serbisë për qasje të Serbisë dhe Malit të Zi në Bashkim Evropian (2005).

- Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave nacionale (1995).

- Pešić, J., Plut, D. (2007). Kriterijumi za procenu kvaliteta udžbenika, U: Plut, D. (urednik): Cilësia e teksteve mësimore për moshën e re shkollore, Instituti për psikologji, Beograd.

- *Posebne osnove školskog programa za 1. razred osnovnog obrazovanja i vaspitanja RS* (2003). Beograd: Ministria e arsimit dhe sportit.

- Pravilnik o stepenu i vrsti obrazovanja nastavnika i stručnih saradnika u osnovnoj školi, *Sl. glasnik RS* – Gazeta arsimore, br. 11/2012.

- Rekomandimet nga Haga të Komisionarit të lartë të OSBE-së për pakicat nacionale, rekomandimi nr. 1

- Raičević, Vučina (2007). *Opšta metodika nastave slovenskih jezika u inoslovenskoj sredini.* Beograd: Enti për tekste mësimore.

- *Razvoj visokog obrazovanja u Preševu i Bujanovcu: Studija izvodljivosti o mogućnostima razvoja visokog obrazovanja na jugu Srbije,* Beograd 2010.

- Recommendation on the place of the mother tongue in school education (Recommendation 1740 (2006)) [*Preporuka 1740 (2006)* Kuvendet parlamentare të Këshillit të Evropës rreth vendit të gjuhës amtare në arsimimin shkollorë], Kuvendi parlamentarë i Këshillit të Evropës.

- *Gazeta zyrtare e RS – Gazeta arsimore*, 23. avgust 2003.

- Točanac, Dušanka (1982). *Leksika – kriterijum valjanosti udžbenika stranog jezika,* Gjuhët e gjalla, 3–4, Beograd.

- Točanac-Milivojev, Dušanka (1997). *Metode u nastavi i učenju stranog jezika.* Beograd: Enti për tekste mësimore dhe mjete mësimore.

- Kushtetuta e Republikës së Serbisë, G. Zyrtare e RS*,* nr. 83/2006.

- Vučo, Julijana (1998). *Leksika udžbenika stranog jezika,* Podgorica: Universiteti i Malit të Zi.

- Vučo, Julijana (2009). *Kako se učio jezik. Pogled u istoriju glotodidaktike: od prapočetaka do Drugog svetskog rata.* Beograd: Ministria për arsim dhe mbrojtje të mjedisit jetësorë, Fakulteti filologjik.

- Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale *Gazeta zyrtare e RS*, nr. 72/2009, 20/2014 – vendimi US i 55/2014

- Ligji mbi bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit, *G. Zyrtare e RS,* nr. 55/2013.

- Ligji mbi shkollën fillore, *G. Zyrtare e RS,* nr. 22/2002.

- Ligji mbi arsimimin dhe edukimin fillorë, *G. Zyrtare e RS*, nr. 55/2013.

- Ligji mbi përdorimin zyrtarë të gjuhës dhe shkrimit, *G. Zyrtare e RS*, nr. 30/2010.

- Ligji mbi tekstet mësimore dhe mjetet tjera mësimore, *G. Zyrtare e RS,* nr. 72/2009.

- Ligji mbi arsimimin e lartë, *G. Zyrtare e RS*, nr. 89/2013.

- Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, *G. Zyrtare e RS*, nr. 97/2013.

- Ligji mbi arsimimi e mesëm, *G. Zyrtare e RS*, nr. 55/2013.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka (2004). Disa pyetje të mësimdhënies së gjuhës serbe sikur gjuhë joamtare në udhëkryq të qasjeve dhe metodave raskršću. *Hungarológiai közlemények,* A magyar tanszék folyóirata, Nyelv- és nyelvészetoktatás, 2004. XXXV. évf. 3. sz. Új folyam X. évf. 3. sz., Újvidék, 73–85.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka (2007). Gjuha serbe si gjuhë joamtare – domethënia, shqyrtimi i perspektivës së literaturës së teksteve mësimore. *„Udžbenik i savremena nastava“*, Zbornik povodom 50 godina rada Zavoda za udžbenike. Beograd: Enti për tekste mësimore, 61–67.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka (2010).). Leksikoni i zakonshm në tekstet mësimore të gjuhës serbe si gjuhë joamtare. *Naučni sastanak slavista u Vukove dane* 39/1, 319–330.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka (2011). Karakteristikat gramatikore-leksikore të tekstit dhe niveli i kuptueshmërisë në gjuhë serbe si gjuhë joamtare. *Naučni sastanak slavista u Vukove dane* 40/1, 439–450.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka (2011). Tekstet mësimore për gjuhë serbe si gjuhë joamare në shkollë fillore. *Srpski kao strani jezik u teoriji i praksi (tematski zbornik radova).* Beograd: Fakulteti filologjik, Qendra për gjuhë serbe si gjuhë e huaj, 153–162.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka Nataša Dobrić (2010). *Priručnik za nastavnike srpskog kao nematernjeg jezika uz udžbenike od 5. do 8. razreda osnovne škole sa orijentacionim rasporedom gradiva.* Beograd: Enti për tekste mësimore.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka, Nataša Dobrić (2007). Disa mundësi të zbatimit të sistemeve moderne metodike në mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare. *Savremene tendencije u nastavi jezika i književnosti, Zbornik radova.* Beograd: Fakulteti filologjik, 341–350.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka, Nataša Dobrić (2008a). *Priručnik za nastavu srpskog kao nematernjeg jezika uz udžbenike za 3. i 4. razred osnovne škole.* Beograd: Enti për tekste mësimore.

- Zvekić-Dušanović, Dušanka, Nataša Dobrić (2008b). *Srpski kao nematernji jezik: diferencirani nastavni plan i program od prvog do osmog razreda osnovnog obrazovanja i vaspitanja (predlog).* Novi Sad: Enti pedagogjik i Vojvodinës.

Burimet e pranishme në internet:

- Zyra për zhvillim të qëndrueshëm të zonave të pazhvilluara **www.kornrp.gov.rs**

- Komenti nr. 1 – *Obrazovanje na osnovu Okvirne konvencije za zaštitu nacionalnih manjina,* ACFC/25DOC(2006)002. Komiteti këshillëdhënës për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, Këshilli Evropian: **http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_fcnmdocs/PDF_CommentaryEducation_sr.pdf**

- Enti nacional për punësim **www.nsz.gov.rs**

- Shpjegimet me Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale (1995) **http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/157.htm**

- Pádraig Ó Riagáin and Georges Lüdi, *Bilingual Education: Some Policy Issues,* [„Edukimi dygjuhësorë: disa çështje nga fusha e politikës publike“] Language Policy Division DG IV – Directorate of School, Out-of-School and Higher Education Council of Europe, Strasbourg: **www.coe.int/lang**

DONATORËT

Zyra e Komesarit të lartë
për pakica nacionale e OSBE-së në Hagë

Ambasada e Britanisë së Madhe